



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri:214

Tiranë – E hënë, 11 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 1.12.2017	Për miratimin e Planit të Dytë dhe të Tretë Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë për Shqipërinë, 2017–2020..... 11183

VENDIM

Nr. 709, datë 1.12.2017

**Për MIRATIMIN E PLANIT TË DYTË
DHE TË TRETË KOMBËTAR TË
VEPRIMIT PËR EFIÇENCËN E
ENERGJISË PËR SHQIPËRINË,
2017–2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 124/2015, datë 12.11.2015, “Për eficiency e energjisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Dytë dhe të Tretë Kombëtar të Veprimit për Eficiency e Energjisë për Shqipërinë, 2017–2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

PLANI I DYTË DHE I TRETË KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË PËR SHQIPËRINË,
2017–2020


Politika Kombëtare për Eficiency e Energjisë

Sektori i energjisë konsiderohet nga Qeveria e Shqipërisë si një sektor strategjik për zhvillimin ekonomik të vendit. Për të ofruar një kuadër parimesh operative që mundësojnë planifikimin e politikave qeveritare, në mënyrë të koordinuar, koherente dhe të integruar, Shqipëria ka miratuar një Sistem Planifikimi të Integruar (SPI). Një karakteristikë kryesore e SPI-së është Strategjia e dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI-II), e cila përshkruan objektivat kombëtare të zhvillimit social, demokratik dhe ekonomik për periudhën 2015–2020.

SKZHI-II identifikon furnizimin me energji, në mënyrë të sigurtë dhe me kosto efektive, si një objektiv kryesor të politikave për Shqipërinë. Kjo është përcaktuar në kuadër të qëllimeve më të gjera ekonomike, që përfshijnë një normë rritjeje reale të përkohshme e të synuar të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) prej 4.9%, deri në 2020. Kjo është në kontrast me një normë rritjeje të ngadalësuar, megjithëse pozitive, ndërmjet 2009 dhe 2013, e shkaktuar pjesërisht nga efektet e krizës financiare globale të 2008–2009 që ende vazhdojnë.

Konsumi final i energjisë në Shqipëri u rrit në mënyrë graduale, ndërmjet 2007 dhe 2011, përpara se të tkurrej në 2012, që përkon me një ngadalësim të ekonomisë shqiptare, siç paraqitet në Figura 1. Kjo rënie e konsumit në 2012 ishte veçanërisht e dukshme në nën-sektorin e ndërtimit dhe sektorin e transportit, të cilët janë të ndjeshëm ndaj prodhimit ekonomik. Megjithatë, pavarësisht se rritja e PBB-së mbeti e ulët, prapëseprapë konsumi i energjisë u rrit në mënyrë të shpejtë, në 2013, kryesisht për shkak të rritjes së kërkesës në sektorin e banesave. Më pas, në 2014, konsumi pësoi një rritje të madhe të mëtejshme, kryesisht në sajë të sektorit të hekurit dhe çelikut. Si përmbledhje, gjatë periudhës 2009–2014, konsumi final i energjisë u rrit nga 1,871 ktoc në 2,070 ktoc. Kjo përfaqëson një rritje prej rreth 11%, por norma e rritjes nuk ishte e qëndrueshme gjatë periudhës.

Figura 1 Konsumi final i energjisë gjatë periudhës së shqyrtuar



Burimi: Bilanci Energjetik i Shqipërisë 2009–2014, AKBN; INSTAT

Plani i Parë Kombëtar i Veprimit për Eficiency e Energjisë në Shqipëri u hartua në përputhje me transpozimin e Direktivës së Bashkimit Evropian (BE) 2006/32/KE (Direktiva e



Shërbimeve Energjetike - DSHE) dhe me Vendimin e Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë të vitit 2009. Plani u miratua nga Qeveria e Shqipërisë, në shtator 2011, dhe parashikoi arritjen e kursimeve vjetore të energjisë prej 3% në vitin 2012¹ dhe 9% në vitin 2018, të llogaritura si përqindje e konsumit mesatar final të energjisë për periudhën pesëvjeçare 2004-2008 (përfshirë).

Me VKM Nr.348 dt. 11.05.2016 “ Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020” për sektorin e energjisë, SKZHI 2015-2020 nxjerr në pah objektiva strategjike shitesë, të cilat përfshijnë një numër objektivash që kanë rëndësi për zbatimin e masave për eficiencën e energjisë:

- Uljen e intensitetit të energjisë me mbi 12.5%, deri në 2020, krahasuar me nivelin e 2012;
- Plotësimi i angazhimeve të Shqipërisë në kuadrin e iniciativës 20/20/20, me përmirësimi i eficiencës së energjisë dhe ulja e emetimeve të karbonit (CO₂);
- Menaxhimi i kërkesës për energji përmes rritjes së eficiencës të përdorimit të energjisë, sidomos në sektorin e ndërtesave;
- Uljen e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes deri në 14%, deri në 2018;

Në lidhje me ndryshimet klimatike, Shqipëria ka paraqitur *objektivin e saj kombëtar të pikësnyuar* (INDC), i cili është pjesë e procesit të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), për përcaktimin dhe përmbushjen e objektivave për uljen e emetimeve në nivel ndërkombëtar. Në përputhje me vendimin 1/CP.19 dhe vendimin 1/CP.20 të UNFCCC-së, INDC-të e vendeve përcaktojnë objektivat që lidhen me uljen e emetimeve, mbi bazën e kushteve ekonomike dhe industriale vendase. Shqipëria ka përcaktuar një objektiv të skenarit bazë, i cili synon një nivel kursimesh (ulje të emetimeve të CO₂ me 11.5%, deri në 2030) nën nivelin e trajektorës së parashikuar të skenarit bazë.

Për të përmirësuar performancën e sektorit të energjisë në Shqipëri dhe për të përmbushur objektivat e mësipërme, ka zhvillime të konsiderueshme. Për këtë qëllim, Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme (PKVBER), për periudhën 2015-2020, u miratua nga Këshilli i Ministrave më 20 janar 2016, i cili përcakton planin për arritjen e objektivit të vitit 2020, që 38% e konsumit final të energjisë të jetë nga burimet e energjive të rinovueshme.

Në lidhje me Eficiencën e Energjisë (EE), ligji i referimit për eficiencën e energjisë (ligji nr. 124/2015) u miratua në nëntor 2015, i cili transponon shumë prej kërkesave të Direktivës 2012/27/BE (“Direktiva për Eficiencën e Energjisë”). Në mënyrë të ngjashme ligji nr. 116/2016 Për Performancën Energjetike të Ndërtesave (PEN), i cili transponon Direktivën 2010/31/BE (“Direktiva për Performancën Energjetike të Ndërtesave”) - një fushë me potencial të lartë në Shqipëri, janë referenca të qarta për zhvillimin e eficiencës së energjisë.

Së bashku, këto ligje krijojnë bazën mbi të cilën mund të ngrihet një kuadër rregullator më i plotë, mund të krijohet struktura institucionale dhe mbështetja financiare, si dhe të zbatohen në mënyrë të suksesshme masat e parashikuara në kuadër të kësaj PKVEE-je të re. Në të

¹ Ndërsa objektivi i ndërmjetëm i përcaktuar është 3%, një objektiv më i ulët prej 26 ktoe (rreth 1.4% e sasisë referencë) paraqitet në Tabelën 5 të faqes 14 të PKVEE-së I, me synimin për të reflektuar një qëllim realist në kohën e miratimit.



vërtetë, ligji për eficiencën e energjisë parashikon një detyrim ligjor, i cili mungonte më parë, për Agjencinë për Eficiencën e Energjisë që të hartojë një PKVEE për Shqipërinë.

PKVEE parashikon një plan sesi këto zhvillime do të arrijnë objektivat e Shqipërisë për eficiencën e energjisë dhe përmbushin detyrimet e saj në kuadër të Direktivës 2012/27/BE (“DEE”), e cila u miratua nga Komuniteti i Energjisë, më 16 tetor 2015, duke mbuluar edhe aspektet përkatëse të DPEN-së.

Pikat kryesore të PKVEE-së

Kjo PKVEE e re për Shqipërinë rishikon arritjet e PKVEE-së I, për periudhën 2010-2014, dhe më pas përshkruan një plan për përmbushjen e objektivave të reja që dalin, për periudhën deri në vitin 2020.

Arritjet e PKVEE së parë, 2011-2018

Shqipëria nuk përballoi një sërë sfidash në zbatimin e masave që përmbahen në PKVEE-në I të miratuar nga Qeveria në Shtator 2011. Shumë prej masave kërkuar bashkëpunimin e ministrive dhe entiteteve të tjera jashtë ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë. Megjithatë, mirëkuptimi, koordinimi ndërministror, dhe si rrjedhojë mbështetja me akte ligjore dhe financiare për planin mungoi, duke penguar integrimin e masave në planet sektoriale. Gjithashtu, miratimi i ligjit për eficiencën e energjisë, i kërkuar për plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për krijimin e tregut për shërbimet energjetike, për Agjencinë e dedikuar për EE-në dhe Fondin për EE-në, u vonuan së tepërmi. Për më tepër, disa masa nuk ishin realiste, si për sa i përket afateve kohore të propozuara, ashtu edhe gadishmerisë për të monitoruar dhe implementuar ato.

Pavarësisht vështirësive të mësipërme, pak progres është bërë për EE-në në Shqipëri. Janë zhvilluar një sërë projektsh pilote për rinovimin e ndërtesave publike, është kryer trajnim për audituesit dhe menaxherët e energjisë, dhe me mbështetjen e institucioneve financiare ndërkombëtare (IFN) dhe donatorëve, bankat vendase ofruan linja kreditimi për masat për eficiencën e energjisë, kryesisht për përmirësimin e veshjeve të jashtme të ndërtesës.

Vlerësimi formal i kursimeve të energjisë të arritura nga masat e mësipërme është penguar nga mungesa e një platforme monitorimi dhe verifikimi, sipas të cilës do të llogariteshin kursimet me metodën “Poshtë-Lart” (PL) (*Bottom-Up*), ndërsa ekzistenca dhe cilësia e ulet statistikave kombëtare ka kufizuar dobishmërinë e metodës “Lart-Poshtë” (LP) (*Top-Down*). Prandaj, për të mundësuar raportim të saktë e në kohë, gjatë periudhës së mbuluar nga kjo PKVEE e re, është parë si masë prioritare krijimi i platformes së monitorimit dhe verifikimit të masave.

Prioritetet për kursimin e energjisë për PKVEE e re.

Stoku i ndërtesave të banimit në Shqipëri dhe efica e energjisë 2020.

Kërkesa për energji nga sektori i ndërtesave të banimit përbën një sfidë të madhe për Shqipërinë. Në vitin 2013, ky sektor ishte përgjegjës për 30 për qind të konsumit fundor kombëtar të energjisë dhe për 60 për qind të konsumit kombëtar të energjisë elektrike. Përgjithësisht, banesat shqiptare ngrohen pjesërisht për pak orë në ditë. Përdorimi i vazhdueshëm i sobave të vjetra me dru zjarri sjell probleme të shumta për mjedisin dhe shëndetin.



Jane propozuar dy paketa në shtesë të kuadrit të sotëm të politikave, të cilat kanë si qëllim ta shndërrojnë stokun e ndërtesave të banimit në ndërtesa me nivelin minimal të harxhimit të energjisë dhe çlirimit të karbonit deri në vitin 2050. Është vlerësuar shkalla e përpjekjeve të nevojshme për të arritur këto objektiva të matura për sipërfaqen e dyshemesë (banimit) të marre në konsiderate, si edhe investimet e kërkuara. Është vlerësuar kursimi i energjisë, kostot e kursyera lidhur me energjinë, impakti në shkarkimet e CO₂ që dhe kosto-efektshmërinë e paketave të ndërhyrjeve².

Gjetjet se konsumi përfundimtar i energjisë në vitin 2015 në sektorin e banimit për shërbimet e energjisë termike ishte 4.9 miliardë kWh, nga të cilat 54% përbusheshin nga energjia elektrike, 37% nga lënda drusore dhe 9% nga gazi i lëngët. Sektori shkarkoi 96 mijë tonë CO₂ i bashkëlidhur me konsumin e gazit të lëngët. Energjia përfundimtare e konsumuar e përlllogaritur mbi bazën e veçorive gjeometrike dhe termike të ndërtesave si dhe veçoritë e sistemeve të instaluar energjisë ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga balanca e energjisë. Për këtë shkak, konsumi përfundimtar i energjisë u kalibrua kundrejt balancës duke korrigjuar nivelin e sotëm të komfortit termik, shprehimisht sipërfaqja e pjeshme e dyshemesë e ngrohur dhe e ftohur dhe kohëzgjatja e ngrohjes dhe ftohjes së hapësirës.

Duke ndjekur tendencat e tregut, ne supozojmë një rritje të shpejtë të ngrohjes me energji elektrike të banesave ekzistuese. Për këtë shkak, gjatë periudhës 2015 - 2030 konsumi i energjisë elektrike do të rritet afërsisht me 2.2%/vit, ndërsa konsumi i druve të zjarrit dhe gazit të lëngët do të ulet respektivisht me afërsisht 11%/vit dhe 10%/vit. Në vitin 2030, shkarkimet e CO₂ do të zënë 23% të nivelit të tyre në vitin 2015, ndikuar kryesisht prej ndryshimit në llojit të energjisë, kalimit nga gazi i lëngët tek energjia elektrike. Kërkesa për energji në ndërtesat ekzistuese pritet të zvogëlohet pavarësisht rritjes së komfortit termik për shkak të përmirësimeve që lidhen me periudhën e përdorimit të ndërtesës duke marrë në konsideratë rritimin e rinovimit të ndërtesave të stokut ekzistues me 2.8%/vit.

Eshtë e domosdoshme që kodet energjetike të ndërtimit që do të miratohen brenda 2018 dhe në vitin 2022 duhet të parashikohet një kod energjetik edhe më i rreptë, me kërkesa që përfshijnë jo vetëm nderhyrjet në izolimin termik por edhe vendosjen e sistemit termik me efikasitet të lartë. Me qëllim që tregu të përgatitet, Shqipëria duhet të zbatojë kreditë me interesa të ulta për ndërtimin e ndërtesave të reja në mënyrë të arrijë performancën e kërkuar prej kodit të ndërtesave të vitit 2022.

Për të siguruar kryerjen e rinovimit të ndërtesave të stokut ekzistues, Shqipëria duhet të fusë stimujt financiarë për investitorët e sektorit të ndërtesave të banimit. Deri në vitin 2022, duhet të jepen stimujt financiarë, në mënyrë që të arrihet shkalla e performancës sipas modelit me karbon të ulët.

Stoku i ndërtesave Publike dhe efikasiteti i energjisë 2020.

Një studim i financiar nga ADA (Austrian Development Agency) siguroi informacion për modelimin sektorial të stokut të ndërtesave publike të Shqipërisë me qëllim strategjinë e rinovimit të tyre me Efikasitetin e Energjisë. Një element kyç i arritur në këtë studim është identifikimi i tipologjisë së ndërtesave publike për Shqipërinë, i cili nuk ka ekzistuar më parë. Bazuar në studim janë identifikuar gjashtë kategori në bazë sipas funksionit të ndërtesave Publike që mirëmbahen nga buxheti qendror dhe Lokal: (i) konvikte, (ii) spitale, (iii) kopshte,

² <http://sled.rec.org/building.html>



(iv) zyra, (v) shkolla dhe (vi) universitete. Është vlerësuar kërkesa për energji për çdo kategori.

Është bërë identifikimi dhe kosto e përfitimeve të tjera lidhur me përmirësimin e efikasitetit termik përtej kursimeve të kostove të energjisë. Këto përfitime përfshijnë, përveç të tjerave (i) komfortin termik, (ii) shmangiet e çlirimeve të CO₂, (iii) shmangie e efekteve ekonomike nga ndotësve ajrit, (iv) punësimin, dhe (v) rritjen ekonomike

U vlerësuan 6.6 milionë m² sipërfaqe e target grupit të llojeve kryesore të ndërtesave publike, shifër që nuk pritet të ndryshojë në menyrë të konsiderueshme. Nderkohe që klasifikimi sipas **Tipologjisë tregon se rreth 75% ose $\frac{3}{4}$ e sipërfaqes është e zënë nga ndërtesa që përdoren për qëllime arsimore, 13% Zyrat dhe 11% Spitalet. Analiza tregon se 57% është e vendosur në zonën e klimës A, 26% në zonën klimatike B dhe 17% është në zonën klimatike C.**

Kosto e Rikonstruksionit dhe prioritete

Prioriteti sipas kërkesës për investim klasifikohet fillimisht për Kopshtet, të ndjekur nga Shkollat, Spitalet dhe Zyrat. Investimi më i madh është i nevojshëm në zonën klimaterike A.

Kursimet më të larta të kërkesës për energji primare dhe fundore, si dhe reduktimet e emetimeve të CO₂ për m² janë pa mëdyshje në ndërtesat e zonës klimatike C. Këta tregues janë dy herë më të vegjël për të zonat klimatike A dhe B, dallimi midis tyre nuk është dhe aq i rëndësishëm. Kursimet më të larta të kërkesës për energji primare dhe për m² janë në konvikte, spitale dhe zyra

Zona Klimatike A zë pjesën më të madhe të kursimeve finale të energjisë në vlera absolute për shkak të numrit më të madh të ndërtesave në zonën klimatike A se sa në zonën klimatike C. Për sa i përket potencialit absolut për kursime fillestare dhe përfundimtare, kopshtet janë në radhë të parë, të ndjekur nga shkollat dhe spitale. Në kushtet e kursimeve të mundshme të shkarkimeve CO₂, potenciali më i madh është në spitale dhe kopshte.

Kursimet Mesatare të Energjisë sipas jetëgjatësisë së rikonstruksionit janë 4.4 EUR/m² në vit, ose 76 EUR/m² gjatë gjithë jetëgjatësisë. Ndersa Totali i Kursimeve të kostos së energjisë është 29 milion EUR/vit dhe 502 milionë EUR gjatë jetëgjatësisë. Pothuajse 45% e saj është në zonën klimaterike A për shkak të numrit të madh të ndërtesave. Kursimet më të larta të kostos së energjisë për m² janë të ofruara nga spitale, të ndjekur nga konvikte. Shpenzimet e kursyera të energjisë për m² në zonën klimaterike C janë më shumë se dy herë më të larta se ato në zonën klimaterike A dhe janë 65% më të larta se ato në zonën klimaterike B.

Rikonstruksionet e universiteteve nuk janë financiarisht të realizueshme, nëse vetëm shpenzimet e ruajtjes së energjisë do të merren si përfitime (vetëshlyerje më të lartë se jetëgjatësia, raporti kosto-benefit më i lartë se 1, NPV negative, IRR negative). Gjithashtu, rikonstruksionet e shkollave dhe kopshteve, nuk do të jenë financiarisht tërheqëse (NPV negative, raporti kosto-benefit më i lartë se 1). Konviktet dhe spitale janë financiarisht të realizueshme për rikonstruksione ndërsa zyrat janë në kufi të fizibilitetit.

Vecanërisht të larta janë edhe efektet në GDP dhe punësim. Nëse të gjitha këto përfitime do të merren parasysh në analizën financiare, kosto-efektiviteti i rikonstruksioneve të efikasitetit termal i të gjitha llojeve të ndërtesave publike do të jetë shumë më i lartë.



Skenarët e Rinovimit të ndërtesave publike të parashikuara në PKVEE 2018-2020

Nga modelimi, janë identifikuar 2 skenarë të mundshëm që mund të përfshihen në PKVEE.

Skenari i Parë, fokusohet në tipologjinë e ndërtesave ku rikonstruktionet janë me kosto efektive më të lartë dhe të cilat mund të zgjidhen si prioritet nga pikëpamja sociale, të cilat janë, Spitale dhe Kopshtet për të cilat parashikohet rikonstruktimi i 545,000 m², në zonën klimatike C ku kosto totale e investimit është 40 Mil. EUR në periudhën 2018-2020 dhe përbën rreth 8% të stokut total të ndërtesave publike ose 2% në vit (10 Mil. EUR/Vit)

Të gjitha kopshtet dhe spitalet në zonën e klimës C do të rikonstruktohen duke pasur parasysh nivelin e **moderuar** të performancës të përcaktuar masat për përmirësimin e performances se energjisë.

Skenari i Dytë, parashikon të njëjtën sasi investimi të shpërndarë në të gjitha zonat në mënyrë proporcionale me ndarjen e sipërfaqes së ndërtesave sipas tipit të ndërtesave. Ky skenar sugjeron 530,000 m² sipërfaqe të rikonstruktuar të shpërndarë proporcionalisht në tre zonat ku kosto 40 mil. EUR do të aplikohet në 8 % të sipërfaqes se ndërtimeve ose 2% /vit qe perben 10 mil. EUR në Vit

Aktivitetet e planifikuara për PKVEE-në e re

Miratimi i ligjit për eficiency e energjisë (124/2015) dhe miratimi i ligjit për performancën energjetike të ndërtesave (116/2016), ofrojnë bazën mbi të cilën mund të krijohet një strategji e re për eficiency e energjisë në Shqipëri. Kjo përfshin krijimin e Agjencisë për Eficiency e Energjisë (AEE) dhe Fondit për Eficiency e Energjisë, hartimin e akteve nënligjore e mjeteve rregullatore të nevojshme, dhe më e rëndësishmja zbatimin e një sërë masash të reja, siç propozohet në këtë PKVEE.

Masat e propozuara këtu dhe objektivat për eficiency e energjisë të krijuara prej tyre, përbëjnë deklaratën e qëllimit të Shqipërisë për përmbushjen e detyrimeve të saj, në kuadër të transpozimit të Direktives së EE-së. Ato përfshijnë kursimet në energjinë primare dhe përdorimin fundor dhe për këtë të fundit adresojnë masa për përdorimin e energjisë në ndërtesa, proceset industriale dhe transportin, si dhe respektimin e rëndësisë së rolit model që duhet të luajë sektori publik.

Tabelat paraqesin, përkatësisht, një pasqyrë të të gjitha masave të propozuara për kursimin e energjisë primare dhe finale, së bashku me kursimet e pritshme deri në 2018, si dhe deri në 2020. Kursimet e pritshme të energjisë për një sërë masash nuk janë dhënë ose për shkak se kërkohet punë shtesë, përpara se ato të mund të vlerësohen me një nivel të arsyeshëm besimi (ky është rasti për pjesën më të madhe të masave në energjinë primare), ose ato janë masa mbështetëse që ndihmojnë në kursimin e energjisë, por vetë nuk rezultojnë drejtpërdrejt në kursime (ky është rasti për masat horizontale).

Kërkesa për financime publike ne PKVEE-në e re

Zbatimi i masave të propozuara për EE-në në Shqipëri, do të varet nga atraktiviteti i kostos së atyre masave, në krahasim me koston e energjisë në mungesë të tyre. Konkurrueshmëria e kostos do të varet nga çmimet e tregut, subvencionet, politikat dhe mirëqenien dhe vendimet e konsumatorit. Parashikimet e penetrimit të teknologjive të ndryshme në treg dhe vendimet e konsumatorit janë çështje që po fitojnë terren në modelimin e politikave energjetike dhe qarqet vendimmarrëse në BE, megjithatë ende nuk janë publikuar kërkime të mjaftueshme për të kryer analizë gjithëpërfshirëse. Në të vërtetë, masat specifike në kuadër të kësaj



PKVEE-je mund t'i nënshtrohen veçmas vlerësimeve të plota të ndikimit rregullator për të vlerësuar kostot neto për zbatimin e tyre, si për sektorin publik ashtu edhe atë privat. Kjo do të thotë masat e parashikuara në këtë dokument do kenë plane konkrete zhvillimi dhe plane të ndërhyrjeve të mëtejshme, të cilat, do të japin të dhëna më konkrete mbi zbatimin e masave.

Ky dokument adreson pritshmërinë për reduktimin e energjisë në mënyre realiste, i cili, vjen i mbështetur në 3 prioritete (sektori i ndërtesave, Industrisë dhe Transporti) dhe i jep shembull ekzemplar veprimeve të Qeverisë. Kjo nënkupton se për të arritur objektivin (6.8% deri në 2020) nevojiten masa të financuara drejtpërdrejt nga Buxheti.

Tabelat e mëposhtme paraqesin gjithashtu një vlerësim të kostove direkte nga buxheti publik për masat e propozuara dhe të kostuara, kur vlerësime të tilla janë të mundura. Për më tepër, masat e propozuara përfshijnë aktivitete të cilat kanë përfitime të konsiderueshme më të gjera sesa eficientia e energjisë, veçanërisht në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe furnizimit me ujë, dhe prandaj një krahasim direkt i efektivitetit të kostos ndërmjet masave mund të jetë çorientues.

Tabela 1 Pasqyra e masave në energjinë primare së bashku me vlerësimin e zbatimit të tyre

Nr.	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Kursimet e pritshme të në 2018 [ktoe]	Kursimet e pritshme të në 2020 [ktoe]	Kosto mil. ALL deri 2020	Reduktimet e karbonit në 2018 [tCO ₂]	Reduktimet e karbonit në 2020 [tCO ₂]	Entiteti përgjegjës	Kategoria e masës
E1	Rivitalizimi i hidrocentraleve ekzistuese	6	18.1	30,800			KESH	Prodhimi i energjisë
E2	Zëvendësimi i transformatorëve jo eficientë Instalimi i nënstacioneve dhe linjave të reja.	10.1	19	16,800	658.0	1,280.0	OST OSHEE	Infrastrukturë
E3	Ujja e humbjeve fikse në transformatorë dhe Optimizimi i konfigurimit të rrjetit TM	9	10	-	530.0	650.0	OSHEE	Operimi
KURSIME TE ENERGJISE PRIMARE		25.1	47.1	47,600.0	1,188.0	1,930.0		

Tabela 2/1 Pasqyra e masave rregulatore dhe Informuese në energjinë finale së bashku me vlerësimin e zbatimit të tyre

Nr.	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018 [ktoe]	Kursimet e pritshme të energjisë në 2020 [ktoe]	Kosto mil. ALL deri 2020	Kursimet e pritshme të karbonit në 2018 [tCO ₂]	Kursimet e pritshme të karbonit në 2020 [tCO ₂]	Entiteti përgjegjës	Kategoria e masës
R2	Krijimi dhe funksionimi i Fondit të Eficencës së Energjisë neni 19- 24 të Ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë", (2018-2020).	0.9	4.9	560.0	1,170.0	3,291.0	MIE/MFE	Rregulatore & Infrastrukturë
R3	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në funksion të Performancës së Energjisë në Ndërtesa lidhur me metodologjinë kombëtare e llogaritjes të PEN - kostos optimale për kërkesat minimale të dhe përdorimi i sistemeve alternative me eficientë të lartë për sistemet teknike.	3.61	9.1	28.0	1,487.0	7,167.0	MIE/AEE	Rregulatore



R4	Vleresimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PRIVATE, përcaktimi i kostos optimale për eficientë e energjisë per ndërtesat që parashikohet ti nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat per ndertsa te reja me performance te larte.	1.1	3.5	36.7			MIE/AEE	Rregullatore
R5	Vleresimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PUBLIKE, përcaktimi i kostos optimale për eficientë e energjisë per ndërtesat që parashikohet ti nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat per ndertsa te reja me performance te larte.	0.8	2.83	33.6			MIE/AEE	Rregullatore
R6	Hartimi i skemave mbështetëse financiare për përmirësimin e performancës së energjisë, në veshjen e jashtme të ndërtesave dhe sistemet teknike të ndërtesës.	1.2	4.5	14.0	2,341.0	3,665.0	MIE/AEE & Fondi për EE-në	Rregullatore
R7	Hartimi i një planit të veprimit për të rritur numrin e ndërtesave me performancë afër zero-energji.	0.3	1.2	28.0			MIE/AEE	Rregullatore
R8	Përcaktimi i klases së energjisë për produktet që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë, të cilat përmbushin kërkesat minimale të eficientës së energjisë,	0.61	3.1	14.0			MIE/AEE	Rregullatore
R9	Certifikimi energjetik i ndërtesave	0.34	4.2	-	-	-	MIE/AEE	Informimi i detyrueshëm
P2	Miratimi i rregullave për Prokurimet publike 'të gjelbra' me fokus ndërtesat publike	5.07	12.1	28.0	-	-	MIE, MMT	Rregullatore

I1	Kërkesat minimale të eficientës së energjisë për proceset industriale dhe skemat detyruese.	2.25	3.7	36.7	-	-	MIE/AEE	Rregullatore
I3	Marrëveshjet vullnetare për ndërmarjet industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, në përputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë".	0.25	0.9	9.8	3,148.0	6,009.0	MIE/AEE	Rregullatore
H1	Faturimi informativ, Fushatat e ndërgjegjësimit, Edukimi dhe trajnimi për eficientë e energjisë.	0.5	1.4	42.0	-	-	MIE/AEE	Informimi
H2	Promovimi i Kontraktimit të Performancës Energjetike dhe Shërbimeve Energetike	0.3	1.2	14.0	-	-	MIE/AEE	Informimi
H3	Udhe-treguesi per Auditimet dhe menaxhimin e energjisë për konsumatorët e mëdhenj të energjisë	0.1	1.1	33.6	-	-	MIE/AEE	Informimi
H4	Krijimi i një sistemi të integruar informacioni për monitorimin, verifikimin dhe zbatimin e politikave për eficientë e energjisë	0.5	1.1	140.0	-	-	MIE/AEE	Monitorimi
	KURSIME TE ENERGJISE FINALE	17.83	54.83	1,018.4	8,146.0	20,132.0		



Tabela 2/2 Pasqyra e masave zbatuese në energjinë finale së bashku me vlerësimin e zbatimit të tyre

Nr.	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018 [ktoe]	Kursimet e pritshme të energjisë në 2020 [ktoe]	Kosto mil. ALL per 2018	Kosto mil. ALL per 2020	Kursimet e pritshme të karbonit në 2018 [tCO2]	Kursimet e pritshme të karbonit në 2020 [tCO2]	Entiteti përgjegjës	Kategoria e masës
R10	Rinovim i stokut të ndërtesave publike me 2% cdo vit të sipërfaqes së ngrohur/ ftohur për ndërtesat që janë në administrim ose përdorim nga një autoritet publik ose nga institucionet që sigurojnë një shërbim ndaj publikut, me qëllimin për përmbushjen e kërkesave minimale të performancës së energjisë.	1.8	4.1	2,100.0	5,600.0	2,000.0	4,913.0	MEI AEE/Fondi për EE/ /Pushteti Vendor	Infrastrukturë
P1	Programi 'Ndriçimi Publik me Eficiencë të Energjisë'	1.2	3.9	191.8	334.0	-	-	MIE/AEE/Fondi për EE-në	Instrument financiar
I2	Auditimet energjetike për ndërmjetet industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, të cilët, sipas skemes detyruese, nënshkruajnë marrëveshje vullnetare ne perputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë".	1.2	2.3	79.8	152.9	-	-	MIE/AEE/Fondi për EE-në	Instrument financiar
T1	Trajnim për drejtimin e automjetit në mënyrë eficiente (eco-driving)	3.7	11.8		3.5	293.0	732.0	MIE/AEE	Informimi
T2	Fushatat e informimit dhe edukimit	1.2	3		56.0	3,683.0	9,208.0	MIE/AEE	Informimi
T3	Promovimi i transportit të integruar	3.1	7.4		1,288.0	15,540.0	22,865.0	Pushteti Vendor & MIE/AEE	Informimi

T4	Etiketimi energjetik i automjeteve të reja	-	3.497		-	-	10,827.0	MIE & MM (AEE)	Rregullatore/ Informimi
T6	Stimujt financiarë për automjetet me eficiencë të energjisë	2.2	3.4		1,400.0	4,211.0	10,527.0	MIE/Fondi për EE-në/Pushteti Vendor	Instrument financiar
T7	Transporti intermodal i udhëtarëve dhe i mallrave	-	5.3		-	-	16,360.0	MTI	Infrastrukturë
T8	Modernizimi i sistemit të semaforëve dhe futja e menaxhimit të automatizuar të trafikut	4	15.1		798.0	24,749.0	92,655.0	Pushteti Vendor & MIE (e mbështetur nga Fondi për EE-në)	Infrastrukturë
H5	Raportet e auditimit dhe Ndërhyrjet për përdorim me eficiencë të energjisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.	2.3	9.1		3,920.0	-	-	MIE (e mbështetur AEE/Fondi për EE-në)	Infrastrukturë
	KURSIME TE ENERGJISE FINALE	20.70	68.90	2,371.60	13,552.40	50,476.00	168,087.00		



Struktura institucionale dhe qeverisja

Siç u shpreh më lart, strukturat institucionale kanë nevojë që të zhvillohen dhe sqarohen në mënyrë që masat e parashikuara në këtë PKVEE të zbatohen lehtësisht. Në veçanti, ligji për eficiencën e energjisë parashikon krijimin e Agjencisë për Eficiencën e Energjisë, në varësi të MIE-s. Ligji për eficiencën e energjisë kërkon gjithashtu që Agjencia të hartojë aktet nënligjore që duhen miratuar nga ministri, siç parashikohet në ligj, standarde dhe rregullore të tjera teknike për eficiencën e energjisë, të promovojë dhe përhapë informacionin rreth programeve për eficiencën e energjisë, të koordinojë programe trajnimi, të administrojë gjobat dhe verifikojë auditimet. Detaje të mëtejshme mbi detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë jepen në Seksionin 6.

Ndërsa Agjencia për Eficiencën e Energjisë do të ketë një rëndësi jetike në lehtësimin e zbatimit dhe monitorimit të veprimeve, si një entitet në varësi të MEI-t, ajo nuk do të jetë në gjendje që të sigurojë bashkëpunim ndërministror dhe delegim të përgjegjësiave. Prandaj, për të ofruar një rrugë komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet ministrive, mbi dorëzimin e planit, propozohet një Grup Ndërmistror Punë (GNP). Një GNP që përfshin ministrinë dhe agjencitë kryesore, me MIE-n si entiteti drejtues, është krijuar tashmë gjatë hartimit të PKVEE-së dhe në këtë mënyrë pritet që të vazhdojë në një formë të ngjashme gjatë zbatimit të tij, duke u takuar të paktën 4 herë në vit.

Rishikimi i objektivave për kursimin e energjisë dhe arritjet

Siç vihet në dukje më sipër në Seksionin 0, vlerësimi i kursimeve të arritura gjatë periudhës 2010-2014 (përfshirë), në lidhje me zbatimin e PKVEE-së I, është sfidues për shkak të kufizimeve në ekzistencën e të dhënave, qëllimin dhe cilësinë e tyre. Megjithatë, aty ku ekzistonin të dhënat e mjaftueshme për kryerjen e vlerësimit, u zhvillua analiza PL për masat. Kjo analizë arriti në përfundimin që kursimet kumulative të energjisë të arritura deri në fund të 2015 u vlerësuan në 16.4 ktoe, që është baras me rreth 0.9% të konsumit referues të DSHE-së. Kjo u krahasua me një objektiv (të ekstrapoluar) prej 5.2% dhe ndërsa analiza nuk mund të përfshinte të gjitha veprimet e zbatuara deri tani, hendeku është qartësisht i konsiderueshëm dhe për të përshpejtuar veprimin për masat e propozuara në këtë dokument, për periudhën deri në 2020, nënvizon rëndësinë e krijimit, në mënyrë të suksesshme, të mjedisit të përshtatshëm (institucional, rregullator dhe financiar). Pjesa më e madhe e kursimeve të energjisë në periudhën e deritanishme kishin lidhje me përmirësimet e veshjes së jashtme të ndërtesave dhe kolektorët diellorë për ngrohjen e ujit në sektorët e banesave dhe shërbimeve, duke theksuar potencialin e madh të ndërtesave në Shqipëri për kursime të energjisë.

Shqipëria ruan një objektiv të kursimeve kumulative të energjisë, deri në fund të 2018, të barasvlerëshëm me 9% të konsumit referues të DSHE-së (që është baras me 168 ktoe, përta përkatet konsumit final të energjisë, ose 10 herë më shumë se kursimet kumulative që vlerësohet të jenë arritur deri në fund të 2015). Megjithatë, për shkak të kalimit të kohës dhe faktit që rregulloret mbështetëse, financimi dhe modelimi i skemës ende duhet të hartohen dhe zbatohen, ky objektiv nuk është realisht i arritshëm. Kështu që, për të përshpejtuar veprimet për eficiencën e energjisë, propozohet që të zbatohen masa të mjaftueshme në mënyrë që, deri në 2020, kursimet kumulative të energjisë të arrijnë sa më afër këtij niveli që të jetë e mundur.

Prandaj, objektivat që dalin për 2018 dhe 2020, mbi bazën e masave të përfshira në këtë PKVEE, paraqiten në Tabelën 3 dhe Tabelën 4 të mëposhtme. Tabela e parë ndalet në mënyrë specifike tek kursimet finale të energjisë (të paraqitura edhe në formë grafike në Figura 2), të ndara sipas sektorëve, ndërsa tabela e dytë paraqet kursimet e energjisë primare dhe asaj finale.

Tabela 3 Objektivat kombëtarë orientues të kursimeve finale të energjisë sipas sektorëve

Ndarja e objektivit në sektorë	Kursimet e vlerësuara të energjisë në 2018 (ktoe)	Kursimet e vlerësuara të energjisë në 2020 (ktoe)
	Nga masat (PL)	Nga masat (PL)
Banesa	10.66	37.43
Shërbime	6.27	16
Industri	3.7	6.9
Transport	14.2	49.49
Horizontale	3.7	13.9
Totali (njësi ekuivalente):	38.5	123.7
Totali (GWh):	447.8	1,438.6
<i>Përqindja (%) krahasuar me skenarin bazë</i>	2.1% (krahasuar me skenarin bazë 2018)	6.8% (krahasuar me skenarin bazë 2020)

Figura 2 Objektiva kombëtare orientuese e kursimeve finale të energjisë sipas sektorëve






Tabela 4 Pasqyra e objektivave dhe e kursimeve të arritura/të parashikuara të energjisë, si për energjinë primare, ashtu dhe atë finale

	Energjia primare		Energjia finale		
	Objektivi (ktoe)	Kursimet e arritura/parashikuara të energjisë (ktoe)	DSHE	DPEN	
			Objektivi i kursimeve finale të energjisë, siç përcaktohet në PKVEE-në e parë/të dytë ose në versionin më të fundit nëse është rishikuar (në terma absolute (ktoe))	Kursimet finale të energjisë të arritura (për 2015) ose të parashikuara (për 2018) (në terma absolute (ktoe))	Objektivi për shtëpitë me konsum energjie pothuajse zero (Të gjitha ndërtesat e reja, përqindja (%) ose shtrëngimi i kërkesave për performancën energjetike)
2012	N/A	N/A	26	10.5	
2015	N/A	N/A	97*	16.4	#
2018	40	-	39	-	
2020	154	-	124	-	Për t'u konfirmuar

* Për shkak se PKVEE-ja e dytë nuk është hartuar për Shqipërinë, objektivi për 2015 është marrë ai i përfshirë në PKVEE e parë, ndërsa objektivat për 2018 dhe 2020 janë ato që dalin në kuadër të këtij dokumenti.

Megjithatë, theksohet që objektivat sasiore të mësipërme për kursimet e energjisë përfaqësojnë vetëm një element të objektivave të kësaj PKVEE-je. Më gjerësisht shihen si:

- Një mjet për të stimuluar dhe zhvilluar tregjet për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve me eficiencë të energjisë, duke përfutur kështu ekonomia e Shqipërisë.
- Përmirësim i standardeve të jetesës për qytetarët e Shqipërisë, përmes rritjes së komfortit dhe uljes së emetimeve.
- Kontribut ndaj arritjes së qëllimeve të Shqipërisë për ndryshimet klimatike.
- Ndihmë në modernizimin e transportit, industrisë dhe shërbimeve.

Tirane me 2.9.2017



Shkurtime dhe akronime

BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BNRZH	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
DEE	Direktiva për Eficiencën e Energjisë
DPEN	Direktiva për Performancën Energjetike të Ndërtesave
DSHE	Direktiva e Shërbimeve Energjetike
ECA	Economic Consulting Associates
EE	Eficienca e Energjisë
ENTSO-e	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike
EPC	Kontraktimi i Performancës Energjetike
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
ESCO	Kompani për Shërbime Energjetike
GLN	Gaz i lëngëzuar i naftës
GPN	Grup Pune Ndërministror
GWh	Gigavat-orë
HEC	Hidrocentral
IFN	Institucion Financiar Ndërkombëtar
INDC	Kontributi Kombëtar i Pikësnuar
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
Ktoe	Kilo-tonë naftë ekuivalente
LED	Dioda që emetojnë dritë
LP	Lart-Poshtë (<i>Top-Down</i>)
M&V(&V)	Monitorimi, Verifikimi (dhe Vlerësimi)
MAED	Modeli për Analizën e Kërkesës për Energji
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MFH	Shtëpi me shumë familje
MKLL	Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes
NACE	Klasifikimi statistikor i aktiviteteve ekonomike në Komunitetin Evropian
NKEZ	Ndërtesa me Konsum Energjie Pothuajse Zero
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë
PL	Poshtë-Lart (<i>Bottom-Up</i>)
SFH	Shtëpi me një familje
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SWH	Kolektorët diellorë për ngrohjen e ujit
T (L/M/U)	Tensioni (I lartë/I mesëm/I ulët)
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike



Përmbajtja

1 Hyrje

PKVEE-ja I u hartua në përputhje me transpozimin e Direktivës së BE-së 2006/32/KE (DSHE) me Vendimin e Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë të vitit 2009. Plani u miratua nga Qeveria e Shqipërisë, në shtator 2011, dhe parashikoi arritjen e kursimeve kumulative vjetore të energjisë prej 3% në vitin 2012 dhe 9% në vitin 2018, të llogaritura si përqindje e konsumit mesatar final të energjisë, për periudhën pesëvjeçare 2004-2008 (përfshirë).

DSHE-ja u shfuqizua, për Shtetet Anëtare të BE-së, me Direktivën 2012/27/BE (DEE), e cila u miratua nga Komuniteti i Energjisë më 16 tetor 2015. DEE-ja i ka bërë një sërë ndryshimesh dhe shtesash DSHE-së, përfshirë zëvendësimin e objektivit të vetëm të konsumit final të energjisë lart-poshtë për vitin 2018 me një objektiv orientues për vitin 2020, i shprehur në termat e treguesve primarë, si dhe finalë të energjisë. DEE-ja kërkon hartimin e PKVEE-ve të përditësuara, në përputhje me kërkesat e reja dhe më të gjera të Direktivës.

Ky dokument synon të ofrojë një vështrim gjithëpërfshirës mbi statusin e zbatimit dhe planet e ardhshme të politikave për eficiencën e energjisë në Shqipëri, si dhe përputhshmërinë e tyre me angazhimet e vendit në kuadrin e Komunitetit të Energjisë. Prandaj, ai hedh drite mbi strategjinë e Shqipërisë për të transpozuar si kërkesat e Direktivës për Eficiencën e Energjisë (DEE), ashtu edhe të Direktivës për Performancën Energjetike të Ndërtesave (PEN), duke përfshirë masat për EE-në që ndikojnë në furnizimin me energji primare, transformimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë, si dhe në konsumin final të energjisë.

Ky dokument është strukturuar sipas modelit për “Planin e Tretë Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë”, të ofruar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në tetor 2015. Për shkak të mungesës së një PKVEE-je të II-të për Shqipërinë, ky dokument është në përputhje me PKVEE-në e III-të, por përfshin progresin që nga hartimi i PKVEE-së I. Seksionet janë si më poshtë:

- Seksioni 2** detajon objektivat dhe strategjitë për kursimet e energjisë primare, së bashku me masat e propozuara që synojnë furnizimin, transformimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë.
- Seksioni 3** detajon objektivat, strategjitë dhe masat që synojnë uljen e konsumit final të energjisë. Këto masa nën-ndahen në:
 - Masa në sektorin e ndërtesave
 - Masa në sektorin publik
 - Masa në industri (përfshirë bujqësinë)
 - Masa në transport



- Masa horizontale
- Përveç një deklarate të qëllimit të politikave, nëpërmjet detajimit të masave të ndryshme të propozuara dhe objektivave të përgjithshme, seksioni ofron gjithashtu një rishikim cilësor të progresit në secilin prej segmenteve të mëdha të tregut për EE-në.
- **Seksioni 4** ndalet në mënyrë specifike në transpozimin e kërkesave kryesore të DEE-së, duke trajtuar statusin e zbatimit, pengesat kryesore, legjislacionin mbështetës, aktivitetet e planifikuara dhe institucionet përgjegjëse. Kur ky informacion është dhënë më parë në Seksionin 3, jepet referenca përkatëse.
- **Seksioni 5** detajon kuadrin institucional dhe iniciativat e planifikuara të financimit.

DEE-ja është një Direktivë e objektivave dhe bazohet në veprim, është ndër-sektoriale në mbulimin e saj, duke adresuar të gjithë sektorët e përdoruesve fundorë, si edhe aspektet e furnizimit me energji. DPEN-ja është Direktivë që bazohet në veprim dhe adreson segmente të veçanta të tregut, si dhe mbështet ose shton veprimet dhe objektivat e DEE-së. Në këtë kuptim, në hierarki ajo është në varësi të DEE-së dhe në këtë mënyrë kërkesat përkatëse janë reflektuar në fushat e nëngrupeve të ndryshme të eficiencës së energjisë, të detajuara në Seksionin 3.

Përshkrimet e masave specifike në këtë PKVEE paraqiten në formë tabelore në Seksionin 2.3, për ato që adresojnë kursimet në furnizimin me energji primare, dhe Seksionin 3.3 për ato që adresojnë kursimet e konsumit final të energjisë. Pjesa e mbetur e Seksionit 3, së bashku me Seksionin 4, trajtojnë më tej sesi këto masa individuale së bashku adresojnë kërkesat e ndryshme sipas DEE-së dhe DPEN-së.


2 Objektivat dhe masat për kursimet e energjisë primare

2.1 Objektivat e energjisë primare, parashikimet e konsumit të energjisë primare

Prodhimi total i energjisë primare në Shqipëri, në 2013, ishte 2,041 ktoe dhe konsumi i brendshëm bruto ishte 2,346 ktoe, ndërsa importet neto ishin 894 ktoe. Në krahasim me 2009, kjo është një rritje e konsumit të brendshëm bruto prej 12% dhe një rritje e prodhimit primar prej 62%, ndërsa importet neto u ulën me 37%.

Struktura e konsumit të brendshëm bruto paraqitet në Figura 3. Përqindja e lartë e “naftës bruto, gazit të lëngëzuar të naftës dhe nënprodukteve të naftës gjysmë të përpunuara” vjen për shkak të konsumit të lëndës djegëse nga motorët në sektorin e transportit, i cili ishte 802 ktoe dhe konsumohet kryesisht në transportin rrugor.

Figura 3 Struktura e konsumit të brendshëm bruto të Shqipërisë



Burimi: Bilanci Energjetik i Shqipërisë 2014 (AKBN)

Energjia elektrike përdoret kryesisht në banesa, tregti dhe në sektorin publik dhe në 2013 konsumi bruto ishte 459 ktoe. Pjesa e mbetur e konsumit të energjisë elektrike vinte nga sektori i industrisë.

Për të llogaritur humbjet e ndodhura në transformimet e energjisë, si dhe transmetimin e shpërndarjen e saj, d.m.th. të llogaritet energjia primare (furnizimi) që kërkohet për të plotësuar konsumin specifik final të energjisë (kërkesa), nga të dhënat e bilancit energjetik u nxorën faktorët e konvertimit. Keta faktorë janë përdorur për të llogaritur lidhjen ndërmjet konsumit të brendshëm bruto dhe konsumit final të energjisë. Ia vlen të theksohet se asnjë nga format e energjisë, përveç energjisë elektrike, nuk ka konstatuar humbje në shpërndarje

Sipas nenit 2 të DEE-së, 'konsumi i energjisë primare' përkufizohet si konsumi i brendshëm bruto i burimeve të energjisë, duke përfshirë burimet që përdoren për qëllime jo energjetike.

Faktorët e nxjerrë të konvertimit, të përdorur në pjesën e mbetur të studimit, jepen në Tabelën 5. Supozohet që faktorët e konvertimit do të mbeten të njëjtë për të gjithë periudhën e studimit.

Tabela 5 Faktorët e konvertimit nga energjia finale tek ajo primare

Lëndë djegëse të ngurta	1.00
Nafta bruto, GLN-ja, nënproduktet e naftës	1.01
Biomasa	1.00



Energjia elektrike	1.35
Nxehtësia e përfituar	1.46

Burimi: Bilanci Energjetik i Shqipërisë 2014 (AKBN) dhe llogaritjet e EIHP-së

2.2 Lista e strategjive që adresojnë kursimet e energjisë primare

Për të ofruar një kuadër parimesh operative që mundësojnë planifikimin e politikave qeveritare, në mënyrë të koordinuar, koherente dhe të integruar, Shqipëria ka miratuar një Sistem Planifikimi të Integruar (SPI). Një karakteristikë kryesore e SPI-së është Strategjia e dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI-II), e cila përshkruan objektivat kombëtare të zhvillimit social, demokratik dhe ekonomik për periudhën 2015-2020.

SKZHI-II ofron një sërë treguesish dhe objektivash që synojnë furnizimin me energji, transformimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë në Shqipëri. Në lidhje me sektorin e energjisë elektrike, këto përfshijnë rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet, uljen e humbjeve në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, diversifikimin e burimeve të prodhimit dhe fuqizimin e interkonjeksionit me vendet fqinje.

Objektivat e mëtejshme për të përmirësuar eficiencën, përjashtuar energjinë elektrike, përfshijnë modernizimin e kapacitetit përpunues të naftës bruto, duke integruar sektorin e gazit në Shqipëri në nismat evropiane dhe rajonale të lidhjes së gazit dhe duke zhvilluar Master Planin për gazifikimin e Shqipërisë (përfshirë ndërtimin e infrastrukturës për të furnizuar konsumatorët e mëdhenj të energjisë), megjithëse rezultatet e këtyre nismave pritet të kenë ndikim më të gjerë në periudhën pas 2020.

Në mbështetje të SKZHI-II, Qeveria e Shqipërisë po përgatit një sërë strategjish sektoriale. Këto përfshijnë Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2017-2030, e cila do të ofrojë një deklaratë të politikave për sektorin e energjisë dhe është aktualisht duke u përgatitur.

Zhvillimi i hidrocentraleve të vegjël, i burimeve të erës, i energjisë diellore dhe i biomasës janë edhe objektiva të politikave për Shqipërinë, me PKVBER-në e miratuar së fundmi, që synon një përqindje të barasvlershme me 38% të konsumit final të energjisë deri në vitin 2020.

Si Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), edhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) kanë planifikuar dhe vazhdojnë të ndërmarrin investime për përmirësimin e rrjetit me synimin për të ulur humbjet në sistemin e energjisë elektrike. Këto nisma po mbështeten nga fondi i Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH), prej 150 milionë USD (rreth 135 milionë €), i cili synon përmirësimin e besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë financiare të sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri. Qëllimi i deklaruar i OSHEE-së është ulja e humbjeve të energjisë elektrike nga 31.8% në 2015, në 19.8% në 2018, siç paraqitet në Figura . Ndërkohë që vetëm humbjet teknike deklarohen nga OSHEE të jenë 21.04% në 2015 dhe parashikohet të ulen në 16.8% në 2018. Si pjesë e kësaj iniciative, OSHEE-ja ka kryer studimin/vlerësimin për instalimin e pajisjeve



inteligjente të matjes dhe infrastrukturës shoqëruese të komunikimeve dhe kontrollit të avancuar që synon përmirësimin e dhënies së informacionit mbi humbjet, kryerjen e leximeve automatike dhe uljen e të ardhurave të pambledhshme, vjedhjes së energjisë elektrike dhe matjes së gabuar.

2.2.1 Humbjet teknike te OSHEE dhe parashikimet për periudhën 2016 – 2018

Niveli i humbjeve teknike për vitin 2015, sipas studimit të Divizionit të Shitjes në OSHEE, është shumë i lartë, 20.6%. Edhe për vitin 2017 niveli i humbjeve teknike pritet të jetë i njëjtë pasi efekti i investimeve të reja që do të futen në punë do të japin efektin e tyre të plotë në vitin 2018:

Nga analiza e llogaritjes së humbjeve teknike të kompanisë OSHEE.sh për vitin 2015 duket se humbjet më të mëdha janë në Tiranë (509 GWh) të ndjekura nga Fieri (123 GWh), Shkodra dhe Durresi. Humbjet më të ulta janë në Korçë dhe Elbasan ku në nivel prefekturë arrijnë përkatësisht në 43 dhe 52 GWh, por krahasuar me energjinë e konsumuar janë 16 dhe 15%. Analiza e mëtejshme del në këto përfundime:

- Del e domosdoshme vazhdimi i zëvendësimit të rrjetit 6/10 kV me rrjetin me tension 20 kV;
- Zëvendësimi i rrjeteve TU me përcjellësa ajror të zhveshur me përcjellësa ajror të izoluar me vetëmbajtje ABC;
- Ndërtimi i nënstacioneve elektrike 110/20 kV

Parashikimet tregojnë se humbjet teknike në shpërndarje do të jenë:

Tabela 4. Humbjet teknike në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE)

Kategorite e Tensionit	Humbjet%	2016 - energjia sipas tensionit MWh	Ne %	Humbjet sipas tensionit	Humbjet %
35kV	6.74%	22,947	0.49%	1,547	0.28%
20kV	2.51%	319,090	6.77%	8,009	1.43%
10-6 kV	9.53%	540,154	11.46%	51,477	9.20%
0.4 kV	13.00%	3,833,135	81.29%	498,308	89.09%
Total	20.60%	4,715,325		559,340	100.00%


Tabela 5. OSHEE - Tregues të Bilancit 2015 dhe parashikime të humbjeve 2017-2018

	2015	2016	2017	2018
Energji Totale në rrjetin e OSHEE Sh.a (MWh)	6,490,058	6,376,428	5,864,027	4,986,438
Humbjet totale në OSHEE Sh.a (MWh)	2,033,984	1,657,871	1,331,134	987,315
Humbjet totale në OSHEE Sh.a (%)	31.34%	26.00%	22.70%	19.80%
Humbjet në OSHEE Sh.a (MWh)	2,192,939	1,814,042	1,474,756	1,109,442



Humbjet në OSHEE Sh.a (%)	28.89%	23.55%	20.25%	17.35%
Humbjet teknike në Njësitë e TL (MWh)	158,954	156,171	143,622	122,128
Humbjet teknike në Njësitë e TL (%)	2.45%	2.45%	2.45%	2.45%
Energji për Zonat e OSHEE Sh.a (MWh)	6,490,058	6,376,428	5,864,027	4,986,437
Humbjet në Zonat e OSHEE Sh.a	2,033,984	1,657,871	1,331,134	987,315
Humbjet në zonat e OSHEE Sh.a (%)	28.89%	23.55%	20.25%	17.35%
Humbjet Teknike (MWh)	1,365,508	1,153,496	1,037,933	837,722
Humbjet Teknike (%)	21.04%	18.09%	17.70%	16.80%

Figura 6 Objektivat e deklaruar të OSHEE-së për uljen e humbjeve të energjisë në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipëri



Treguesit që duhen monitoruar për objektivat e tjera energjetike që lidhen me furnizimin me energji primare janë:

- **Plane afat shkurtër:** Brenda vitit 2017 të gjithë konsumatorët industrialë me fuqi mbi 200kVA do të pajisen me matje në TM të shoqëruar me bateri kondensatore nga ana TU. Kjo do të thotë se brenda 2017 këta konsumatorë me transformatorë të vit prodhimit përpara vitit 1993 do të zëvendësohen me transformatorë të rinj të cilat plotësojnë kushtet e efikasitetit të energjisë.
- **Plane afat mesme:** Brënda një periudhe 2 vjetecare në të gjithë qytetet e mëdha si (Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë dhe Shkodër) të gjitha kabinat elektrike transformuese TM/ TU 400kVA e lartë në pronësi të OSHEE apo të subjekteve të tretë dhe rregjim ngarkimi mbi 80% të jenë të pajisur me bateri kondensatorë nga ana TU. Në fazën e parë brenda 2 vjetësh të gjithë konsumatorët industrial me transformatorë vit prodhimi nga viti 1993-2000 do të zëvendësohen me të rinj. Në fazën e dytë, brënda 3 vjetësh të gjithë konsumatorët industrial me vit prodhimi 2000-2007 dhe të OSHEE me transformatorë vit prodhimi nga viti



1993-2000 do të procedohet me zëvendësim dhe plotësim të kriterëve të reduktimit të humbjeve teknike.

- **Planet afat gjata.** Brënda një periudhe 3-4 vjecare të gjitha kabinat elektrike transformuese TM/TU 400kVA e larte në pronësi të OSHEE apo të subjekteve të tretë dhe rregjim ngarkimi mbi 80% të jenë të pajisur me bateri kondensatorë nga ana TU. Po kështu brenda 4 vjetësh të gjithë kabinat në pronësi të OSHEE me transformatorë vit prodhimi nga vitit 2000-2007 të procedohet me zëvendësim dhe plotësim të kriterëve të reduktimit të humbjeve teknike

Për arritjen e objektivave të përcaktuara në SKZHI-II, MIE është përcaktuar si entiteti përgjegjës kryesor, me ndihmën e Entit Rregullator të Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

2.3 Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme

Shqipëria miratoi Planin e saj Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme (PKVBER), i cili përcakton objektivin që, deri në 2020, 38% e konsumit final të energjisë të jetë nga burimet e energjive të rinovueshme dhe përcakton masat e synuara për përmbushjen e tij. Për të siguruar përputhshmërinë ndërmjet dokumenteve, në këtë PKVEE është përdorur trajektorja e konsumit final të energjisë, e identifikuar në PKVBER-në.

2.4 Masat për kursimet e energjisë primare

2.4.1 Masat për kursimin e energjisë në anën e furnizimit

Masat për kursimin e energjisë në anën e furnizimit u përzgjedhën mbi bazën e raporteve vjetore të Entit Rregullator të Energjisë, informacionit të dhënë drejtpërdrejt nga OST-ja dhe OSHEE-ja lidhur me përmirësimet e eficiencës së energjisë në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes dhe sektorin e prodhimit të energjisë elektrike.



Tabela 6 Lista përmbledhëse e masave në anën e furnizimit

Indeksi	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Përdoruesi fundor i synuar	Kursimet e pritshme të energjisë në 2020 (ktoe)	Financimi total i kërkuar (para publike), Milion ALL
E1	Rivitalizimi i hidrocentraleve ekzistuese	HEC-et ekzistuese	18.06	30'800
E2	Zëvendësimi i transformatorëve jo eficientë Instalimi i nënstacioneve dhe linjave të reja.	OST dhe OSHEE	19	16'800
E3	Ulja e humbjeve fikse në transformatorë dhe Optimizimi i konfigurimit të rrjetit TM	OSHEE	10	-

Tabelat e mëposhtme përmbledhin masat për kursimin e energjisë që synojnë furnizimin me energji.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Rivitalizimi i hidrocentraleve ekzistuese
Indeksi i masës		E1
Përshkrimi	Kategoria	Prodhimi i energjisë elektrike
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masë e re
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Rivitalizimi i HEC-eve ekzistuese përfshin zëvendësimin e pajisjeve primare dhe sekondare me synimin për të rritur fuqinë e instaluar, gatishmërinë operative dhe disponueshmërinë e hidrocentraleve. Kjo masë që kërkon shumë kapitale do të rrisë prodhimin e ardhshëm të HEC-eve dhe përmirësojë parametrat e tyre operativë, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve ndihmëse për OST-në që mund të sjellin gjithashtu uljen e humbjeve në rrjet.
	Përdoruesi fundor i synuar	HEC-et ekzistuese
	Grupi i synuar	KESH



	Aplikimi rajonal	/
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<p>Aktivitetet e ardhshme:</p> <p>Rivitalizimi i HEC-it të Komanit</p> <p>Kryerja e masës së propozuar kërkon vlerësimin e kushteve aktuale të pajisjeve ekzistuese, primare dhe sekondare, në HEC-in e Komanit dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve të nevojshme për rivitalizimin në faza: projektimi i rikonstruksionit të hidrocentralit dhe kryerja e rinovimit dhe riparimi i pajisjeve ekzistuese, me zëvendësimin e pajisjeve primare dhe sekondare, kur është e nevojshme, (zëvendësimi i mundshëm i rotorit të gjeneratorit shoqëruar me zëvendësimin dhe riparimin e pajisjeve ekzistuese të kontrollit, matjes, mbrojtjes dhe sinjalizimit).</p> <p>Rivitalizimi i HEC-it të Vaut të Dejës</p> <p>Kryerja e masës së propozuar kërkon të njëjtin grup veprimesh për HEC-in e Vaut të Dejës, siç përshkruhet më lart për HEC-in e Komanit.</p>
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Rivitalizimi i HEC-it të Komanit</p> <p>KESH/Fonde të tjera (BERZH, WB, KFW, GIZ, etj): përafërsisht deri në 21'000 Milion ALL, deri në 2020 (në rastin e zëvendësimit të rotorit të gjeneratorit).</p> <p>Rivitalizimi i HEC-it të Vaut të Dejës</p> <p>KESH/(BERZH, WB, KFW, GIZ, etj): përafërsisht deri në 9'800 Milion ALL, deri në 2020 (në rastin e zëvendësimit të rotorit të gjeneratorit).</p>
	Organi zbatues	KESH
	Autoriteti monitorues	KESH dhe MEI
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	<p>Krahasimi i energjisë elektrike të prodhuar në rrethana të krahasueshme hidrologjike, përpara dhe pas rivitalizimit.</p> <p>Analiza dhe krahasimi i disponueshmërisë së njësive dhe efijencës, përpara dhe pas rivitalizimit.</p>
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/



	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	<p>Rivitalizimi i HEC-it të Komanit</p> <p>Rritja e pritshme e prodhimit të energjisë hidrike në HEC-in e Komanit është 50 GWh/vit.</p> <p>Rritja e pritshme në disponueshmërinë e njësive është 5%.</p> <p>Rivitalizimi i HEC-it të Vaut të Dejës</p> <p>Rritja e pritshme e prodhimit të energjisë hidrike në HEC-in e Vaut të Dejës është 20 GWh/vit.</p> <p>Rritja e pritshme në disponueshmërinë e njësive është 5%.</p> <p>Kursimet totale janë baras me: 6.019 ktoe.</p>
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	<p>Rivitalizimi i HEC-it të Komanit</p> <p>Rritja e pritshme e prodhimit të energjisë hidrike në HEC-in e Komanit në sasinë prej 150 GWh, për periudhën 2018-2020.</p> <p>Rivitalizimi i HEC-it të Vaut të Dejës</p> <p>Rritja e pritshme e prodhimit të energjisë hidrike në HEC-in e Vaut të Dejës në sasinë prej 60 GWh, për periudhën 2018-2020.</p> <p>Kursimet totale janë baras me: 18.058 ktoe.</p>
	Supozimet	Arritja e të paktën rrethanave hidrologjike mesatare; sigurimi i fondeve të mjaftueshme për masën; përfundimi i aktiviteteve të masës sipas qëllimit të planifikuar.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	Asnjë nga faktorët e rëndësishëm që mund të ndikojnë performancën e planifikuar të aktiviteteve të sipërpërmendura, nuk synonin përmirësimin e sistemit të menaxhimit të hidrocentraleve.

2.4.2 Masat për kursimin e energjisë në transformimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë

Duke marrë parasysh ligjin për sektorin e energjisë elektrike (ligji nr. 43/2015), ky nënseksion trajton transpozimin e nenit 15 të DEE-së, duke adresuar mënyrën sesi eficientia e energjisë mund të stimulohet përmes tarifave të rrjetit, dizenjimit të tregut ndaj reagimit të kërkesës, si dhe planifikimit të rrjetit.

Kriteret e eficientës së energjisë në tarifatat dhe rregulloret e rrjetit

Stimulimi i përdorimit eficient të energjisë, nëpërmjet tarifave të rrjetit, arrihet më së miri nëse sigurohet që tarifatat reflektojnë koston dhe në këtë mënyrë stimulojnë përdorimin



racional të energjisë. Megjithatë, shkalla në të cilën komponentë të tillë, që reflektojnë koston, mund të zbatohen në përcaktimin e tarifave, lidhet me kufizimet praktike në tregun aktual. Në mënyrë të ngjashme, heqja e komponentëve të dëmshëm për eficiencën e përgjithshme (përfshirë eficiencën e energjisë) kërkon heqjen e komponentëve që nuk reflektojnë koston dhe që si të tillë stimulojnë konsumin jo eficient të energjisë.

Neni 21 i ligjit për sektorin e energjisë elektrike parashikon parimet e vendosjes së tarifave për operimin dhe shërbimet e rrjetit, të cilat përfshijnë nevojën që tarifat të reflektojnë koston reale. Siç parashikohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), metodologjitë e tarifave aktuale të transmetimit dhe shpërndarjes janë nxjerrë nga ligji i mëparshëm për sektorin e energjisë elektrike (ligji nr. 9072/2003), por synojnë të ndjekin të njëjtat parime përsa i përket reflektimit të koston.

Kërkesa pik dhe çmimi sipas kohës se përdorimit

Përveç tarifave të energjisë, Shqipëria adopton edhe tarifat e kërkesës pik (ose “tarifat e kapacitetit”), si për përdorimin e tarifave të sistemit në transmetim (TUoS), edhe përdorimin e tarifave të sistemit në shpërndarje (DUoS). Këto tarifa synojnë që të reflektojnë koston, në mënyrë që tarifat e para të mbulojnë shpenzimet kapitale (kryesisht koston e ofrimit të infrastrukturës për kapacitet), ndërsa tarifat e dyta synojnë të mbulojnë koston operative (të cilat shkallëzohen më shumë me konsumin e energjisë). Një “tarifë matjeje” e veçantë për lidhjen e konsumatorit reflekton koston e matjes së energjisë të përdorur nga konsumatori.

Konsumatorët e lidhur në sistemin e transmetimit dhe konsumatorët e lidhur në sistemin e shpërndarjes, të pajisur me matës të përshtatshëm, gjatë periudhës 12-mujore, paguajnë një tarifë kapaciteti bazuar në kapacitetin e tyre më të lartë, të kontraktuar e të garantuar, ose ngarkesën pik. Konsumatorët e lidhur në sistemin e shpërndarjes, të cilët nuk janë të pajisur me matës të përshtatshëm paguajnë vetëm një tarifë për energjinë.

Përdorimi i tarifës në kohën e kërkesës pik stimulon konsumatorët të ulin kërkesën e tyre pik ose duke e zhvendosur ngarkesën për të zbutur profilet e kërkesave të tyre ose nëpërmjet uljes së konsumit të përgjithshëm. Megjithatë, një qasje që reflekton më shumë koston do të ishte nëse tarifa e përdorimit do të bazohej tek piku i sistemit dhe jo piku i konsumatorit. Për të shmangur përfitimin në mënyrë të padrejtë të atyre që, rastësisht, kanë një kërkesë shumë të ulët në një orë të vetme pik, tarifa do të shpërndahet ndërmjet tre ngarkesave pik më të larta.

Në mënyrë alternative, dhe veçanërisht pas futjes së teknologjisë inteligjente të matjes, mund të merret në konsideratë çmimi sipas kohës së përdorimit ose edhe çmimi sipas kohës reale, me anën e të cilit mund të përcaktohen *ex-ante* periudhat pik nga operatori i rrjetit (që ka akses në informacionin më të mirë mbi pikun e sistemit sesa mbi konsumatorët dhe ndaj përdoret për të parashikuar ndodhjen e tij).

Tarifimi sipas vendndodhjes

Shqipëria faturon të gjitha tarifat e përdorimit të rrjetit (pa përfshirë tarifat e lidhjes) tek ngarkesa sesa tek prodhimi. Ngarkesa (kërkesa), në mënyrë tipike, është më pak në gjendje të zhvendoset sesa prodhimi (furnizimi) në përgjigje të sinjaleve të çmimit, të cilat mund të



pengojnë sjelljen eficiente. Megjithatë, stimuj të tillë për prodhimin do të funksiononin vetëm nëse do të miratohen tarifat e rrjetit që lidhen me vendndodhjen dhe jo tarifat e mesatarizuara (siç përdoren në Shqipëri). Duke pasur parasysh që prodhimi në Shqipëri është gjithsesi i bazuar tek energjia hidrike, është e diskutueshme nëse stimujt e vendndodhjes do të kishin më tepër efekt tek vendimet për investime.

Trajtimi i humbjeve

Shqipëria adopton rregulloren e çmimit tavan (me përmirësimet e eficientës), si për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, ashtu dhe për atë të Shpërndarjes. Humbjet vlerësohen dhe përfshihen në nxjerrjen e të ardhurave të lejuara, por jo të trajtuara si kosto që barten. Prandaj, operatorët e sistemit stimulohen për të minimizuar humbjet, pasi çdo e ardhur shtesë, nga performanca më e mirë në skenarin bazë, ruhet nga entitetet përkatëse. Gjithashtu, në llogaritjet e tarifave në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes, ERE, bazuar në nivelin e humbjeve të vërejtura në rrjet, lejohet të aplikojë stimuj shtesë që bazohen tek performanca.

2.4.3 Masa për lehtësimin dhe promovimin e reagimit të kërkesës

Tregu i pakicës në Shqipëri mbetet i rregulluar në mënyrë të konsiderueshme, por *Metodologjia e llogaritjes së tarifave të rregulluara të shitjes me pakicë*, e publikuar nga ERE, lejon elementin e çmimit sipas kohës së përdorimit. Tarifat e furnizimit për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, përjashtuar konsumatorët familjarë, ofrojnë nivele më të larta në kohën pik, përveç nivelit bazë më të ulët.

Krijimi i ndarjes ose fleksibilitetit shtesë të tarifave sipas kohës së përdorimit mund të lehtësohet nga futja në përdorim e matësve inteligjentë. Neni 78 i ligjit për sektorin e energjisë elektrike, i miratuar në prill 2015, lidhet me “sistemet inteligjente të matjes”. Ligji kërkon që Operatori i Shpërndarjes, brenda një viti nga data e hyrjes së tij në fuqi, përgatit vlerësimin ekonomik (për t’u miratuar nga ministri përgjegjës për energjinë), përfshirë formën dhe afatin kohor për futjen e sistemeve inteligjente të matjes në Shqipëri. Një projekt pilot që do të drejtohet nga Deutsche Telekom në Tiranë është lançuar në 2015.

Në maj 2015, OSHEE-ja publikoi një “Plan për Modernizimin e Rrjetit”, i cili bëri studimin/vlerësimin për futjen e matësve të automatizuar për 200,000 klientë, me një kursim vjetor të vlerësuar prej 23.9 milionë USD, krahasuar me koston e investimit fillestar prej 35 milionë USD. Këto kursime të vlerësuar arrihen nga aftësia për të kryer lexime automatike dhe ulin të ardhurat e pambledhshme, vjedhjen e energjisë elektrike dhe matjen e gabuar. Inkurajimi i pagesës së saktë dhe që reflekton koston duhet të stimulojë përdorimin më eficient të energjisë.

Gjithashtu, instalimi i matësve inteligjentë të matjes (të avancuar), së bashku me infrastrukturën e përshtatshme të komunikimeve dhe kontrollit të avancuar mund të lejojë që në të ardhmen të përdoren më shumë mekanizma të sofistikuar për reagimin ndaj kërkesës, të tilla si sistemet TOU (sipas kohës së përdorimit), si dhe duke bërë të mundur menaxhimin në kohë reale të rrjetit të shpërndarjes. OSHEE-ja, në diskutime me Bankën Botërore, ka raportuar objektivin që matës të tillë të vendosen në 20,000 nryje të transformatorëve në rrjet, si edhe për 50,000 klientë jo familjarë.



Në lidhje me integrimin e reagimit të kërkesës në tregjet e shërbimeve ndihmëse, neni 8 i ligjit të ri për sektorin e energjisë elektrike kërkon eliminimin e pengesave që ndalojnë përdorimin e kontratave të furnizimit me ndërprerje. Kapitulli VIII i Rregullave të Tregut (2008) adreson procedurat aktuale të prokurimeve të shërbimeve shtesë dhe Shtojca A thekson përfshirjen e ngarkesës me ndërprerje si burim potencial i shërbimeve. Ky kapitull kërkon që Operatori i Sistemit të Transmetimit, OST, të marrë në konsideratë burimet më ekonomike për këto shërbime - sidomos rezervën dytësore dhe terciare.

Megjithatë, aktualisht nuk ka procedura të qarta prokurimi dhe modalitete teknike të përcaktuara për kompanitë në anën e kërkesës që të marrin pjesë në këto tregje. Prandaj, në kuadër të ligjit të ri për sektorin e energjisë elektrike, ERE, mund të marrë në konsideratë rezervën terciare, duke kërkuar që OST-ja të ofrojë informacion të mjaftueshëm e të reklamuar në mënyrë të qartë në faqen e saj të internetit, duke përfshirë:

- afatin kohor të ankandëve të pritshme për rezervë terciare;
- rregullat e pjesëmarrjes;
- kërkesat minimale teknike për pjesëmarrje (dhe potenciali për bashkim për të lehtësuar përmbushjen e kërkesave teknike)
- formularët e aplikimit dhe kontratat paraprake.

Eficienca e energjisë në dizenjimin dhe operimin e rrjetit

Nenin 56 i ligjit për sektorin e energjisë elektrike, i miratuar së fundmi, përfshin si një detyrë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, kryerjen e një analize vjetore të humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe hartimin e zbatimin e masave për uljen e humbjeve dhe masave të tjera për eficiencën e energjisë. Në mënyrë të ngjashme, neni 75 kërkon që Operatori i Shpërndarjes të marrë parasysh në planet e tij të investimit eficiencën e energjisë.

Për të përmirësuar eficiencën e energjisë në dizenjimin dhe operimin e rrjetit është propozuar që të zbatohet grupi i masave të mëposhtme.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Zëvendësimi i transformatorëve jo eficientë Instalimi i nënstacioneve dhe linjave të reja.
Indeksi i masës		E2
Përshkrimi	Kategoria	Infrastrukturë
	Afati kohor	Projekt afatgjatë (për shembull 10 ose 20 vjet) Masë e re



	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	i	Zëvendësimi i transformatorëve të vjetër jo eficientë me transformatorë të rinj, në përputhje me Direktivën e KE-së për Eko-Dizajnin. Vjetërsia mesatare e transformatorëve në Shqipëri është afro 40 vjet. Zëvendësimi i tyre do të jetë pjesë e çdo plani për zhvillimin e rrjetit dhe zgjedhja e transformatorëve më të kushtueshëm, por me eficiencë të energjisë, duhet analizuar duke marrë parasysh uljen e humbjeve të energjisë elektrike gjatë jetëgjatësisë së pajisjes, në vend të kryerjes së shpenzimeve kapitale vetëm. Brenda kësaj mase, vlerësimet do të paraqiten për zëvendësimin e supozuar të 75% të transformatorëve.
	Përdoruesi fundor synuar	i	OSHEE-ja
	Grupi i synuar		OSHEE-ja
	Aplikimi rajonal		Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën		Kapaciteti mesatar i instaluar në nënstationet e TM/TU është 202 kVA. Humbjet vjetore të energjisë në transformatorët e vjetër, me fuqi nominale prej 100 kVA ose 400 kVA, janë në mënyrë tipike ndërmjet 1.5% dhe 3% të energjisë së transformuar, ndërsa në transformatorët e rinj ato duhet të jenë nën 1%.
	Buxheti dhe burimi financiar		OSHEE/Fonde të tjera (BERZH, WB, KFW, GIZ, etj): Duke supozuar zëvendësimin e 75% të transformatorëve (njësitë më inefficente) dhe çmimin mesatar prej 30 euro/kVA, buxheti mund të vlerësohet ndërmjet 100 milionë € dhe 120 milionë € (14'000-16'800 milion ALL)
	Organi zbatues		OSHEE-ja
	Autoriteti monitorues		OSHEE-ja dhe MEI
Kursimet energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	e	Matjet dhe llogaritjet e humbjeve të energjisë/ngarkesës së transformatorëve të vjetër dhe të rinj.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II		Humbjet teknike të energjisë në OSHEE janë analizuar në atë masë që të mundësonin një vlerësim të përafërt të



		efektit të masave për eficiencën e energjisë.
	Kursimet e arritura në 2015	Nuk ka të dhëna.
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	Kursimet totale që vlerësohen të jenë rreth (10.1 ktoe) deri në 2018.
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	Kursimet totale të të gjithë projektit (zëvendësimi i 75% të transformatorëve) vlerësohen të jenë rreth (19 ktoe) deri në 2020.
	Supozimet	Në llogaritjet e vlerësimeve të humbjeve, u bënë supozimet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> • Ngarkesa mesatare e transformatorëve 60% • Koha e përdorimit të ngarkesës pik 3000 orë • Të dhënat për humbjet e transformatorit, pa ngarkesë dhe me ngarkesë, të ngjashme me ato të përdorura në ish Jugosllavi • Pjesa më e madhe e humbjeve teknike në tensionin e ulët (TU) (rreth 89.09)
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergia	Instalimi i transformatorëve të rinj mund të kombinohet me kalimin nga tensioni i mesëm i punës (TM) prej 6 kV ose 10 kV në 20 kV, me optimizim të njëhershëm të ngarkesave të transformatorit (zhvendosja e transformatorëve 6 kV dhe 10 kV të cilët zëvendësohen me ata 20 kV).

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Ulja e humbjeve fikse në transformatorë dhe Optimizimi i konfigurimit të rrjetit TM
Indeksi i masës		E3
Përshkrimi	Kategoria	Operimi (organizative)
	Afati kohor	Optimizimi sezonal verë/dimër Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masë e re
	Qëllimi/Përshkrim i shkurtër	Ulja e humbjeve fikse në transformatorë, pa i zëvendësuar ato, mund të arrihet duke



		<p>ulur numrin e transformatorëve të aktivizuar në sistem, në dy mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> • duke eliminuar hapat e transformimit, duke përdorur zëvendësimin/dublimin e linjave të tensionit të ulët me tension të lartë, pa përdorimin e transformatorëve të ndërmjetëm, ose • duke fikur transformatorët në periudhat e kërkesës së ulët në nënstacionet me dy ose më shumë transformatorë të kërkuar për ngarkesën pik. <p>Megjithatë, të dyja zgjidhjet mund të çonin në vazhdueshmëri më të ulët të furnizimit të konsumatorëve.</p> <p>Përveç humbjeve, ka disa kritere të tjera që ndikojnë në konfigurimin e rrjetit, të tilla si vazhdimi i furnizimit ose procedurat e zakonshme ose të parashikuara të operimit. Duke u kujdesur për humbjet, mund të rezultojnë disa kursime.</p> <p>Konfigurimi optimal i rrjetit, në lidhje me humbjet, është gjithashtu i arritshëm me gjeneratorë të shpërndarë (DG) të lidhur në rrjetin TM, duke supozuar madhësi optimale që mundëson konsumimin e energjisë elektrike të prodhuar afër vendndodhjes së tyre.</p> <p>Modelet më komplekse, duke marrë parasysh kontrollin e njësisë të DG/BER-ve, përfshirë depozitimin e energjisë në rrjet, duke iu përshtatur sinjaleve operative të çmimit dinamik, kërkojnë komunikim të përparuar dhe infrastrukturën për kontroll (SmartGrids).</p>
	Përdoruesi fundor i synuar	OSHEE-ja
	Grupi i synuar	OSHEE-ja
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<p>Fikja e transformatorëve eliminon humbjet shoqëruese.</p> <p>Humbjet në linja rriten me katrorin e ngarkesës, ndaj optimizimi i gjatësive të ushqyesit në rrjetet TM (6 kV – 20 kV) mund të kontribuojë në uljen e humbjeve.</p>



	Buxheti dhe burimi financiar	OSHEE-ja. Buxheti varet nga operimi i rrjetit (p.sh. SCADA, manual, prania e punonjësve në nënstacione). Nuk ka të dhëna.
	Organi zbatues	OSHEE-ja
	Autoriteti monitorues	OSHEE-ja, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/ matjen e kursimeve që rezultojnë	Humbjet teknike të energjisë në OSHEE janë analizuar në atë masë që të mundësonin një vlerësim të përafërt të efektit të masave për eficiencën e energjisë. Matjet dhe llogaritjet e humbjeve të energjisë/ngarkesës në transformatorë.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	Ulja e humbjeve në transformatorët TL/TM dhe TM/TM, për shkak të fikjes së transformatorëve gjatë sezonit me ngarkesë të ulët mund, për shembull, të jetë e nivelit prej 10%.
	Kursimet e arritura në 2015	Nuk ka të dhëna.
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	Kursimet totale që vlerësohen të jenë rreth (9.0 ktoe) deri në 2018.
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	Kursimet totale që vlerësohen të jenë rreth (10 ktoe) deri në 2020.
	Supozimet	Nuk ka të dhëna.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergia	/

3 Kursimet finale të energjisë në sektorët e përdoruesve fundorë

3.1 Rishikimi i objektivave për kursimin final të energjisë dhe arritjet e kursimit final të energjisë

3.1.1 Objektivat kombëtare të përgjithshme për kursimin e energjisë nga përdoruesit fundorë dhe progresi drejt arritjes së tyre

Duke marrë në konsideratë peshën relative të masave në përdorimin e energjisë nga përdoruesit fundorë, objektivi i energjisë primare, i paraqitur në Seksionin 3.1, mund të konvertohet edhe në një nivel të barasvlershëm orientues të kursimeve finale të energjisë, duke përdorur faktorët e paraqitur në Tabelën 5.

Arritja e objektivit të ndërmjetëm 2015 për përdorimin e energjisë nga përdoruesit fundorë

Rishikimi i progresit të deritanishëm të kursimeve të energjisë në Shqipëri është i vështirë, pasi nuk është krijuar asnjë platformë monitorimi dhe verifikimi për raportimin e saktë poshtë-lart (PL), ndërsa kufizimet në qëllimin dhe cilësinë e statistikave kombëtare pengojnë modelimin e besueshëm lart-poshtë (LP). Më tepër detaje mbi vlerësimin e tentuar LP paraqiten në Shtojcën A2. Nga 38 masat e parashikuara në PKVEE-në I, zbatimi i shumë prej tyre u vonua nga ngadalësimi i progresit të pritur në hartimin dhe miratimin e legjislacionit mbështetës, si edhe nga mungesa e një agjencie të dedikuar. Këto çështje trajtohen në mënyrë të detajuar në seksionet e mëposhtme.

Aktiviteti i matshëm që është kryer ishte kryesisht në formën e asistencës financiare (huatë dhe grantet) për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në veshjet e jashtme të ndërtesave, për kolektorët diellorë për ngrohjen e ujit, për automjetet e transportit të mallrave dhe traktorët më eficientë, dhe në një masë më të vogël, për pajisjet me efikasitet të energjisë. Të dhënat për këto programe, me përjashtim të kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit, u morën, për çdo institucion financiar, në formën e mbështetjes financiare në vit të paraqitur në nivel të grupuar. Një përshkrim i plotë i analizës së kryer, me synimin për të vlerësuar kursimet e energjisë të arritura nëpërmjet këtyre programeve nga këto të dhëna, paraqitet në Shtojcën A3. Një përshkrim më i plotë i analizës së kryer, duke përdorur metodologjitë Lart-Poshtë dhe Poshtë-Lart, përfshihet në dokumentin “Raport mbi zbatimin e PKVEE-së I”. Të dyja analizat lidhen me periudhën 2010-2014 (përfshirë). Për të ruajtur strukturën e raportimit, të kërkuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE), këtu janë raportuar kursimet e vlerësuara, përfshirë vitin 2015, nëpërmjet të cilave supozohet që kursimet e reja të arritura brenda vitit, 1 janar deri 31 dhjetor 2015, të jenë të barabarta me ato të arritura në 2014.

Tabela 7 mbledh kursimet e energjisë, bazuar në analizën PL, të përshkruar në Shtojcën A3. Këto kursime krahasohen me objektivat e përfshira në PKVEE-në I. Vihet re që ndërsa PKVEE-ja I përcaktoi fillimisht një objektiv të ndërmjetëm prej 3% të konsumit mesatar vjetor, gjatë periudhës referuese, i miratuar për 2012, vlera e kursimit të energjisë që lidhet



me të u ndryshua në 26 ktoe, e cila është aktualisht ekuivalente me rreth 1.4% të konsumit mesatar gjatë periudhës referuese. Ky objektivi më i ulët u përcaktua për shkak të miratimit të vonë të PKVEE-së, në shtator 2011, dhe se realizimi i nivelit prej 3% do të ishte i paarritshëm. Rezultati neto është që kursimet priteshin të ecnin me një ritëm më të ulët deri në fund të 2012, përpara se të rriteshin në vitet 2013-2018.

Tabela 7 Objektivi kombëtar orientues për 2015 dhe arritja e tij

	Objektivi i kursimeve finale të energjisë		Kursimet finale të energjisë, të arritura ose të parashikuara	
	në terma absolute (ktoe)	Përqindja (%) (krahasuar me konsumin referues të DSHE-së)	në terma absolute (p.sh. ktoe)	Përqindja (%) (krahasuar me konsumin referues të DSHE-së)
2015 (periudha e ndërmjetme)	97.0	5.2%	16.4	0.88%

Theksohet se rezultatet e mësipërme nuk janë një vlerësim gjithëpërfshirës i kursimeve të energjisë në Shqipëri. Përveç faktit që mbulon një numër të kufizuar masash, analiza nuk parashikon në mënyrë të plotë përfshirjen e efekteve multiplikative të arritura nga skemat bankare përmes stimulimit të tregjeve për produkte me EE. Në anën tjetër, supozohet që nuk ka asnjë efekt negativ 'free-rider' (përmes të cilit masat që do të ishin zbatuar gjithsesi kanë ndihmuar në uljen e kostos së një kredie).

Kursimet e pritshme në lidhje me objektivin e përgjithshëm të 2018 për përdorimin e energjisë nga përdoruesit fundorë dhe objektivi orientues i 2020


Bazuar në masat e ndryshme të trajtuara në nën-seksionet e mëposhtme, është nxjerrë objektivi orientues i kursimeve të energjisë për Shqipërinë që paraqitet në Tabelën 8. Vihet re që objektivi orientues i 2018 dështoi që të arrijë nivelin prej 169 ktoe të përfshirë në PKVEE-në I për të njëjtin vit. Megjithatë, për shkak të kohës së shkurtër të mbetur, përpara përmbushjes së synuar të tij dhe kërkesave të mbetura për hartimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve, si dhe modelimit që nevojitet për zbatimin e skemave, ky objektivi nuk konsiderohet realist. Kështu që, propozohet që nëpërmjet përshtetimit të veprimeve, deri në 2020, kursimet kumulative finale të energjisë t'i afrohen këtij niveli me një objektivi të kursimeve finale të energjisë prej 123.7 ktoe.

Tabela 8 Objektivi kombëtar orientues për 2018 dhe 2020 dhe arritja e tij

	Objektivi i kursimeve finale të energjisë	
	në terma absolute (ktoe)	Përqindja (%) si raport i sasisë referuese të PKVEE-së I
2018 (periudha e përgjithshme)	38.5 ktoe	2.1% e sasisë referuese
2020	123.7 ktoe	6.8% e sasisë referuese

Shënim 1: “Sasia referuese” lidhet me konsumin mesatar vjetor final të energjisë për vitet 2004-2008 (përfshirë), siç llogaritet në PKVEE-në I.

Figura 5 Kursimet kumulative të energjisë të arritura/të synuara që nga 2010



Shënim*: Shifra për 2015 është vlerësuar sipas analizës së përmblodhur në Tabela dhe tekstit shoqërues

3.1.2 Objektivi kombëtar për konsumin e energjisë në ndërtesat ekzistuese dhe rritjen e numrit të ndërtesave me konsum energjie pothuajse zero (NKEZ)

Një pjesë e veçantë dhe më vete e legjislacionit parësor mbi performancën energjetike të ndërtesave (“Ligji 116/2016 i PEN-së”) është përgatitur dhe është në përputhje me dispozitat e Direktivës së BE-së për Performancën Energjetike të Ndërtesave (PEN), ndryshuar në 2010 (Direktiva 2010/31/BE). Shqipëria miratoi këtë ligj nr 116 dt 10.11.2016.

Ligji i PEN-së përfshin dispozitat përkatëse për ndërtesat me konsum energjie pothuajse zero (NKEZ) dhe në këtë mënyrë krijon bazën për identifikimin e objektivit (ve) kombëtar përkatës dhe përgatitjen e një plani për realizimin e objektivit (ve). Në mënyrë specifike, dispozitat përkatëse të ligjit të PEN-së parashikojnë ndër të tjera që:

- Përgjegjësia për përgatitjen e planit do t’i mbetet ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe asaj përgjegjëse për ndërtimin
- Objektivat që pas datës 31 dhjetor 2018, të gjitha ndërtesat e reja që janë në përdorim nga autoritetet publike duhet t’i përmbahen këtij detyrimi;
- Objektivat që pas datës 31 dhjetor 2020, të gjitha ndërtesat e reja duhet t’i përmbahen këtij detyrimi;



- Objektivat e ndërmjetme janë vendosur për përmirësimin e performancës së ndërtesave të reja dhe stokut të ndërtesave ekzistuese, të cilat mund të diferencohen sipas kategorisë së ndërtesës.

Aktualisht, objektivat nuk janë vendosur dhe plani përkatës nuk është hartuar. Megjithatë, qëllimi është që deri më 31 dhjetor 2019, autoritetet përkatëse duhet të:

- Hartojnë planin kombëtar (pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë) për rritjen e numrit të NKEZ-ve në Shqipëri.
- Hartojnë Strategjinë për Rinovimin e Ndertesave Publike (ministra e energjisë dhe ajo e ndërtimit)
- Përcaktojnë kërkesat minimale të performancës dhe kërkesat për përdorimin e sistemeve alternative me eficiencë të lartë për Stokun e Ndertesave Publike dhe Private, si edhe numurin e NKEZ-të (ministra përgjegjëse për energjinë dhe ajo e ndërtimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave).


3.1.3 Objektiva të tjera dhe/ose parashikime për arritjen e Objektivit të kursimeve të energjisë finale

Ndonëse objektiva të tilla nuk janë në mënyrë specifike formale, ndarja në nivel sektori, bazuar në parashikimet e kursimit final të energjisë, paraqitet në Tabelën 9 dhe Figura . Siç mund të shihet, sektori i banesave zë përqindjen më të madhe, duke reflektuar qëllimin për përmirësimin e stokut të ndërtesave në këtë fushë. Megjithatë, theksohet që këto përqindje janë vetëm orientuese, pasi nuk është e mundur të vlerësohen dhe përcaktohen në sasi efektet e disa prej aktiviteteve të planifikuara. Gjithashtu, disa prej masave nuk ofrojnë direkt kursime të energjisë, por krijojnë kuadër pozitiv ligjor, institucional e financiar dhe mjedis më të përshtatshëm. Kjo është veçanërisht e vërtetë për masat horizontale.

Tabela 9 Ndarja e objektivit të kursimit final të energjisë sipas sektorëve

Ndarja e objektivit në sektorë	Kursimet e vlerësuara të energjisë në 2018 (ktoe)	Kursimet e vlerësuara të energjisë në 2020 (ktoe)
	Nga masat (PL)	Nga masat (PL)
Banesa	10.66	37.43
Shërbime	6.27	16
Industri	3.7	6.9
Transport	14.2	49.49
Horizontale	3.7	13.9
Totali (njësi ekuivalente):	38.5	123.7
Totali (GWh):	447.8	1,438.6
<i>Përqindja (%) krahasuar me skenarin bazë</i>	2.1% (krahasuar me skenarin bazë 2018)	6.8% (krahasuar me skenarin bazë 2020)

Figura 6 Ndarja e objektivit të kursimit final të energjisë sipas sektorëve



3.2 Strategjitë kombëtare që kanë ndikim në kërkesën finale

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Projekti i SKZHI-II, i paraqitur në Seksionin 2.1, është përdorur për të kuptuar sesi ndikimi i objektivave kombëtare të politikave energjetike, si dhe i objektivave kombëtare për sektorët e tjerë të ekonomisë, mund të ndikojë mbi parashikimet e konsumit final të energjisë dhe lehtësinë e zbatimit të masave që lidhen me eficiencën e energjisë.

Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve formon një shtyllë të politikave strategjike në kuadër të SKZHI-së dhe energjia (veçanërisht furnizimi me energji elektrike, me kosto efektive) është identifikuar nga Qeveria e Shqipërisë, në mbështetje të kësaj shtylle, si një nga gjashtë prioritetet e politikave kombëtare. Besueshmëria e ulët dhe performanca financiare e dobët, veçanërisht i ndërmarrjes së shpërndarjes së energjisë elektrike janë shqetësimet më të mëdha, ndërsa ulja e humbjeve të energjisë elektrike (teknike dhe jo teknike) dhe rritja e nivelit të arkëtimit nga pagesat citohen si objektiva strategjike. Aktivitetet në këtë fushë mund të kenë ndikime të dobishme e të rëndësishme mbi eficiencën e energjisë, veçanërisht në kuadër të kërkesave të nenit 15, siç trajtohet në Seksionin 2.4.

Në mënyrë të veçantë për eficiencën e energjisë, SKZHI-II vë në dukje se miratimi i PKVEE-së re dhe transpozimi i kuadrit ligjor mbi Performancën Energjetike të Ndërtesave (Direktiva 2010/31/KE) janë objektiva strategjike për Shqipërinë. Një draft tregues tjetër që duhet monitoruar dhe që lidhet me konsumin final është synimi i uljes së intensitetit të energjisë nga 0.338 kgoe/1000 euro në 2014, në 0.301 kgoe/1000 euro në 2020.



Ashtu si për energjinë primare, për arritjen e objektivave të përcaktuara në SKZHI-II, MIE është përcaktuar si entiteti përgjegjës kryesor, me ndihmën e Entit Rregullator të Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar

Objektivi kombëtar i pikësnyuar (INDC) është pjesë e procesit të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) për përcaktimin dhe përmbushjen e objektivave për uljen e emetimeve në nivel ndërkombëtar. Në përputhje me vendimin 1/CP.19 dhe vendimin 1/CP.20 të UNFCCC-së, INDC-të e vendeve përcaktojnë objektivat që lidhen me uljen e emetimeve, mbi bazën e kushteve ekonomike dhe industriale vendase. Shqipëria ka përcaktuar një objektiv të skenarit bazë, i cili synon një nivel kursimesh (ulje të emetimeve të CO₂ me 11.5% deri në 2030) nën nivelin e trajektorës së parashikuar të skenarit bazë.

Plani i Qëndrueshëm i Transportit dhe Plani Kombëtar i Transportit për Shqipërinë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me mbështetjen e BERZH-it, po harton një Plan të Qëndrueshëm Transporti (PQT) për Shqipërinë. PQT-ja kërkon të parashikojë emetimet dhe konsumin e energjisë në sektorin e transportit, të përcaktojë objektivat e qëndrueshmërisë për sektorin e transportit dhe të dorëzojë një Plan Veprimi për politikat dhe masat.

Ndërkohë, Plani Kombëtar i Transportit parashikon si objektivë të përgjithshme ofrimin e një sistemi të sigurtë, të besueshëm, eficient dhe plotësisht të integruar, të transportit dhe infrastrukturës, që do të plotësojë nevojat për transportin e mallrave dhe udhëtarëve, ndërsa do të jetë i qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore dhe ekonomike. Në vitet e fundit, është bërë progres i konsiderueshëm në ndërtimin e infrastrukturës rrugore të nevojshme, i cili mund të rezultojë në rritje të aktivitetit të transportit rrugor në periudhën e ardhshme. Gjithashtu, progres i konsiderueshëm është arritur edhe në transportin detar, ku porti i Durrësit dhe disa porte të tjera të vogla po vazhdojnë të rrisin qarkullimin e tyre të mallrave. Nga ana tjetër, në transportin hekurudhor, infrastruktura dhe mirëmbajtja vazhdon të mos financohet mjaftueshëm, shpejtësitë e operimit janë të ulëta dhe qarkullimi është në rënie të vazhdueshme.

Sfidat kryesore të identifikuar në SKZHI-II për elementët thelbësorë të transportit lidhen me integrimin e mënyrave të ndryshme të transportit për të rritur eficiencën e sistemit, përmirësimin e infrastrukturës së transportit rrugor në përputhje me standardet e BE-së duke siguruar mbrojtjen e mjedisit, zbatimin e politikave të përshtatshme, të cilat sjellin përmirësime në menaxhim dhe performancë, si dhe me modernizimin e mëtejshëm. Objektivat strategjike që lindin nga këto sfida janë rritja e densitetit të rrugëve kombëtare dhe ulja e kohës mesatare të udhëtimit ndërmjet qyteteve të mëdha (rritja e volumit vjetor të transportit të udhëtarëve dhe mallrave), rritja e volumit të transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave përmes integritit të mëtejshëm të rrjetit hekurudhor kombëtar në rrjetet hekurudhore rajonale, zhvillimi i transportit detar për të arritur standardet evropiane dhe rritja e eficiencës së transportit ajror.



Stoku i ndërtesave të banimit në Shqipëri dhe efica nca e energjisë 2020.

Kërkesa për energji nga sektori i ndërtesave të banimit përbën një sfidë të madhe për Shqipërinë. Në vitin 2013, ky sektor ishte përgjegjës për 30 për qind të konsumit fundor kombëtar të energjisë dhe për 60 për qind të konsumit kombëtar të energjisë elektrike. Përgjithësisht, banesat shqiptare ngrohen pjesërisht për pak orë në ditë. Përdorimi i vazhdueshëm i sobave të vjetra me dru zjarri sjell probleme të shumta për mjedisin dhe shëndetin.

SLED ofroi hartimin e politikave për efica nca n e energjisë dhe zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike për sektorin e ndërtesave të banimit në Shqipëri. Projekti selektoi njëzet kategori përfaqësuese të ndërtesave të banimit, të cilave ju është llogaritur performanca energjetike termike në tre zona klimatike, janë hartuar paketat e standardizuara të rikonstruksionit, është llogaritur kursimi i mundshëm i energjisë, dhe investimet e kërkuara në varësi të tipit të ndërtesës. Gjithashtu është përcaktuar shkalla dhe struktura e konsumit të energjisë në të tashmen dhe në të ardhmen sipas kategorisë së moshës së ndërtesës, tipit të ndërtesës, zonës klimatike, dhe përdorimit fundor të energjisë.

Konsulenti propozoi dy paketa në shtesë të kuadrit të sotëm të politikave, të cilat kanë si qëllim ta shndërroje stokun e ndërtesave të banimit në ndërtesa me nivelin minimal të harxhimit të energjisë dhe çlirimit të karbonit deri në vitin 2050. Është vlerësuar shkalla e përpjekjeve të nevojshme për të arritur këto objektiva të matura për sipërfaqen e dyshemesë (banimit) të marre në konsiderate, si edhe investimet e kërkuara. Së fundi, është vlerësuar kursimi i energjisë, kostot e kursyera lidhur me energjinë, impakti në shkarkimet e CO₂ që dhe kosto-efektshmërinë e paketave të ndërhyrjeve¹.

Modeli simulimit nga poshtë-lart është zbatuar për të gjithë periudhën kohore 2015 deri në vitin 2030. Janë marrë në shqyrtim vetëm shërbimet lidhur me energjinë termike të ofruar në ndërtesat e banimit për ngrohjen/ftohjen e hapësirës, ftohjen dhe ngrohjen e ujit. Modeli nuk ka marrë në konsideratë përdorimin e energjisë për pajisjet shtëpiake, ndriçimin dhe gatimin. Shkarkimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të CO₂ janë marrë në konsideratë në analizat e studimit. Studimi u përqendrua në dhënien e përgjigjes për:

Nivelet e sotme dhe tendencat e të ardhmes në konsumin përfundimtar të energjisë elektrike dhe shkarkimet e CO₂ në sektorin e ndërtesave të banimit.

Gjetjet se konsumi përfundimtar i energjisë në vitin 2015 në sektorin e banimit për shërbimet e energjisë termike ishte 4.9 miliardë kWh, nga të cilat 54% përmbusheshin nga energjia elektrike, 37% nga lënda drusore dhe 9% nga gazi i lëngët. Sektori shkarkoi 96 mijë tonë CO₂ i bashkëlidhur me konsumin e gazit të lëngët. Energjia përfundimtare e konsumuar e përlllogaritur mbi bazën e veçorive gjeometrike dhe termike të ndërtesave si dhe veçoritë e sistemeve të instaluara energjisë ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga balanca e energjisë. Për këtë shkak, konsumi përfundimtar i energjisë u kalibrua kundrejt balancës duke korrigjuar nivelin e sotëm të komfortit termik, shprehimisht sipërfaqja e pjesshme e dyshemesë e ngrohur dhe e ftohur dhe kohëzgjatja e ngrohjes dhe ftohjes së hapësirës.

¹ <http://sled.rec.org/building.html>



Gjithashtu, në skenarin e referencës, konsumi përfundimtar i energjisë për shërbimet termike pritet të zbrësë me 17% gjatë periudhës 2015 - 2030 dhe do të mbrijë në 4.1 miliardë kWh në vitin 2030. Duke ndjekur tendencat e tregut, ne supozojmë një rritje të shpejtë të ngrohjes me energji elektrike të banesave ekzistuese. Për këtë shkak, gjatë periudhës 2015 - 2030 konsumi i energjisë elektrike do të rritet afërsisht me 2.2%/vit, ndërsa konsumi i druve të zjarrit dhe gazit të lëngët do të ulet respektivisht me afërsisht 11%/vit dhe 10%/vit. Në vitin 2030, shkarkimet e CO2 do të zënë 23% të nivelit të tyre në vitin 2015, ndikuar kryesisht prej ndryshimit në llojit të energjisë, kalimit nga gazi i lëngët tek energjia elektrike. Kërkesa për energji në ndërtesat ekzistuese pritet të zvogëlohet pavarësisht rritjes së konfortit termik për shkak të përmirësimeve që lidhen me periudhën e përdorimit të ndërtesës duke marrë në konsideratë rritimin e rinovimit të ndërtesave të stokut ekzistues me 2.8%/vit.

Segmentet prioritare të sektorit për politikëbërjen.

Në këndvështrimin afatgjatë, është e rëndësishme të sigurohet që ndërtesat e ndërtuara pas vitit 1991 të jenë të rinovuara, meqë ato do të zënë rreth 43% të konsumit përfundimtar të energjisë në këtë sektor në vitin 2030. Ndërtesat e reja do të konsumojnë 18% të konsumit përfundimtar të energjisë në vitin 2030. Për këtë arsye është e rëndësishme ti jepet përparësi zbatimit të kodit të ndërtesave, me qëllim që të shmanget domosdoshmëria e rikonstruksionit të këtyre ndërtesave në të ardhmen.

Shtëpitë e veçuara apo gjysëm të veçuara janë një përparësi e qartë për politikë-bërjen sepse në vitin 2030, 72% e konsumit përfundimtar të energjisë për energji termike do të vijë nga këto banesa. Në vitin 2030, gjysma e konsumit përfundimtar të energjisë do të ndodhë në zonën klimatike B (zonën e klimës së butë), e ndjekur nga zona klimatike A (bregdeti) dhe në fund prej zonës klimatike C (zona malore).

Sot, ngrohja e hapësirës zë pjesën më të madhe të konsumit përfundimtar të energjisë, por ajo do të vijë duke u zvogëluar në të ardhmen. Por në dallim me këtë, pjesa për ftohjen e hapësirës pritet të rritet në mënyrë të ndjeshme. Në përgjithësi, në vitin 2030, Ngrohja e hapësirës, ngrohja e ujit, dhe ftohja e hapësirës do të jenë përgjegjëse respektivisht për 56%, 15% dhe 29% të konsumit përfundimtar të energjisë.

Çfarë paketash të politikave janë të mundura?

Sipas skenarit të moderuar SLED, në vitin 2018 Shqipëria do të miratojë kodin energjetik të ndërtimit (Metodologjine Kombëtare të PEN), i cili do të ndikojë në performancën e ndërtesave të reja dhe atyre që i nëneshtrohen rinovimit të madh.

Për të siguruar që të gjitha ndërtesat ekzistuese, që do të mbeten edhe pas vitit 2050 dhe që do të rikonstruktohen deri në këtë kohë, supozohet se Shqipëria do të fusë stimuj financiarë për investitorët në sektorin e banimit. Këto përfshijnë futjen e kredive me normë të ulët interesi për 90% të familjeve në shtëpi të veçuara ose gjysëm të veçuara si dhe futjen e ndihmës në formë grantesh për pjesën e mbetur prej 10% të këtyre familjeve. Gjithashtu, këtu përfshihet edhe futja e kredive për 10% banesave familjare tashmë të rikonstruktuar dhe pallateve me shumë apartamente banimi; kjo pjesë supozohet të rritet me 90% deri në



vitin 2050. Pjesa e mbetur e banesave familjare në varg ose soletë betoni dhe pallateve me shumë apartamente banimi duhet të përfitojnë grante.

Eshte e domosdoshme qe kodet energjetike të ndërtimit qe do te miratohen brenda 2018, në vitin 2022 duhet te parashikohet nje kod energjetik edhe më i rreptë, me kërkesa që përfshijne jo vetem nderhyrjet ne izolimin termik por edhe vendosjen e sistemit termik me eficence te larte. Me qëllim që tregu të përgatitet, Shqipëria duhet të zbatojë kreditë me interesa të ulta për ndërtimin e ndërtesave të reja në mënyrë të arrijë performancën e kërkuar prej kodit të ndërtesave të vitit 2022.

Për të siguruar kryerjen e rinovimit te ndërtesave te stokut egzistues, Shqipëria duhet të fusë stimujt financiarë për investitorët e sektorit të ndërtesave të banimit. Deri në vitin 2022, duhet të jepen stimujt financiarë, në mënyrë që të arrihet shkalla e performancës sipas modelit me karbon te ulet.

Parashikimet e kursimi final te energjisë dhe zvogëlimi i shkarkimeve të CO₂.

Duke konsideruar skenarin e moderuar të SLED, në vitin 2030, konsumi përfundimtar i energjisë për shërbimin e energjisë termike do të zvogëlohet deri në 3.0 miliardë kWh, ose 27 përqind më i vogël se niveli *baze i vitit 2015*. Shkarkimet e CO₂ të lidhura me to do të jenë 73 përqind më të ulta se niveli përkatës.

Pjesa më e madhe e energjisë së kursyer do të vijë prej ndërtesave të konstruktura në periudhën 1991 dhe 2000, dhe ndërtesave të reja. Lidhur me tipin e ndërtimit, pjesën më të madhe të energjisë përfundimtare të kursyer do ta kenë shtëpitë individuale. Zona klimatike B (zona e mesme) dominon potencialin për sasinë e energjisë së kursyer, e ndjekur prej zonës klimatike A (bregdeti), dhe zona klimatike C (zona malore). Kursimi më i madh i energjisë do të jetë prej ngrohjes/ ftohjes së sipërfaqes së banimit.

Sa do ti kushtojnë këto përpjekje qeverisë dhe aktorëve të tjerë?

SLED vendos nje strategji per rinovimin e ndërtesave për periudhën 2015 deri në 2030. Konsulentet gjykojne se duhet të jenë rinovuar te pakten 1.1 milionë m², ose 2.5 përqind e sipërfaqes së përgjithshme të dyshemesë së ndërtesave private te cilat perbejne nje stok prej 40 milion m². Gjithashtu, në këtë skenar është e përfshirë edhe sipërfaqja e re e ndërtuar – rreth 1.1 milionë m² çdo vit. Ky transformim kërkon investime të rëndësishme që duhen kryer prej aktorëve të ndryshëm.

Kostoja e investimeve të përgjithshme për rinovimin e ndërtesave është 1.1 miliardë EURO për periudhën nga 2015 në 2030, ose 72 milionë EURO në vit. Për më tepër, kostot shtesë të investimeve në ndërtesat e reja duhet të jenë 593 milionë EURO në periudhën nga 2015 deri në 2030, ose 40 milionë në vit. Në rastin e ndërtesave të ngritura së fundi, kostot e skenarit të investimeve përfshijnë vetëm kostot shtesë të investimit, meqë ndërtimi do ti ketë të përfshira në çdo rast edhe kostot e komponenteve dhe sistemeve të ndërtimit.

Duke supozuar një zbritje prej 4 përqind, kostot shtesë të skenarit të moderuar të SLED për periudhën nga 2015 deri në 2030 janë 2.3 EURO për m². Kostot e energjisë së kursyer do të jenë mesatarisht 3.8 EURO për m² për sipërfaqet e reja ku është kryer rinovimi në këtë



periudhë. Kjo nënkupton se investimet në skenarin e moderuar të SLED dalin me fitim. Është e rëndësishme të theksojmë se kostot e energjisë së kursyer janë më të larta se kostot vjetore të investimit për këtë skenar në të gjithë vendin, por jo për të gjitha kategoritë e ndërtesave. Për pak kategori të ndërtesave, kostot e energjisë së kursyer janë më të ulta se kostot vjetore shtesë të investimeve, prandaj investimet shtesë nuk mbulojnë shpenzimin e bërë. Rritja e përqindjes së zbritjes në më shumë se 9 përqind e bën investimin jo tërheqës për të gjithë skenarin. Analiza është kryer duke supozuar një rritje të mundshme të çmimit të energjisë.

Stoku i ndërtesave Publike dhe eficienta e energjisë 2020.

Nje studim i financuar nga ADA (Austrian Development Agency) dhe REC Europe, SLED2, siguroi informacion për modelimin sektorial të stokut të ndërtesave publike të Shqipërisë me qëllim strategjinë e rinovimit të tyre me Eficienten e Energjisë. Një element kyç i arritur në këtë studim është identifikimi i tipologjisë së ndërtesave publike për Shqipërinë, i cili nuk ka ekzistuar më parë. Bazuar në studim janë identifikuar gjashtë kategori në bazë sipas funksionit të ndërtesave Publike që mirëmbahen nga buxheti qendror dhe Lokal: (i) konvikte, (ii) spitale, (iii) kopshte, (iv) zyra, (v) shkolla dhe (vi) universitete. Është vlerësuar kërkesa për energji për çdo kategori.

Treguesit, të tillë si energjia e furnizuar për burime të energjisë, energjia primare dhe çlirimet e dyoksidit të karbonit janë përcaktuar për ngrohje/ftohje, ujë të ngrohtë sanitar, ventilim dhe ndriçim. Analiza u bazua në auditimet energjetike në 70 ndërtesa të selektuara sipas zonës klimatike (nga një stok me 690 të tilla). Në fundi, u përcaktuan opsione komplekse të rikonstruksionit, një paketë standarde dhe një ambicioze e rikonstruksionit, dhe u përcaktua kursimi i energjisë. Kostot specifike e investimeve janë paraqitur edhe sipas kategorisë të ndërtesës dhe masës.

Raporti përfundon me një analizë të kostove dhe përfitimeve të rikonstruksioneve në përfitimin termik të ndërtesave publike shqiptare në mbarë vendin. Në pari, është kryer analiza tradicionale financiare bazuar në krahasimin e flukseve financiare hyrëse dhe dalëse të lidhura me rikonstruksionet në eficienten termik të ndërtesave publike. Analiza financiare është përgatitur duke marrë parasysh investimet kapitale, shpenzimet e instalimit dhe mirëmbajtjes, si dhe kostot e ruajtura të energjisë.

Është bërë identifikimi dhe kosto e përfitimeve të tjera lidhur me përmirësimin e eficientës termike përtej kursimeve të kostove të energjisë. Këto përfitime përfshijnë, përveç të tjerave (i) komfortin termik, (ii) shmangiet e çlirimeve të CO₂, (iii) shmangie e efekteve ekonomike nga ndotësve ajrit, (iv) punësimin, dhe (v) rritjen ekonomike

Se fundi, është kryer analiza duke përdorur kurbat e kursimit të furnizimit të energjisë. Në rastin tonë, një kurbë e energjisë finale karakterizon kursimet e mundshme të energjisë nga një grup i paketave të rikonstruksionit të energjisë termike të aplikuar për lloje të ndryshme të ndërtimit si një funksion i kostos për njësi.



Stoku i ndërtesave publike dhe klasifikimi

U vlerësuan 6.6 milionë m² sipërfaqe e target grupit të llojeve kryesore të ndërtesave publike, shifër që nuk pritet të ndryshoje në mënyrë të konsiderueshme. Nderkohe që klasifikimi sipas **Tipologjisë tregon se rreth 75% ose $\frac{3}{4}$ e sipërfaqes është e zënë nga ndërtesa që përdoren për qëllime arsimore, 13% Zyrat dhe 11% Spitalet. Analiza tregon se 57% është e vendosur në zonën e klimës A, 26% në zonën klimatike B dhe 17% është në zonën klimatike C.**

Kosto e Rikonstruksionit dhe prioritete

Në mënyrë që të rikonstruktojmë të gjitha ndërtesat publike shqiptare në nivelin e përmirësimit të moderuar, nevojiten **500 milionë Euro ose 70 Miliardë ALL**. Kostot e investimeve për m² janë më të ulët në kategorinë e ndërtimit të konvikteve, e ndjekur nga kopshtet dhe shkollat.

Prioriteti sipas kërkesës për investim klasifikohet fillimisht për Kopshtet, të ndjekur nga Shkollat, Spitalet dhe Zyrat. Investimi më i madh është i nevojshëm në zonën klimaterike A.

Kursimet më të larta të kërkesës për energji primare dhe fundore, si dhe reduktimet e emetimeve të CO₂ për m² janë pa mëdyshje në ndërtesat e zonës klimatike C. Këta tregues janë dy herë më të vegjël për të zonat klimatike A dhe B, dallimi midis tyre nuk është dhe aq i rëndësishëm. Kursimet më të larta të kërkesës për energji primare dhe për m² janë në konvikte, spitale dhe zyra

Zona Klimatike A zë pjesën më të madhe të kursimeve finale të energjisë në vlera absolute për shkak të numrit më të madh të ndërtesave në zonën klimatike A se sa në zonën klimatike C. Për sa i përket potencialit absolut për kursime fillestare dhe përfundimtare, kopshtet janë në radhë të parë, të ndjekur nga shkollat dhe spitalet. Në kushtet e kursimeve të mundshme të shkarkimeve CO₂, potenciali më i madh është në spitale dhe kopshte.

Kursimet e Vlerësuara

Kursimet Mesatare të Energjisë sipas jetëgjatësisë së rikonstruktimit janë 4.4 EUR/m² në vit, ose 76 EUR/m² gjatë gjithë jetëgjatësisë. Ndersa Totali i Kursimeve të kostos së energjisë është 29 milion EUR/vit dhe 502 milionë EUR gjatë jetëgjatësisë. Pothuajse 45% e saj është në zonën klimaterike A për shkak të numrit të madh të ndërtesave. Kursimet më të larta të kostos së energjisë për m² janë të ofruara nga spitalet, të ndjekur nga konviktet. Shpenzimet e kursyera të energjisë për m² në zonën klimaterike C janë më shumë se dy herë më të larta se ato në zonën klimaterike A dhe janë 65% më të larta se ato në zonën klimaterike B.

Rikonstruksionet e universiteteve nuk janë financiarisht të realizueshme, nëse vetëm shpenzimet e ruajtjes së energjisë do të merren si përfitime (vetëshlyerje më të lartë se jetëgjatësia, raporti kosto-benefit më i lartë se 1, NPV negative, IRR negative). Gjithashtu, rikonstruksionet e shkollave dhe kopshteve, nuk do të jenë financiarisht tërheqëse (NPV negative, raporti kosto-benefit më i lartë se 1). Konviktet dhe spitalet janë financiarisht të realizueshme për rikonstruksione ndërsa zyrat janë në kufi të fizibilitetit.



Vecanërisht të larta janë edhe efektet në GDP dhe punësim. Nëse të gjitha këto përfitime do të merren parasysh në analizën financiare, kost-efektiviteti i rikonstruksioneve të efikasë termale i të gjitha llojeve të ndërtesave publike do të jetë shumë më i lartë.


Skenari i përmirësimit standard të efikasë se energjisë.

Figura 1 paraqet potencialin kumulativ për kursimet e energjisë fundore si një funksion i kostos së energjisë së kursyer për të gjithë vendin. Figura ilustron se tipat e ndërtesave të cilët kumulativisht janë në gjendje të furnizojnë me potencialin më të madh të kursimit janë, kopshtet, shkollat dhe spitalet. Zyrat gjithashtu ofrojnë potencial të madh për kursimin e energjisë.

Nëse të gjitha rikonstruksionet në vend do të ndërmerren, ato do të ndihmojnë të kursehen 210 GWh/vit. (16 ktoe). Në qoftë se vetëm ndërtesat më sipër do të rikonstruktohen, kostoja e të cilave është më pak se 0.1 euro/kWh atëherë 62 GWh/vit. (5.3 ktoe) mund të kursehen.

Nëse supozohet gjithashtu se ndërtesat furnizohen plotësisht me energji elektrike, me çmimet aktuale të rikonstruksioneve, ato janë me kosto-efektive në të gjitha ndërtesat me përjashtim të shkollave të zonës klimatike C, si dhe e konviktet në zonat klimatike A dhe B duke supozuar se çmimi i energjisë elektrike do të indekskohet me 1.5%/vit. Në terma realë, rikonstruksionet e të gjitha llojeve të ndërtesave në zonën klimatike C, si dhe konvikte dhe spitalet në zonën e klimës B do të bëhet kosto efektive. Konkluzione të ngjashme, mund të nxirren edhe duke krahasuar koston e energjisë së konservuar me çmime të tjera të energjisë.

Figura: Kurba e Furnizimit me energjinë e kursyer, Sipas Skenarit të përmirësimit 1





Skenarët e Rinovimit të ndërtesave publike të parashikuara në PKVEE 2018-2020

Nga modeli i kryer, janë identifikuar 2 skenarë të mundshëm të cilët mund të përfshihen në planin kombëtar PKVEE.

Skenari i Parë, fokusohet në tipologjinë e ndërtesave ku rikonstruktionet janë me kosto efektive më të lartë dhe të cilat mund të zgjidhen si prioritet nga pikëpamja sociale, të cilat janë, Spitale dhe Kopshtet për të cilat parashikohet rikonstruktimi i 545,000 m², në zonën klimatike C ku kosto totale e investimit është 40 Mil. EUR në periudhën 2018-2020 dhe përbën rreth 8% të stokut total të ndërtesave publike ose 2% në vit (10 Mil. EUR/Vit)

Të gjitha kopshtet dhe spitalet në zonën e klimës C do të rikonstruktohen duke pasur parasysh nivelin e moderuar të performancës të përcaktuar masat për përmirësimin e performances se energjisë.

Skenari i Dytë, parashikon të njëjtën sasi investimi të shpërndarë në të gjitha zonat në mënyrë proporcionale me ndarjen e sipërfaqes së ndërtesave sipas tipit të ndërtesave. Ky skenar sugjeron 530,000 m² sipërfaqe të rikonstruktuar të shpërndarë proporcionalisht në tre zonat ku kosto 40 mil. EUR do të aplikohet në 8 % të sipërfaqes se ndërtimeve ose 2%/vit qe perben 10 mil. EUR në Vit

Të gjitha ndërtesat do të rikonstruktohen duke pasur parasysh nivelin e moderuar të performancës të përcaktuar masat për përmirësimin e performances se energjisë.

3.3 Masat në përdorimin fundor dhe kursimet finale të energjisë

3.3.1 Metodologjia e llogaritjes

Siç trajtohet në Seksionin 4.1, asnjë platformë monitorimi dhe verifikimi nuk është zbatuar për periudhën e deritanishme (2010-2014), ndërsa shumë prej masave të propozuara në PKVEE-në I nuk arritën kursime, gjatë periudhës së shqyrtuar, për shkak që dhe pse u miratua shumë herët (në vitin 2005) ligji “Për Eficencën e Energjisë”, por nuk gjeti mbështetje me daljen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e tij. Gjithashtu, mungesa e grupeve të të dhënave statistikore kombëtare të sigurta pengoi kryerjen e një analize Lart-Poshtë, duke përdorur treguesit e preferuar, ndërsa analiza e kryer me treguesit minimalë dha rezultate kontradiktore dhe të pasigurta. Si rezultat, metodologjia e llogaritjes e përdorur për të vlerësuar kursimet e energjisë të arritura përpara përfundimit të këtij raporti (domethënë një metodologji Poshtë-Lart e përshtatur, bazuar në modelin e rekomanduar deri në masën që e lejonin grupet e të dhënave) ndryshon nga ajo e propozuar për monitorimin dhe analizimin e kursimeve të ardhshme. Detajet e analizës së tentuar,



Lart-Poshtë dhe Poshtë-Lart, të kursimeve të energjisë, për periudhën 2010-2014, paraqiten përkatësisht në Shtojcat A2 dhe A3².

Duke lejuar zbatimin e platformës së M&V-së, si dhe statistikave të përmirësuara, metodologjia e propozuar e llogaritjes së kursimeve të energjisë, që rezultojnë nga masat e prezantuara në seksionin e mëposhtëm, deri në 2020, paraqiten në Tabelën 10 dhe Tabelën 11.

Tabela 10 Pasqyra e metodave LP të përdorura për llogaritjen dhe raportimin e kursimeve të arritura të energjisë

Treguesi LP	Sektori	Mundësia e llogaritjes	Numri i masës për kursimin e energjisë, që është vlerësuar duke përdorur treguesin LP
P1	Banesa	✓	R1, R2, R3, R4, R6, R7, R10
P2		✓	
P3		✓	
P4		-	
P5		✓	
M1		✓	
M2		✓	
P6	Shërbime	-	R1, R2, R3, R4, R6
P7		-	
M3		✓	
M4		✓	
P8	Transport	✓	T1, T3, T6, T7
A1 për P8		✓	
P9		✓	
A2 për P9		✓	
P10		✓	
P11		✓	
P12		✓	
P13		✓	
M5		✓	
M6		✓	
M7	✓		
P14	Industri	✓	I1, I2, I3
A3 për P14		✓	
M8		✓	

Monitorimi i objektivave për eficiencën e energjisë, qoftë në nivel lokal, rajonal apo kombëtar, kërkon vlerësimin e ndikimeve të politikave dhe masave për eficiencën e energjisë, përse i përket kursimeve të energjisë, dhe si pasojë e kontributit të tyre në objektivin për eficiencën e energjisë. Ndikimet e mundshme të politikave dhe masave të tilla, nga njëra anë, mund të vlerësohen sipas metodës lart-poshtë, d.m.th. nëpërmjet treguesve specifikë, të tillë si konsumi i energjisë në banesa për ngrohje për m². Nga ana tjetër, metodat e ashtuquajtura poshtë-lart mund të përdoren për të vlerësuar ndikimin e

² Në kohën e zhvillimit të analizës, të dhënat për 2015 nuk ishin në dispozicion. Për të ruajtur përputhshmërinë me kërkesat e raportimit, në vlerësimin e progresit kundrejt objektivit të ndërmjetëm për 2015, supozohet që kursimet e reja të energjisë në 2015 të jenë të njëjta me ato në 2014.



masave të vetme për eficiencën e energjisë. Megjithatë, ato lejojnë vlerësimin a masave të vetme, jo vetëm përsa i përket kursimeve të energjisë, por edhe përsa i përket efektivitetit të kostos së tyre, i shprehur si kosto në raport me ndikimin e kursimit të energjisë (p.sh. euro/kWh). Kursimet e energjisë të arritura nëpërmjet zbatimit të një mase të vetme për eficiencën e energjisë mund të mblidhen për të vlerësuar kursimet totale të energjisë në një fushë specifike (p.sh. ngrohja).

Qëllimi i metodave PL të përdorura për llogaritje është që të ofrohen udhëzime për vlerësimin e ndikimeve të masave për eficiencën e energjisë. Aty përfshihen një mori e masave për eficiencën e energjisë për të cilat janë përdorur metodat poshtë-lart të llogaritjes së kursimeve, d.m.th. formula specifike llogaritjeje.

Për të zbatuar këto metoda llogaritjeje, janë përdorur vlerat e llogaritjes specifike për vendin, të ashtuquajturat vlerat e parapërcaktuara, (p.sh. mund të aplikohen skenari bazë për llogaritjen e kursimeve të energjisë nga rinovimi i ndërtesave ekzistuese, kërkesa mesatare për ngrohjen e hapësirave në stokun e ndërtesave në një periudhë të dhënë, në një vend të veçantë). Megjithatë, duhet të theksohet se kursimet e llogaritura me metodat poshtë-lart janë para së gjithash teorike, veçanërisht kur për llogaritjen e kursimeve përdoren vlerat e paracaktuara, në vend të vlerave specifike të projektit, d.m.th. vlerat specifike për ndërtesën që është rinovuar.

Kursime të tilla të llogaritura quhen kursime të supozuara, në krahasim me kursimet e matura, ku kursimet nga një masë e veçantë janë “(...) përcaktuar nëpërmjet regjistrimit të uljes aktuale të përdorimit të energjisë, duke marrë në konsideratë faktorë të tillë si shtueshmëria, zënia, nivelet e prodhimit dhe moti, të cilët mund të ndikojnë tek konsumi”³. Format e tjera të llogaritjes së ndikimit të masave për eficiencën e energjisë, sipas metodës poshtë-lart, janë kursimet e shkallëzuara dhe kursimet eurvejuara.

Tabela 11 Pasqyra e metodave PL të përdorura për llogaritjen dhe raportimin e kursimeve të arritura të energjisë

Metoda PL	Metodë e rekomanduar nga KE/metodë kombëtare	Numri i masës për kursimin e energjisë, që është vlerësuar duke përdorur treguesin PL
Rinovimi i ndërtesave ekzistuese rezidenciale dhe terciare	KE	R6, R7
Futja e kodeve të ndërtimit për ndërtesat e reja rezidenciale dhe terciare dhe promovimi i ndërtesave përtej kodeve të ndërtimit	KE	R1, R2, R4
Zëvendësimi ose pajisje të reja elektroshtëpiake (pajisjet e ftohta, makinat larëse, makinat për larjen e enëve, televizorët, etj.) në ndërtesat rezidenciale.	KE	R10
Faturimi informativ	KE	H1

³ Direktiva për Eficiencën e Energjisë, Shtojca V, faqe 35.



Metoda PL	Metodë e rekomanduar nga KE/metodë kombëtare	Numri i masës për kursimin e energjisë, që është vlerësuar duke përdorur treguesin PL
Zëvendësimi i motorëve elektrikë që sigurojnë energji lëvizëse në industri, ri-dimensionimi i motorëve elektrikë rrotullues, motorë me shpejtësi të ndryshueshme, ndriçimi në ndërtesat industriale	KE	I1, I2, I3
Ndriçimi rrugor me eficiencë të energjisë	KE	P1
Teknologjitë alternative të automjeteve	KE	T6
Drejtimi i automjetit në mënyrë eficiente (<i>Eco-driving</i>)	KE	T1
Ndryshime modale në transport	KE	T3, T7

Pjesa më e madhe e formulave të paraqitura në Tabela 11 janë marrë nga publikimi i Komisionit Evropian “Rekomandime mbi metodat e matjes dhe verifikimit në kuadër të Direktivës 2006/32/KE mbi përdorimin me eficiencë të energjisë për përdoruesit fundorë dhe shërbimet energjetike”, ndërsa disa formula janë zhvilluar në kuadër të projektit të BE-së multEE për monitorimin e zbatimit të Direktivës 2006/32/KE mbi përdorimin me eficiencë të energjisë për përdoruesit fundorë dhe shërbimet energjetike (DSHE) dhe Direktivës 2012/27/BE për eficiencën e energjisë (DEE).

3.3.2 Të gjitha masat individuale

Zbatimi i masave të propozuara për EE-në në Shqipëri, do të varet nga atraktiviteti i kostos së atyre masave, në krahasim me koston e energjisë në mungesë të tyre. Konkurrueshmëria e kostos do të varet nga çmimet e tregut, subvencionet, politikat dhe sjellja e vendimet e konsumatorit. Parashikimet e penetrimit të teknologjive të ndryshme në treg dhe vendimet e konsumatorit janë çështje që po fitojnë terren në modelimin e politikave energjetike dhe qarqet vendimmarrëse në BE, megjithatë ende nuk janë publikuar kërkime të mjaftueshme për të kryer analizë gjithëpërfshirëse. Prandaj, pjesa e mbetur e këtij seksioni do të paraqesë kostot direkte të përlllogaritura nga buxheti publik për masat e propozuara dhe vlerësimi i kostove totale shtesë për individët që është rezultat i detyrimeve ligjore shtesë, kur vlerësimet e tilla janë të mundshme.

Ky seksion do të paraqesë gjithashtu vlerësimet e efektit/përfitimit shtesë të aktiviteteve për eficiencën e energjisë tek punësimi. Për shkak se në Shqipëri nuk ka kërkime gjithëpërfshirëse për këtë çështje, vlerësimi kryhet duke përdorur raportin “Vende pune në sektorin e energjisë deri në 2030: Një Analizë Globale”, e përgatitur nga Rutovitz, J., dhe Atherton, A., për Greenpeace International, nga Instituti për të Ardhmen e Qëndrueshme, Universiteti i Teknologjisë, Sidnej, në 2009.



Nga raporti i sipërpërmendur, faktorët e punësimit për kursimet në sektorë të ndryshëm janë:

<input type="checkbox"/>	Banesa:	5.70 vende pune/ktoe
<input type="checkbox"/>	Tregti:	7.21 vende pune/ktoe
<input type="checkbox"/>	Industri:	3.14 vende pune/ktoe
<input type="checkbox"/>	Pajisje dhe elektronika:	11.86 vende pune/ktoe
<input type="checkbox"/>	Transporti:	0.70 vende pune/ktoe
<input type="checkbox"/>	Ndërmarrjet e shërbimeve:	0.35 vende pune/ktoe

Faktorët e sipërpërmendur lidhen me vendet e punës, të krijuara për çdo ktOE të energjisë finale të kursyer/ulur. Është e rëndësishme të përmendet që shifrat e mësipërme janë rezultat i kërkimit të kryer në nivelin e OECD-së për Evropën dhe mund të jenë të ndryshme në rastin e situatës specifike social-ekonomike në Shqipëri. Megjithatë, pasi nuk ka në dispozicion më shumë kërkime të fokusuara dhe specifike, këto shifra ofrojnë një orientim fillestar mbi potencialin. Megjithatë për shkak të nivelit tepër të ulët të konsumit të energjisë për banor në Shqipëri, në krahasim me vendet e vlerësuara, shifrat e dhëna ka të ngjarë të jenë konservative.

Çmimet mesatare të lëndëve djegëse të ndryshme, në 2014, jepen në tabelën e mëposhtme. Në mënyrë që masat për eficientësinë e energjisë të jenë me kosto efektive, vlera monetare e kursimeve neto të energjisë duhet të jetë më e lartë sesa kostot monetare të atyre masave.

Çmimet me pakicë të lëndëve djegëse të ndryshme të përdorura në llogaritje janë:

<input type="checkbox"/>	Dru zjarri	10 euro/MWh
<input type="checkbox"/>	Solar	70 euro /MWh
<input type="checkbox"/>	Qymyr	12 euro /MWh
<input type="checkbox"/>	GLN	29 euro /MWh
<input type="checkbox"/>	Energji elektrike – banesa	68 euro /MWh
<input type="checkbox"/>	Energji elektrike – tregti	100 euro /MWh

Pas konvertimit, çmimet e përdorura në llogaritje janë:

<input type="checkbox"/>	Dru zjarri	116.3 keuro/ktOE
<input type="checkbox"/>	Solari	814.1 keuro/ktOE
<input type="checkbox"/>	Qymyr	139.5 keuro/ktOE
<input type="checkbox"/>	GLN	337.3 keuro/ktOE



- Energji elektrike – banesa 790.8 keuro/ktoe
- Energji elektrike – tregti 1,163.0 keuro/ktoe

Për të mundësuar lehtësinë dhe qartësinë e rezultateve u llogarit kosto specifike e energjisë për çdo sektor, bazuar në miksin e konsumit final të energjisë, d.m.th. si një kosto mesatare e ponderuar.

- Banesa: 559,885 EUR/ktoe
- Tregti: 622,644 EUR/ktoe
- Industri: 474,962 EUR/ktoe
- Transport: 1,098,448 EUR/ktoe

Bazuar në vlerat e propozuara më sipër, të gjitha masat vlerësohen në lidhje me koston specifike të vendosur për buxhetin publik, koston specifike të përdoruesve privatë, periudhën e thjeshtë të kthimit të investimit dhe efektin e masave të propozuara tek punësimi në Shqipëri.

Masat në sektorin e ndërtesave

Një listë përmbledhëse e të gjitha masave të propozuara për eficiencën e energjisë, në lidhje me ndërtesat, jepet më poshtë, së bashku me kursimet e pritshme të energjisë në 2020, në ktoe, dhe financimin publik të kërkuar.

Tabela 12 Lista përmbledhëse e masave në sektorin e ndërtesave

Indeksi	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Përdoruesi fundor i synuar	Kursimet e pritshme të energjisë në 2020 [ktoe]	Financimi total i kërkuar (para publike), mil. ALL
R2	Krijimi dhe funksionimi i Fondit të Eficencës së Energjisë neni 19- 24 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë", (2018-2020).	Konsumatorët e energjisë	2.8	215.0
R3	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në funksion të Performancës së Energjisë në Ndërtesa: - metodologjia kombëtare e llogaritjes të PEN - koston optimale për kërkesat minimale të PEN - përdorimi i sistemeve alternative me eficiencë të lartë për sistemet teknike të ndërtesave.	Ndërtesat private ekzistuese dhe të reja më një ose shumë apartamente, Ndërtesat private ekzistuese dhe të reja tregtare jo rezidenciale, Ndërtesat ekzistuese dhe të reja publike jo rezidenciale.	9.1	28.0



R4	Vleresimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PRIVATE, përcaktimi i kostos optimale për efikasitetin e energjisë për ndërtesat që parashikohet të nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat për ndërtesat e reja me performancë të lartë.	Stoku ekzistues i Ndërtesave private ekzistuese dhe të reja më një ose shumë apartamente, dhe tregtare jo rezidenciale.	3.5	36.7
R5	Vleresimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PUBLIKE, përcaktimi i kostos optimale për efikasitetin e energjisë për ndërtesat që parashikohet të nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat për ndërtesat e reja me performancë të lartë.	Stoku ekzistues i ndërtesave Publike	2.83	33.6
R6	Hartimi i skemave mbështetëse financiare për përmirësimin e performancës së energjisë, në veshjen e jashtme të ndërtesave dhe sistemet teknike të ndërtesës.	Konsumatori fundor/Ndërtesat ekzistuese që i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm.	4.5	14.0
R7	Hartimi i një planit të veprimit për të rritur numrin e ndërtesave me performancë afër zero-energji.	Ndërtesat e reja	1.2	28.0
R8	Përcaktimi i klases së energjisë për produktet që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë, të cilat përbushin kërkesat minimale të efikasitetit të energjisë, siç përcaktohet në ligjin 124/2015 "Për Efikasitetin e Energjisë" dhe ligjin 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji".	Pajisjet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë.	3.1	14.0
R9	Certifikimi energjetik i ndërtesave	Ndërtesat e reja dhe ekzistuese që i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm	4.2	-
R10	Rinovim i stokut të ndërtesave publike me 2% cdo vit të sipërfaqes së ngrohur/ftohur për ndërtesat që janë në administrim ose përdorim nga një autoritet publik ose nga institucionet që sigurojnë një shërbim ndaj publikut, me qëllimin	Ndërtesat publike që i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm	4.1	5,600.0



	për përmbushjen e kërkesave minimale të performancës së energjisë.			
--	--	--	--	--

Në faqet e mëposhtme jepen përshkrime të detajuara të secilës masë të propozuar për eficientën e energjisë, së bashku me supozimet e përdorura për të llogaritur kursimet dhe vlerësuar kostot.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Krijimi dhe funksionimi i Fondit të Eficencës së Energjisë neni 19- 24 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë", (2018-2020).
Indeksi i masës		R2
Përshkrimi	Kategoria	Rregullatore & Infrastruktura
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: Mbështetur në kërkesën e ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë", neni 19,20,21,22,23 dhe 24 është punuar nga Drejtoria e RES&EE në MIE mbi Draft kuadrin ligjor i krijimit dhe funksionimit për Fondit të Eficencës së Energjisë.
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	i Synohet krijimi i një Fondi të Eficencës së Energjisë si organizatë jofitimprurëse, që ka për qëllim dhënie të mbështetjes financiare dhe menaxhimin e projekteve për zhvillimin e një tregu për përmirësimin e eficientës së energjisë si dhe programeve të mbështetjes të konsumatorëve fundorë në rastet e kryerjes së investimeve me kosto dhe risk të lartë. Fondi përdoret për nxitjen e programeve për përmirësimin e eficientës së energjisë për shoqëritë e shërbimeve energjetike, ekspertë të pavarur të energjisë, auditues energjetikë, shpërndarësit e energjisë, operatorët e sistemit të shpërndarjes, shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë dhe operatorët e pajisjeve eficiente., etj.
	Përdoruesi fundor i synuar	Konsumatorët në sektorët rezidencialë, të shërbimeve, industrisë, transportit dhe



		bujqësisë, dhe atyre ndërsektoriale.
	Grupi i synuar	<ul style="list-style-type: none"> - Shoqëritë e prodhimit të energjisë; - Shoqëritë e shpërndarjes së energjisë; - Shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë; - Konsumatorët fundorë të energjisë; - Siguruesit e masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.
	Aplikimi rajonal	Në shkallë vendi
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<p>Fondi krijon mundësinë për të financuar politikën dhe programet për përdorimin eficient të energjisë që është një nevojë e mbështetjes kryesore që do të ketë zbatimin në këtij Plan Veprimi Kombëtar për Eficencën e Energjisë. Krijimi dhe funksionimi me cilësi profesionale dhe kapacitet teknik të lartë të Fondit është direkt e lidhur me implementimin e kësaj PKVEE-je. Po ashtu si AEE-ja dhe Fondi është Institucion kryesor që do të kontribuojë në financimin drejtperdrejt të masave të NEEAP : R3, R4, R5, R6, R7, R8, R9, R10</p> <p>P1, P2 I1, I2, I3 H1, H2, H3, H4, H5 T1, T2, T3, T4, T5, T6, T7, T8</p>
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Nuk pritet barrë financiare shtesë në detyrën e miratimit të VKM për krijimin e Fondit, por duke qënë së është institucion i ri i krijuar janë marrë në konsideratë infrastruktura dhe operimi i këtij institucion gjatë periudhës 2018-2020.</p> <p>Sipas një kostimi paraprak për krijimin dhe funksionimin të FEE, parashikohet që buxheti i parashikuar për krijimin dhe funksionimin e FEE-së nga 2018-2020 është 215 mil ALL.</p> <p>Për krijimin dhe funksionimin e Fondit, parashikohet të financohet nga Buxheti i Shtetit, por Buxheti i Fondit që do investohet për Eficencën e Energjisë parashikohet të financohet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. fondet e përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe donatorëve të ndryshëm për financimin e projekteve, të zbatuara nga Fondi i Eficencës së Energjisë; 2. fondet nga buxheti i shtetit, nga individë dhe institucione, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve përkatëse; 3. fondet nga bashkëfinancimi i përfituesve dhe i njësive të qeverisjes vendore; 4. të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e saj



		<p>dhe shërbimet e ofruara;</p> <p>5. kontributet materiale nga programet dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe nga organizata të ndryshme jofitimprurese;</p> <p>6. burime të tjera, të lejuara nga legjislacioni në fuqi.</p>
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) / Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE)
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	<p>- Metoda - LP dhe PL; rezultatet do të përdoren për të konfirmuar ose ndryshuar treguesit karakteristikë për metodën PL të llogaritjes së kursimeve.</p> <p>- Kursimet do të maten nëpërmjet përpunimit të të dhënave të përfutuara nga rezultatet e projekteve që monitorohen nga AEE-ja dhe të dhënave të tjera të mbledhura nga AEE-ja sic përshkruan ligji 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë" dhe ligjit "Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa".</p>
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	-
	Kursimet e arritura në 2015	-/ masë e re
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	<p>Në lidhje me vlerësimin e kursimeve të pritshme nga krijimi i Fondit për Eficencën e Energjisë, theksojmë që nuk ka një ndikim të drejtpërdrejt, por e vlerësuar nga ekipi i MEI-t, e vlerësuar në cilësinë e implementimit të masave rezultojnë të kursëhet rreth</p> <p>0.6 ktoe 1,170 tCO₂ (e kombinuar me R1)</p>
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	<p>2.8 ktoe 3,291 tCO₂ (e kombinuar me R1)</p>
	Supozimet	Në kushtet ideale për implementimin masave që përmban kjo PKVEE duhet që Fondi për Eficencën e Energjisë të jetë e krijuar dhe të jetë funksional në fillim të 2018. Kjo për shkakun se FEE është e një instrument shumë i rëndësishëm financiar për implementimin e shumë nga masat që përmban kjo PKVEE.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	Krijimi i FEE-së nuk ka mbivendosje të detyrave. Efekti i FEE-së mund të ndikojë në krijimin e një instrumenti financiar garant për projektet e investimeve me kosto dhe risk të lartë. FEE i hap rrugë skemave të ndryshme të financimit të projekteve të eficientës së energjisë.



Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në funksion të Performancës së Energjisë në Ndërtesa: - metodologjia kombëtare e llogaritjes të PEN - kostos optimale për kërkesat minimale të PEN - përdorimi i sistemeve alternative me efikasitet të lartë për sistemet teknike të ndërtesave.
Indeksi i masës		R3
Përshkrimi	Kategoria	Rregullatore
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime, amendime dhe përmirësime të VKM Nr. 38, date 16.1.2003: Nevojitet rregullore e re për kërkesat minimale të sistemeve teknike të ndërtesës, bazuar në analizën e kostos optimale dhe normat që mbështesin PEN-ë.
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	i Krijimi i një metodologjie kombëtare llogaritje të performancës së energjisë të ndërtesave që do të përdoret për llogaritjen e nivelit të kostove optimale të kërkesave të performancës së energjisë të ndërtesave, njësive dhe elementëve të ndërtesave, me qëllim vlerësimin dhe plotësimin e certifikatave të performancës së energjisë. Gjithashtu nevoja për llogaritjen e kostove optimale për kërkesat minimale të PEN dhe përcaktimi i kërkesave minimale të sistemeve teknike të ndërtesës janë qëllimi kryesor i kësaj mase.
	Përdoruesi fundor i synuar	- Ndërtesat e reja dhe ekzistuese që i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja me një apartament. - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja me shumë



		<p>apartamente.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja tregtare jo rezidenciale - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja publike jo rezidenciale
	Grupi i synuar	<ul style="list-style-type: none"> - Konsumatorët fundorë të energjisë në ndërtesa; - Siguruesit e masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë. - Pronarët e ndërtesës, - Përdoruesit e ndërtesës, - Projektuesit
	Aplikimi rajonal	Në shkallë vendi
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Eficientia minimale e kërkuar për ndërtesat dhe sistemet teknike të saj duhet të përcaktohet nga llogaritja e kostos optimale të të gjithë ndërtesës dhe sistemit teknik të saj.
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Nuk pritet barrë financiare shtesë në detyrën e miratimit të ligjit për performancën energjetike të ndërtesave; Krijimi i metodologjisë, përcaktimi i kërkesave minimale me kosto optimale për ndërtesat, përdorimi i sistemeve alternative me efikasitet të lartë për sistemet teknike të ndërtesave (R3) përfshin numrin e kategorive të ndërtesave të përdorura për të përcaktuar stokun e ndërtesave. Llogaritjet me anë të metodologjisë së koston optimale për secilën kategori përfshijnë përcaktimin e sistemit të referimit të ndërtesave dhe procedurat e optimizimit për sistemin teknik, bazuar në konsumin final të energjisë.</p> <p>Kjo masë rregullatore nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit pasi është masë që do të hartohet nga AEE-ja, por vetëm në raste konsulence të jashtme bazuar në nivelin minimal të modelimit të nevojitur, kosto e zbatimit të kësaj masë është 28 Mil ALL për kategorinë e ndërtesave që mund të mbulohen nga FEE ose Fonde të tjera.</p>
	Organi zbatues	MIE (AEE)
	Autoriteti monitorues	MIE (AEE)
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Metoda - LP dhe PL; rezultatet do të përdoren për të konfirmuar ose ndryshuar treguesit karakteristikë për metodën PL të llogaritjes së kursimeve.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	-
	Kursimet e arritura në 2015	-/masë e re



Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	Kërkesa aktuale për energji në ndërtesa, bazuar në energjinë finale, për shkak të ndryshimeve të rregullores, pritet të ulet e vlerësuar kjo me këto rezultate kursimesh. 3.61 ktoe 1,487 tCO ₂ (e kombinuar me R4)
Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	9.1 ktoe 7,167 tCO ₂ (e kombinuar me R4)
Supozimet	Për implementim sa me të shpejtë të kësaj mase (R3) duhet që brenda 2018 të jetë miratuar MKLL dhe kosto optimale për kërkesat minimale të PEN. Kjo do të ndikonte në kursimin e energjisë në ndërtesa dhe në përdorimi i sistemeve alternative me efikasitet të lartë për sistemet teknike të ndëresave.
Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergia	Ndërveprimi me kërkesat e performancës energjetike për veshjen e jashtme të ndërtesës nëpërmjet llogaritjes së koston optimale.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Vlerësimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PRIVATE, përcaktimi i koston optimale për efikasitetin e energjisë për ndërtesat që parashikohet të nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat për ndërtesa të reja me performancë të larte.
Indeksi i masës		R4
Përshkrimi	Kategoria	Rregullatore
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020
	Qëllimi/Përshkrim i shkurtër	Të mbështesë me informacionin e nevojshëm për hartimin e politikave për efikasitetin e energjisë dhe zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike për sektorin e ndërtesave të banimit në Shqipëri.
	Përdoruesi fundor i synuar	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtesat e reja dhe ekzistuese private që i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja private me një apartament. - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja private me shumë apartamente. - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja private



		tregtare jo rezidenciale
	Grupi i synuar	<ul style="list-style-type: none"> - Konsumatorët fundorë të energjisë në ndërtesa; - Siguruesit e masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë. - Pronarët e ndërtesës, - Përdoruesit e ndërtesës, - Projektuesit
	Aplikimi rajonal	Në shkallë vendi
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<p>Hartimi dhe zbatimi i një modeli simulimi nga poshtë-lart të zbatueshëm për të gjithë periudhën kohore deri në vitin 2030. Marrja në shqyrtim i shërbimeve lidhur me energjinë termike të ofruar në ndërtesat e banimit, shprehimisht për ngrohjen e hapësirës, ftohjen e hapësirës dhe ngrohjen e ujit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i kategorive përkatëse të ndërtesave. - Llogaritja e performancës energjitike termike sipas 3 zonave Klimatike. - Hartimi i paketave të standartizuara të rikonstruksionit. - Përcaktimi i kursimit të mundshëm të energjisë në shkallë vendi. - Përcaktimi i investimit të kërkuar në varësi të ndërtesës. - Përcaktimi i shkallës dhe strukturës së konsumit të energjisë në të tashmen dhe të ardhmen sipas kategorisë së : <ul style="list-style-type: none"> • moshës së ndërtesës • tipit të ndërtesës • zonës klimatike • përdorimit fundor të energjisë. <p>Sugjerimi i paketave shtesë të kuadrit të sotëm të politikave të cilat kanë si qëllim ta shndërojnë stokun e ndërtesave të banimit në ndërtesa me nivelin zero të harxhimit të energjisë dhe çlirimit të karbonit deri në vitin 2050.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i <ul style="list-style-type: none"> • kursimit të energjisë • kostot e kursyera lidhur me energjinë



		<ul style="list-style-type: none"> • shkarkimet e CO2 të shmangura • kosto-efekshmëria e paketave të rinovimit.
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Nuk pritet barrë financiare shtesë në detyrën e vleresimit i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PRIVATE, përcaktimi i koston optimale për efijencën e energjisë për ndërtesat që parashikohet ti nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat për ndersa te reja me performance te larte.</p> <p>Kjo masë rregullatore nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit pasi është masë që pjesa më e madhe e studimit është kryer nga projekti SLED dhe merret në konsideratë për tu ripunuar për periudhën 2018-2020, e cila, do të hartohet nga AEE-ja, por vetëm në raste konsulence të jashtme bazuar në nivelin minimal të modelimit të nevojitur, kosto e zbatimit të kësaj mase është 36.7 Mil ALL.</p>
	Organi zbatues	MIE (AEE)
	Autoriteti monitorues	MIE (AEE)
Kursimet energjisë	e Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Metoda - LP dhe PL; rezultatet do të përdoren për të konfirmuar ose ndryshuar treguesit karakteristike për metodën PL të llogaritjes së kursimeve.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	-
	Kursimet e arritura në 2015	-/masë e re
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	Për shkak të krijimit të kësaj rregulloreje, pritet të ulet e vlerësuar kjo me këto rezultate kursimesh. 1.1 ktoe 1,487 tCO ₂ (e kombinuar me R3)
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	3.5 ktoe 7,167 tCO ₂ (e kombinuar me R3)
	Supozimet	Kjo do të ndikonte në indentifikimin e potencialit për kursimin e energjisë në ndërtesat private dhe në marrjen e masave me kosto optimale në përdorimin i sistemeve alternative me efijencë të lartë për sistemet teknike të ndërtesave private.



	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergia	Ndërveprimi me kërkesat e performancës energjetike për veshjen e jashtme të ndërtesës nëpërmjet llogaritjes së kostos optimale.
Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Vlerësimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PUBLIKE, përcaktimi i kostos optimale për eficientësinë e energjisë për ndërtesat që parashikohet të nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat për ndërtesa të reja me performancë të lartë.
Indeksi i masës		R5
Përshkrimi	Kategoria	Rregullatore
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Të mbështesë me informacionin e nevojshëm për hartimin e politikave për eficientësinë e energjisë dhe zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike për sektorin e ndërtesave të banimit në Shqipëri. Studimi duhet të sigurojë informacion për modelimin sektorial të stokut të ndërtesave publike të Shqipërisë. Një element kyç është identifikimi i tipologjisë së ndërtesave publike për Shqipërinë. Ofrimi i një mjeti për gjykimin e skenarëve të eficientimit të ndërtesave publike sipas standartëve të eficientësisë dhe konfortit Përcaktimi i një kostoje mesatare për rindërtimin, në m ² , duke marrë parasysh të gjitha kërkesat e eficientësisë energjetike për tu përfshirë në parashikimet e prokurimeve publike.
	Përdoruesi fundor i synuar	Stoku i Ndërtesave ekzistuese dhe të reja Publike si: <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtesave Qeveritare, • Kopshte, • Shkolla, • Spitale, • Universitete • Konvikte.
Grupi i synuar		- Konsumatorët fundorë të energjisë në ndërtesa;



		<ul style="list-style-type: none"> - Siguruesit e masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë. - Pronarët (Institucionet/ Administratorët) e ndërtesës, - Përdoruesit e ndërtesës, - Institucione të Prokurimeve publike - Projektuesit
	Aplikimi rajonal	Në shkallë vendi
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<p>Mënyra e mbledhjes së të dhënave të këtij studimi është Poshtë-Lart. Modelimi i skenarëve të efikasitetit të energjisë bazohet mbi të dhënat e marra në terren.</p> <p>Zhvillohet një anketim i ndërtesave sipas kategorive përkatëse të identifikuara.</p> <p>Të dhënat e përftuara mbi Elementet konstruktiv të ndërtesës Sistemet teknike</p> <p>Përpunohen për të gjykuar nevojën e ndërtesave përfaqësuese për rinovim.</p> <p>Këto të dhëna bashkë me kostot mesatare të elementëve të ndërtimit do të përcaktojnë një kosto për m² të rinovimit të ndarë sipas kategorisë së ndërtesës.</p> <p>Këto kosto do të shërbejnë si pikë referimi për prokurimet publike konform me kërkesat e efikasitetit të energjisë.</p> <p>Rezultatet specifike të pritshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i kërkesës për energji për çdo kategori. - Përcaktimi i treguesve për ngrohje, ujë të ngrohtë sanitar dhe ftohje, të tillë si: <ul style="list-style-type: none"> • energjia fundore • energjia primare • çlirimet e dyoksidit të karbonit. - Përcaktimi i opsioneve komplekse të rikonstruksionit, <ul style="list-style-type: none"> • një paketë standarde dhe • një paketë ambicioze - Përcaktimi i kursimit të energjisë. - Paraqitja e kostove specifike të investimeve edhe sipas kategorisë së ndërtesës dhe masës. - Analizë të kostove dhe përfitimeve të



		<p>rikonstruksioneve për eficencën termike të ndërtesave publike shqiptare në mbarë vendin.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryerja e analizës tradicionale financiare bazuar në krahasimin e flukseve financiare hyrëse dhe dalëse të lidhura me rikonstruksionet në eficencën termike të ndërtesave publike. - Analizë financiare duke marrë parasysh investimet kapitale, shpenzimet e instalimit dhe mirëmbajtjes, si dhe kostot e ruajtura të energjisë. - Identifikimi dhe monetarizimi i përfitimeve të tjera të përmirësimit të efikasitetit termik përtej kursimeve të kostove të energjisë. Këto përfitime përfshijnë : <ul style="list-style-type: none"> • komfort termik, • shmangiet e çlirimeve të CO₂, • shmangie e efekteve ekonomike nga ndotësve ajrit, • punësimin, • rritjen ekonomike
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Vlerësimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PUBLIKE, përcaktimi i kostos optimale për eficencën e energjisë për ndërtesat që parashikohet ti nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat për ndërtesa të reja me performancë të lartë.</p> <p>Kjo masë rregullatore nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit pasi është masë që pjesa më e madhe e studimit është kryer nga projekti SLED dhe merret në konsideratë për tu ripunuar për periudhën 2018-2020, e cila, do të hartohet nga AEE-ja, por vetëm në raste konsulence të jashtme bazuar në nivelin minimal të modelimit të nevojitur, kosto e zbatimit të kësaj mase është 33.6 Mil ALL.</p>
	Organi zbatues	MIE (AEE)
	Autoriteti monitorues	MIE (AEE)
Kursimet e	Metoda për monitorimin/matjen e	Metoda - LP dhe PL; rezultatet do të përdoren për të konfirmuar ose ndryshuar



energjisë	kursimeve që rezultojnë	treguesit karakteristikë për metodën PL të llogaritjes së kursimeve.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	-
	Kursimet e arritura në 2015	-/masë e re
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	Për shkak të krijimit të kësaj rregulloreje, pritet të ulet e vlerësuar kjo me këto rezultate kursimesh. 0.8 ktoe 2,341 tCO ₂ (e kombinuar me R6 dhe R7)
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	2.83 ktoe 3,665 tCO ₂ (e kombinuar me R6 dhe R7)
	Supozimet	Kjo do të ndikonte në indentifikimin e potencialit për kursimin e energjisë në ndërtesat publike dhe në marrjen e masave me kosto optimale në përdorimin i sistemeve alternative me efikasitet të lartë për sistemet teknike të ndërtesave publike.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	Ndërveprimi me kërkesat e performancës energjetike për veshjen e jashtme të ndërtesës nëpërmjet llogaritjes së koston optimale.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Hartimi i skemave mbështetëse financiare për përmirësimin e performancës së energjisë, në veshjen e jashtme të ndërtesave dhe sistemet teknike të ndërtesës.
Indeksi i masës		R6
Përshkrimi	Kategoria	Hartimi i akteve rregullatore për skemat e financimit dhe subvencionimit nga Fondi për Eficencën e Energjisë dhe/ose Huatë (të buta dhe/ose të subvencionuara)
	Afati kohor	Fillimi: 2010 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar hartime të akteve të reja rregullatore, amendime dhe përmirësime në lidhje me këtë masë
	Qëllimi/Përshkrim i shkurtër	Krijimi i skemave të ndryshme të financimit dhe subvencionimit nga Fondi i



		Eficcencës së Energjisë. Po ashtu mund të implementohen linjat e kreditimit të ofruara nga institucione financiare ndërkombëtare për banesat, shërbimet private dhe klientët industrialë, në koordinim me Qeverinë e Shqipërisë.
	Përdoruesi fundor i synuar	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtesat e reja dhe ekzistuese që i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja me një apartament. - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja me shumë apartamente. - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja tregtare jo rezidenciale - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja publike jo rezidenciale
	Grupi i synuar	<ul style="list-style-type: none"> - Konsumatorët fundorë të energjisë në ndërtesa; - Siguruesit e masave të përmirësimit të eficcencës së energjisë. - Pronarët e ndërtesës, - Përdoruesit e ndërtesës,
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Subveccionimet dhe skemat mëshetëse të ofruara për furnizimin dhe instalimin e masave me ndikim në kursimin e energjisë si psh. furnizimi dhe instalimi i boilerëve me EE dhe sistemeve eficientë të ngrohjes qendrore, zëvendësimi i produkteve si dritareve, dyerve, termoizolimi i mureve dhe i çatisë me ato me eficientë në kursimin e energjisë.
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Fondi i Eficcencës së Energjisë/MIE (AEE)/Fonde të tjera (IFC, GIZ, EBRD, Banka Lokale, etj.)</p> <p>Kjo masë rregullatore nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit pasi është masë që do të hartohet nga AEE-ja, por vetëm në raste konsulence të jashtme parashikohet një buxhet prej 14 Milion ALL që mund të mbulohet nga FEE ose Fonde të tjera.</p>
	Organi zbatues	Fondi i Eficcencës së Energjisë/MIE (AEE)/Fonde të tjera (IFC, GIZ, EBRD, Banka Lokale, etj.)
	Autoriteti monitorues	MIE (AEE)



Kursimet energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Është përdorur një metodë PL e përshtatur, e nxjerrë nga metodologjitë e harmonizuara, siç përshkruhet në Shtojcën A3.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	Masa nuk është përfshirë në PKVEE-në I
	Kursimet e arritura në 2018	1.2 ktoe 2,341 tCO ₂ (e kombinuar me R5 dhe R7)
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2020	4.5 ktoe 3,665 tCO ₂ (e kombinuar me R5 dhe R7)
	Supozimet	<ul style="list-style-type: none"> Supozohet se që kjo masa të implementohet për rinovimin e stokut të ndërtesave private dhe publike
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergia	<ul style="list-style-type: none"> Për të parandaluar mbivendosjet e projekteve të njëjta duhet të organizohet mbledhja e përqendruar e të dhënave.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Hartimi i një planit të veprimit për të rritur numrin e ndërtesave me performancë afër zero-energji.
Indeksi i masës		R7
Përshkrimi	Kategoria	Rregullatore
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Parashikohet hartimi i një plan veprimi për të rritur numrin e ndërtesave me performancë afër zero-energji. – masë e re.
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Ndërtesat me konsum energjie pothuajse zero janë domosdoshmëri për arritjen e qëllimeve dhe përcaktimin e drejtimit për ndërtesat e reja dhe ato të rinovuara. Llogaritjet e kostos optimale në masaën R3 dhe dhe vlerësimi i potencialit të kursimit në masat R4 dhe R5, si një rezultat dytësor, japin informacion mbi koston e ciklit të jetëgjatësisë për ndërtesat ekzistuese, d.m.th. kërkesa për energji me koston efektive më të ulët për NKEZ-të.
	Përdoruesi fundor i synuar	- Ndërtesat e reja dhe ekzistuese që i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm



		<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja me një apartament. - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja me shumë apartamente. - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja tregtare jo rezidenciale. - Ndërtesat ekzistuese dhe të reja publike jo rezidenciale.
	Grupi i synuar	<ul style="list-style-type: none"> - Konsumatorët fundorë të energjisë në ndërtesa; - Siguruesit e masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë. - Pronarët e ndërtesës, - Përdoruesit e ndërtesës,
	Aplikimi rajonal	Në shkallë vendi
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<p>Pas zbatimit të standardeve që mbështesin PEN-ë, kërkesat minimale për ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese duhet të përcaktohen sipas metodologjisë së kostos optimale.</p> <p>Përcaktimi i NKEZ-ve duhet të vendoset përpara afatit aktual të zbatimit për të lejuar përshtatjen e sektorit të ndërtimit me kërkesat e ardhshme.</p>
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Fondi i Eficencës së Energjisë/MIE (AEE)/Fonde të tjera (IFC, GIZ, EBRD, Banka Lokale, etj.)</p> <p>Kjo masë rregullatore nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit pasi është masë që do të hartohet nga AEE-ja, por vetëm në raste konsulence të jashtme parashikohet një buxhet prej 28 Milion ALL që mund të mbulohet nga FEE ose Fonde të tjera</p>
	Organi zbatues	MIE (AEE)
	Autoriteti monitorues	MIE (AEE)
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Metoda - LP dhe PL; rezultatet do të përdoren për të konfirmuar ose ndryshuar treguesit karakteristikë për metodën PL të llogaritjes së kursimeve
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	-
	Kursimet e arritura në 2015	-/ masë e re
	Kursimet e pritshme të	Kursimet e pritshme nga kjo masë janë



	energjisë në 2018	0.8 ktoe kursime në 2018. 2,341 tCO ₂ (e kombinuar me R5 dhe R6)
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	1.2 ktoe kursime në 2020. 3,665 tCO ₂ (e kombinuar me R5 dhe R6)
	Supozimet	Performanca energjetike aktuale e veshjes së jashtme të ndërtesës; numri i ndërtesave të ndërtuara në vit.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	Ndërveprimi me kërkesat e performancës energjetike për sistemet e ndërtesës - kërkohet fuqi e instaluar më e ulët, eficienta e sistemeve të ndërtesës.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Përcaktimi i klases së energjisë për produktet që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë, të cilat përmbushin kërkesat minimale të eficientës së energjisë, siç përcaktohet në ligjin 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë" dhe ligjin 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji".
Indeksi i masës		R8
Përshkrimi	Kategoria	Informimi dhe masat e informimit të detyrueshëm; Instrumentet financiare
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime, amendime dhe përmirësime: Masa është vazhdim dhe përmirësim i masave të mëparshme "Legjislacioni dhe zbatimi i kuadrit ligjor për etiketimin e pajisjeve me ndikim në konsumin e energjisë" dhe "Zbatimi i standardeve minimale për pajisjet elektroshtëpiake".
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Etiketimi i pajisjeve me ndikim në konsumin e energjisë, sipas klasave të eficientës, bazuar në standardet evropiane, është prezantuar me siç përcaktohet në ligjin 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë" dhe ligjin 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji", nga pajisjet për përdorim shtëpiak, nëpërmjet etiketimit dhe informacionit standard të produkteve". Për zbatimin e tij duhet të përgatiten aktet nënligjore me standardet minimale për



		pajisjet me ndikim në konsumin e energjisë. Gjithashtu, duhet të krijohet programi i bashkëfinancimit për prokurimin e pajisjeve më efikente që gjenden në treg, si dhe zëvendësimin e pajisjeve të vjetra.
	Përdoruesi fundor i synuar	Konsumatorët fundor / Pajisjet me ndikim në konsumin e energjisë
	Grupi i synuar	<ul style="list-style-type: none"> - Konsumatorët fundorë të energjisë në ndërtesa; - Siguruesit e masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë. - Pronarët e ndërtesës, - Përdoruesit e ndërtesës, - Qytetarët
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Duhet të zbatohet kuadri rregullator për etiketimin energjetik të pajisjeve me ndikim në energji dhe Eko-dizajnin, përfshirë aktet nënligjore të nevojshme. Programi për bashkëfinancimin e prokurimit të pajisjeve më efikente që gjenden në treg, si dhe zëvendësimin e pajisjeve të vjetra, të cilat po hiqen nga përdorimi, duhet të hartohet nga MEF dhe AEE-ja.
	Buxheti dhe burimi financiar	MEF - 14 Mil ALL për Programin
	Organi zbatues	MEF e mbështetur nga MIE (AEE)
	Autoriteti monitorues	MEF / MIE (AEE)
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Metoda PL do të përdoret për të monitoruar suksesin e skemës së bashkëfinancimit për blerjen e pajisjeve të reja. Për të monitoruar efektin e përgjithshëm të skemës së etiketimit të pajisjeve, sipas efikasitetit të energjisë, do të përdoren treguesit LP.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	Asnjë kursim i arritur
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	0.61 ktoe
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	3.1 ktoe
	Supozimet	Kursimet mund të vlerësohen në 5% të konsumit të përgjithshëm të energjisë



		elektrike nga pajisjet në banesa.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	Për të parandaluar mbivendosjet e projekteve të njëjta duhet të organizohet mbledhja e përqendruar e të dhënave.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Certifikimi energjetik i ndërtesave
Indeksi i masës		R9
Përshkrimi	Kategoria	Informimi dhe masat e detyrueshme të informimit
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Është parashikuar krijimi i një akti rregullator i ri ku procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës së energjisë të ndërtesave si dhe modeli, përmbajtja, kushtet e regjistrimit të certifikatës së performancës së energjisë të ndërtesave përkatëse sipas parashikimit të Nenit 11 të ligjit të PEN, përcaktohen Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
	Qëllimi/Përshkrimi i shkurtër	Në përputhje me kuadrin ligjor të ri të Performancës së Energjisë së Ndërtesave.
	Përdoruesi fundor i synuar	Ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese
	Grupi i synuar	<ul style="list-style-type: none"> - Konsumatorët fundorë të energjisë në ndërtesa; - Siguruesit e masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë. - Pronarët e ndërtesës, - Përdoruesit e ndërtesës,
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Për të harmonizuar cilësinë dhe metodën e zbatimit të auditimeve energjetike do të miratohet një metodologji kombëtare e kryerjes së auditimeve energjetike. Auditimet Energjetike dhe certifikimi energjetik i ndërtesave duhet të kryhen nga ekspertë të trajnuar dhe të autorizuar, ndaj duhet të krijohet programi dhe procesi i trajnimit të tyre. Duhet të krijohet regjistri i ekspertëve të miratuar dhe i certifikatave energjetike të lëshuara, i cili mund të ketë elementë të përbashkët për auditimin e plotë



		<p>dhe dhënien e certifikatave për ndërtesat. Duhet të prezantohen aktet nënligjore të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja për certifikimin energjetik dhe auditimet energjetike të ndërtesave • Rregullorja për personat që kryejnë auditime energjetike dhe certifikim energjetik • Metodologjia e kryerjes së auditimeve energjetike <p>Çertifikimi i performancës së energjisë në ndërtesa duhet të jetë i detyrueshëm për:</p> <p>(a) Të gjithë ndërtesat ose njësitë e ndërtesave të cilat do të shiten ose do të jepen me qira;</p> <p>(b) Të gjithë ndërtesat të cilat ndërtohen ose do ti nënshtrohen rinovimit të rëndësishëm;</p> <p>(c) Të gjithë ndërtesat që janë në përdorim nga një autoritet publik ose nga institucionet që sigurojnë një shërbim ndaj publikut dhe që frekuentohen shpesh nga publiku, të cilat kanë një sipërfaqe të shfrytëzueshme deri në 500 m². Duke filluar nga data 9 Korrik 2018, kërkesa për kufirin e mësipërm të sipërfaqes së shfrytëzueshme do të zvogëlohet deri në 250 m². Në këtë rast certifikatat e performancës së energjisë duhet të vendosen në vende qartësisht të dukshme nga publiku..</p> <p>Pronari i ndërtesës ekzistuese do të sigurojë që certifikata e energjisë të bëhet pjesë integrale e kontratës së shitjes/qirasë, kur ndërtesa shitet ose jepet me qira. Të gjitha ndërtesat ekzistuese që shiten, jepen me qira, duhet të vënë në dispozicion të blerësit ose qiramarrësit certifikatën e energjisë.</p> <p>Ndërtesat publike duhet të shfaqin në mënyrë publike certifikatën e energjisë, e cila përfshin një listë të masave për rritjen e efikasitetit të energjisë.</p>
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Fondi i Eficencës së Energjisë/MIE (AEE)/Fonde të tjera (IFC, GIZ, EBRD, Banka Lokale, etj.)</p> <p>Kjo mase rregullatore nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit pasi është masë që do të hartohet nga AEE-ja dhe do të vihet në funksion nëpërmjet trupës së Audituesvë të Energjisë dhe ESCO-ve, të cilët, do të zhvillojnë procesin e certifikimeve energjetike. Kjo skemë certifikimi mund të jetë dhe skemë subvencionimi në kuader të</p>



		marrveshjeve vullnetare nëpërmjet konsumatorëve të mëdhenj – AEE-së dhe Fondit të EE-së.
	Organi zbatues	MIE (AEE)
	Autoriteti monitorues	MIE (AEE)
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/ matjen e kursimeve që rezultojnë	PL sipas metodologjisë për M&V&V
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	Asnjë kursim i arritur
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	0.34 ktoe
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	4.2 ktoe
	Supozimet	Kursimet mund të vlerësohen në 5% të konsumit të energjisë, për skenarin bazë, të paraqitur në auditimet energjetike.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergia	Kjo masë mund të mbivendoset me Auditimet Energjetike dhe menaxhimin e energjisë në kompanitë e mëdha dhe auditimet energjetike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Nëse auditimi energjetik kryhet me qëllim lëshimin e certifikatës energjetike, atëherë efektet jepen në këtë masë.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Rinovim i stokut të ndërtesave publike me 2% cdo vit të sipërfaqes së ngrohur/ftohur për ndërtesat që janë në administrim ose përdorim nga një autoritet publik ose nga institucionet që sigurojnë një shërbim ndaj publikut, me qëllimin për përmbushjen e kërkesave minimale të performancës së energjisë.
Indeksi i masës		R10
Përshkrimi	Kategoria	Rregullatore
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Sugjerim në raportin përfundimtar të projektit SLED për ndërtesat publike.



	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	i	Qëllimi i kësaj masë është rinovimi i ndërtesave që janë në administrim ose përdorim nga një autoritet publik ose nga institucionet që sigurojnë një shërbim ndaj publikut, sipas kriterëve që përmbushin kërkesave minimale të performancës së energjisë.
	Përdoruesi fundor synuar	i	Ndërtesat publike që i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm.
	Grupi i synuar		Stoku i Ndërtesave ekzistuese dhe të reja Publike si: <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtesave Qeveritare, - Kopshte, - Shkolla, - Spitale, - Universitete - Konvikte.
	Aplikimi rajonal		Në shkallë vendi
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën		<p>Kjo masë parashikon një sasi investimi të shpërndarë në të gjitha zonat në mënyrë proporcionale me ndarjen e sipërfaqes së ndërtesave sipas tipit të ndërtesave.</p> <p>Ky skenar sugjeron rinovimin e 530,000 m² sipërfaqe të ndërtesave publike.</p> <p>E shpërndarë proporcionalisht në territorin e Shqipërisë sipas kategorisë së ndërtesave dhe ndarjes së tyre në zonat Kimatike.</p> <p>Kjo përbën 8 % të sipërfaqes së stokut total të ndërtesave publike.</p> <p>Investimi mendohet të përfshijë 2% të stokut në vit, me një kosto prej 1.4 Miliard ALL .</p> <p>Impakti i punësimit sipas studimit SLED llogaritet të jetë 5987 të punësuar për periudhën 2018-2020 nëse do të implementohet masa e plotë.</p> <p>Të gjitha ndërtesat do të rikonstruktohen duke pasur parasysh nivelin e performancës të përcaktuar nga masa rregullatore R5.</p>
	Buxheti dhe burimi financiar		<p>Fondi i Eficencës së Energjisë/MIE (AEE)/Fonde të tjera (IFC, GIZ, EBRD, Banka Lokale, etj.)</p> <p>Buxheti i kërkuar për rikonstruktimin e ndërtesave në të cilat kursimi i energjisë do të ishte më i ndjeshëm është 5'440 Milion ALL.</p>



		<p>Kjo masë implementuese ka ndikim në buxhetin e shtetit pasi është masë që kërkon investim të drejtpërdrejtë në ndërtesat që përdoren nga autoritetet publike. Nëse kjo masë do të mund të trajtohet me një plan konkret zhvillimi mund të këtë hapsira për të krijuar partneritet investimi ose të zhvillohen skema investimi nëpërmjet kompanive ESCO-ve dhe Pushtetit Vendor ose partneritet Publik-Privat. Kjo masë varet shumë nga potenciali i kursimit për të vendosur mbi skemat e financimit për implementimin e kësaj mase. Po ashtu kjo mund të jetë dhe skeme subvencionimi në kuader të marrveshjeve vullnetare nëpërmjet konsumatorëve të mëdhenj - AEE-së dhe Fondit të EE-së.</p>
	Organi zbatues	MIE (AEE)-në/Fondi i EE-së/Pushteti Vendor/Fonde të tjera
	Autoriteti monitorues	MIE (AEE)
Kursimet energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Metoda - LP dhe PL; rezultatet do të përdoren për të konfirmuar ose ndryshuar treguesit karakteristikë për metodën PL të llogaritjes së kursimeve
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	-
	Kursimet e arritura në 2015	-/ masë e re
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	Kursimet e pritshme nga kjo masë janë 1.8 ktoe kursime në 2018. 2,000 tCO ₂
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	4.1 ktoe kursime në 2020. 4,913 tCO ₂
	Supozimet	Performanca energjetike aktuale e veshjes së jashtme të ndërtesës; numri i ndërtesave publike që i nënshtrohen rinovimit të rëndësishëm në vit.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	Ndërveprimi me kërkesat e performancës energjetike për sistemet e ndërtesës - kërkohet fuqi e instaluar më e ulët, eficaenca e sistemeve të ndërtesës.



Tabela 13.a Efektet social-ekonomike të masave në ndërtesa nga Investime të Buxhetit Publik/ Fondi për EE-në

Masa	Financimi total nga Buxheti publik/ Fondi për EE-në (Mil ALL)	Kursimet vjetore të lëndës djegëse (Mil ALL)	Punësim i ri (vende pune)	
R1,R2,R3,R4,R5,R6	Rregullatore/Krijim institucioni	700	3'178	168
R8	Rregullatore	14	344	23
R9	Informim i detyrueshëm	-	465	31

Tabela 13.b Efektet social-ekonomike të masave në ndërtesa nga Investime të Buxhetit publik/Fondi për EE-në/Fonde të tjera

Masa	Financimi total shtesë i kërkuar Buxheti publik/Fondi për EE-në/Fonde të tjera (Mill ALL)	Kursimet vjetore të lëndës djegëse (Mil ALL)	Punësim i ri (vende pune)	
R10	Infrastrukturë	5'440	668 ⁴	1'497

Në lidhje me financimet për rinovimin stokut të ndërtesave kërkohen investime të mëdha. Është e qartë se kostot e këtyre investimeve nuk mund të mbulojnë vetëm prej buxhetit dhe parave publike. Qëllimi i qeverisë është të përdorë mjete të politikave dhe buxhetin e parave publike për të nxitur e shtuar investimet private për ndërtimin dhe rikonstruksionin e ndërtesave më efikente në aspektin termik. Për të siguruar që të gjitha ndërtesat ekzistuese, që do të mbeten edhe pas vitit 2050 dhe që do të rikonstruktohen deri në këtë kohë, supozojmë se Shqipëria do të fusë stimuj financiarë për investitorët në sektorin e banimit. Këto përfshijnë futjen e kredive me normë të ulët interesi për 90% të familjeve në shtëpi të veçuara ose gjysëm të veçuara si dhe futjen e ndihmës në formë grantesh për pjesën e mbetur prej 10% të këtyre familjeve. Gjithashtu, këtu përfshihet edhe futja e kredive për 10% banesave familjare tashmë të rikonstruktura dhe pallateve me shumë apartamente banimi; kjo pjesë supozohet të rritet me 90% deri në vitin 2050. Pjesa e mbetur e banesave familjare në varg ose soletë betoni dhe pallateve me shumë apartamente banimi duhet të përfitojnë grante.

Pra, sic parashikohet skenarin e moderuar të SLED, në periudhën 2015 deri në 2020 do të jenë rikonstruktuar 6.4 milion m² ose 1.6 milion m² në vit ose 2.5% e stokut në vit. Kostoja e investimeve të përgjithshme për rikonstruksionin e ndërtesave është 85.7 Miliardë ALL për periudhën nga 2018 në 2020, ose 21.4 Miliardë ALL në vit. Përfitimet e pritshme nga kostot

⁴ Ky kursim prej 668 Mil ALL është llogaritur vetëm për periudhën 2018-2020. Kjo do të thotë që kosto e investimit për vitet e para nuk kthehet menjëherë nga kursimet e pritshme.



e energjisë së kursyer kundrejt skenarit të references vlerësohen në 6.3 Miliardë ALL deri në vitin 2020.

Gjithashtu, nga ky rinovim i stokut të ndërtesave private për periudhën 2018-2020 vlerësohet të shmangen reth 4'700 ton CO2 të cliruara në atmosferë. Këto të dhëna të mësipërme do të jenë subjekt i skemave financuesë nga Fonde të eficientës së energjisë për sektorin privat të banesave, kredive të buta për EE nga Bankat, strategjive të rinovimit të stokut të ndërtesave privatë, etj.

Masat në sektorin publik

Një listë përmbledhëse e të gjitha masave të propozuara për eficientën e energjisë që lidhen me sektorin publik (përjashtuar ato që tashmë janë identifikuar në tekstin e mësipërm dhe që lidhen me ndërtesat) jepet më poshtë, së bashku me kursimet e pritshme të energjisë në 2020, në ktoe, dhe financimin publik të kërkuar në euro.

Tabela 14 Lista përmbledhëse e masave në sektorin publik

Indeksi	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Përdoruesi i fundor synuar	Kursimet e pritshme të energjisë në 2020 (ktoe)	Financimi total i kërkuar nga buxheti publik, (Milion ALL)
P1	Programi 'Ndriçimi Publik me Eficientë të Energjisë'	Konsumi i energjisë elektrike për ndriçimin publik	3.9	-
P2	Miratimi i rregullave për Prokurimet publike 'të gjelbra' me fokus ndërtesat publike	Të gjitha llojet e konsumit të energjisë në sektorin publik	12.1	28

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Programi 'Ndriçimi Publik me Eficientë të Energjisë'
Indeksi i masës		P1
Përshkrimi	Kategoria	Instrumente financiare, shërbime energjetike për kursimet e energjisë
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020



		Është parashikuar krijimi i një akti rregullator i ri ku parashikohen kryerja e shërbimeve energjetike që përfshihen një ose më shumë veprimtari apo masa për përmirësimin e efijencës së energjisë dhe kursimin e energjisë sipas parashikimit të Nenit 18 të ligjit të 124/2015 për EE: Masa është vazhdim dhe përmirësim i masës së mëparshme “Promovimi i Kontraktimit të Performancës Energjetike dhe ndriçimi rrugor në bashki”
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Kjo masë nxit efijencën e energjisë në sistemet e ndriçimit publik nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm financiarë: bashkëfinancimi i masave dhe shërbimeve energjetike të kompanive ESCO.
	Përdoruesi fundor synuar	Konsumi i energjisë elektrike për ndriçimin publik
	Grupi i synuar	<ul style="list-style-type: none"> - Personat përgjegjës për ndriçimin publik, kompanitë, - Konsumatorët fundorë të energjisë, - Siguruesit e masave të përmirësimit të efijencës së energjisë në ndriçimin publik- Ofruesit e shërbimeve energjetike (ESCO-t).
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<p>Sektori publik duhet të detyrohet të organizojë menaxhimin e energjisë dhe të zbatojë masat për efijencën e energjisë në ndërtesat e saj dhe në ndriçimin publik (me detyrimin e kryerjes së auditimeve energjetike periodike). Duhet të prezantohet akti ligjor për mbrojtjen nga ndotja e ndriçimit, me detyrimet për të përpiluar planet e veprimit për përputhshmërinë e ndriçimit publik me standardet e përshtatshme dhe për të raportuar çdo vit mbi aktivitetet e zbatuara. Personat përgjegjës do të stimulohen për të shfrytëzuar potencialet e tyre për kurse të energjisë, nëpërmjet përdorimit të shërbimeve energjetike, pa vendosur barrë buxhetore.</p> <p>Programi i detajuar për rinovimin e ndriçimit publik duhet të hartohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja) në bashkëpunim me Pushtetin Vendor. Zbatimi i Programit duhet të fillojë në 2018. Programi duhet, ndër të</p>



		tjera, të përfshijë dhe zhvillojë komponentët inovativë për mekanizma të ndryshëm financiarë.
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Fondi i Eficencës së Energjisë/MIE (AEE)/Pushteti Vendor/Fonde të tjera (IFC, GIZ, EBRD, Banka Lokale, etj.)</p> <p>Kjo mase implementuese ka ndikim nëse do të implementohet nga buxheti i shtetit pasi është masë që kërkon investim të drejtpërdrejtë në sistemin e ndricimit publik. Nëse kjo masë do të mund të trajtohet me një plan konkret zhvillimi mund të këtë hapsira për të krijuar partneritet investimi ose të zhvillohen skema investimi nëpërmjet kompanive ESCO dhe Pushtetit Vendor ose partneritet Publik-Privat. Kjo masë varet shumë nga potenciali i kursimit për të vendosur mbi skemat e financimit për implementimin e kësaj mase. Po ashtu kjo mund të jetë dhe skeme subvencionimi në kuader të marrveshjeve vullnetare nëpërmjet konsumatorëve të mëdhenj - AEE-së dhe Fondit të EE-së.</p> <p>Buxheti i parashikuar për implementimin e kësaj mase është 334 Mil ALL deri në 2020.</p>
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja) / Fondi për EE-në / Pushteti Vendor
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
Kursimet energjisë	e Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	PL sipas metodologjisë për M&V&V-në
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	1.2 ktoe
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	3.9 ktoe
	Supozimet	Kursimi mund të vlerësohet në 450 KWh në vit për ndriçues. Zëvendësimi i 10,000 ndriçuesve në vit.



	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergia	Për të parandaluar mbivendosjet e projekteve të njëjta duhet të organizohet mbledhja e përqendruar e të dhënave.
--	--	--

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Prokurimet publike 'të gjelbra'
Indeksi i masës		P2
Përshkrimi	Kategoria	Rregullatore
	Afati kohor	Fillimi: 2018 End: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masa është vazhdim dhe përmirësim i masës së mëparshme "Kërkesat për prokurimet publike të produkteve me EE".
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Është e nevojshme që të fillojnë aktivitetet të cilat mund t'u ofrojnë specialistëve të prokurimeve publike njohuritë ligjore dhe teknike për përfshirjen dhe vlerësimin e kërkesave të eficiencës së energjisë në procedurat e prokurimeve publike, duke zbatuar kriterin e ofertës ekonomike më të favorshme, përmes analizës së kostos së ciklit të jetëgjatësisë.
	Përdoruesi fundor i synuar	Të gjitha llojet e konsumit të energjisë në sektorin publik, përfshirë konsumin e karburanteve nga automjetet e përdorura nga sektori publik.
	Grupi i synuar	Personat kompetentë për prokurimet publike në nivel kombëtar dhe LRSGU-je.
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Aktivitetet e ardhshme: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet AEE-së, në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës dhe organet e tjera përkatëse, duhet të hartojnë një udhërrëfyes (udhëzime) për integrimin e kërkesave të eficiencës së energjisë në procedurat e prokurimeve publike, i cili do të përfshinte edhe përpunimin e detajuar të kriterëve teknike për prokurimin e gjelbër të produkteve të caktuara. Me udhëzim të qeverisë, ky udhërrëfyes (udhëzime) duhet t'u dërgohet të gjitha institucioneve shtetërore dhe autoriteteve lokale dhe



		<p>rajonale.</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duhet të koordinojë projektin e Planit Kombëtar të Veprimit për Prokurimet Publike të Gjelbra, i cili do të identifikojë palët e interesuara dhe masat kryesore që duhet të ndërmerren, në nivel kombëtar dhe lokal, për të arritur integrim më të mirë të kriterëve të prokurimeve publike të gjelbra në procedurat e prokurimeve publike.</p> <p>Pasi të hartohet udhërrëfyesi, duhet të përgatiten dhe zbatohen kurset dhe aktivitetet e tjera të edukimit për punonjësit e administratës publike, qendrore dhe lokale, që do të kryejnë prokurimet, si dhe duhet të krijohet një sistem monitorimi për përdorimin e kriterëve të gjelbra.</p>
	Buxheti dhe burimi financiar	Fondi i Eficencës së Energjisë/MIE (AEE)/ /MM/ MEF/Pushteti Vendor
	Organi zbatues	MIE (AEE)/Fondi për EE-në/MM/ MEF
	Autoriteti monitorues	MIE (AEE)
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Efektet e kësaj mase monitorohen nëpërmjet përdorimit të metodës PL, të rekomanduar nga Komisioni Evropian, si dhe metodës kombëtare të vlerave të referencës.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	5.07 ktoe
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	12.1 ktoe
	Supozimet	Duke pasur parasysh mungesën e aktiviteteve (prokurimet publike) të cilave mund t'u alokohen kursime të energjisë gjatë periudhës së mëparshme, nuk është e mundur që të alokohen kursimet e vlerësuara as në 2018, as në 2020. Megjithatë, kur të fillojë zbatimi i kësaj mase, do të krijohet një sistem për monitorimin e efekteve, nëpërmjet metodës PL, dhe si rrjedhojë pritet që të jetë e mundur të llogariten kursimet e



		energjisë për këtë masë në periudhën e ardhshme.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	Prokurimi i produkteve me EE do të kryhet jo vetëm për pajisjet (do të zbatohet standardi i ndërtesave të reja publike dhe në këtë mënyrë do të reflektohet në prokurimet publike).

Efektet e vlerësuara social-ekonomike të masave sasiore në sektorin publik paraqiten në Tabelën 15 a dhe b.

Tabela 15.a Efektet social-ekonomike të masave në sektorin publik nga Investime të Buxhetit Publik/ Fondi për EE-në/Fonde të tjera

Masa	Financimi total nga Buxheti publik/ Fondi për EE-në/Fonde të tjera (Mil ALL)	Kursimet vjetore të lëndës djegëse (Mil ALL)	Punësim i ri (vende pune)	
P1	Infrastrukturë	334	635	48

Tabela 15.b Efektet social-ekonomike të masave në sektorin publik nga Investime të Buxhetit publik/Fondi për EE-në

Masa	Financimi total shtesë i kërkuar Buxheti publik/Fondi për EE-në (Mill ALL)	Kursimet vjetore të lëndës djegëse (Mil ALL)	Punësim i ri (vende pune)	
P2	Regullatore	28	1'333	5

Masat në industri dhe NVM-të

Një listë përmbledhëse e të gjitha masave të propozuara për eficientësi të energjisë, në lidhje me sektorin e industrisë, jepet në Tabelën 16 më poshtë, së bashku me kursimet e pritshme të energjisë në 2020, në ktoe, dhe financimin publik të kërkuar në euro, për ato aktivitete ku vlerësimi ishte i mundur.



Tabela 16 Lista përmbledhëse e masave në industri

Indeksi	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Përdoruesi i fundor synuar	Kursimet e pritshme të energjisë në 2020 (ktoe)	Financimi total i kërkuar (para publike), Milion ALL
I1	Kërkesat minimale të efikasitetit të energjisë për proceset industriale dhe skemat detyruese.	Sektori i industrisë	3.7	36.7
I2	Auditimet energjetike për ndërmmajet industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, të cilët, sipas skemes detyruese, nënshkruajnë marrëveshje vullnetare në përputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë".	Ndërtesat e ndërmarrjeve industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë.	2.3	153
I3	Marrëveshjet vullnetare për ndërmmarjet industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, të cilët, nënshkruajnë marrëveshje vullnetare në përputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë".	Kompanitë industriale	0.9	9.8

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Kërkesat minimale të efikasitetit të energjisë për proceset industriale dhe skemat detyruese.
Indeksi i masës		I1
Përshkrimi	Kategoria	Kategoria: Rregullimi / Nënkatëoria: Standardet minimale të performancës energjetike të pajisjeve
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masë nga PKVEE-ja I



	<p>Qëllimi/Përshkrim shkurtër</p>	<p>i</p> <p>Në sektorin e industrisë, në shumë raste, deri në 70% e konsumit total të energjisë elektrike konsumohet nga motorët elektrikë që sigurojnë energji lëvizëse. Si pasojë, ato përfaqësojnë një potencial tepër të lartë për kursime, kryesisht për shkak se masat dhe programet sistematike nuk zbatohen në këtë sektor. Në të shumtën e rasteve, zëvendësimi i motorit elektrik brenda transmisionit elektrik nuk është i mjaftueshëm. Është më tepër e nevojshme të përdoren sisteme të rregulluara duke instaluar inverter fuqie (frekuenca), ku kursimet e energjisë mund të realizohen nëpërmjet sasisë optimale të prurjeve fluide, e cila nënkupton përshtatjen ndaj situatës reale në proces.</p> <p>Kursimet vijnë nga ulja e kostos së përdoruesit fundor, si dhe nga ulja e fuqisë së instaluar (pik). Për operimin e përshtatshëm të motorëve elektrikë kërkohet energji reaktive si dhe aktive, kështu që rekomandohet instalimi i një pajisjeje, qendrore ose lokale, për kompensimin e fuqisë reaktive, e cila ul koston e përdoruesit fundor dhe ul humbjet në rrjetin e transmetimit dhe në këtë mënyrë konsumin e energjisë primare.</p> <p>Masa do të synojë edhe kaldajat industriale, ndërsa aktivitetet e tjera të nën-sektorëve të industrisë do të analizohen dhe vlerësohen nëpërmjet auditimeve energjetike specifike të impiantit dhe përmirësimeve të efijencës së energjisë.</p>
	Përdoruesi fundor i synuar	Sektori i industrisë
	Grupi i synuar	Kryesisht kompanitë industriale
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<p>Aktivitetet në të ardhmen:</p> <ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi dhe zbatimi kërkesave minimale të efijencës së energjisë për proceset industriale dhe skemat detyruese, në lidhje me ligjin nr. 124/2015, për racionalizimin e konsumit të energjisë elektrike me vlerësimin e efektivitetit të kostos së përmirësimeve, me një metodologji të thjeshtë që zbatohet



		<p>pothuajse në të gjitha impiantet industriale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i modeleve të favorshme të bashkëfinancimit me zhvillimin e mekanizmave të garancisë. • Trajnimi i Menaxherëve të Energjisë në sektorin e industrisë
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Kjo masë rregullatore do të hartohet nga AEE-ja dhe nuk pritet të ndikim në buxhetin e shtetit, por vetëm në rastet e konsulencës së huaj ose shpenzimeve në rritjen e kapaciteteve teknike të AEE-së në fushën e EE-së në proceset industriale do të kërkojë një buxhet të llogaritur prej 36.7 Milion ALL.</p> <p>Burimi i bashkëfinancimit: Fondi i Eficencës së Energjisë/MIE (AEE) /Fonde të tjera (IFC, GIZ, EBRD, Banka Lokale, etj.)</p>
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
Kursimet energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Monitorimi i ndikimit të këtyre masave realizohet nëpërmjet përdorimit të metodës PL të Komisionit Evropian. Në përgjithësi është e mundur të përdoret parimi i “kursimit të matur”, bazuar në matjet e kryera përpara dhe pas zbatimit të masave për eficiencën e energjisë.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	2.25 ktoe
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	3.70 ktoe
	Supozimet	Deri në 70% e konsumit total të energjisë elektrike konsumohet nga motorët elektrikë që sigurojnë energji lëvizëse. Kursimet ekonomike janë më të ulëta se ato teknike, por megjithatë mjaftueshmërisht të larta që kjo masë të jetë ekonomikisht e realizueshme. Kompanitë duhet të inkurajohen që të



		<p>zbatojnë programe të integruara për zëvendësimin dhe përmirësimin e motorëve elektrikë që sigurojnë energji lëvizëse dhe jo të përdorin zgjidhje emergjente për raste të veçanta. Auditimet energjetike të standardizuara japin një vlerësim të qëllimit dhe potencialit për zbatimin e kësaj mase që lehtëson më tej financimin, nëse ka modele të zhvilluara financimi.</p> <p>Në këtë model supozohet që, deri në 2018, të zëvendësohet 10% e pajisjeve ekzistuese industriale të vjetëruara (motorët elektrikë) dhe 10% tjetër deri në 2020.</p>
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	Një numër i konsiderueshëm i motorëve të vjetër elektrikë, që përdoren aktualisht, janë mbi kapacitetin e duhur - duke zbatuar këtë masë do të ulen fuqia e instaluar, si edhe kostot përkatëse, dhe do të shmangeshin mbingarkesat e papritura të rrjetit.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Auditimet energjetike për ndërmarrjet industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, të cilët, sipas skemes detyruese, nënshkruajnë marreveshje vullnetare ne perputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë".
Indeksi i masës		I2
Përshkrimi	Kategoria	Instrumente financiare, informimi
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Kjo masë është vazhdim dhe përmirësim i masës së mëparshme: "Skema e auditimit për industrinë".
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Objektiva e kësaj mase është ofrimi i mbështetjes financiare ndërmarrjeve për ndërmarrjet industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, të cilët, sipas skemes detyruese, nënshkruajnë marreveshje vullnetare ne perputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë", në mënyrë që ato të prezantojnë dhe zbatojnë aktivitetet për përmirësimin e



		eficiencës së energjisë dhe kryesisht për kryerjen e auditimeve energjetike me cilësi të lartë dhe menaxhimin e vazhdueshëm të energjisë (prezantimi i standardeve ndërkombëtare, të tilla si ISO 50001), si dhe për promovimin e aktiviteteve promocionale-edukuese për punonjësit.
	Përdoruesi fundor i synuar	Ndërtesat e ndërmarrjeve për ndërrmajat industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, të cilët, sipas skemes detyruese, nënshkruajnë marreveshje vullnetare në përputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë".
	Grupi i synuar	Ndërrmajat industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<p>Aktivitetet e ardhshme:</p> <p>Për ndërrmajat industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë që duan të përmirësojnë eficiencën e energjisë në kompanitë e tyre do të ketë dy lloje mbështetjesh:</p> <p>Mbështetje financiare - një thirrje për tender për financimin e auditimeve energjetike të ndërtesave të ndërrmajat industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë.</p> <p>Mbështetje edukuese - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja) do të hartojë, deri në fund të 2018, metodologji standarte për zhvillimin e procesit të auditimit në ndërmarjet industriale. Kjo mund të shërbejë për informimin në procesin e auditimit të ndërrmajeve industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë. Në përputhje me kriteret ekzistuese, do të shpallet thirrja për tender për ofruesin e aktiviteteve edukuese. Është roli i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të specifikuar se cila kritere duhet të përmbushë edukimi.</p> <p>Aktivitetet edukuese duhet të mbulojnë çështjet e mëposhtme:</p> <p>Prezantimi i një sistemi të menaxhimit të energjisë</p> <p>Auditimi energjetik</p> <p>Projektet e përmirësimit të eficiencës së</p>



		energjisë
	Buxheti dhe burimi financiar	MIE (AEE)/Fondi për Eficiencën e Energjisë - Buxheti parashikohet të jetë rreth 152.9 Milion ALL vetëm në rastet kur marrin mbeshtetje financiare nga Fondi nëpërmjet marrveshjeve vullnetare. Ky është një buxhet që duhet të parashikohet në buxhet publik vetëm kur ka marrëveshje vullnetarë.
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
Kursimet energjisë	e	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë
		Efektet e kësaj mase monitorohen nëpërmjet përdorimit të metodës PL, të rekomanduar nga Komisioni Evropian, si dhe metodës kombëtare të vlerave referuese në dispozicion.
		Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II
		/
		Kursimet e arritura në 2015
		/
		Kursimet e pritshme të energjisë në 2018
		1.2 ktoe
		Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020
		2.3 ktoe
		Supozimet
		Në përgjithësi, kursimet e arritura në vendet e tjera, në lidhje me këtë masë, janë shumë të ulëta. Arsyet lidhen ose me mungesën e interesit nga sektori tregtar ose me kërkimin e burimeve të tjera të (bashkë) financimit.
		Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergia
		Kjo masë mbivendoset me masën horizontale "Auditimet Energjetike". Megjithatë, kur vlerësohen efektet, sektorët e veçantë analizohen në mënyrë të ndarë dhe kursimet e arritura listohen vetëm në një nga masat, në mënyrë që kursimet të mos numërohen dy herë.



Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Marrëveshjet vullnetare për ndërmarjet industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, të cilët, nënshkruajnë marrëveshje vullnetare në përputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë".
Indeksi i masës		I3
Përshkrimi	Kategoria	Kategoria: Marrëveshjet vullnetare / Nënkategoria: Marrëveshjet vullnetare me kompanitë industriale
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Vazhdim i masës nga PKVEE-ja I
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	<p>Synimi i kësaj mase është krijimi i parimit të një rritje të synuar të eficiencës së energjisë përmes detyrimeve vullnetare të konsumatorëve të energjisë - kompanive industriale. Në kuadër të kësaj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kërkimi i kapaciteteve të ekspertëve të disponueshëm, përfshirja e tyre në përcaktimin e teknologjive industriale energjetike me rëndësi, në kuadër të përdorimit racional të energjisë, dhe në hartimin e skemave detyruese për rritjen e eficiencës së energjisë në industri • aktivitetet e kërkimit për prezantimin e skemës së marrëveshjeve vullnetare, nëpërmjet një studimi fizibiliteti i cili do të përcaktonte parimet e përzgjedhjes së kompanive industriale që përshtaten në konceptin e marrëveshjeve vullnetare • përcaktimi i metodologjisë për ndjekjen e zbatimit të marrëveshjeve • krijimi i stimujve të përshtatshëm për marrëveshjet vullnetare efektive



		<ul style="list-style-type: none"> • kërkimi dhe përzgjedhja e kompanive industriale, me rezultate të dëshmuara në rritjen e eficiencës së energjisë, të cilat mund të përfshihen në skemën e marrëveshjeve • krijimi i monitorimit të energjisë dhe menaxhimit të energjisë në kompanitë e përzgjedhura
	Përdoruesi fundor i synuar	Kompanitë industriale
	Grupi i synuar	<ul style="list-style-type: none"> • Konsumatorët e mëdhenj të energjisë • Agjencia për Eficiencën e Energjisë
	Aplikimi rajonal	Në shkallë vendi
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<p>Brenda skemës së marrëveshjeve vullnetare, veprimet marrin në konsideratë zbatimin e masave në proceset industriale që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kursejnë energji elektrike, ose nëpërmjet masave për eficiencën e energjisë apo me kosto eficiente, ose nëpërmjet ndryshimit të sjelljes, • kursejnë energji termike dhe si rrjedhojë lëndën djegëse për prodhimin e saj ose që ndërrojnë lëndën djegëse për prodhim më të pastër dhe më eficient, duke marrë në konsideratë nxehtësinë për proceset industriale, nxehtësinë indirekte, përdorimin e nxehtësisë dytësore etj. • kursejnë ujë dhe burime të tjera të rëndësishme. • Reduktime të pritshme të CO₂.
	Buxheti dhe burimi financiar	Masat synojnë sektorin privat, me shpenzimet e tij, por si masë rregullatore kjo do të hartohet nga AEE-ja. Kosto e hartimit të modelit për krijimin e një sistemi të marrëveshjeve vullnetare, me kriteret për kompanitë me të cilat mund të lidhin marrëveshje vullnetare, dhe metodat për ndjekjen e arritjeve dhe përzgjedhjen e stimujve të propozuar për pjesëmarrje në marrëveshje vullnetare, kap shumën rreth 9.8 Milion ALL. Pas nënshkrimit të kontratës, Fondi për Eficiencën e Energjisë



		mund të japë mbështetje të pjesshme financiare për kryerjen e një procesi auditimi energjetik ose zbatimin e masave për eficiencën e energjisë.
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Duhet të krijohet një metodologji për aktivitetet e ardhshme (metoda PL mund të krijohet për çdo masë të standardizuar ose mund të kërkohet një vlerësim i kursimeve).
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	0.25 ktoe 3,148 tCO ₂
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	0.9 ktoe 6,009 tCO ₂
	Supozimet	/
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergia	/

Efektet e vlerësuara social-ekonomike të masave sasiore në sektorin e industrisë paraqiten në Tabelën 17.

Tabela 17.a Efektet social-ekonomike të masave në sektorin e industrisë nga Investime të Buxhetit Publik/ Fondi për EE-në

Masa	Financimi total nga Buxheti publik/ Fondi për EE-në (Mil ALL)		Kursimet vjetore të lëndës djegëse (Mil ALL)	Punësim i ri (vende pune)
I1	Rregullatore	36.7	602	13
I2	Instrument Financiar	152.9	374	8
I3	Rregullatore	9.8	146	3



Masat në transport

Në Shqipëri shihen tendenca në rritje të aktiviteteve të transportit, ndërsa legjislacioni i Bashkimit Evropian (me të cilin Qeveria e Shqipërisë kërkon të harmonizohet) synon t'i përgjigjet sfidës globale për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Prandaj, sektori i transportit në Shqipëri duhet të zbatojë masat që përmirësojnë në mënyrë të konsiderueshme eficiencën e energjisë për t'i hapur rrugën uljes së emetimeve. Qeveria mund të luajë një rol të rëndësishëm në sektorin e transportit, d.m.th. për krijimin e transportit me eficiencë të energjisë, në mbarë vendin, qeveria do të krijojë kushte të favorshme dhe mbështesë iniciativa lokale. Ky angazhim është thelbësor, pasi janë strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit, të tilla si ky dokument, së bashku me legjislacionin shoqëruar, që mbështesin politikat lokale. Një politikë gjithëpërfshirëse për të rritur eficiencën e energjisë në sistemin e transportit do të adresojë të tre nivelet e transportit me eficiencë të energjisë; eficiencën e sistemit, eficiencën e udhëtimit dhe atë të automjeteve. Eficienca e sistemit lidhet me mënyrën si krijohet kërkesa për transport (dhe mënyrat e ndryshme të transportit). Infrastruktura dhe strukturat e qytetit ndikojnë në kërkesën për transport - një strukturë urbane e dendur me përdorime mikse është thelbësore për eficiencën e lartë të sistemit, pasi përfshin distanca më të shkurtra udhëtimi dhe ndryshimin modal nga transporti rrugor (i cili kërkon hapësira të mëdha) tek mënyrat më eficiente të transportit, të tilla si ecja, lëvizja me biçikletë dhe transporti publik. Eficienca e udhëtimit lidhet me konsumin e energjisë për mënyrat e ndryshme të transportit.

Parametrat kryesore të eficiencës së udhëtimit janë epërsia relative e mënyrave të ndryshme të transportit (ndarja modale) dhe faktori i ngarkesës së automjeteve. Një mënyrë efektive e rritjes së eficiencës së energjisë është inkurajimi i udhëtarëve që të përdorin mënyra më eficiente transporti, të tilla si transporti publik dhe mjetet e pamotorizuara. Përveç transportit të udhëtarëve, eficienca e energjisë duhet të rritet edhe në transportin e mallrave. Transporti i mallrave është veçanërisht eficient për shkak të faktorit të lartë të ngarkesës. Gjithashtu, autoriteti kombëtar do të mbështesë përhapjen e teknologjive eficiente në treg, duke rritur ndërgjegjësimin dhe krijuar stimuj për konsumatorët që të blenë automjete me më shumë eficiencë të energjisë. Në këtë kontekst, ky dokument identifikon dhjetë masat kryesore për eficiencën e energjisë në sektorin e transportit, të cilat do të rezultojnë në një sistem më të mirë transporti dhe mënyra më të rehatshme udhëtimi, në uljen e ndotjes së ajrit dhe të zhurmës, me një ndikim pozitiv tek shëndeti i njerëzve dhe jetueshmëria në qytet, në uljen e dëmeve në mjedis, si në nivel lokal dhe global, në rritjen e konkurrueshmërisë dhe atraktivitetit të qyteteve dhe të ardhurave shtesë për qytetet që mund të investohen në infrastrukturën e re të transportit dhe kontribuojnë në uljen e kostove të jashtme të transportit. Zbatimi i përshtatshëm i masave të përcaktuara në këtë dokument mund të rezultojë në uljen e rreth 200,000 tonëve CO₂, deri në fund të 2020.

Një listë përmbledhëse e të gjitha masave të propozuara për eficiencën e energjisë, në lidhje me transportin, jepet më poshtë, së bashku me kursimet e pritshme të energjisë në 2020, në ktoe, dhe financimin e kërkuar.



Tabela 1 Lista përmbledhëse e masave në transport

Indeksi	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Përdoruesi i fundor synuar	Kursimet e pritshme të energjisë në 2020 (ktoe)	Financimi total i kërkuar (para publike), Milion ALL
T1	Projekti pilot i trajnimit për drejtimin e automjetit në mënyrë eficiente (<i>eco-driving</i>)	Automjetet e udhëtarëve, automjetet e transportit të mallrave dhe autobusët	11.8	3.50
T2	Fushatat e informimit dhe edukimit	Qarkullimi i udhëtarëve me automjete private dhe publike (të gjitha mënyrat e transportit)	3	56.00
T3	Promovimi i transportit të integruar	Automjetet rrugore, rrugët për biçikleta, zonat e këmbësorëve	7.4	1,288.00
T4	Etiketimi energjetik i automjeteve të reja	Automjetet rrugore	3,497	
T6	Stimujt financiarë për automjetet me efikasitet të energjisë	Automjetet rrugore	3.4	1,400.00
T7	Transporti intermodal i udhëtarëve dhe i mallrave	Transporti publik - me autobus dhe hekurudhor	5.3	
T8	Modernizimi i sistemit të semaforëve dhe futja e menaxhimit të automatizuar të trafikut	Automjetet rrugore	15.1	798.00



Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Projekti pilot i trajnimit për drejtimin e automjetit në mënyrë eficiente (<i>eco-driving</i>)
Indeksi i masës		T1
Përshkrimi	Kategoria	Masat e informimit
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masa është nxjerrë nga masat "Mënyra e drejtimin të automjetit" dhe "Kursët për drejtimin e automjetit në mënyrë eficiente (<i>eco driving</i>) për drejtuesit profesionistë të kamionëve", të propozuara në PKVEE-në I.
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	<i>Eco-driving</i> njihet si një nga masat më eficiente për promovimin e efijencës së energjisë në nivelin e BE-së. Fillimi i projektit pilot, në nivel kombëtar, për <i>Eco-driving</i> mund të provonte përfitimin nga rritja e ndërgjegjësimit të të gjithë qytetarëve dhe drejtuesve të mjeteve në Shqipëri, mbi avantazhet e këtij stili modern, inteligjent dhe miqësor me mjedisin, të drejtimin të automjetit, përmes zbatimit aktiv të trajnimeve për drejtimin e automjetit në mënyrë eficiente (<i>eco-driving</i>) për drejtuesit (ekzistues) të mjeteve të pajisur me leje drejtimi. Bazuar në mësimet e nxjerra nga projekti pilot, mund të merret në konsideratë më pas kryerja e një fushate të plotë, në shkallë më të gjerë. Përveç drejtuesve të mjeteve të pajisur tashmë me leje drejtimi, autoshkollat duhet të zhvillojnë kurse mbi pasojat e stilit të drejtimin të automjetit në mënyrë ekologjike.
	Përdoruesi fundor i synuar	Automjetet e udhëtarëve, automjetet e transportit të mallrave dhe autobusët
	Grupi i synuar	Drejtesit e automjeteve të udhëtarëve, drejtuesit e autobusëve në transportin publik dhe drejtuesit e automjeteve publike dhe private të transportit të mallrave
Aplikimi rajonal	Kombëtar	
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Propozohet, deri në 2020, trajnimi i një minimumi prej 1,000 drejtuesish të automjeteve të udhëtarëve, të pajisur me leje drejtimi. Pritet që trajnimi që po kryhet për <i>eco-driving</i> do t'u mundësojë të gjithë



		<p>pjesëmarrësve uljen e konsumit të karburantit mesatarisht deri në 18%⁵, me kusht që ata të zbatojnë në praktikë parimet <i>eco-driving</i>.</p> <p>Propozohet, deri në 2020, trajnimi i një minimumi prej 50 drejtuesish të automjeteve të transportit të mallrave. Me zbatimin e kësaj mase, pritet që konsumi i karburantit të ulet mesatarisht me deri në 8%, për pjesëmarrës. Me përfundimin e trajnimit, çdo drejtuesi mjete do t'i lëshohet certifikata e veçantë për përfundimin e trajnimit <i>eco-driving</i>.</p> <p>Propozohet, deri në 2020, trajnimi i një minimumi prej 30 drejtuesish të autobusëve. Me zbatimin e kësaj mase, pritet që konsumi i karburantit të ulet mesatarisht me deri në 8%, për pjesëmarrës. Me përfundimin e trajnimit, çdo drejtuesi mjete do t'i lëshohet certifikata e veçantë për përfundimin e trajnimit <i>eco-driving</i>.</p> <p>Për zbatimin e këtij aktiviteti, kërkohet marrja në punë e instruktorëve dhe inspektorëve të trajnuar jashtë fushëveprimit të aktiviteteve të tyre të zakonshme.</p>
	Buxheti dhe burimi financiar	Fondet totale të kërkuara: 148.4 Mil ALL (30 Mil ALL në vit). Si burim financimi propozohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Fondi për Eficiencën e Energjisë/Fonde të tjera me mbështetjen e buxheteve të autoriteteve lokale dhe Komisionit Evropian.
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/AEE-ja
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/AEE-ja
Kursimet energjisë e	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Kjo masë do të monitorohet duke përdorur metodën me bazë kërkimin. Për të monitoruar në mënyrë sistematike kursimet, para së gjithash, do të jetë e nevojshme të hartohet një listë kombëtare për të gjithë pjesëmarrësit në trajnimin <i>eco-driving</i> . Të dhënat e pjesëmarrësve mund të mbahen përmes një liste të tillë dhe me anë të pyetësorëve periodikë mund të mblidhet informacion për kursimet e arritura pas përfundimit të trajnimit.

⁵ IEE Projekti *Eco-driving* - Zbatimi i përhapur për kursantët për drejtues mjeteve dhe drejtuesit e mjeteve të pajisur me leje drejtimi - rezultatet e rastit studimor të EIHP-së



	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	3.7 ktoe 293 tCO ₂
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	11.8 ktoe 732 tCO ₂
	Supozimet	Supozohet të kryhen më shumë se 200 kurse të shkurtra trajnimi për drejtuesit e automjeteve të udhëtarëve, automjeteve të transportit të mallrave dhe autobusëve, në vit. Supozohet që 50% e drejtuesve të mjeteve do të ndryshojnë zakonet e tyre, pas kryerjes së kursit, dhe ata do të arrijnë kursime mesatare të karburantit prej 12% për automjetet e udhëtarëve dhe 8% për automjetet e transportit të mallrave dhe autobusët. Supozohet që gjatësia mesatare e udhëtimit për drejtuesit e automjeteve të udhëtarëve është 12,000 km, për drejtuesit e automjeteve të transportit të mallrave 30,000 km dhe për drejtuesit e autobusëve 35,000 km. Supozohet që konsumi mesatar i karburantit të automjeteve të udhëtarëve është 7.9 litra/100 km për automjetet me naftë dhe 9.4 litra/100 km për automjetet me benzinë (me ndarjen: 78% automjete me naftë dhe 22% automjete me benzinë), konsumi mesatar i automjeteve të transportit të mallrave është 32.3 litra/100 km, dhe i autobusëve 35 litra/100 km.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	/



Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Fushatat e informimit dhe edukimit
Indeksi i masës		T2
Përshkrimi	Kategoria	Masat e informimit
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masë e re
	Qëllimi/Përshkrim i shkurtër	Zhvillimi i fushatës së informimit dhe edukimit të integruar me synim kryesor tërheqjen e vëmendjes së njerëzve mbi ndikimet negative të qarkullimit individual me mjete motorike dhe efektet pozitive të lëvizjes me biçikletë, ecjes në këmbë dhe përdorimit të transportit publik, mund të rezultojë në kursime të konsiderueshme të energjisë. Fushata mund të përfshijë evenimente për forcimin e imazhit të transportit publik, platformat e mësimi elektronik, iniciativat e ditës pa automjete, promovimin e transportit të qëndrueshëm, transportit publik, automjeteve me emetime të ulëta, kombinimin e një grupi personash për të udhëtuar në të njëjtin automjet etj. Në mënyrë të veçantë, për t'u prezantuar konceptin e lëvizshmërisë elektrike politikanëve, sipërmarrësve, vendimmarrësve, qytetarëve etj., duhet që promovimi i teknologjive të lëvizshmërisë elektrike të zbatohet në mënyrë të përshtatshme. Prandaj, për ilustrimin e nocionit, avantazheve, mangësive, mundësive dhe sfidave të tij është i nevojshëm një promovim cilësor.
	Përdoruesi fundor i synuar	Qarkullimi i udhëtarëve me automjete private dhe publike (të gjitha mënyrat e transportit).
	Grupi i synuar	Qytetarët dhe drejtuesit e mjeteve, me fokus të veçantë tek të rinjtë, personat juridikë
Aplikimi rajonal	Kombëtar (iniciativa duhet të hartohet dhe bazohet tek burimet e informacionit në nivel kombëtar). Rajonal (autoritetet lokale mund të duan që zbatimin e iniciativës t'ia përshtatin territorit të tyre).	
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Duhet të ndiqen disa hapa pune: <ul style="list-style-type: none"> • Një anketë mbi karakteristikat, sjelljen dhe nevojat konkrete të grupit të synuar • Një plan veprimi për fushatën e informimit (materiale promovimi, workshop-e dhe kurse trajnimi) • Evenimente për forcimin e imazhit të transportit publik dhe lëvizshmërisë elektrike



		<ul style="list-style-type: none"> Integrimi i qytetarëve në diskutimet mbi çështjet e lëvizshmërisë dhe proceset e planifikimit, nëpërmjet evenimenteve publike, trailer-ave në TV dhe radio, si dhe artikujve në gazeta <p>Fushata duhet të marrë parasysh vendosjen e reklamave (<i>branding</i>) për të promovuar përdorimin e mënyrave të qëndrueshme të transportit.</p> <p>Është shumë e rëndësishme që të fitojmë mbështetje politike me shembuj pozitivë të fushatave të suksesshme.</p>
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Duhet të mbulohen kostot për mbledhjet e koordinimit, si dhe trajnimin e stafit përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve. Gjithashtu, duhet të merren në konsideratë kostot për organizimin dhe zbatimin e ëorkshop-eve dhe kurseve të trajnimit. Përfshirja e grupeve të ndryshme të interesit mund të rezultojë në një ndarje të shpenzimeve të fushatave (media, organizimi vullnetar, etj.).</p> <p>Fondet totale të kërkuara: 11.2 Milion ALL në vit. Si burim kryesor financimi propozohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Fondi për Efiçencën e Energjisë/Fonde të tjera, me mbështetjen e buxheteve të autoriteteve lokale dhe Komisionit Evropian.</p>
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/AEE-ja
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/AEE-ja
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Efektet e kësaj mase do të regjistrohen duke përdorur treguesit LP, në përputhje me rekomandimet e KE-së për transportin rrugor (treguesit P.8 dhe P.9).
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	1.2 ktoe 3 683 tCO ₂
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	3.0 ktoe 9 208 tCO ₂
	Supozimet	Janë parashikuar të zhvillohen, në nivel kombëtar, 6 ëorkshop-e e trajnime dhe 1 eveniment për lëvizshmërinë e qëndrueshme. Gjithashtu, janë parashikuar programe vjetore



		edukimi mbi lëvizshmërinë për shkollat dhe kompanitë. Përveç kësaj, është parashikuar përgatitja e materialeve informuese dhe pajisjeve teknike me vlerë 7 Milion ALL në vit. Supozohet që fushata do të ndikojë tek një numër i madh qytetarësh dhe, së fundi, do të sjellë kursime, deri në 10% të karburantit, për drejtues mjeti.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergia	Kjo masë mund të konsiderohet si horizontale në sektorin e transportit dhe ndikon pothuajse të gjitha masat e tjera. Kursimet e vlerësuara konsiderohen të jenë vetëm rezultat i fushatës dhe përjashtojnë masat e tjera.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Promovimi i transportit të integruar
Indeksi i masës		T3
Përshkrimi	Kategoria	Masat e informimit dhe organizimit
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masa është vazhdim, përmirësim dhe plotësim i masës së mëparshme "Promovimi i ecjes në këmbë dhe lëvizjes me biçikleta".
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Blokimi i trafikut po bëhet një problem në rritje për qytetet dhe ka një ndikim të lartë në rritjen e panevojshme të konsumit të karburantit. Prandaj, zhvillimi i qëndrueshëm i sistemeve të transportit urban duhet promovuar përmes: <ul style="list-style-type: none"> • optimizimit të logjistikës në qytet për transportin e mallrave • menaxhimit inteligjent të hapësirave të parkingut publik • ofrimit të mbështetjes për zhvillimin e infrastrukturës për çiklistët dhe këmbësorët • prezantimit të skemave <i>car-sharing</i> në qytete
	Përdoruesi fundor i synuar	Automjetet rrugore, rrugët për biçikleta, zonat e këmbësorëve
	Grupi i synuar	Shoferët, çiklistët dhe këmbësorët
	Aplikimi rajonal	Urban/Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë	- Për të kontribuar në mënyrë aktive në përmirësimin e efikasitetit të energjisë në logjistikën urbane të transportit të mallrave,



	masën	<p>masa kryesisht do të përcaktojë udhëzime për rritjen e efijencës së transportit të mallrave, mbi bazën e të cilave do të zhvillohen trajnime për operatorët e shërbimit të dhënies së automjeteve me qira;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për kërkesat e zbatimit të menaxhimit inteligjent të hapësirave të parkingut publik, do të jetë e nevojshme të përcaktohen udhëzime mbi bazën e të cilave mund të miratohen vendime për përjashtime ose zbritje tarifash për përdorimin e shërbimeve të parkingut publik, nga automjete që janë miqësore me mjedisin. Për të lehtësuar një transferim gradual drejt përdorimit të teknologjive të qëndrueshme në transportin në zonat urbane, do të jetë e nevojshme të prezantohet një akses i diferencuar në hapësirat e parkingut publik, duke i dhënë në këtë mënyrë, zgjidhjeve me më shumë efijencë të energjisë dhe më miqësore me mjedisin, një mundësi për t'u krijuar në treg; - Duhet të rritet gjatësia e rrugëve me trotuare, rrugica e kryqëzime të vazhduara dhe të lidhura, duhet të përmirësohen gjerësitë, sipërfaqet dhe ndriçimi rrugor i korsive të biçikletave, si dhe duhet të zbatohet, në masën maksimale, parkimi për biçikletat dhe sistemet e biçikletave publike në qytet; - Për të zbatuar skemën <i>car-sharing</i>, si një nga masat për rritjen e efijencës së energjisë në transport, propozohet futja e njëpasnjëshme në skemë e një numri të mjaftueshëm automjeteve, në vit, në qytetet më të mëdha.
	Buxheti dhe burimi financiar	Në fazën e parë, duhen marrë parasysh kostot që lidhen me shpenzimet institucionale, si dhe me kërkimet e studimit e përshtatshme që mbështesin vendimmarrësit (rreth 28 Milion ALL). Platforma e zbatimit për logjistikën e transportit të mallrave, parkingun inteligjent dhe skemën <i>car sharing</i> , si edhe përmirësimet e rrugëve për biçikleta dhe këmbësorë, vlerësohen në 1'260 milionë ALL. Si burim kryesor financimi propozohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Fondi për Efijencën e Energjisë, me mbështetjen e buxheteve të autoriteteve lokale dhe Komisionit Evropian.
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/AEE-ja/Pushteti Vendor
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/AEE-ja/Pushteti Vendor



Kursimet energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Efektet e kësaj mase do të regjistrohen duke përdorur treguesit LP, në përputhje me rekomandimet KE-së për transportin rrugor (treguesit P.8 dhe P.9).
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	0.139 ktoe
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	3.143 ktoe 3,540 tCO ₂
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	7.384 ktoe 22,865 tCO ₂
	Supozimet	<p>Supozohet që kërkohen 2 vjet për vlerësimin teknik (studimet, plani i biznesit, etj.) dhe negociatat institucionale për optimizimin e logjistikës së transportit të mallrave, menaxhimin e parkingut publik dhe skemën <i>car sharing</i>. Kur të zbatohet, optimizimi i logjistikës së transportit të mallrave mund të rezultojë në një rritje të faktorit të ngarkesës deri në 5% në periudhën afatshkurtër (3 vjet pas zbatimit) dhe 10% në periudhën afatgjatë (10 vjet pas zbatimit).</p> <p>Eksperienca e vendeve dhe qyteteve evropiane ka treguar që një automjet në skemën <i>car sharing</i> zëvendëson rreth 4-8 automjete të rregullta. Për të zbatuar skemën <i>car sharing</i>, si një nga masat për rritjen e eficiencës së energjisë në transport, propozohet prezantimi i njëpasnjëshëm në skemë, deri në 2020, i një minimumi prej 100 automjetesh, në vit, në qytetet më të mëdha. Përveç kësaj, vlerësohet që kursimet prej 2 litra/100 km për automjet, në krahasim me flotën ekzistuese, mund të arrihen nëse në skemë futen automjetet më eficiente. Propozohet që, deri në 2020, të futen 1,500 biçikleta publike në territoret e qyteteve më të mëdha shqiptare.</p> <p>Duke supozuar që gjatësia mesatare e udhëtimit ditor të një biçiklete publike në qytet është 5.5 km, pritset që, deri në 2020, integrimi i tyre në lëvizshmërinë urbane, si një nga zgjidhjet, mund të ndihmonte në shmangien e rreth 3.5 milionëve km, të cilat banorët ndoshta do t'i bënin me automjetet e tyre.</p>
Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	/	



Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Etiketimi energjetik i automjeteve të reja
Indeksi i masës		T4
Përshkrimi	Kategoria	Informimi dhe rregullimi
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: Zbatimi deri në fund të 2018; efekti i masës deri në 2020 e më tej Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: masë nga PKVEE-ja I
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	i Për të ndihmuar drejtuesit e mjeteve që të zgjedhin automjete të reja me konsum të ulët të karburantit, Shqipëria duhet të sigurojë që konsumatorëve t'u ofrohet informacioni përkatës, përfshirë etiketën që tregon efikasitetin e karburantit dhe emetimet e CO ₂ për automjetin. Masa synon të rrisë ndërgjegjësimin e konsumatorit mbi përdorimin e karburantit dhe emetimet e CO ₂ në automjetet e reja të udhëtarëve. Për më tepër, kompanitë shtetërore duhet të blenë ose marrin me qira automjete që konsumojnë më pak karburant dhe si rrjedhojë emetojnë më pak CO ₂ .
	Përdoruesi fundor i synuar	Automjetet rrugore
	Grupi i synuar	Importuesit dhe tregtuesit e automjeteve
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Miratimi i sistemit të BE-së për etiketimin energjetik të automjeteve të reja me klasat A-G, sipas emetimeve të CO ₂ . Detyrimi për importuesit e automjeteve/tregtuesit e automjeteve që t'u tregojnë klientëve etiketën e energjisë.
	Buxheti dhe burimi financiar	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - përmirësimi i rregulloreve brenda buxhetit
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Efektet e kësaj mase do të regjistrohen duke përdorur treguesit LP, në përputhje me rekomandimet KE-se për transportin rrugor (treguesit P.8 dhe P.9).
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/



Kursimet e arritura në 2015	/
Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	/
Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	3,497 ktoe 10,827 tCO ₂
Supozimet	Supozohet që 40% e blerësve të automjeteve të reja do të marrin në konsideratë blerjen e një automjeti me klasë energjie më të mirë (mesatarisht me 8% më pak konsum të energjisë).
Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	/

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Stimujt financiarë për automjetet me eficiencë të energjisë
Indeksi i masës		T6
Përshkrimi	Kategoria	Instrumente financiare
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masë e re
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Është e nevojshme që qeveria të hapë një linjë të veçantë bashkëfinancimi për qëllime specifike, të tilla si blerja e automjeteve elektrike (automobila, skutera, autobusë), blerja e automjeteve hibride, kamionëve dhe traktorëve me eficiencë të energjisë dhe riciklimi i automjeteve të vjetra për skrap (duke supozuar zëvendësimin e automjeteve të vjetra me automjete të reja Euro 6 ⁶).
	Përdoruesi fundor i synuar	Automjetet rrugore
	Grupi i synuar	Individët dhe personat juridikë
	Aplikimi rajonal	Kombëtar

⁶Rregullorja (EC) Nr. 715/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 20 qershor 2007, mbi miratimin e llojit të automjeteve motorike, në lidhje me emetimet nga automjetet e lehta të udhëtarëve dhe ato tregtare (Euro 5 dhe Euro 6), dhe për aksesin mbi informacionin për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve



Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Aktualisht në Shqipëri, nuk ka ndonjë dispozitë qeveritare që krijon ndonjë skemë stimulimi për blerjen e automjeteve më të pastra dhe më efçiente. Qeveria do të hartojë një skemë të stimujve financiarë për të ndihmuar konsumatorët që të blejnë automjete më të pastra dhe më efçiente dhe të zëvendësojnë automjetet e vjetra me automjete të reja.
	Buxheti dhe burimi financiar	Shuma e kërkuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Fondi për Eficiencën e Energjisë, me mbështetjen e buxheteve të autoriteteve lokale dhe Komisionit Evropian është 280 Milion ALL në vit.
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/AEE-ja
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/AEE-ja
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Kjo masë do të monitorohet duke përdorur metodën e vlerësimit
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	2.2 ktoe 4 211 tCO ₂
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	3.4 ktoe 10 527 tCO ₂
	Supozimet	Çdo vit do të zëvendësohen 1,000 automjete të vjetra me automjete të reja, nga të cilat 10% do të jenë elektrike ose hibride <i>plug in</i> .
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	/



Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Transporti intermodal i udhëtarëve dhe i mallrave
Indeksi i masës		T7
Përshkrimi	Kategoria	Infrastrukturë, planifikimi strategjik, dhe masat e organizimit dhe informimit
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masa është vazhdim, përmirësim dhe plotësim i masave të mëparshme "Përmirësimi i shërbimeve hekurudhore ndërmjet qendrave kryesore", "Përmirësimi i shërbimeve të transportit hekurudhor të mallrave në rajonet me transportin më të madh të mallrave" dhe "Përmirësimi i transportit publik në bashki".
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Kjo masë fokusohet tek transporti i mallrave dhe i udhëtarëve dhe potenciali që ajo ofron për lehtësimin e linjave rrugore dhe uljen e konsumit të karburantit, duke përdorur infrastrukturën hekurudhore dhe të autobusëve publikë. Në mënyrë që të zbatohet kjo masë, është e nevojshme që të ofrohet një infrastrukturë e përshtatshme, të jenë në dispozicion dhe lehtësisht të aksesueshme stacionet e unifikuara të transportit publik, qendrat e informimit mbi ofertën e transportit ndërqytetës/rajonal dhe të përcaktohet një planifikim i besueshëm i zhvillimit të linjave hekurudhore.
	Përdoruesi fundor i synuar	Transporti publik - autobusë dhe hekurudhë
	Grupi i synuar	Qytetarët, kompanitë që operojnë transportin publik
	Aplikimi rajonal	Kombëtar /lokal
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Përmirësimi i transportit publik në Shqipëri kërkon veprime specifike, si planifikimi i besueshëm i linjave ndërqytetëse dhe rajonale, përcaktimi i linjave hekurudhore prioritare, ndërtimi i linjave të reja dhe modernizimi i linjave ekzistuese, ofrimi i shërbimit të informacionit, lehtësisht të aksesueshëm, për nivelin ndërqytetës, mundësisht edhe me bileta të integruara me shërbimet lokale dhe ofrimi i stacioneve të unifikuara të transportit publik, lehtësisht të aksesueshme, p.sh. terminalët e autobusëve të lidhur me transportin lokal tokësor.



		Strategjia për përcaktimin e planifikimit të përgjithshëm dhe futja graduale e përmirësimeve duhet të zhvillohet në nivel kombëtar dhe lokal.
	Buxheti dhe burimi financiar	Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Fondi për Eficiencën e Energjisë, me mbështetjen e buxheteve të autoriteteve lokale dhe Komisionit Evropian. Kostot varen nga vëllimi i punimeve të prejardhura dhe vlerësohen në disa milionë euro.
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe organet lokale
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Kursimet energjisë	e Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Efektet e kësaj mase do të regjistrohen duke përdorur treguesit LP, në përputhje me rekomandimet e KE-së për transportin rrugor dhe hekurudhor.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	/
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	5.283 ktoe 16,360 tCO ₂
	Supozimet	Me zbatimin e sistemit të përgjithshëm të informacionit dhe modernizimin e linjave, deri në 2020, gjatësia e udhëtimit për udhëtarët (me autobus dhe hekurudhë) dhe për mallrat (me hekurudhë) në transportin publik mund të rritet deri në 5% në të njëjtin vit, duke pasur parasysh situatën aktuale në transportin publik. Gjatësia e përgjithshme e udhëtimit në transportin publik mund të rritet me 40%, gjatë pesë viteve të ardhshme, pas zbatimit, duke sjellë kursime të konsiderueshme të energjisë, si dhe përfitime të konsiderueshme mjedisore.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	/



Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Modernizimi i sistemit të semaforëve dhe futja e menaxhimit të automatizuar të trafikut
Indeksi i masës		T8
Përshkrimi	Kategoria	Infrastrukturë
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masë e re
	Qëllimi/Përshkrim i shkurtër	<p>Instalimi i një treguesi vizual për kohëzgjatjen e dritës së kuqe do të rrisë ndërgjegjësimin e drejtuesve të mjeteve mbi mundësinë për të vendosur nëse do të fikin motorin, ndërsa presin në trafik në një kryqëzim rruge. Mbështetja e integritit të semaforëve të tillë në kryqëzimet me trafik do të kontribuojë në uljen sistematike të konsumit të karburantit në transport, duke iu ofruar drejtuesve të mjeteve një informacion të përshtatshëm dhe në kohë rreth lëvizjeve në një kryqëzim, mbi bazën e të cilit një drejtues mjete mund të vendosë nëse do të fikë motorin me opsionin <i>start-stop</i>. Kursime shtesë mund të arrihen nga modernizimi i rrjetit të komunikimit ndërmjet sinjaleve të trafikut dhe me futjen e dritave LED që kanë jetëgjatësi më të madhe, konsum më të ulët të energjisë elektrike dhe cilësi më të mira optike, të cilat ulin ndjeshëm kostot e mirëmbajtjes, ndikojnë në fluksin e trafikut dhe sigurinë e trafikut, për shkak të zëvendësimit të shpeshtë të llambave ekzistuese. Gjithashtu, është e nevojshme të vendosen bazat për mundësinë e futjes së kontrollit adaptiv, në kohë reale, të trafikut në qytetet e mëdha.</p> <p>Për më tepër, eksperiencia e vendeve evropiane tregon që kufizimi i shpejtësisë në nivelet poshtë standardit, veçanërisht në autostrada, është një kontribut i madh drejt uljes sistematike të konsumit të karburantit në transportin rrugor. Megjithatë, zbatimi më i rreptë i kufijve ekzistues të shpejtësisë, me tolerancë më të ulët për tejkalimin e kufijve, mund të sillte rezultate shumë të mira në vetvete.</p>



	Përdoruesi fundor i synuar	Automjetet rrugore
	Grupi i synuar	Organet lokale, qytetet, automjetet
	Aplikimi rajonal	Kombëtar /lokal
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<p>Aktivitetet e propozuara në kuadër të masës:</p> <ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i Planit të Veprimit për zëvendësimin e sistemit ekzistues të semaforëve dhe instalimin e dritave LED dhe treguesve vizualë. Në lidhje me këtë, bashkitë duhet të zhvillojnë plane transporti të standardizuara që vënë theksin tek EE-ja e semaforëve brenda territorit të tyre. Studimi i mundësisë së futjes së kontrollit adaptiv, në kohë reale, të trafikut në qytetet e mëdha. Krijimi i infrastrukturës së nevojshme. <p>Gjithashtu, për menaxhim më të plotë të trafikut, është e nevojshme të zhvillohet dhe vlerësohet efekti i masës si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i një sistemi të vetëm të kontrollit të trafikut; prokurimi dhe instalimi i rreth 100 pajisjeve - kamera digjitale, me opsionin e matjes së shpejtësisë së automjetit. Lidhja e kamerave në një sistem të vetëm dhe transmetimi i të dhënave në qendrën e vetme të përpunimit të të dhënave. Zhvillimi i një qendre të vetme të përpunimit të të dhënave (kontrolle për shkelësit e rregullave të trafikut - pronarët e automjeteve, si dhe printimi e shpërndarja e gjobave të vendosura në të gjithë territorin e Shqipërisë).
	Buxheti dhe burimi financiar	Kostot e modernizimit të pajisjeve në 100 kryqëzime vlerësohen në 609 Milion ALL. Fondet e planifikuara që kërkohen për zbatimin e sistemit të kontrollit të trafikut arrijnë në 175 Milion ALL. Megjithatë, zbatimi do të paraprihet nga një studim i detajuar, i cili do të përcaktojë qëllimin e



		<p>saktë të masës dhe fondet e kërkuara. Studimi do të hartohet nga një konsulent teknik dhe do të prokurohet e financohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Fondet e kërkuara për studimin vlerësohen në: 14 Milion ALL.</p> <p>Si burimi kryesor i fondeve propozohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë /Pushteti Vendor.</p>	
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë /Pushteti Vendor	
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë /Pushteti Vendor	
Kursimet energjisë	e	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	
		Për të vlerësuar suksesin e zbatimit të masës, duhet të monitorohet numri i semaforëve të zëvendësuar. Efektet, në kuptimin e kursimeve të energjisë, mbuloohen nga treguesit LP për transportin rrugor, në përputhje me rekomandimet e KE-së.	
		Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
		Kursimet e arritura në 2015	/
		Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	4.0 ktoe 24,749 tCO ₂
		Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	15.1 ktoe 32,655 tCO ₂
		Supozimet	<p>Masa propozon zëvendësim të njëpasnjëshëm të semaforëve ekzistues në 100 kryqëzime rruge, deri në 2020. Kjo do të sjellë uljen e konsumit të karburantit, si edhe kursime të energjisë që rezultojnë nga vendosja e llambave LED.</p> <p>Toleranca më e ulët për tejkalimin e kufijve maksimalë të shpejtësisë në autostrada do të sjellë uljen e konsumit të karburantit me 2% në autostrada, në transportin e udhëtarëve.</p>
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	/	

Efektet e vlerësuara social-ekonomike të masave sasiore në sektorin e transportit paraqiten në Tabelën 19.



Tabela 19 Efektet social-ekonomike të masave në sektorin e transportit

Masa	Kursimet vjetore të karburantit (Milion ALL)	Punësim i ri (vende pune)
T1	42.0	1
T2	462.0	2
T3	1,134.0	5
T4	532.0	2
T6	518.0	2
T7	812.0	4
T8	4,606.0	21

Masat horizontale

Më poshtë jepet një listë përmbledhëse e të gjitha masave horizontale të propozuara. Për shkak të natyrës së masave horizontale, për pjesën më të madhe të aktiviteteve të propozuara, ende nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar kursimet potenciale, pasi pjesa më e madhe e masave përfaqësojnë aktivitete promovionale që mund të monitorohen, por jo të vlerësohen.

Masat, të cilat paraqiten në Tabela më poshtë, përfshijnë veprime të cilat nuk lidhen ngushtë me një sektor apo degë specifike, por konsiderohen thelbësore për zbatimin dhe monitorimin e të gjitha veprimeve të mbështetura në të gjithë sektorët. Ato përqendrohen kryesisht në mbledhjen dhe vlerësimin e informacionit përkatës, si dhe ofrimin e mbështetjes financiare nëpërmjet programeve operacionale.

Prandaj, është e vështirë të përcaktohen në sasi efektet e masave të listuara, megjithatë, kjo nuk duhet të pakësojë rëndësinë e atyre aktiviteteve.



Tabela 20 Lista përmbledhëse e masave horizontale

Indeksi	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Përdoruesi i fundor synuar	Kursimet e pritshme të energjisë në 2020 (ktoe)	Financimi total i kërkuar (para publike), Milion ALL
H1	Faturimi informativ, Fushatat e ndërgjegjësimit, Edukimi dhe trajnimi për eficiencën e energjisë.	Konsumi i energjisë elektrike, energjisë për ngrohje, gazit natyror dhe ujit në banesa, industri, shërbime dhe sektorin publik. Të gjithë sektorët dhe i gjithë konsumi, nga qytetarët tek organet publike dhe industria	1.4	42.0
H2	Promovimi i Kontraktimit të Performancës Energjetike	Të gjithë sektorët dhe i gjithë konsumi	1.2	14.0
H3	Auditimet energjetike dhe menaxhimi i energjisë në kompanitë e mëdha	Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë dhe i ujit në kompanitë e mëdha	1.1	33.6
H4	Krijimi i një sistemi të integruar informacioni për monitorimin dhe zbatimin e politikave për eficiencën e energjisë	Konsumi primar dhe final; kjo masë do të monitoronte zbatimin e masave, programeve, planeve dhe projekteve për eficiencën e energjisë në të gjithë sektorët e konsumit final dhe primar.	1.1	140.0
H5	Ndërhyrjet për përdorim me eficiencë të energjisë - sistemi i furnizimit me ujë	Sistemet e furnizimit me ujë	9.1	3'920



Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Faturimi informativ, Fushatat e ndërgjegjësimit, Edukimi dhe trajnimi për eficiencën e energjisë.
Indeksi i masës		H1
Përshkrimi	Kategoria	Informimi dhe masat e detyrueshme të informimit
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masa është vazhdim dhe përmirësim i masave të mëparshme "Fushatat e ndërgjegjësimit për eficiencën e energjisë në sektorin e banesave" dhe "Informimi dhe fushatat e ndërgjegjësimit për përdoruesit fundorë".
	Qëllimi/Përshkrim i shkurtër	Fatura energjie të qarta dhe të kuptueshme (energja elektrike, energja për ngrohje dhe gazi natyror). Kjo do të rrisë ndërgjegjësimin e konsumatorëve mbi mënyrën e konsumimit të energjisë prej tyre. Faturat duhet të përmbajnë krahasime, në formë grafike, të konsumit në periudhën e faturimit të vitit aktual dhe konsumit në periudhën korresponduese të vitit të mëparshëm. Faturat duhet të bazohen në konsumin aktual. Faturat duhet të përmbajnë, gjithashtu, informacion se ku mund të merren këshilla për konsumin e energjisë në mënyrë eficiente, si dhe rekomandohet të vendoset një numër telefoni jeshil (pa pagesë). Gjithashtu fushatat e informimit janë përpjekur të rrisin ndërgjegjësimin e grupeve të synuara rreth përfitimeve dhe mundësive të përmirësimit të eficiencës së energjisë. Nëse janë duke u zbatuar masa gjithëpërfshirëse, që kërkojnë financime, është provuar se rinovimi integral është masa më efiçiente dhe me koston më efektive. Megjithatë, nëse masat në fjalë janë 'masa të vogla', fushatat më efiçiente janë ato të kryera në një periudhë të kufizuar kohe dhe që synojnë aktivitete specifike, për shembull termoizolimi i ndërtesave, ndriçimi më efiçient, etj. Fushatat e informimit duhet



		<p>t'u drejtohen të gjithë pjesëmarrësve të përfshirë në arritjen e objektivit të përmirësimit të efikasitetit të energjisë. Përveç aktiviteteve të synuara, kërkohet edhe një faqe e vetme interneti që përmban të gjithë informacionin për të gjitha palët e interesuara, nga qytetarët tek industria.</p>
	Përdoruesi fundor i synuar	Konsumi i energjisë elektrike, energjisë për ngrohje, gazit natyror dhe ujit në banesa, industri, shërbime dhe sektorin publik.
	Grupi i synuar	Shpërndarësit dhe furnizuesit e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe gazit natyror; menaxherët e ndërtesës.
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	<ul style="list-style-type: none"> - Detyrimet e operatorëve/furnizuesve duhet të përcaktojnë që, të paktën një herë në vit, t'u shpërndajnë konsumatorëve të tyre një faturë që specifikon si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Konsumin në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm - Pasqyrë grafike dhe me tabela • Propozimin e masave që mund të ndërmerren nga klienti në mënyrë që të pakësohet monitorimi • Pikat e informacionit, përfshirë faqen kryesore të internetit, ku konsumatorët mund të gjejnë informacion të mëtejshëm - Zbatimi i fushatës së përgjithshme kombëtare në media duhet të kryhet me aktivitete që synojnë grupet individuale të përdoruesve dhe/ose llojet individuale të konsumit final të energjisë. Aktivitete të tilla duhet të shoqërohen me një mbështetje financiare. Prezantimi i çdo programi bashkëfinancimi duhet të shoqërohet me aktivitete të fuqishme promovionale. - Përcaktimi (edhe ai sasior) i



kërkesave dhe mundësi të sektorit të ndërtimit në Shqipëri me synimin për të ndihmuar në arritjen e objektivave kombëtare ambicioze për eficiencën e energjisë dhe për të lehtësuar transformimin e sektorit të ndërtimit me teknologji dhe kërkesa të reja. Përfituesve të sektorit publik duhet t'u ofrohet edukim dhe trajnim mbi këshilltarët e energjisë për të gjitha ndërtesat e mëdha (administrata shtetërore qendrore, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe rajonale). Duhet të hartohen udhëzuesit kombëtarë për krijimin e një sistemi edukimi të vazhduar mbi eficiencën e energjisë për punëtorët e ndërtimit (aktualë dhe të ardhshëm). Duhet të zhvillohet sistemi për vlerësimin e tregut të një force pune të kualifikuar. Zbatimi i këtyre sistemeve duhet të sjellë rritjen e aplikimit të eficiencës së energjisë dhe burimeve të energjive të rinovueshme në praktikën e përditshme të ndërtimit, nëpërmjet përmirësimit të njohurive teknike praktike të punëtorëve në kantier, të specializuar për të gjitha fazat e ndërtimit të një ndërtese, si dhe për procedurat e mirëmbajtjes së saj. Hartimi i një plani dhe programi edukimi e trajnimi dhe organizimi i edukimit dhe trajnimit sistematik e të vazhduar të punëtorëve të ndërtimit. Për të siguruar cilësi në ndërtimin e ndërtesave, zbatimi i projektit duhet të rrisë numrin e punëtorëve të trajnuar profesionalisht ose të trajnojnë zanatçinjtë dhe sipërmarrësit që kanë njohuri teknike të mjaftueshme ose që janë të specializuar në ndërtimin e ndërtesave që konsumojnë pak energji, ndërtesave pasive ose atyre që konsumojnë pothuajse



		zero energji.
	Buxheti dhe burimi financiar	Buxheti i parashikuar është 42 Milion ALL. Ky buxhet parashikohet të financohet nga Fondi për Eficiencën e Energjisë
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
Kursimet energjisë e	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Efekti i kësaj mase mund të mbulohet nga treguesit LP, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian. Kurse zbatimi i fushatës si masë mund të monitorohet duke përdorur një metodë me bazë kërkimin. Kjo masë është një parakusht për informimin e të gjitha palëve të interesuara dhe zbatimin e masave të tjera për eficiencën e energjisë.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	0.5 ktoe
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	1.4 ktoe
	Supozimet	Praktika ka treguar që është e pamundur të izolohen efektet e kësaj mase dhe që më e mira është që masa të monitorohet duke përdorur treguesit LP. Prandaj, vlerësimet e efekteve të kësaj mase nuk jepen më.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	Kjo masë mund të ketë efekte, kryesisht, në sektorin e banesave dhe efektet në kuptimin e kursimeve të energjisë do të tregohen për atë sektor. Gjithashtu kjo masë plotëson masën 'Promovimi i shërbimeve energjetike', e cila do të përdoret gjithashtu për të edukuar publikun e gjerë mbi shërbimet energjetike, ofruesit e shërbimeve energjetike e të tjera



Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Promovimi i Kontraktimit të Performancës Energjetike dhe Shërbimeve Energetike
Indeksi i masës		H2
Përshkrimi	Kategoria	Informimi dhe masat e detyrueshme të informimit
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masa është vazhdim dhe përmirësim i masës së mëparshme "Promovimi i Kontraktimit të Performancës Energjetike dhe ndriçimi rrugor në bashki".
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Kjo masë synon rritjen e ndërgjegjësimit të përdoruesve të ndërtesës dhe transformimin e tregut drejt ndërtesave më eficiente. Zhvillimi i një fushate informimi për të rritur ndërgjegjësimin e grupeve të synuara rreth përfitimeve dhe mundësive të zbatimit të masave për eficiencën e energjisë, nëpërmjet kontraktimit të performancës energjetike dhe shërbimeve energetike. Informimi dhe edukimi i publikut të gjerë rreth kompanive ESCO, modeleve EPC dhe ESC. Përgatitja dhe mbajtja e dokumenteve për shërbimet energetike, kontraktimin e performancës energetike dhe ofruesit e kontraktuar për furnizimin me energji.
	Përdoruesi fundor i synuar	Të gjithë sektorët dhe i gjithë konsumi
	Grupi i synuar	Pronarët e njësive të banimit (qytetarët), njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, sektori publik, qytetarët, kompanitë - ofruesit e shërbimeve energetike, klientët e shërbimeve energetike, bankat dhe institucionet e tjera, të cilat duhet të monitorojnë kompanitë në financimin e shërbimeve energetike.
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Aktivitetet e ardhshme: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të përgatisë një grup rregullash për hartimin e rregulloreve mbi kualifikimet/kërkesat që duhen përmbushur nga ofruesit e shërbimeve



		<p>energjetike.</p> <p>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të përpilojë dhe mbajë të dhëna të personave juridikë, ofruesve të shërbimeve energjetike. Ajo do të trajtojë ofruesit e shërbimeve energjetike mbi metodën e vetme të raportimit për kursimet e arritura nëpërmjet Sistemit qendror të Matjes dhe Verifikimit të Kursimeve.</p> <p>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të caktojë një vend qendror (pikë kontakti) tek e cila përdoruesit fundorë do të kenë mundësi të marrin informacion mbi shërbimet energjetike dhe ofruesit e tyre. Kjo do të arrihet, ndërmjet të tjerash, nëpërmjet projektimit të një portali ëeb mbi shërbimet energjetike. Projekti i një portali ëeb mbi shërbimet energjetike do të lejojë qytetarët që të vlerësojnë informacionin.</p> <p>Duhet të organizohen aktivitete të mëtejshme edukimi/trajnimi për grupet e synuara (që synojnë projektuesit, planifikuesit dhe operatorët e tjerë të cilët marrin pjesë në arritjen e objektivit për rritjen e efijencës së energjisë). Projektuesve duhet t'u ofrohet edukimi dhe trajnimi mbi aplikimin e sistemeve të furnizimit me energji alternative, me efijencë të lartë. Kjo duhet të koordinohet me masën 'Edukimi dhe trajnimi mbi efijencën e energjisë'.</p>
	Buxheti dhe burimi financiar	Buxheti i parashikuar është 14 Milion ALL. Ky buxhet parashikohet të financohet nga Fondi për Efijencën e Energjisë
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
Kursimet energjiksë	e Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Kjo masë mund të monitorohet duke përdorur një metodë me bazë kërkimin. Kjo masë është një parakusht për është një parakusht për monitorimin në mënyrë të suksesshme të kursimeve të arritura, nëpërmjet aplikimit të shërbimeve energjetike.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/



Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	0.3 ktoe
Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	1.2 ktoe
Supozimet	/
Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergia	Kjo masë mbivendoset dhe është një vazhdim i të gjitha masave që po zbatohen ose që mund të zbatohen nëpërmjet modelit të ofrimit të shërbimeve energjetike.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Udhe-treguesi për Auditimet dhe menaxhimin e energjisë për konsumatorët e mëdhenj të energjisë
Indeksi i masës		H3
Përshkrimi	Kategoria	Informimi dhe masat e detyrueshme të informimit
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: Masa është vazhdim dhe përmirësim i masës së mëparshme "Zbatimi i auditimeve energjetike në ndërtesat e shërbimit".
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Kjo masë duhet të sigurojë mbështetje për vlerësimin e potencialit të kursimeve të energjisë në kompanitë e mëdha, nëpërmjet bashkëfinancimit të zbatimit të auditimeve energjetike sipas ligjit për EE-në nr. 124/2015. Për menaxhimin gjithëpërfshirës të energjisë në kompani do të merret parasysh standardi ISO 50001 dhe udhëzimet e ngjashme.
	Përdoruesi fundor i synuar	Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë dhe ujit në kompanitë e mëdha
	Grupi i synuar	Kompanitë e mëdha
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Aktivitetet e ardhshme: Amendimet e rregulloreve do të lidhen me detyrimet e kryerjes së auditimeve energjetike në kompanitë e mëdha. Kjo



		<p>masë përpiqet të ndihmojë kompani të tilla në përmbushjen e detyrimit të sipërpërmendur, duke u dhënë atyre një pjesë të subvencioneve për kryerjen e auditimeve energjetike.</p> <p>Deri në fund të 2018, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të hartojë skemën e Auditimit Energjetik për Industrinë. Objektiva e hartimit të Skemës së Auditimit Energjetik për Industrinë është krijimi dhe promovimi i një skeme për konsumatorët e mëdhenj (zbatimi i masave me kosto efektive duhet të jetë një kusht për auditimet energjetike, i cili është në përputhje me detyrimin ligjor dhe duhet të sigurohet monitorimi i përmbushjes së detyrimit në fjalë), krijimi dhe promovimi i një skeme për konsumatorët e tjerë industrialë, në veçanti për konsumatorët e mëdhenj dhe veçmas për degë të veçanta të industrisë.</p>
	Buxheti dhe burimi financiar	Buxheti i parashikuar është 33.6 Milion ALL. Ky buxhet parashikohet të financohet nga Fondi për Eficiencën e Energjisë
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
Kursimet energjisë	e	
	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Kjo masë do të monitorohet duke përdorur metodën PL <i>ex-ante</i> .
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	0.1 ktoe
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	1.1 ktoe
Supozimet	Kursimet e energjisë që rezultojnë nga vetë auditimi energjetik përcaktohen mbi bazën e potencialeve të vlerësuara të paraqitura në raportin final të auditimit energjetik. Supozohet që do të arrihen të paktën 5% e atyre potencialeve. Për shkak të mungesës së të dhënave mbi konsumin total të energjisë nga kompanitë e mëdha, në fillim	



		të zbatimit të kësaj mase nuk është e mundur të vlerësohen uljet e pritshme të konsumit të energjisë që rezultojnë vetëm nga kjo masë deri në 2020.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	/

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Krijimi i një sistemi të integruar informacioni për monitorimin, verifikimin dhe zbatimin e politikave për eficiencën e energjisë
Indeksi i masës		H4
Përshkrimi	Kategoria	Mekanizma për arritjen dhe monitorimin e kursimeve të energjisë
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: masë e re
	Qëllimi/Përshkrim i shkurtër	Sistemi i integruar do të jetë një bazë për zbatimin e masave të përcaktuara në planet kombëtare të veprimit në kuptimin e: monitorimit të zbatimit të të gjitha masave, llogaritjeve metodologjike të kursimeve, hartimit të rregulloreve për eficiencën e energjisë, lehtësimin e zbatimit të masave, integrimin e të gjithë pjesëmarrësve dhe përdoruesve fundorë.
	Përdoruesi fundor i synuar	Konsumi primar dhe final; kjo masë do të monitoronte zbatimin e masave, programeve, planeve dhe projekteve për eficiencën e energjisë në të gjithë sektorët e konsumit final dhe primar.
	Grupi i synuar	Të gjitha palët e detyruara në zbatimin e masës (organet ekzekutive) të përcaktuara në këtë plan veprimi.
	Aplikimi rajonal	Kombëtar
Informacion mbi zbatimin	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e energjisë që përbëjnë masën	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e planifikon këtë aktivitet në buxhet. Projekti i zhvillimit të një sistemi të integruar informacioni duhet të fillojë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në gjashtëmujorin e parë të 2018. Zhvillimi i sistemit kryhet në faza dhe zhvillimi shtesë varet nga kërkesat e ardhshme të KE-së dhe detyrimet.



		<p>Deri në fund të 2018, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të ndërtojë sistemin bazë, i cili do të mbështesë aktivitetet, raportet e zbatimit për qeverinë e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Sistemi i integruar i informacionit duhet të mundësojë:</p> <p>Raportimin e rregullt mbi zbatimin e masave, programeve dhe planeve për eficiencën e energjisë;</p> <p>Analizën e zbatimit të masave, programeve dhe planeve, si dhe rekomandimet për periudhën e ardhshme dhe rishikimin e planeve, masave dhe programeve;</p> <p>Identifikim më të lehtë të pengesave në zbatimin e masave, planeve dhe programeve;</p> <p>Mbështetje për koordinimin e zbatimit të politikave për eficiencën e energjisë;</p> <p>Mbështetje për hartimin e rregulloreve kombëtare për eficiencën e energjisë dhe mbështetje për hartimin e dokumenteve të planifikimit kombëtar;</p> <p>Kontributin në të gjithë sistemin e zbatimit të politikave për eficiencën e energjisë.</p>
	Buxheti dhe burimi financiar	Fondi për Eficiencën e Energjisë - 140 Milion ALL
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AEE-ja)
Kursimet e energjisë	Metoda për monitorimin/matjen e kursimeve që rezultojnë	Në nivel kombëtar, kjo masë aplikon llogaritjen e masave, programeve dhe planeve të zbatuara për eficiencën e energjisë, në përputhje me metodën PL dhe LP.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	0.5 ktoe
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	1.1 ktoe



	Supozimet	/
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	Kjo masë është në përputhje me të gjitha masat e përcaktuara në planet e veprimit, si dhe me palët e tjera të detyruara.

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë		Raportet e auditimit dhe ndërhyrjet për përdorim me efikasitet të energjisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.
Indeksi i masës		H5
Përshkrimi	Kategoria	Infrastrukturë, planifikimi strategjik, dhe masat e organizimit dhe informimit
	Afati kohor	Fillimi: 2018 Mbarimi: 2020 Janë parashikuar ndryshime të mëdha, amendime dhe përmirësime: masë e re
	Qëllimi/Përshkrim shkurtër	Sektori i ujit në Shqipëri po përballet me sfida të rëndësishme, përsa i përket ofrimit të ujit të pijshëm në mënyrë të sigurtë, të përballueshme dhe të qëndrueshme. Në përpjekjet e tyre për të mbuluar të gjitha shpenzimet operative, shumë ndërmarrje ujësjellësi përballen me sistemet e pompimit, që shpesh janë të vjetra, të pamirëmbajtura dhe të amortizuara, (d.m.th. sistemi përbëhet nga pompat, motorët, tubacionet e thithjes dhe shpërndarjes dhe rezervuarët). Si rezultat, shumë ndërmarrje ujësjellësi kanë shpenzime për energjinë që zënë 30-40% të shpenzimeve operative direkte dhe për disa ndërmarrje ujësjellësi kjo shifër shkon mbi 50%. Një përqindje shumë e konsiderueshme e kërkesës për energji, në Shqipëri, vjen si pasojë e ofrimit të shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve, shërbime që karakterizohen nga shumë ineficienca e që kanë potenciale të larta për t'u përmirësuar.
	Përdoruesi fundor i synuar	Sistemet e furnizimit me ujë
	Grupi i synuar	Qytetarët
Aplikimi rajonal	Kombëtar	
Informacion mbi	Lista dhe përshkrimi i veprimeve për kursimin e	Për të siguruar përdorim më të mirë të energjisë, me një ulje të konsiderueshme të



zbatimin	energjisë që përbëjnë masën	<p>sasisë së ujit që duhet të pompohet, kërkohen sisteme të reja pompimi, me pompa e motorë eficientë, dhe ulje e sasisë shumë të lartë të ujit që nuk sjell të ardhura (uji që ka “humbur” përpara se të arrijë konsumatorin).</p> <p>Pas investimeve në sistemet e pompimit, me eficiencë të energjisë, për pjesën më të madhe të ndërmarrjeve të ujësjellësit do të jetë e mundur që të rriten orët e furnizimit dhe të shkohet drejt arritjes së furnizimit 24 orë duke ofruar në këtë mënyrë një shërbim shumë më të përmirësuar. Megjithatë, kjo do të rrisë konsumin e energjisë dhe si rrjedhojë edhe shpenzimet operative. Në periudhën afatgjatë, pritet që kjo të ketë një efekt shumë pozitiv mbi operimet e përgjithshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ulja e humbjeve të ujit në nivelin e konsumatorit rezulton në uljen e shifrave të prodhimit për banor - Kënaqësia dhe gatishmëria më e mirë e konsumatorit për të paguar shërbimet e ujit/ujit të ndotur sjell një eficiencë më të mirë të arkëtimeve dhe fluksit të parasë (<i>cash-flow</i>) - Ulja e numrit të plasjeve/rrjedhjeve dhe humbjeve teknike nëpërmjet presioneve më të qëndrueshme të punës dhe menaxhimit më të mirë të presionit
	Buxheti dhe burimi financiar	<p>Subvencionet e synuara nga qeveria qendrore për të përmirësuar operimin dhe eficiencën e energjisë, në vend të pagesës së thjeshtë të faturave të prapambetura të energjisë elektrike, financimi i donatorëve (grantet dhe/ose huatë nga programet ekzistuese ose zhvillimi i një fondi të ri të dedikuar), huatë nga bankat e nivelit të dytë për bashkinë përkatëse.</p> <p>Përafërsisht 3'920 milion ALL.</p>
	Organi zbatues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me ndërmarrjet e ujësjellësit, në varësi të bashkisë
	Autoriteti monitorues	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me ndërmarrjet e ujësjellësit, në varësi të bashkisë
Kursimet e	Metoda për monitorimin/matjen e	Monitorimi përmes mbledhjes së të dhënave operative, të besueshme dhe të



energjisë	kursimeve që rezultojnë	sakta. Kjo do t'u mundësojë ndërmarrjeve të ujësjellësit të raportojnë arritjet tek Njësia Benchmarking dhe Enti Rregullator i Ujit, si edhe tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, që kërkohet në kontekstin e përcaktimit sasior të kontributit të këtyre masave për të arritur objektivat e eficiencës së energjisë.
	Kursimet e pritshme në 2015 sipas PKVEE-së II	/
	Kursimet e arritura në 2015	/
	Kursimet e pritshme të energjisë në 2018	2.3 ktoe
	Ndikimi i pritshëm tek kursimet e energjisë në 2020	9.1 ktoe
	Supozimet	Kursimet bazohen në të dhënat operative që janë në dispozicion nga Njësia Benchmarking, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve, në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të analizuara nga programi i GIZ-it për reformën në sektorin e ujit. Kursimet e energjisë nga ndërhyrjet për përdorim me eficiencë të energjisë përcaktohen mbi bazën e ruajtjes së <i>status quo</i> të operimit aktual, d.m.th. ruajtja e të njëjtave orë pune.
	Mbivendosjet, efekti multiplikativ, sinergjia	/

Efektet e vlerësuara social-ekonomike të masave sasiore horizontale paraqiten në Tabela .

Tabela 21 Efektet social-ekonomike të masave horizontale

Masa	Kursimet vjetore të lëndës djegëse (Milion ALL)	Punësimi i ri (vende pune)
H5	1'482	40



3.3.3 Përmbledhje e kursimeve totale finale të energjisë

Modelimi i konsumit dhe përcaktimi i objektivit

Modelimi i kërkesës për energji është kryer duke përdorur MAED-in (Modeli për Analizën e Kërkesës për Energji). MAED-i është program kompjuterik i përgatitur dhe mirëmbajtur nga ANEA (Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike). MAED-i vlerëson kërkesat e ardhshme për energji bazuar në skenarët afatmesëm deri afatgjatë të zhvillimeve social-ekonomike, teknologjike dhe demografike. Kërkesa për energji është ndarë në një numër të madh të kategorive të përdoruesve fundorë që i korrespondojnë produkteve dhe shërbimeve të ndryshme në sektorë të ndryshëm. Për një skenar të dhënë, janë vlerësuar ndikimet e faktorëve nxitës socialë, ekonomikë dhe teknologjikë. Këto janë kombinuar për të dhënë një panoramë të përgjithshme të rritjes së kërkesës për energji në të ardhmen. Bazuar në eficiencën e pajisjeve të përdoruesve fundorë është përllogaritur energjia e dobishme, si dhe kërkesa për energji finale. Detajet e plota, sektor pas sektori, jepen në Shtojcën A4.

Skenari i përshkruar në Shtojcën A4 është bazuar në supozimin se, deri në vitin 2020, nuk do të miratohet dhe zbatohet asnjë politike energjetike e re, që do të thotë se kuadri ligjor dhe politik do të jetë i njëjtë me këtë të sotmin. Në këtë skenar, është supozuar aktiviteti i zakonshëm, gjë e cila sugjeron se nuk do të ketë ndryshime rrënjësore në sjelljen e qytetarëve, d.m.th. parashikohen banesat, biznesi dhe industria. Megjithatë, ky skenar ende merr në konsideratë penetrimin “pasiv” të teknologjive të reja dhe më eficiente nëpërmjet blerjes së pajisjeve elektroshtëpiake, automjeteve, makinerive dhe pajisjeve të tjera të reja.

Në mënyrë që të jepet një vështrim i përgjithshëm i efekteve që masat për eficiencën e energjisë, të propozuara në këtë PKVEE, do të kenë mbi konsumin total të energjisë në Shqipëri, aktivitetet u modeluan, duke përdorur përqasjen PL, dhe u krahasuan me skenarin bazë.


Figura 7 Konsumi final i energjisë në Shqipëri sipas skenarëve të ndryshëm



Tabela 2 paraqet kërkesën finale për energji deri në vitin 2020 për dy skenarë – skenarin bazë d.m.th. skenarin me politikat energjetike ekzistuese dhe skenarin ePKVEE-së, d.m.th skenari me zbatimin e masave për efikasitetin e energjisë, të propozuara në këtë dokument.

Tabela 2 Konsumi final i energjisë në Shqipëri sipas skenarëve të ndryshëm

	Njësitë	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Skenari bazë	ktoe	2,045	2,012	2,148	2,255	2,345	2,439	2,536	2,638
Skenari i PKVEE-së	ktoe	5	6	7		2,328	2,400	2,457	2,514

Kur të zbatohen masat e propozuara për efikasitetin e energjisë, ato do të përlllogariten në shifrën 123 ktoe të kursimeve të energjisë në 2020. Kjo përbën rreth 7 % të konsumit final të energjisë, referuar DSHE-së.

Figura 8 Përqindja e kursimeve për çdo sektor



Kjo figurë paraqet përqindjen e kursimeve që zë çdo sektor në kursimet totale të energjisë, të cilat u llogaritën në këtë analizë.

Kosto totale e masave të propozuara është 56 milionë euro për të gjithë sektorët e analizuar të konsumit final, me detajet që jepen në seksionet që vijojnë.

Përveç konsumit final, kursime të energjisë mund të arrihen edhe në sektorët e transformimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë, të cilët pritet të kapin vlerën mbi 40 ktoe në 2020. Për shkak të karakterit afatgjatë të investimeve dhe aktiviteteve në sektorin e energjisë, efekti i plotë i masave të propozuara do të jetë i dukshëm pas periudhës së marrë në studim.

Figura paraqet përqindjet që zënë sektorë të ndryshëm në kursimet totale që rezultojnë nga masat e propozuara, në 2020. Megjithatë, është e rëndësishme të vihet në dukje se përqindjet në Figura janë vetëm orientuese, pasi nuk është e mundur të vlerësohen dhe përlllogariten efektet e disa prej aktiviteteve të planifikuara. Gjithashtu, disa prej masave nuk japin direkt kursime të energjisë, por krijojnë një kuadër pozitiv ligjor, institucional dhe financiar, si dhe mjedis më të përshtatshëm. Kjo është veçanërisht e vërtetë për masat horizontale.

Kontributi i çdo sektori në objektivin e kursimeve finale të energjisë, prej 123 ktoe, në 2020 është si më poshtë:

- 49% e objektivit për kursime të energjisë mund të arrihet nëpërmjet masave në sektorin e ndërtesave. Në këtë skenar, kursimet do të jenë rrjedhojë e përgatitjes dhe miratimit të akteve nënligjore për kërkesat e efijencës së energjisë në ndërtesa, në lidhje me veshjen e jashtme të ndërtesave dhe sistemet teknike të ndërtesës. Kjo përfshin ndërtesat e reja dhe ekzistuese (ndërtesa banimi për një familje, ndërtesa banimi me shumë familje dhe ndërtesa jo-banimi). Kursimet finale do të vijnë nga rinovimi i veshjes termike të ndërtesave ekzistuese, përmirësimit të efijencës së energjisë në sistemet e ngrohjes, ftohjes, ujit të



ngrohtë, ndriçimit, ashensorëve dhe pajisjeve të tjera të transportit, si dhe instalimeve elektrike. Kursimet mund të vijnë edhe prej restaurimit të ndërtesave ekzistuese, duke u klasifikuar në një kategori më të lartë. Ky përfshin gjithashtu zbatimin e sistemeve inteligjente dhe rinovimin e stokut të pajisjeve elektrike.

- 40% e objektivit për kursime të energjisë mund të arrihet nëpërmjet masave në sektorin e transportit, duke filluar me ndryshimet e mënyrave të transportit, si p.sh. promovimi i transportit të integruar, i cili përfshin masat për një transport urban të qëndrueshëm, si edhe transportin intermodal të udhëtarëve dhe mallrave, duke vazhduar me masat që lidhen me një përdorim më eficient të transportit, si p.sh. kurset për një drejtim eficient të automjeteve, fushatave të informimit dhe ndërgjegjësimit, etj.
- 5% e objektivit për kursime të energjisë mund të arrihet nëpërmjet masave për kursimin dhe eficiencën e energjisë të fokusuara në sektorin e industrisë. Kursimet do të vijnë si pasojë e përgatitjes së kërkesave minimale të eficiencës së energjisë për proceset industriale, kryerjes së auditimeve energjetike, si dhe marrëveshjeve vullnetare dhe si pasojë e krijimit të një organi të përhershëm në nivel kombëtar, me kompetenca dhe përgjegjësi për aktivitetet dhe politikat për eficiencën e energjisë në nivel kombëtar.
- 6% e objektivit për kursime të energjisë mund të arrihet nëpërmjet masave horizontale që lidhen me ndriçimin publik, prokurimet publike të gjelbra, faturimin informativ, fushatat e ndërgjegjësimit, edukimin dhe trajnimin, promovimin e EPC-së, auditimet energjetike dhe krijimin e një sistemi të integruar informacioni për monitorimin e zbatimit të politikave të hartuara për eficiencën e energjisë.

Vendosja e prioriteteve për masat

Masat e ndryshme, të përshkruara në Seksionin 3.3.2, përfshijnë masat për të cilat është tashmë duke u përgatitur legjislacioni mbështetës dhe mënyra e zbatimit. Për më tepër, siç shtjellohet në nën-seksionet e veçanta të këtij raporti që vijojnë, ka një rrugë kritike dhe ndërvarësi ndërmjet masave të ndryshme, ndërsa pengesat e ndeshura ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Prandaj, gjykohet e dobishme që të përcaktohen prioritetet për masat për të ndihmuar në përqendrimin e përpjekjeve dhe siguruar që zbatimi është ndërmarrë në mënyrën më eficiente. Në Figurën 9, më poshtë, janë paraqitur: masat me prioritet të lartë me ngjyrë të kuqe, masat me prioritet të mesëm me ngjyrë portokalli dhe ato me prioritet më të ulët me ngjyrë të verdhë, duke treguar gjithashtu dhe afatin kohor të pritshëm për zbatimin e tyre.

Masat me prioritet të lartë përbëjnë veprimet e detyrueshme sipas DEE-së dhe PEN-së, dhe në shumicën e rasteve është marrë tashmë angazhim përmes ligjeve. Këto masa lidhen me sektorin e ndërtesave dhe sektorin publik, si dhe me masat horizontale ndër-sektoriale. Për të gjitha këto masa, duhet të fillojë menjëherë puna për aktet nënligjore përkatëse, në rastet kur nuk ka filluar tashmë. Në lidhje me masat në sektorin e ndërtesave, rrugët kritike për zhvillimin e sistemeve dhe proceseve mbështetëse të kërkuara janë shtjelluar në Seksionin 4.11. Vëmendje e veçantë i kushtohet masës horizontale H6 mbi monitorimin dhe



verifikimin, krijimi i të cilave mundëson raportim të saktë mbi masat dhe kursimet shoqëruese të energjisë. Një përjashtim bën masa e transportit T8, e cila vlerësohet të ketë potencialin më të lartë për kursimin e energjisë nga të gjitha masat e propozuara në këtë PKVEE dhe si e tillë meriton statusin 'me prioritet të lartë' për të maksimizuar mundësitë e arritjes së objektivit të kursimit të energjisë për 2020.

Ngjyra e gjelbër tregon fazën përgatitore që mbulon planet, konsultimet, rregulloret, proceset dhe infrastrukturën për çdo masë. Siç mund të shihet, është i nevojshëm fillimi i aktiviteteve përgatitore për të gjitha masat, brenda 2018, nëse ato duhet të zbatohen dhe ofrojnë kurse në një afat kohor në përputhje me këtë raport.

Figura 9 Vendosja e prioriteteve dhe afati kohor për zbatimin e masave

Sektori	Masa	2017	2018	2019	2020
Ndërtesa	R1				
	R2				
	R3				
	R4				
	R5				
	R6				
	R7				
	R8				
	R9				
	R10				
Sektori publik	P1				
	P2				
Industria & NVM-të	I1				
	I2				
	I3				
Transporti	T1				
	T2				
	T3				
	T4				
	T5				
	T6				
	T7				
	T8				
Masa horizontale	H1				
	H2				
	H3				
	H4				
	H5				
	H6				
	H7				



3.4 Sektori publik

3.4.1 Roli model i sektorit publik

Statusi i zbatimit

Shqipëria pranon rëndësinë e rolit model që sektori publik jep në përmirësimet e efijencës së energjisë dhe nxitjen e tregut për produkte dhe shërbime me efijencë të energjisë. Tashmë, një numër projektsh pilote kanë filluar, duke përfshirë:

- Ministria përgjegjëse për zhvillimin urban, Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit (MZHU/DSHUS), së bashku me bashkitë, ka ndërmarrë projekte pilote për EE-në (tre ndërtesa MFH në Lezhë, Korçë dhe Lushnjë) që kushtojnë rreth 200,000 € në total. Janë planifikuar disa projekte pilote shtesë në pjesë të ndryshme të Shqipërisë (në 2017, një projekt është planifikuar në Bashkinë Pukë).
- Një program rinovimi për ndërtesat publike nëpërmjet Programit të EE-së & BER-eve (12 milionë €) të KfW-së. Projekte pilote përfshijnë rinovimin dhe BER-et për: 3 kopshte (2009-2011) dhe Qytetin Studenti nr. 2 (5 ndërtesa, 5.3 milionë €, në vazhdim, përfshin edhe përdorimin e SWH-ve).
- Në 2014-2015, MIE dhe AKBN-ja kanë zbatuar, në kuadër të një programi ndërkufitar të BE-së, një program 1.6 milionë € për EE-në në Bashkitë e Lezhës dhe Lushnjës, i cili konsiston në rehabilitimin (PEE) e 10 shkollave.

Kuadri ligjor mbështetës

Për të përshpejtuar këtë progres, neni 5 i ligjit për efijencën e energjisë kërkon që politika kombëtare për efijencën e energjisë të mbështetet ndër të tjera në parimin e transformimit të sektorit publik në një model/shembull të mirë, nëpërmjet investimeve, mirëmbajtjes dhe përdorimit eficient të pajisjeve që konsumojnë energji, përdorimit të shërbimeve energjetike dhe masave të tjera për përmirësimin e efijencës së energjisë.

Masat e synuara dhe veprimet e planifikuara

Dihet që sektori publik përfshin një larmi nën-sektorësh dhe në këtë mënyrë entitetet, angazhimi i të cilave do të jetë i nevojshëm për zbatimin me sukses, mundësisht duke përfshirë ndërmjet të tjerave dhe ndërtesat e qeverisë qendrore, ndërtesat e autoriteteve vendore dhe shërbimet publike (ndriçimi rrugor, uji dhe mbetjet), spitalet, kolegjet, shkollat, policia, ushtria, strehimi social, agjencitë publike dhe aeroportet.

Përveç fushave të shqyrtuara më poshtë dhe në Seksionin 5.3 mbi ndërtesat e qeverisë qendrore, aspekte të tjera kryesore të një roli model mund të përfshijnë krijimin dhe zbatimin e programeve pragmatiste të menaxhimit të energjisë, siç parashikohet në nenin 10



të ligjit për eficiency e energjisë që trajton Menaxherët e Energjisë. Këta mund të fokusohen në praktikat e mira të operimit dhe mirëmbajtjes (përfshirë sjelljen), duke përfshirë regjimet e mira të M&V-së dhe publikimin/komentet e rezultateve për punonjësit dhe menaxhimin.

3.4.2 Roli udhëheqës i sektorit publik në PEN-në

Statusi i zbatimit

Ndërsa zbatimi, përveç projekteve pilote të përmendura më sipër, deri tani ka qenë i ngadaltë, auditimet energjetike të kryera nëpërmjet programit të KfW-së tregojnë se ndërtesat publike të qeverisë qendrore dhe bashkive kanë potencial të madh për kursimin e energjisë nëpërmjet masave për EE-në. Në të vërtetë është vlerësuar që konsumi mesatar i energjisë në sektorin e ndërtesave ka potencial të ulët me 10-35%, si rezultat i zbatimit të një programi gjithëpërfshirës për EE-në. Përfitime shtesë, përveç uljes së emetimeve, përfshijnë fatura më të ulëta, rritje të sigurisë së furnizimit me energji (nëpërmjet uljes të importit) dhe standarde më të larta të komfortit.

Analizat vlerësojnë se ndërmjet 30% dhe 50% (në varësi të numrit të gradë-ditëve të ngrohjes të vendndodhjes) e konsumit të energjisë elektrike në ndërtesat publike përdoret për të siguruar ngrohjen. Ky nivel pritet të rritet në vitet që vijnë, duke sjellë një rritje të standardit të jetesës, pasi ndërtesat aktuale ofrojnë një ngrohje me cilësi të ulët, sidomos ndërtesat bashkiake. Për këtë arsye, marrja në konsideratë e faktit sesi mund të sigurohet ngrohje shtesë në mënyrë më eficiente do të jetë një çështje e rëndësishme për t'u trajtuar në këtë PKVEE.

Konsumi/përdorimi varet nga tipi dhe qëllimi i ndërtesës, por mund të përfshijë ndriçimin, ngrohjen e hapësirave, konsumin e pajisjeve elektrike, ventilimin dhe kondicionimin e ajrit, gatimin dhe përgatitjen e ujit të ngrohtë. Masat për EE-në ka të ngjarë të fillojnë me termoizolim, dritaret eficiente dhe instalimin e sistemeve eficiente të ngrohjes së hapësirave (që nuk përdorin energji elektrike).

Kuadri ligjor mbështetës

Shqipëria ka miratuar një ligj të veçantë që transponon DPEN-ë. Ky Ligj 116/2016 përfshin kërkesat sipas Direktivës së ndryshuar në këtë pikë, që është, se:

- Pas 31 dhjetorit 2019, ndërtesat e reja në përdorim dhe në pronësi të autoriteteve publike duhet të përmbushin përcaktimet e NKEZ-ve (shih Seksionin 3.1.2).

Për ndërtesat sipërfaqja e shfrytëzueshme e katit të cilave kalon 500 m², dhe të cilat janë në përdorim dhe pronësi të një autoriteti publik dhe vizitohen shpesh nga publiku i gjerë, një certifikatë e performancës energjetike duhet të shfaqet në një vend të përshtatshëm dhe qartësisht të dukshëm për publikun (duke filluar nga 9 korriku 2019, kufiri i sipërfaqes do të ulet në 250 m²) – procedurat për certifikatën e performancës energjetike (përfshirë dhe aktet nënligjore mbështetëse) priten të përgatiten nga fundi i 2018.



Masat e synuara dhe veprimet e planifikuara

Një grup veprimesh janë propozuar në Seksionin 3.3.2 për të lejuar zbatimin e kërkesave të PEN-së në Shqipëri. Duke theksuar rolin e rëndësishëm që sektori publik luan në fillimin e këtyre reformave, masat e sektorit të ndërtesave në mënyrë specifike adresojnë përgatitjen e akteve nënligjore mbështetëse që përfshijnë origjinën e standardeve me kosto optimale dhe zbatimin e NKEZ-ve me synime prioritare për sektorin publik. Për më tepër, masa R9 adreson kërkesat që ndërtesat publike të shfaqin certifikatat energjetike të tyre, duke publikuar një listë me masat që ato do të zbatojnë.

Institucionet përgjegjëse

MIE dhe MZHU-ja janë bashkërisht përgjegjëse për përgatitjen e akteve nënligjore dhe zbatimin e masave të identifikuara për ndërtesat publike në Seksionin 3.3.2.

3.4.3 Masat specifike për prokurimet publike

Statusi i zbatimit

Masa e propozuar P2 që përshkruhet në Seksionin 3.3.2 i referohet Prokurimeve Publike të Gjebra të produkteve dhe shërbimeve. Kjo masë ishte përfshirë edhe në PKVEE-në I, por zbatimi u vonua për shkak të mungesës së legjislacionit të nevojshëm.

Kuadri ligjor mbështetës

Veprimet për të mbyllur këto boshllëqe kanë filluar nëpërmjet miratimit të ligjit për eficiencën e energjisë, në nëntor 2015. Neni 9, paragrafi 1, kërkon që Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, të përfshijë specifikimet teknike për minimumin e eficiencës së energjisë për produktet që kanë një ndikim në konsumin e energjisë.

Standarde të tilla minimale do të kërkojnë gjithashtu përgatitje me qëllim krijimin e kushteve që kjo masë të zbatohet. Procesi i përgatitjes dhe miratimit do të përfshijë përpunimin e detajuar të kriterëve teknike për produkte të veçanta (duke iu referuar, kur është e përshtatshme, standardeve të etiketimit energjetik), udhëzues për përdorimin e tyre nga autoritetet kontraktuese (për t'u ndarë me autoritetet qendrore dhe lokale), trajnim të stafit të administratës publike dhe përfshirjen e tyre në sistemet e monitorimit.

Këto standarde do të përgatiten që të jenë në përputhje me ligjin për prokurimet publike (9643/2006 të ndryshuar). Ky ligj përcakton gjithashtu Agjencinë e Prokurimeve Publike (APP) si institucioni qendror përgjegjës për prokurimet publike.

Masat e synuara dhe veprimet e planifikuara

Masa P1 nga Seksioni 3.3.2 mbi ndriçimin publik me eficiencë të energjisë mund edhe të kategorizohet si një mbështetje për prokurimet publike. Si konsumatorë të mëdhenj, sipas



nenit 16 të ligjit për eficiencën e energjisë, bashkitë e mëdha do të jenë të detyruara t'i nënshtrohen auditimit energjetik dhe të plotësojnë rekomandimet e auditimit. Përmirësime të tilla për eficiencën e energjisë në ndriçimin publik janë përfshirë në mënyrë të qartë në nenin 24 të ligjit për eficiencën e energjisë, si një masë e përshtatshme për të përfituar financim nga Fondi i Eficiencës së Energjisë.

Siç u përmend në Seksionin 3.4.2 më sipër, sektorit publik i kërkohet të marrë rolin drejtues për zbatimin e PEN-ës. Masa R5 reflekton kërkesat e reja për prokurimin e ndërtesave me eficiencë të energjisë nga autoritetet publike, duke theksuar se të gjitha ndërtesat e reja në përdorim dhe pronësi të autoriteteve publike do të përmbushin përcaktimet e ndërtesave me konsum energji pothuajse zero, duke filluar nga fundi i dhjetorit 2018.

Institucionet përgjegjëse

Përgatitja e standardeve teknike është një përgjegjësi e MEI-t, por mund të kalojë tek Agjencia për Eficiencën e Energjisë ose tek ndonjë institut teknik i përshtatshëm, me miratimin e Këshillit të Ministrave në rastin më të parë. Megjithatë, këto standarde do të kërkojnë përditësime periodike, nga entiteti i përcaktuar, në mënyrë që të sigurohet që këto standarde të jenë të harmonizuara me përparimet teknike, si dhe me kërkesa të tjera të Komunitetit Evropian, lidhur me këtë çështje. Procesi aktual i miratimit mund të jetë subjekt i ndryshimeve në mënyrë që të sigurohet zbatimi në kohë i ndryshimeve të kriterëve. Trajnimi do të jetë i nevojshëm për agentët zbatues – në mënyrë të veçantë APP-ja dhe autoritetet lokale.

3.5 4.5 Programet e informimit të konsumatorit dhe trajnimit

Statusi i zbatimit

Masat e parashikuara për këtë kategori nga PKVEE-ja I janë shtyrë kryesisht për shkak të vonesave në miratimin e ligjit për eficiencën e energjisë, si dhe krijimit të Agjencisë së dedikuar për Eficiencën e Energjisë, e cila parashikohet të drejtojë shumë prej iniciativave. Megjithatë, disa aktivitete janë ndërmarrë dhe përfshijnë; një program i GIZ-it për auditimin energjetik dhe menaxhimin e energjisë, i cili ka trajnuar deri tani 50 menaxherë objektivash në Shqipëri; një program i mëtejshëm nga Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT), i cili ka certifikuar rreth 75 auditues të energjisë; dhe kompania e shpërndarjes, OSHEE, e cila duke filluar nga viti 2014 ka ndërmarrë një fushatë për EE-në dhe përmirësimin e humbjeve teknike dhe jo-teknike që rezultoi në uljen e rreth 300-400 GWh (rreth 26-34 ktoe), për vitet 2014 dhe 2015.

Në Shqipëri, bankat e nivelit të dytë kanë krijuar një eksperiencë dhe njohuri shumë të mira në lidhje me masat për EE-në, nëpërmjet programeve të mbështetura nga IFC-ja, KfW-ja dhe Fondi 'Green for Growth'. Që prej vitit 2010, IFC-ja ka mbështetur tre banka (Credins, Societe Generale, Union) dhe katër institucione mikrofinanciare, në lidhje me programet për EE-në (kryesisht për sektorin e banesave). Që prej vitit 2009, KfW-ja ka mbështetur me asistencë teknike bankën ProCredit, e cila ka përdorur linjat e saj të kreditimit për hua për EE-në (për



sektorin e banesave dhe NVM-të). BKT-ja ka një linjë kreditimi nga Fondi 'Green for Growth' me një fond prej 8 milionë € dhe është duke zbatuar masat për EE-në në sektorin e banesave dhe NVM-të.

Tregu financiar shqiptar ka një kosto relativisht të ulët të financimit të borxhit, e kushtëzuar nga një normë interesi e ulët e bonove të thesarit. Bankat janë duke huazuar në nivelin 4.9-5.5% për hua të sigurta dhe 7-8.5% për hua të pasigurta.

- Bankat kanë një likuiditet të lartë (*over-liquidity*) dhe janë në treg për ofrimin e produkteve të reja financiare, pjesa më e madhe e bankave janë aktive në kërkimin e produkteve të reja për huadhënie.
- Bankat e përmendura më sipër kanë linja kreditimi të dedikuara për eficiencën e energjisë. Eficienca e energjisë është mbuluar direkt ose indirekt nga produkte të ndryshme huaje në bankat e tjera nëpërmjet huave shumëqëllimëshe/gjithëqëllimëshe.
- Nevojat për asistencë teknike të identifikuar nga bankat përfshijnë:
 - Ekspertizën - mbi praktikën më të mira, karakteristikat e projekteve për EE-në në sektorin e banesave dhe performancën financiare.
 - Dizajnimin e produktit, vlerësimin e projektit, kujdesin teknik.
 - Marketingun dhe reklamimin e produktit.
 - Mbështetjen ligjore - përgatitja e akteve nënligjore, mbështetja për zbatim.
 - Trajnimin për bankierët mbi aftësitë teknike.
 - Fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mjetet/materialet për to.

Kuadri ligjor mbështetës

Miratimi i ligjit për eficiencën e energjisë tani ofron bazën mbi të cilën do të zbatohen veprime sapo të përgatiten aktet nënligjore të nevojshme. Në të vërtetë, një tjetër parim i politikës kombëtare për eficiencën e energjisë, siç përcaktohet në nenin 5 të ligjit për eficiencën e energjisë, është edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe përdoruesve fundorë në lidhje me nevojën dhe përfitimet nga ulja e konsumit jo eficient të energjisë. Ndërkohë, neni 15, i dedikohet ofrimit të informimit dhe trajnimit. Kjo kërkon që Agjencia e re për Eficiencën e Energjisë të:

- Publikojë, në faqen e saj zyrtare të internetit, informacion mbi mekanizmat, botimet, kuadrin financiar dhe ligjor i cili mund të ndihmojë në arritjen e kursimeve të energjisë.
- Informojë konsumatorin final mbi metodat dhe praktikën e ndryshme që shërbejnë për të rritur kursimet e energjisë.



- Ofrojë trajnime për institucionet qeveritare dhe autoritetet vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxherët e energjisë.

Neni 24 i ligjit për eficiencën e energjisë lejon gjithashtu që financimet, nëpërmjet Fondit për Eficiencën e Energjisë, të drejtohen tek programe që ofrojnë fushata ndërgjegjësimit dhe aktivitete edukimi në lidhje me eficiencën e energjisë.

Etiketimi energjetik është gjithashtu i njohur si një bazë për rritjen e informimit të konsumatorit mbi eficiencën e energjisë. Shqipëria ka miratuar ligjin për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji (ligji nr. 68/2012), i cili transponon Direktivën 2010/30/EU mbi etiketimin energjetik. Megjithatë, për zbatimin e plotë të tij kërkohen disa akte nënligjore.

Masat e synuara dhe veprimet e planifikuara

Një numër masash të reja janë propozuar për t'u zbatuar, siç jepet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3.3, të cilat lidhen me rritjen e informimit të konsumatorit, rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimin. Këto përfshijnë masat horizontale H1 dhe H6, të cilat mbulojnë faturimin informativ, fushatat e informimit, edukimin dhe trajnimin, promovimin e kontraktimit të performancës energjetike, auditimin energjetik dhe monitorimin e zbatimit (duke lejuar komentet e publikut mbi arritjet).

Një fushatë specifike e informimit dhe edukimit propozohet për transportin, në masën T2, për të inkurajuar ndarjen modale dhe zgjedhjet me eficiencë të energjisë në transportin privat dhe publik.

Institucionet përgjegjëse

Organi drejtues për sigurimin e përhapjes së informacionit mbi masat për eficiencën e energjisë, politikave dhe mekanizmave, si edhe trajnimet përkatëse, është planifikuar të jetë Agjencia për Eficiencën e Energjisë. Megjithatë, është gjithashtu i nevojshëm angazhimi i ministrive të tjera për çështje specifike sektoriale (p.sh. transporti dhe bujqësia), si edhe sigurimi i bashkëpunimit dhe aftësive të marketingut të kompanive private. Në mënyrë specifike, siç u përmend më sipër, bankat e nivelit të dytë kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në ofrimin e masave dhe marketingun e mundësive financiare për to.

Në mënyrë të ngjashme, masat që mbështeten dhe zbatohen nga operatori i shpërndarjes dhe furnizuesit e energjisë do të kërkojnë që këto entitete të sigurojnë një marketing të përshtatshëm të mundësive tek konsumatorët.



3.6 4.6 Detyrimet e kompanive energjetike për të promovuar kursimin e energjisë tek konsumatorët fundorë

Statusi i zbatimit

Deri tani nuk ka asnjë detyrim për kompanitë energjetike lidhur me uljen e konsumit final të energjisë nga përdoruesit fundorë (megjithëse strategjitë për uljen e humbjeve në transmetim dhe shpërndarje janë duke u përgatitur, siç u trajtua më sipër në Seksionin 2.2).

Kuadri ligjor mbështetës

Siç përmendet më poshtë, një rregullim vullnetar mund të kërkohet fillimisht me OSHEE-në për t'u mbështetur nga masat alternative (të tilla si marrëveshjet vullnetare të propozuara me konsumatorët e mëdhenj). Marrëveshjet vullnetare sipas ligjit për eficiencën e energjisë kërkohet të jenë transparente, jo diskriminuese, dhe të përmbajnë informacion mbi objektivat sasiore, sipas fazave, procesin e monitorimit dhe raportimit. Aty ku supozohet që mbështetja financiare të kërkohet nga Fondi për Eficiencën e Energjisë, kjo gjë lejohet sipas nenit 12 dhe nenit 19, të cilët në mënyrë të qartë lejojnë që kompanitë e furnizimit me energji të përfitojnë nga Fondi. Megjithatë, një marrëveshje vullnetare supozohet të jetë efektive vetëm me miratimin e ministrit përgjegjës për energjinë.

Për më tepër, neni 24 lejon që përmirësimet e matjes dhe faturimit informativ nga kompanitë energjetike mund të mbështeten nga Fondi për Eficiencën e Energjisë. Për këtë qëllim, masa H1 e propozuar, përfshin një detyrim për furnizuesit që t'u ofrojnë konsumatorëve informacion, mbi baza vjetore, duke specifikuar konsumin e tyre në krahasim me vitin e mëparshëm, propozimin mbi masat që mund të ndërmerren për të ulur konsumin dhe për të treguar se ku mund të gjendet informacion shtesë.

Masat e synuara dhe veprimet e planifikuara

Një skemë zyrtare Detyrimi për Eficiencën e Energjisë (EEO) aktualisht nuk është propozuar për Shqipërinë, kjo për shkak të kushteve aktuale të tregut (p.sh. mungesa e eksperiencës në marketingun dhe zbatimin e masave për EE-në nga përdoruesit fundorë, mungesa e gatishmërisë së tregut për një skemë të mundshme komplekse). Megjithatë, kompania e shpërndarjes dhe kompanitë e furnizimit me energji do të kenë ende një rol të rëndësishëm për të ndihmuar në arritjen e objektivave të PKVEE-së. Kështu që, propozohet që kompania e shpërndarjes/furnizuesi publik, (OSHEE) të vendosë objektivat e tij në bashkëpunim me

Agjencia mund të ofrojë këshilla/asistencë mbi masat për EE-në, kriteret minimale për kursimin e energjisë, të cilat mund të konsiderohen të pranueshme për t'u llogaritur në plotësimin e objektivave, dhe marrjen e praktikave më të mira nga jashtë. Kjo ndjek përfaqshjen e një numri të Shteteve Anëtare të BE-së, të tilla si Irlanda dhe Austria, të cilat filluan skemat e tyre EEO me marrëveshje vullnetare, përpara se të procedonin me një skemë zyrtare EEO. Masat duhet të jenë të kualifikuara për t'u mbështetur nga Fondi për Eficiencën e Energjisë, ndërsa kostot e detyrueshme për OSHEE-në duhet të konsiderohen si



shpenzime operative të pranueshme për qëllime rregullatore. Masat e mëposhtme janë shembuj të formave të veprimeve për EE-në, të parashikuara për t'u mbështetur dhe promovuar nga OSHEE-ja dhe/ose nëpërmjet masave paralele që mbështesin EE-në të cilat mund të kontribuojnë drejt kërkesave të nenit 7 të DEE-së (p.sh. masa R6 lidhur me mbështetjen financiare për përmirësimin e EE-së në veshjen e jashtme të ndërtesës dhe sistemin e ngrohjes). Bazuar në eksperiencën e vendeve të tjera, mund të ndodhë që vetëm një pjesë e vogël e kostove më efektive të këtyre masave të miratohen në masë të madhe.

Masat e mëposhtme për EE-në janë masa të mundshme për sektorin e banesave:

- Përdorimi i ndriçimit me eficiencë të energjisë;
- Përdorimi i frigoriferëve, makinave larëse, makinave pjatlarëse me eficiencë të energjisë, dhe pajisjeve shtëpiake ("produkte të bardha") të tjera me konsum të madh të energjisë;
- Përdorimi i kondicionerëve të ajrit me eficiencë të energjisë;
- Përdorimi i pompave të nxehtësisë me eficiencë të energjisë;
- Futja në përdorim e releve termike/releve të kohës për boilerët elektrikë;
- Futja në përdorim e Ngrohësve Diellorë të Ujit për të zëvendësuar boilerët elektrikë; etj.

Masat e mëposhtme për EE-në janë masa të mundshme për sektorin e shërbimeve publike dhe private:

- Futja në përdorim e Ngrohësve Diellorë të Ujit për të zëvendësuar boilerët elektrikë.
- Përdorimi i sistemeve qendrore të kondicionimit të ajrit me eficiencë të energjisë.
- Përdorimi i ndriçimit me eficiencë të energjisë;
- Përdorimi i frigoriferëve, makinave larëse, makinave pjatlarëse me eficiencë të energjisë, dhe pajisjeve shtëpiake ("produkte të bardha") të tjera me konsum të madh të energjisë;
- Përdorimi i pompave të nxehtësisë me eficiencë të energjisë; etj.

Masat e mëposhtme për EE-në janë masa të mundshme për sektorin e industrisë:

- Futja në përdorim e motorëve elektrikë me eficiencë të energjisë;
- Përmirësimi i faktorit të fuqisë;
- Futja në përdorim e ndriçimit me eficiencë të energjisë;
- Menaxhim më i mirë për të ulur konsumin e energjisë;



- Futja në përdorim e teknologjive të reja industriale, të cilat konsumojnë më pak energji (intensitet energjetik më të ulët); etj.

Institucionet përgjegjëse

Institucionet kryesore përgjegjëse për të sjellë kursimet e energjisë janë operatori i shpërndarjes/furnizuesi publik me pakicë, OSHEE-ja, Agjencia për Efiçencën e Energjisë (në varësinë e MEI-t), si edhe ERE për qëllimet rregullatore. Entitete të tjera të përfshira në zbatim do të jenë Fondi për Efiçencën e Energjisë, krijuesit e skemës dhe bashkëpunëtorët (p.sh. bashkitë dhe bankat e nivelit të dytë) dhe kompanitë e shërbimeve energjetike.

3.7 Tregu për shërbimet energjetike

Statusi i zbatimit

Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm nga kontraktimi i performancës energjetike, pavarësisht gjendjes të dobët të stokut aktual të ndërtesave. Ndërsa pengesat për zbatimin e kontraktimit të shërbimeve energjetike për sektorin e banesave janë të mëdha, kursime të konsiderueshme janë të mundshme në ndërtesat publike dhe sektorët e tregtisë dhe industrisë.

Në Shqipëri, kompanitë e shërbimeve energjetike (ESCO) duhet të pajisen me licencë, sipas ligjit nr. 10081 *“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”*. Megjithatë, tregu për ESCO-t dhe kontraktimi i performancës energjetike në vend kanë qenë të kufizuara nga mungesa e një kuadri rregullator të qartë dhe procesit të licencimit, opsioneve të financimit dhe stimujve, si dhe njohjes së kostove dhe pasjes së eksperiencës në furnizim.

Në Shqipëri ka disa shoqata tregtare të fuqishme, të cilat mund të sigurojnë koordinimin e zhvillimit të tregut për produkte dhe shërbime me EE, gjë që sjell një furnizim të ndarë dhe mungesë të opsioneve dhe ekspertizës për sigurimin e masave për EE-në. Kjo mungesë e tregut për furnizimin me produkte dhe shërbime me EE është një kufizim për zhvillimin e këtij sektori. Kombinimi i një furnizimi të pakoordinuar të tregut me mungesën e kodeve të praktikës dhe niveleve të ulëta të informimit lidhur me kriteret për EE-në (p.sh. nëpërmjet etiketimit), çon drejt vendimeve për blerjen e produkteve bazuar në çmimin më të lirë sesa në cilësinë. Kjo nxjerr në pah rëndësinë shtesë jo vetëm për zbatimin e një platforme të fortë të monitorimit dhe verifikimit, por gjithashtu edhe zbatimin e standardeve të garantimit të cilësisë në mbështetje të masave për EE-në.

Kuadri ligjor mbështetës

Neni 18 i ligjit për efiçencën e energjisë, të sapo miratuar, ka për qëllim të ofrojë bazat për të luftuar këtë çështje. Ky nen kërkon që Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë të miratojë kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit e të ekspertizës profesionale që duhet të kenë kompanitë që do të licencohen. Shërbimet energjetike mund të sigurohen me negociim të lirë ndërmjet palëve, të termave dhe kushteve, përveçse kur ato sigurohen nga një program i financuar nga Fondi për Efiçencën e Energjisë. Në këto rrethana, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, me propozimin e Agjencisë për Efiçencën e Energjisë, do të miratojë kontrata



standarde për shërbimet energjetike. Aktet nënligjore përkatëse për zbatimin e këtij procesi kërkojnë të përgatiten dhe miratohen deri në nëntor 2017.

Përderisa mundësitë e financimit tregtar në këtë fushë vazhdojnë të mungojnë, në fazat e para të zhvillimit të tregut Fondi për Eficiencën e Energjisë mund të jetë një burim shumë i rëndësishëm për financim. Neni 24 i ligjit për eficiencën e energjisë, paragrafi 4, kërkon që financimi i shërbimeve energjetike nga Fondi duhet t'i nënshtrohet procedurave të hapura konkurruese.

Masat e synuara dhe veprimet e planifikuara

Masa e propozuar H4, "Promovimi i Kontraktimit të Performancës Energjetike", është rrjedhojë e këtij kuadri ligjor. Me qëllim të rritjes maksimale të potencialit të ESCO-ve, promovimi/marketingu i mundësive, siç identifikohen nga masa e propozuar H4, është jetësor, veçanërisht duke marrë parasysh nivelin e ulët të njohurive në ministri dhe zyrat e prokurimeve të bashkive, lidhur me format e kontratave të shërbimeve energjetike. Kjo masë do të jetë ngushtësisht e harmonizuar me trajnimin e audituesve të energjisë dhe përditësimin e rregullave të prokurimeve publike me qëllim që të reflektohen kriteret e EE-së dhe kostot e ciklit të jetëgjatësisë.

Detajet financiare për investimet ESCO, të prokuruar nga një agjenci publike kërkojnë sqarimin - që do të thotë se investime të tilla që garantohen nga kursimet e energjisë nuk duhet të jenë borxh publik dhe se pagesat sipas EPC-së duhet të jenë plotësisht të lejuara si një zë i buxhetit (aktualisht kërkojnë miratim nga Thesari).

Ndërsa në Shqipëri buxhetet shumëvjeçare lejohen me miratimin e ministrisë përgjegjëse për financat, aktualisht entitetet publike duhet të përgatisin parashikimet 3-vjeçare. Prandaj propozohet planifikimi buxhetor afatgjatë dhe miratimi i pagesave, sipas një EPC-je, si një zë buxheti plotësisht i lejuar.

Institucionet përgjegjëse

MIE është përgjegjëse për përgatitjen e akteve nënligjore të kërkuara (për t'u miratuar nga Këshilli i Ministrave) mbi kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit e të ekspertizës profesionale që duhet të kenë kompanitë e shërbimeve energjetike. Megjithatë, zbatimi me sukses i kësaj mase do të kërkojë përfshirjen e shumë entiteteve shtetërore, duke përfshirë ministrinë përgjegjëse për financat me ndihmën lidhur me ndryshimet në udhëzimet për buxhetin, Agjencinë për Eficiencën e Energjisë dhe Fondin për Eficiencën e Energjisë në nxitjen dhe mbështetjen me financime të projekteve ESCO, si edhe sigurimin e trajnimeve për specialistët e prokurimeve mbi mënyrën si të trajtohen tenderat ESCO, për APP-në dhe bashkitë në shqyrtimin e ESCO-ve në prokurimet publike.

Nga ana e tregut, krijimi dhe zhvillimi i shoqatave tregtare dhe kodeve përkatëse të praktikës, si edhe thellimi i kuptimit të kontraktimit ESCO nga bankat e nivelit të dytë do të jenë të dyja shumë të rëndësishme.



3.8 4.8 Llogaritjet e kostos optimale

Ligji 116/2016 mbi Performancën Energjetike të Ndërtesave (PEN) kërkon një Metodologji Kombëtare Llogaritjeje (MKLL), e cila të përgatitet bashkërisht nga Ministria përgjegjëse për energjinë dhe Ministria përgjegjëse për ndërtimin. MKLL-ja do të jetë metodologjia për të llogaritur performancën e integruar të një ndërtese apo njërive të ndërtesës. Ajo do të përdoret për llogaritjen e niveleve të kostos optimale të kërkesave të performancës energjetike për ndërtesat, njësitë dhe elementët e ndërtesave që gjithashtu do të mundësojnë përgatitjen e certifikatës të performancës energjetike (EPC). Aktet nënligjore përkatëse pritet që të përgatiten.

Dihet se kryerja e llogaritjeve të kostos optimale qëndron në rrugë kritike për të mundësuar përshtatshmërinë e masave të propozuara që përshkruhen për sektorin e ndërtesave në Seksionin 3.3. Në vazhdim të zhvillimit të tyre, një studim është i nevojshëm për një grup ndërtesash referencë, përfaqësuese të një game të llojeve të ndërtesave dhe të vlefshme si për ndërtesat e reja (gjithë ndërtesën) ashtu edhe për rinovimet e ndërtesave ekzistuese (pjesë të ndërtesës).

3.9 4.9 Strategjia për rritjen e ndërtesave me konsum energjie pothuajse zero

Ligji 116/2016 për PEN (trajtuar gjerësisht në Seksionin 4.11 më poshtë) kërkon që Ministria përgjegjëse për ndërtimin të përgatisë një plan kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me konsum energjie pothuajse zero në Shqipëri. Plani do të përfshijë

- Përcaktimin e detajuar të ndërtesave me konsum energjie pothuajse zero, në kushtet e Shqipërisë, me një referencë bazuar në një tregues numerik për konsumin e energjisë primare (kWh/m² për vit).
- Objektivin që të gjitha ndërtesat e reja duhet të përmbushin këtë përcaktim, deri më 31 dhjetor 2020.
- Objektivin që të gjitha ndërtesat e reja, në përdorim dhe pronësi të autoriteteve publike, duhet të përmbushin këtë përcaktim, deri më 31 dhjetor 2018.
- Objektivin e ndërmjetëm për përmirësimin e performancës të ndërtesave të reja dhe të stokut të ndërtesave ekzistuese.
- Objektivat e ndryshme në varësi të kategorisë së ndërtesës.
- Informimin për masa politike dhe financiare shtesë apo masa të tjera të nevojshme për të arritur këto objektiva. Plani duhet të marrë në konsideratë instrumentet më të përshtatshëm dhe në çdo tre vjet, duke filluar nga 30 qershori 2015, të listojë masat ekzistuese, si edhe të propozojë masa dhe instrumente të tjera.



3.104.10 Masat alternative për sistemet e ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit

Politika mbi inspektimin periodik të sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit duhet ende të përcaktohet në Shqipëri. Kështu, ligji që është hartuar për transpozimin e DPEN-së lejon mundësinë e inspektimit periodik të sistemeve të ngrohjes me kalidaja me një fuqi efektive të ngrohësve të hapësirës më të madhe se 20kW dhe për sistemet e kondicionimit të ajrit me një fuqi efektive më të madhe se 12 kW, dhe gjithashtu për mundësinë e përdorimit të 'masave alternative' për të gjithë apo një pjesë të gamës së sistemeve të tilla të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit. Megjithatë, synimi aktual është që të paktën instalimet e mëdha t'i nënshtrohen inspektimeve periodike, në përputhje me kërkesat e PEN-së, dhe kjo do të fillojë në tetor 2018 për sistemet e ngrohjes dhe në prill 2018 për sistemet e kondicionimit të ajrit.

3.114.11 Masa për të mbështetur zbatimin e DPEN-së

Kuadri ligjor mbështetës

Ligji për performancën energjetike të ndërtesave është hartuar dhe është gati për t'u miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligji transponon kërkesat e Direktivës 2010/31/EU, por zbatimi i plotë lidhet me përgatitjen e akteve nënligjore shoqëruese që përfshijnë:

- Një Metodologji Kombëtare Llogaritjeje (MKLL) për llogaritjen e performancës energjetike të integruar të një ndërtese apo njësisive të ndërtesës dhe të përdorura në llogaritjen e niveleve të kostos optimale të kërkesave të performancës energjetike për ndërtesat, njësitë dhe elementët e ndërtesës që do të mundësojnë përgatitjen e certifikatës së performancës energjetike (EPC).
- Kërkesat minimale për performancën energjetike të ndërtesave (e llogaritur në përputhje me MKLL-në).
- Kërkesat e sistemit për performancën e përgjithshme energjetike, instalimin dhe dimensionimin e përshtatshëm, përshtatjen dhe kontrollin e sistemeve teknike të ndërtesës në ndërtesat ekzistuese.
- Metodologjinë për llogaritjen e niveleve të kostos optimale të kërkesave të performancës energjetike për ndërtesat, njësitë dhe elementët e ndërtesave.
- Kërkesat minimale të performancës dhe kërkesat për përdorimin e sistemeve alternative me efikasitet të lartë për ndërtesat me konsum energjie pothuajse zero.
- Procedurat me anë të të cilave do të kryhet certifikimi energjetik i ndërtesave dhe njësisive të ndërtesave, si edhe tipi, modeli, përmbajtja, dhe procedurat për



lëshimin dhe regjistrimin e certifikatës së performancës energjetike të ndërtesës përkatëse.


- Procedurat për inspektimin e sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit.
- Kërkesat për ekspertizën dhe aftësinë e një eksperti të pavarur për procedurat e certifikimit, procedurat e operimit, regjistrimit, procedurat e supervizionit dhe trajnimit.
- Kodi i praktikës për ekspertët e pavarur që kryejnë certifikimin energjetik të ndërtesave dhe njësive të ndërtesave.
- Sistemin e pavarur të kontrollit për të verifikuar EPC-në me anë të një kontrolli të vlefshmërisë së të dhënave të hedhura për ndërtesën dhe njësinë e ndërtesës, të cilat përdoren për lëshimin e certifikatës të performancës energjetike dhe të rezultateve të pasqyruara në certifikatë.

Masat e synuara për zbatim

Masat specifike që duhen ndërmarrë në mbështetje të zbatimit të ligjit për PEN janë trajtuar në seksionet e mësipërme, së bashku me institucionet përgjegjëse respektive. Në Figura janë paraqitur rrugët kritike për përmbushjen e tre elementëve kyçë të metodologjisë së kostos optimale, kërkesat për performancën energjetike dhe NKEZ-të, si dhe certifikimin e performancës energjetike të ndërtesave. Siç u vu në dukje, ka një ndërvarësi të konsiderueshme, prandaj ka një rëndësi të madhe koordinimi dhe afatet kohore për secilën nga punët.



Figura 10 Hapat kryesore dhe rruga kritike për zbatimin e masave të PEN-së



4 Masat politike për zbatimin e DEE-së

4.1 Masat legislative dhe raportimi mbi objektivat e 2020



Për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ku bën pjesë dhe Shqipëria, transpozimi i Direktivës 2012/27/EU (Për Eficiencën e Energjisë) u bë e detyrueshme me vendim të Këshillit të Ministrave (D/2015/08/MC-EnC) të mbajtur në Tiranë, Shqipëri. Data e fundit për transpozimin e plotë të EED për të gjitha palët kontraktuese të Komunitetit të energjisë është Tetor 2017. Direktiva vendos një sërë detyrimesh të cilat duhet të jetë një pjesë e PKVEE-së në bazë të parimeve EED të cilat duhet të dorëzohen në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë deri në fund të Prill-it 2019 (shih figurën x).

Në krahasim me shtetet anëtare të BE-së, ku afati i fundit për transpozimin e EED ishte para dorëzimit të PKVEE-së tretë, për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, PKVEE e tretë është menduar të jetë e përgatitur në bazë të formatit të PKVEE-së së dytë (për shtetet anëtare të BE-së), por me shtesën e Kapitullit që kanë të bëjnë me masat e planifikuara të politikës DEE-së.




Figura x, Kohezgjatja e implementimit të DEE-së (Nenet 3, 5 dhe 7).

Në Figurën x, jepet afati kohor për raportimin e rezultateve sipas DEE-së. Mund të vërehet se neni 3, i cili, merret me objektivat e përgjithshme kombëtare të kursimit të energjisë mbulon periudhën Qershor 2018 duke përfunduar në Prill 2018. Në këtë periudhë kalimtare NEEAP i parë 2011-2018 duhet të jenë i vlefshëm, derisa NEEAP i dytë dhe i tretë, i cili, është hartohet plotësisht nën DEE duhet të jenë të përgatitur. Transpozimi i plotë i DEE-së pritet nga mesi i Tetor 2018, që do të thotë hartimi i legjislacionit të ri për Eficiencën e Energjisë dhe përgatitjen e legjislacionit dytësor në format e vendimeve, rregulloreve dhe urdhëresave.


Megjithatë, Neni 7 i cili merret me Skemat Detyruese për Eficiencën e Energjisë (SDEE) duhet të japë rezultatet duke filluar nga fillimi i vitit 2018. Vlerësimi i rëndësishëm së këtij detyrimi



bëhet më kompleks nga fakti se neni 7, i DEE-së, pavarësisht instrumentit të zbatimit (skemat e detyrimit ose masave alternative), janë kumulative për çdo vit dhe me zbatimin vetëm në një vit të vetëm mund të rrezikohet se objektivat nuk do të arrihet në fund të periudhës (fundi i 2020).

Për sa i përket nenit 5 lidhur me rinovimin vjetor të ndërtesave në pronësi dhe në përdorim nga institucionet publike duhet të fillojë në fillimin e 2018, pas skadimit të afatit për transpozimin e plotë të DEE-së. Për të dy nenet e përmendura të kursimit të energjisë objektivat (përqindjet) janë të ndryshme në krahasim me shtetet anëtare të BE-së. Më shumë për këtë temë do të jepet në paragrafët që përshkruajnë këto dy nene.

Është e rëndësishme të thuhet se afatet për nene të veçantë për zbatimin e DEE-së në palët kontraktuese SKE-së janë në grup të përgjithshme me zhvendosjen në kohë me 3 vjet në krahasim me shtetet anëtare të BE-së. Kjo do të thotë se përpjekje të konsiderueshme do të duhet të investohen në palët kontraktuese SKE-së duke pasur parasysh se koha në dispozicion për implementim është më e shkurtër sesa në shtetet anëtare të BE-së. Në anën tjetër, palët kontraktuese SKE-së mund të mësojnë nga përvoja shteteve anëtare të BE-së, praktikat e mira dhe të këqija gjatë implementimit.




Në Figurën x jepet plani kohor për zbatimin e neneve të ndryshme, duke përfshirë njoftimin e kërkuar në SKE lidhur me artikuj të ndryshëm nga DEE-ja. Me ngjyrë të verdhë të dhëna në figurën x përfaqësojnë kohën indikative për përgatitjen e studimeve të ndryshme, raportetve dhe konkluzioneve të nevojshme për të dhënë mendimet dhe njoftimin sipas afateve.

Figura 3, paraqet DEE-sw në blloqe, në blloku blu janë objektivat që vijnë nga neni 3 si objektiva tregues kombëtar, Neni 7 si skema të detyrueshme për kursimet e përdorimit



përfundimtar të energjisë me blloqe të kuqe të cilat duhet të mbështesë zbatimin dhe përmbushjen e objektivave të përgjithshme deri në vitin 2020 dhe më tej dhe blloqe portokalli paraqesin elementet të cilat duhet të kontribuojnë dhe të shtyjnë vendet për të arritur objektivat.

Ju lutem vini re, se në kutinë e gri të errët rishikimi dhe monitorimi është treguar i cili duhet të ketë vend të pikatur në të gjithë procesin.



Transpozimi i Direktivës për Eficiencën e Energjisë për Shqipërinë mbështetet mbi ligjin për eficiencën e energjisë (ligji nr. 124/2015), i cili transponon shumë prej kërkesave të Direktivës 2012/27/EU.

Ndërsa dy nga këto pjesë të legjislacionit parësor janë miratuar dhe i treti pritët të miratohet së shpejti, mbetet për t'u kryer një punë e konsiderueshme për përgatitjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e plotë. Përgatitja e këtyre akteve nënligjore dhe institucioneve, si Agjencia për Eficiencën e Energjisë dhe Fondi për Eficiencën e Energjisë, konsiderohen si pengesat kryesore për t'u kapërcyer me qëllim për të arritur përputhshmëri të plotë me detyrimet e DEE-së. Detajet e kësaj strukture institucionale dhe kuadrit financiar jepen në Seksionin 6.

Ligji për eficiencën e energjisë është miratuar zyrtarisht nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në nëntor 2015. Ligji parashikon bazën për transpozimin e kërkesave të nenit 3 (objektivat), nenit 6 (blerjet nga organet publike), nenit 8 (auditimet energjetike dhe menaxhimi i energjisë), nenet 9-11 (matja dhe faturimi), nenet 12 dhe 17 (informimi dhe trajnimi) dhe nenit 18 (shërbimet energjetike). Për më tepër, neni 24 i cili detajon programet



që mund të financohen nga Fondi për Eficiencën e Energjisë do të lejonte transpozimin e nenit 7, duke përdorur rrugën e masave alternative.

Aktet nënligjore kërkohen të miratohen brenda 12 muajve nga miratimi i ligjit për eficiencën e energjisë. Aspektet me rëndësinë më të madhe përfshijnë:

- Kategoritë, kushtet dhe kualifikimet e kërkuara për Menaxherët e Energjisë përdërisa duhet të emërohen nga konsumatorët publikë ose privatë të kategorizuar si konsumatorë të mëdhenj të energjisë.
- Kategoritë, kushtet dhe kualifikimet e kërkuara për lëshimin e licencave për Auditues të Energjisë dhe veçmas për Kompanitë e Shërbimeve Energjetike.
- Politikën kombëtare për eficiencën e energjisë dhe monitorimin e zbatimit mbështetur në dokumentin bazë të Strategjisë Kombëtare të Energjisë (aktualisht po përgatitet nga MIE me ndihmën e USAID-it).
- Përcaktimin e treguesve dhe metodologjive për monitorimin e zbatimit të këtij plani së bashku me kërkesat për raportim.
- Urdhrin mbi formën dhe formatin e dorëzimit të të dhënave energjetike tek Agjencia për Eficiencën e Energjisë nga konsumatorët e energjisë (kur kërkohet).
- Udhëzime mbi përcaktimin e konsumit të energjisë termike në ndërtesat e përbashkëta që nuk kanë matje individuale.
- Udhëzime mbi tipin dhe frekuencën e informacionit të dhënë nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë (p.sh. mekanizmat për eficiencën e energjisë, kuadrin ligjor dhe financiar, trajnimi i audituesve dhe menaxherëve të energjisë).
- Përgatitjen e kontratave standarde për projektet e mbështetura nga Fondi për Eficiencën e Energjisë.
- Formatin dhe afatet e pagesave për auditimet energjetike.

Në vazhdim të atyre më sipër, ligji për eficiencën e energjisë gjithashtu duket të ofrojë garantimin e burimeve të kënaqshme për të përgatitur dhe administruar një sërë sistemesh teknike dhe proceduriale të nevojshme për zbatimin e ligjit për PEN (përshtuar në Seksionin 4.11). Një pjesë shtesë e legjislacionit mbështetës për masat e DEE-së është dhe ligji për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji (ligji nr. 68/2012).

4.2 5.2 Strategjia për rinovimin e ndërtesave (Neni 4)

Një Strategji e plotë për Rinovimin e Ndërtesave në Shqipëri mbetet ende për t'u përgatitur. Ky seksion përmban një paraqitje të zhvillimeve kryesore, të cilat do të jenë komponentët kryesorë të strategjisë. Megjithatë, puna bazë për një strategji të tillë filloi me hartimin e raportit "*Tipologjia e stokut të ndërtesave rezidenciale në Shqipëri dhe modelimi i transformimit të*



*tij me karbon të ulët*⁷, në kuadër të Programit të Evropës Juglindore për Mbështetjen e Zhvillimit me Emetime të Ulëta (MZHEU) me kontributin e MEI-t, MTI-së dhe AKBN-së. Raporti kategorizon ndërtesat rezidenciale, llogarit performacën e tyre energjetike termike në tre zona klimatike, projekton paketat e standardizuara të rinovimit dhe llogarit kursimet e mundshme të energjisë dhe investimet e kërkuara sipas llojit të ndërtesës. Raporti vlerëson që me zbatimin e paketave të propozuara, shërbimet e energjisë termike mund të ulen me 27%, kur krahasohen me situatën e zakonshme.

Statusi i zbatimit dhe kuadri ligjor mbështetës

Siç u përmend në hyrjen e këtij seksioni, MIE është në procesin e harmonizimit dhe transpozimit të legjislacionit për eficiencën e energjisë dhe performancën energjetike të ndërtesave, të cilat do të jenë të përshtatshme për ndërtesat e reja të banimit dhe rikonstruksionin e stokut ekzistues. Ministria përgjegjëse për zhvillimin urban ka në mandatin e saj hartimin e politikave për banesat me kosto të përballueshme, duke përfshirë politikat për rikonstruksionin e banesave. Në mbështetje të kësaj, Ministria përgjegjëse për zhvillimin urban sapo ka miratuar dhe rregulloret për kompanitë e menaxhimit dhe personat fizikë, të cilët do të krijojnë shumë mundësi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që të fillojnë punën për rikonstruksionin e stokut ekzistues.

Pas miratimit të ligjit të përmendur më sipër dhe Vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, u mendua se zbatimi do të fillonte menjëherë, por nuk ndodhi kështu gjatë periudhës 2003-2005 dhe në të vërtetë, gjatë periudhës 2014-2015, u vunë re vetëm përmirësime të vogla. AKBN-ja ka audituar 10 bashkitë më të mëdha të vendit (gjatë 2011-2013), me qëllim që të kontrollojë zbatimin e ligjit për ruajtjen e energjisë në ndërtesa. Nga auditimet u vu re se asnjë nga bashkitë e audituara nuk e ka zbatuar ligjin në shkallë të madhe (niveli aktual është vlerësuar të jetë jo më shumë se 15-20%). Përveç kësaj, Inspektoriati i Ndërtimit (në varësi të Ministrisë përgjegjëse për zhvillimin urban), i cili në të njëjtën kohë është edhe institucioni përgjegjës për kontrollin e zbatimit të lejeve/projekteve të miratuara të ndërtimit, ka mungesa në kuptimin e nevojshëm të ligjit dhe mungesa në ekspertizën teknike për zbatimin e kërkesave të ligjit.

Projektimi dhe ndërtimi i ndërtesave duhet të përmbushë parametrat teknikë të nevojshëm për ruajtjen, kursimin dhe përdorimin me eficiencë të energjisë. Sipas vendimit të përmendur më sipër, të gjitha ndërtesat që do të ndërtohen duhet të respektojnë koeficientin vëllimor e normativ të humbjeve termike (Gv), si dhe të parashikojnë vendosjen e instalimit termik të ngrohjes qendrore ose vendore.

Pas miratimit të ligjit përfundimtar mbi performancën energjetike të ndërtesave, Kodi Energjetik i Ndërtesave në Shqipëri duhet të rishikohet, për të parë nëse kërkohen përditësime ose ndryshime. Ligji është në përputhje dhe konvergjencë të plotë me Direktivën Evropiane “Mbi Performancën Energjetike të Ndërtesave” (“PEN”). Ligji në lidhje me PEN-ë do të miratojë objektivat më kryesore të kësaj Direktive: të ulë konsumin e energjisë dhe të ulë emetimet nga sektori i ndërtesave, me qëllim që të lejojë BE-në dhe përfaqësues të vendeve të tjera evropiane të përmbushin të gjitha detyrimet.

⁷Raporti gjendet në adresën http://sled.rec.org/documents/SLED_Albania_BUILDING_ENG.pdf



Megjithëse kursimet e energjisë me potencialin më të madh duhet të arrihen në sektorin e banesave, pengesat për zbatim janë të konsiderueshme. Zhvillimi në shkallë të gjerë i kredive tregtare është i mundur vetëm në një shkallë të kufizuar, duke marrë parasysh gjendjen e ekonomisë dhe për shkak të nivelit të lartë të shpenzimeve të përgjithshme; për stokun e ndërtesave ekzistuese skemat si ESCO në sektorin e banesave nuk kanë të ngjarë të jenë efektive në periudhën afatshkurtër.

Masat e synuara për t'u përfshirë në Strategjinë për Rinovimin e Ndërtesave

Masat e shumta të propozuara në këtë PKVEE do të kontribuojnë drejt Strategjisë për Rinovimin e Ndërtesave në Shqipëri. Këto përfshijnë bazat për përgatitjen e rregulloreve të përshtatshme, kryerjen e llogaritjeve të kostos optimale, përcaktimin e objektivave për NKEZ-të dhe lëshimin e certifikatave të ndërtesave. Fazat e ndryshme të zbatimit të këtyre veprimeve jepen në Seksionin 4.11 dhe do të kërkojnë përpunim në Strategjinë për Rinovimin e Ndërtesave. Po kështu, përmirësimet e veshjes së jashtme të ndërtesës dhe sistemet e energjisë mund të kryhen nëpërmjet përfshirjes së kompanive të shërbimeve, siç përshkruhet në Seksionin 4.6 dhe skemat e tjera të financimit të ofruara nga bankat e nivelit të dytë.

Institucionet përgjegjëse

MIE me mbështetjen e MZHU-së do të mbajnë përgjegjësinë finale për përgatitjen e Strategjisë për Rinovimin e Ndërtesave dhe zbatimin e saj. Megjithatë, ashtu si me tregun për shërbimet energjetike, shumë entitete të tjera do të nevojiten të përfshihen, si nga sektori publik ashtu dhe sektori privat. Këto do të përfshijnë ministri të tjera dhe APP-në për të siguruar që standardet e efijencës së energjisë janë përfshirë në mënyrë të drejtë në procedurat e prokurimeve dhe vendimet për ndërtesat e reja apo të rinovuara. Ngritja a kapaciteteve dhe njohurive të ndërtuesve, furnizuesve, shoqatave të tyre dhe bankave të nivelit të dytë do të jetë një element i rëndësishëm në shpërndarjen e suksesshme, e cila në mënyrë të dobishme mund të mbështetet nga ana e ndërmarrjeve, si edhe nga Agjencia për Efijencën e Energjisë. Këto entitete do të kenë nevojë për konsultime gjatë përgatitjes së strategjisë.

4.3 5.3 Ndërtesat e qeverisë qendrore (Neni 5)

Statusi i zbatimit

Ndërtesat e qeverisë qendrore përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të stokut të përgjithshëm të ndërtesave dhe masat për EE-në në ndërtesat publike të qeverisë qendrore dhe bashkive përbëjnë një kontribut relativisht të vogël në potencialin e përgjithshëm të kursimeve të energjisë në Shqipëri. Megjithatë, fillimi i zbatimit të masave për kursimin e energjisë në këto ndërtesa është i rëndësishëm, pasi ato janë në gjendje të sigurojnë kursime të ndjeshme të energjisë dhe kështu do të shërbejnë si një shembull pozitiv për iniciativat e tjera për EE-në në Shqipëri, bazuar edhe në projektet pilote të ndërmarra në kuadër të



programit të KfW-së për EE-në. Në anën e furnizimit, kjo do të krijonte mundësi reale për kompanitë e ndërtimit, ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit dhe këto kompani do të punojnë për të rritur aftësitë dhe njohuritë e tyre me qëllim që të fitojnë kontrata për zbatimin e masave për EE-në në stokun e ndërtesave. Pasi të përfundohet me sukses zbatimi i një numri projektesh të tilla, disa nga këto kompani do të zhvillohen dhe transformohen në ESCO.

Kuadri ligjor mbështetës

Një përshkrim i kuadrit ligjor për të mbështetur përmirësimet për EE-në në ndërtesat publike është dhënë në Seksionin 3.4.2.

Gjithashtu, MIE do të përgatisë aktet nënligjore, siç është e detyruar të veprojë në përputhje me ligjin për EE-në, lidhur me masat për financim dhe mekanizmat financiarë për eficiencën e energjisë.

Masat e synuara për zbatim

Masat për të ndihmuar në përmbushjen e objektivit mbulojnë një numër masash të cilat janë trajtuar në seksionet e mëparshme. Këto përfshijnë zbatimin e auditimit energjetik, certifikimin e ndërtesave, përfshirjen e kërkesave për eficiencën e energjisë në kriteret e prokurimeve publike, në mënyrë që vetëm ndërtesat e një standardi të lartë të EE-së të mund të merren me qira apo blihen nga entitetet qeveritare, krijimin e tregut për ESCO-t, dhe mbështetjen financiare nga Fondi për Eficiencën e Energjisë.

Institucionet përgjegjëse

MIE është përgjegjëse për propozimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe rregullator që duhet të krijohet, ndërsa Agjencia për Eficiencën e Energjisë propozohet të marrë rolin drejtues në monitorimin e progresit kundrejt objektivave dhe të sigurojë që masat ndihmëse të përdoren plotësisht. Gjithashtu, Ministria e Zhvillimit Urban do të luajë një rol kryesor nëpërmjet bashkëpunimit me MEI-n në hartimin e rregulloreve të nevojshme dhe zbatimit të tyre.

4.4 Blerjet nga organet publike (Neni 6)

Raportuar në Seksionin 3.4.3.

4.5 Skema detyruese për eficiencën e energjisë dhe masat politike alternative (Neni 7)

Raportuar në Seksionin 4.6.



4.6 Auditimet energjetike dhe sistemet e menaxhimit (Neni 8)

Statusi i zbatimit

Auditimet energjetike dhe certifikimi për ndërtesat rezidenciale dhe ato të shërbimit, si edhe për konsumatorët industrialë ishin të parashikuara edhe në PKVEE-në I, së bashku me masat përkatëse. Lidhur me këtë ishte i parashikuar edhe trajnimi i stafit të menaxherëve të ndërtesave për të monitoruar konsumin e energjisë në ndërtesat publike.

Siç u vu në dukje më sipër, GIZ-i ka zbatuar një program të auditimit energjetik dhe menaxhimit të energjisë, i cili deri tani ka trajnuar 50 menaxherë të energjisë në Shqipëri dhe një program tjetër nga Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) ka certifikuar rreth 75 auditues të energjisë. Megjithatë, një zbatim më i përhapur u pengua nga mungesa e kapaciteteve për trajnimin e audituesve dhe vonesave në miratimin e legjislacionit mbështetës. Në të vërtetë, përgatitja e një kurrikule të qartë dhe krijimi i një Komisioni Licencues për përgatitjen dhe licencimin e audituesve të energjisë për ndërtesat dhe objektet industriale janë hapa të rëndësishëm që duhen ndërmarrë.

Kuadri ligjor mbështetës

Ligji për eficiencën e energjisë i miratuar së fundi, krijon një bazë më të shëndoshë për të mundësuar një metodologji të harmonizuar për auditimet energjetike. Nenet 16 dhe 17 parashikojnë përkatësisht qëllimin e nivelit të lartë për auditimet energjetike dhe rolin e një audituesi të energjisë. Auditimet energjetike janë të detyrueshme për konsumatorët e mëdhenj të energjisë (të përcaktuar si konsumatorë me një konsum vjetor të energjisë më të madh se ekuivalenti i 3 milionë kWh), si për konsumatorët publikë dhe privatë dhe/ose çdo aplikues tek Fondi për Eficiencën e Energjisë.

Auditimet duhet të kryhen çdo tre vjet ose kurdoherë që një objekt industrial apo ndërtesë merret në dorëzim ose rinovohet. Formatit do të përcaktohet në aktet nënligjore dhe rezultatet duhet të dorëzohen pranë Agjencisë për Eficiencën e Energjisë. Veprimet e rekomanduara nga auditimet duhet të zbatohen brenda dy viteve nga pranimi i rezultateve të auditimit.

Sipas nenit 10 të ligjit për eficiencën e energjisë, të gjithë konsumatorët e mëdhenj të energjisë duhet të emërojnë një Menaxher Energjie, përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve që konsumojnë çdo formë energjie, për përmirësimin dhe mbikëqyrjen e metodave të përdorimit të energjisë dhe kryerjen e detyrave të tjera për përdorimin racional të energjisë në industri dhe ndërtesa.

Aktet nënligjore përkatëse kërkohet të përgatiten deri në nëntor 2018. Kjo do të mundësojë zbatimin e një sërë masash të propozuara, siç detajohet në Seksionin 3.3 më poshtë, dhe që përbëhet nga hapat e mëposhtme:

- Përgatitja e akteve nënligjore në lidhje me auditimet energjetike të ndërtesave dhe ndërmarrjeve industriale;



- Përgatitja e metodologjisë bazuar në standardet ndërkombëtare për auditimet energjetike të ndërtesave dhe ndërmarrjeve industriale;
- Hartimi i kurrikulës me njohuritë e nevojshme për t'u njohur nga kandidatët, të cilët do të testohen për të marrë licencën e audituesit të energjisë për ndërtesat dhe ndërmarrjet industriale;
- Krijimi i Komitetit të Licencimit; dhe
- Krijimi i regjistrit të audituesve të energjisë të licencuar për ndërtesat dhe ndërmarrjet industriale.

Masat e synuara dhe veprimet e propozuara

Auditimi energjetik është në vetvete një masë e propozuar dhe një veprim i nevojshëm që lejon zbatimin e mëtejshëm të masave të propozuara. Masa horizontale H5 buron nga ligji për zbatimin e auditimeve energjetike të detyrueshme dhe sistemeve të menaxhimit për konsumatorët e mëdhenj të energjisë, publikë dhe privatë. Kjo parashikon mbështetje për zbatimin e auditimit energjetik, e cila mund të jetë financiare (p.sh. bashkëfinancim nga Fondi për Eficiencën e Energjisë) apo teknike (p.sh. trajnim i audituesve të energjisë). Në mënyrë të ngjashme, masa I2 mbi auditimet energjetike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Trajnimi për auditimin energjetik, që në mënyrë tipike konsiderohet si një vlerësim i ndërtesës, mbështet skemën e certifikimit energjetik të ndërtesave (EPC), e cila do të krijohet sipas masës R9 (që vetë buron nga të dhënat e Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes). Skema EPC do të jetë e detyrueshme për ndërtesat apo njësitë e ndërtesave të reja (që shiten ose jepen me qira), pjesë të ndërtesave që shiten ose jepen me qira, me një matës të ndarë të energjisë, e kërkuar nga qiramarrësi apo pronari i ardhshëm, apo ndërtesa të rinovuara nga tetori 2018.

Auditimet energjetike, së bashku me etiketimin energjetik dhe EPC-në, parashikojnë pjesërisht mjedisin mbështetës edhe për masat P1 mbi ndriçimin publik, I1 mbi kërkesat minimale për eficiencën e energjisë për motorët elektrikë, ndriçimin dhe furrat industriale, dhe I3 mbi marrëveshjet vullnetare me konsumatorët e mëdhenj industrialë.

Institucionet përgjegjëse

Përgjegjësia për përgatitjen e akteve nënligjore që përcaktojnë procesin e kryerjes së auditimeve energjetike mbetet tek MIE dhe Agjencia për Eficiencën e Energjisë. Kërkohet miratimi nga ministri përgjegjës për ndërtimin, si edhe bashkëpunimi dhe përfshirja e ministrisë përgjegjëse për zhvillimin urban është një faktor i rëndësishëm për të matur zbatimin. Në mënyrë të ngjashme, përgatitja e procedurave të EPC-së do të jetë një përpjekje e kombinuar e MEI-t dhe MZHU-së.

Ndihma për zbatimin do të drejtohet nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë, e cila do të jetë organi që lëshon EPC-në, si edhe do të ndihmojë në dhënie të trajnimeve të nevojshme për audituesit dhe menaxherët e energjisë, do të sigurojë që kapacitetet teknike janë të



disponueshme për një zbatim efektiv. Trajnime të tilla mund të jenë një projekt i pranueshëm për të përfituar mbështetje nga Fondi për Eficiencën e Energjisë.

4.7 Matja dhe faturimi (Neni 9-11)

Statusi i zbatimit

Një projekt pilot për instalimin e matësve inteligjentë nga Deutsche Telekom në Tiranë u lançua në 2015. Iniciativa të tjera janë në fazën e planifikimit me kompaninë e shpërndarjes OSHEE, e cila ka filluar testimin e futjes në përdorim të kartave me parapagim për furnizimin me energji elektrike, si edhe nxitjen e përdorimit të kioskave informative në qytetet kryesore. Kompania njoftoi se planifikon të fusë në përdorim matësit inteligjentë, deri në 2019, si edhe forma të tjera të matësve, të cilët mund të lexohen automatikisht, duke eliminuar kështu mbi ose nën faturimin.

Kuadri ligjor mbështetës

Neni 14 i ligjit për eficiencën e energjisë parashikon bazën për vendosjen e matësve individualë për të gjithë konsumatorët finalë në një ndërtesë me shumë njësi edhe ku kjo gjë nuk është teknikisht e mundur (p.sh. sistemet e përbashkëta të ngrohjes dhe ftohjes), përcakton që aktet nënligjore do të përgatiten për të përcaktuar shpërndarjen ndërmjet përdoruesve. Agjencia për Eficiencën e Energjisë është përgjegjëse për përgatitjen e udhëzimeve të tilla, si edhe për miratimin e tyre nga ministri përgjegjës për energjinë.

Siç u vu në dukje në Seksionin 2.4.2, neni 78 i ligjit për sektorin e energjisë elektrike, i miratuar në prill 2015, lidhet me “sistemet e matësve inteligjentë”. Ligji kërkon që operatori i shpërndarjes, brenda një viti nga hyrja në fuqi e ligjit, të përgatisë një vlerësim ekonomik (për t’u miratuar nga ministri përgjegjës për energjinë) mbi formën dhe afatet kohore për futjen në përdorim të sistemeve të matësve inteligjentë në Shqipëri.

Masat e synuara dhe veprimet e propozuara

Masa H1 mbi faturimin informativ është projektuar në mënyrë që të përmbushë kërkesat e DEE-së, nenit 10, paragrafit 3(c) dhe Shtojcës VII, që përcakton informacionin që duhet t’u jepet konsumatorëve fundorë me faturat.

Institucionet përgjegjëse

Entiteti kryesor përgjegjës për zbatimin e veprimeve të nevojshme është operatori i shpërndarjes, OSHEE, me mbikëqyrjen e MEI-t dhe ERE-s.



4.8 5.8 Nxitja e përdorimit të ngrohjes dhe ftohjes eficiente (Neni 14)

Si edhe për Strategjinë e Rinovimit të Ndërtesave, një vlerësim i potencialit për koogjenerim me eficiencë të lartë dhe ngrohjes e ftohjes së përqendruar eficiente për Shqipërinë mbetet ende për t'u përgatitur. Megjithatë, ky seksion përmban një paraqitje të zhvillimeve kryesore të cilat do të përbëjnë komponentët kryesorë të strategjisë.

Nxitja e Prodhimit të Kombinuar të Nxehtësisë dhe Energjisë (CHP) në shkallë të vogël për përdorim industrial ishte një masë e përfshirë në PKVEE-në I, por qendra e kompetencës që ishte parashikuar dhe nxitja e rregullimit nuk u krye. Megjithatë, disa aktivitete janë kryer, përfshirë një studim fizibiliteti nga UNIDO për përdorimin e biomasës për furnizimin me nxehtësi dhe energji për sektorin e prodhimit të vajit të ullirit. Ky projekt, i cili u zbatua në partneritet me ministrinë përgjegjëse për energjinë, ministrinë përgjegjëse për mjedisin, AKBN-ën dhe Shoqatën Shqiptare të Prodhuesve të Vajit të Ullirit (SHSHPVU), synonte rritjen e përdorimit të biomasës në 15 NVM-e pilote, me një kapacitet prej rreth 1-1.5 MW dhe me një kosto prej rreth 4.5 milionë €.

Në mënyrë më të përgjithshme, pranohet të jenë më shumë se 20 ngrohje të përqendruara dhe 7 njësi CHP në përdorim në Shqipëri. Këto janë, megjithëse, kryesisht operacione shumë të vogla që furnizojnë ndërtesa të mëdha individuale publike ose disa apartamente të reja dhe pjesa e kombinuar e tregut të tyre në furnizimin me nxehtësi është e papërfillshme. Pavarësisht, kjo ndodh për arsye të pasjes në Shqipëri të rajoneve me klimë të ftohtë dhe densitet të lartë të ndërtesave që ofron një potencial të lartë për zgjidhje lokale dhe komunale.

Masa I3 mbi marrëveshjet vullnetare me konsumatorët e mëdhenj dhe auditimet e nevojshme që këto duhet të ndërmarrin, do të mbështesë zbatimin e CHP-ës në këtë sektor, atje ku këto auditime do t'i identifikojnë si një zgjidhje me kosto efektive.

4.9 5.9 Transformimi, transmetimi, shpërndarja e energjisë dhe përgjigjia e kërkesës (Neni 15)

Raportuar në Seksionin 2.4.2.

4.105.10 Mundësia për kualifikim, akreditim dhe skemat e certifikimit (Neni 16)

Statusi i zbatimit

PKVEE-ja I parashikoi disa masa që synonin trajnimin e profesionistëve mbi eficiencën e energjisë. Këto përfshinin kurse trajnimi për specialistët në sektorin e ndërtimit, trajnim për stafin e menaxhimit të ndërtesave të sektorit të shërbimeve, nxitjen e kontraktimit të performancës energjetike dhe trajnimin e audituesve të energjisë për industrinë. Për fat të



keq, shumë pak progres është arritur për shkak të mungesës së një kuadri rregullator të qartë për të mbështetur certifikimin dhe akreditimin e punonjësve, si edhe drejtimin institucional dhe mbështetjen financiare për qëllimet e trajnimit. Përgjatë bëjnë programet e trajnimit të parashikuara për audituesit dhe menaxherët e energjisë, siç u vu në dukje në Seksionin 4.6.

Kuadri ligjor mbështetës

Ligji për eficiencën e energjisë parashikon ndryshimet e nevojshme të ligjeve me qëllim që të korigjohet sa më sipër dhe të hapet rruga për Shqipërinë që të përmbushë kërkesat e nenit 16 të DEE-së. Kategoritë, kushtet dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherët e energjisë për konsumatorët e mëdhenj do të përgatiten nga aktet nënligjore, sipas nenit 10 të ligjit për eficiencën e energjisë. Kërkesa të ngjashme janë bërë edhe për aktet nënligjore në mbështetje të Audituesve të Energjisë, në nenin 17, dhe Furnizuesve të Shërbimeve Energjetike, në nenin 18.

Masat e synuara dhe veprimet e propozuara

Shqipëria pranon nevojën për të vazhduar dhe intensifikuar përpjekjet për trajnim, siç mbështetet nga neni 15 i ligjit për eficiencën e energjisë, dhe programet e trajnimit janë të pranueshme për t'u mbështetur nga Fondi për Eficiencën e Energjisë. Masa e propozuar H3 ka për objektiv ofrimin e trajnimeve mbi eficiencën e energjisë për punëtorët e sektorit të ndërtimit në një mënyrë që të mbështesë siç duhet nxitjen dhe zgjerimin e kompanive të shërbimeve energjetike.

Institucionet përgjegjëse

Pritet që Agjencia për Eficiencën e Energjisë dhe Fondi për Eficiencën e Energjisë të marrin rolin kryesor në trajnimin e stafit, si edhe mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e listës së furnizuesve të akredituar për auditimet energjetike, menaxherëve të energjisë dhe kompanive të shërbimeve energjetike.

4.115.11 Shërbimet energjetike (Neni 18)

Raportuar në Seksionin 3.7.



5 6 Krijimi i organeve kompetente dhe organizatave të deleguara, financimi

5.1 6.1 Organet dhe organizatat përgjegjëse

Grupi i punës ndërministror

Përgatitja e PKVEE-së është drejtuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe mbështetur nga Grupi i Punës Ndërministror (GPN) që përfshin tre ministritë e përmendura më sipër, ministrinë përgjegjëse për mjedisin, ministrinë përgjegjëse për zhvillimin ekonomik dhe ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, AKBN-ën dhe organin e statistikave kombëtare, INSTAT, mbështetja e të cilit në mbledhjen e të dhënave është jetike për një progres efektiv monitorimi.

Rekomandohet që ky GPN të vazhdojë gjatë procesit të zbatimit dhe realizimit të kësaj PKVEE-je, në mënyrë që të sigurojë përgatitjen në kohë të legjislacionit me mbështetje ndërministrorë dhe realizimin e veprimeve për kursimin e energjisë në përputhje me objektivat kombëtare. Propozohen mbledhje, të paktën katër herë në vit, për të siguruar efektivitetin e këtij organi. GPN-ja do të sigurojë një koordinim të përgjithshëm dhe mbikëqyrjen e zbatimit të PKVEE-së.

Kujdes duhet t'i kushtohet krijimit të nën-grupeve për zona sektoriale të veçanta dhe pjesëmarrjes së entiteteve shtesë në mbledhjet e këtyre nën-grupeve (p.sh. KESH, OSHEE, ERE dhe OST për masat primare të energjisë). Nën-grupe të tilla mund, gjithashtu, të kërkojnë të krijojnë forumet e grupeve të interesit me pjesëmarrjen e organeve jo-publike për të vepruar si një kanal për dhënie informacioni, konsultime/komente dhe ngritje kapacitetesh.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Përgjegjësia kryesore për përgatitjen dhe zbatimin e politikave energjetike dhe për më tepër të politikave për eficiencën e energjisë, mbetet tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Çështjet e politikave kombëtare dhe akteve nënligjore të veçanta, në vazhdim kërkojnë miratimin e Këshillit të Ministrave.

Deri tani, përgatitja e masave për eficiencën e energjisë është koordinuar nga Drejtoria i Energjive të Rinovueshme dhe Eficiencës së Energjisë në MEL, ndërsa zbatimi është mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN). MIE është parashikuar të drejtojë Agjencinë për Eficiencën e Energjisë, që përshkruhet më poshtë.

Agjencia për Eficiencën e Energjisë

Ligji për eficiencën e energjisë në nenin 25 parashikon krijimin e një Agjencie të dedikuar për Eficiencën e Energjisë, si një entitet i veçantë, në varësi të MEL-t, dhe përgjegjëse për zbatimin e politikave për eficiencën e energjisë dhe nxitjen e masave për eficiencën e energjisë. Agjencia do të ngarkohet me detyrën për të përgatitur, zbatuar dhe monitoruar



këtë PKVEE dhe masat e miratuara nëpërmjet tij në të gjithë sektorët. Ligji për eficiencën e energjisë kërkon që Agjencia të përgatisë aktet nënligjore për t'u miratuar nga ministri, siç parashikohet në ligj, të përgatisë standarde dhe rregullore të tjera teknike për eficiencën e energjisë, të nxisë dhe shpërndajë informacion lidhur me programet për eficiencën e energjisë, të koordinojë programet e trajnimit, të administrojë gjobat dhe të verifikojë auditimet.

Një detyrë tjetër e rëndësishme e Agjencisë është vlerësimi i projekteve që aplikojnë tek Fondi për Eficiencën e Energjisë (shiko më poshtë) dhe t'i bëjë propozime Fondit lidhur me dhënien e financimeve. Agjencia, gjithashtu, do të jetë institucioni që do të kryejë monitorimin vjetor për zbatimin e masave për EE-në, që do të krijojë dhe do të mirëmbajë platformën përkatëse dhe do të përgatisë raportet vjetore që lidhen me përmbushjen e objektivave për EE-në (bazuar në qasjet PL dhe LP).

Një listë e plotë e përgjegjësive të dhëna nga ligji për eficiencën e energjisë jepet më poshtë.

- Të përgatisë, zbatojë dhe monitorojë politikatat dhe programet për përdorimin me eficiencë të energjisë në çdo sektor; banesa, shërbimet, industria, transporti dhe bujqësia.
- Të përgatisë dhe monitorojë Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë.
- Të paraqesë çdo vit, tek ministri përgjegjës për energjinë, një raport të detajuar lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë.
- Të bashkëpunojë me autoritete publike qendrore dhe lokale, kompanitë që operojnë ndërmarrje industriale dhe organizata të tjera jo-fitimprurëse për krijimin dhe përditësimin e një baze të dhënash energjetike, duke përfshirë edhe përgatitjen e katalogëve për eficiencën e energjisë dhe për zbatimin e masave për nxitjen e eficiencës së energjisë.
- Të përgatisë dhe t'i propozojë ministrit aktet nënligjore të nevojshme për nxitjen e eficiencës së energjisë, siç parashikohet në ligj.
- Të përgatisë standarde teknike, norma dhe rregullore që synojnë rritjen e eficiencës së energjisë për pajisje, aparatura, prodhim makinerie dhe energjie, transport, shpërndarje dhe konsum, për çdo sektor, banesa, shërbimet, industria, transporti dhe bujqësia.
- Të vlerësojë teknikisht projekte për investime në fushën e eficiencës së energjisë që, subjekte të interesuara, kanë aplikuar tek Fondi.
- T'i propozojë Fondit ndihmë financiare për projekte që kanë aplikuar për financime nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të brendshme dhe të jashtme, për të ndërmarrë masa për eficiencën e energjisë, në përputhje me dispozitat e nenit 12, paragrafit 3 të ligjit.



- Të përgatisë kontrata model për t'u përdorur për shërbimet energjetike, të financuara nga Fondi, dhe që janë miratuar nga ministri, si dhe t'i publikojë ato në faqen zyrtare të saj.
- Të koordinojë programet për eficiencën e energjisë të financuara nga institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, të bazuara në marrëveshjet qeveritare.
- Të bashkëpunojë me institucionet dhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare me synim përdorimin me eficiencë të energjisë dhe uljen e ndikimit negative në mjedis.
- Të japë këshillime falas për autoritetet publike të administratës lokale, administratorët e ndërtesave publike dhe atyre për qëllime banimi për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve për eficiencën e energjisë.
- Të bashkëpunojë me institucionet e akredituara për t'u informuar mbi testimet dhe masat e ndërmarra me qëllim plotësimin e standardeve kombëtare për eficiencën e energjisë.
- Të përgatisë dhe koordinojë programet e trajnimit.
- Të këshillojë programet për eficiencën e energjisë, të përgatitura nga konsumatorët finalë.
- Të mbështesë dhe këshillojë fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe aktivitete të tjera edukimi që lidhen me nxitjen e përdorimit me eficiencë të energjisë dhe kursimin e energjisë.
- Të verifikojë, nëse konsiderohet e nevojshme, saktësinë e të dhënave në raportet e përgatitura nga audituesit e energjisë.

Fondi për Eficiencën e Energjisë

Fondi për Eficiencën e Energjisë që propozohet është një gur themeli në politikën e financimit pas masave të paraqitura në këtë dokument. Megjithëse hapësira për financime që ky Fond mund të japë është e kufizuar, ai mund të veprojë si një mjet i fuqishëm për lehtësimin e madhësive të nevojshme të financimeve tregtare. Krijimi i Fondit është parashikuar në nenet 19 deri 24 të ligjit për eficiencën e energjisë. Fondi do të drejtohet nga një Bord Drejtorësh të emëruar nga Kryeministri, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë. Zbatimi i aktiviteteve të Fondit do të drejtohet nga një Drejtor Ekzekutiv i emëruar nga Bordi i Drejtorëve. Do të përgatitet një statut dhe manual për procedurat e funksionimit të Fondit.

Veçoritë, proceset dhe veprimet për zhvillimin e Fondit janë trajtuar në mënyrë të detajuar në Seksionin 6.2 më poshtë.



Ministria përgjegjëse për zhvillimin urban

Ministria e Zhvillimit Urban do të ngarkohet që të ndihmojë MEI-n në përgatitjen e akteve nënligjore për performancën energjetike të ndërtesave dhe proceset e auditimit energjetik. Zbatimi i masave për ndërtesat, gjithashtu, do të drejtohet nga të dy ministrinë në mbështetje të bashkive.

Këshillat për Rregullimin e Territorit, të cilat miratojnë lejet e ndërtimit.

Inspektoriatet e Planifikimit Urban (të cilat janë pjesë e Ekipit të Sekretariatit Teknik të Këshillit të Territorit të Bashkisë). Këta punësojnë ekspertë të cilët shqyrtojnë dokumentacionin e projektit të ndërtimit të aplikuar përpara se ato t'i paraqiten për miratim përfundimtar *Këshillit të Territorit të Bashkisë*.

Inspektoriatet e Ndërtimit, i cili kontrollon zbatimin e lejeve/projekteve të miratuara të ndërtimit.

Ministria përgjegjëse për telekomunikacionin

Ministria përgjegjëse për telekomunikacionin është përgjegjëse për dhënien e licencave profesionale për kryerjen e aktiviteteve të zbatimit të punimeve në ndërtesë.

Ministria përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën

Ministria përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën, në bashkëpunim me bashkitë, është përgjegjëse për zbatimin e të gjitha masave që lidhen me transportin.

Autoritetet Lokale

Entitete në nivelin e qeverisjes vendore në mënyrë të veçantë (në nivel bashkie dhe komune) do të kenë një rol të rëndësishëm në zbatimin e iniciativave të sektorit publik.

5.2 6.2 Financimi

Masat e ndërmarra gjatë PKVEE-së I ishin kryesisht të kryera ose me mbështetjen direkte të një institucioni financiar ndërkombëtar (IFN)/donator, ose të kryera nëpërmjet kredive të dhëna nga bankat e nivelit të dytë, të mbështetura nga një IFN/donator. Kjo mbështetje erdhi nga burime financiare dhe teknike. Një mbështetje ndërkombëtare e tillë mund të vazhdojë, por për të përshkallëzuar veprimet për efikasitetin e energjisë kërkohet që të vihen në dispozicion fonde vendase më të mëdha (publike dhe private).

Fondi për Efikasitetin e Energjisë

Në mënyrë që të realizohen shumë nga masat e ndryshme të përshkruara, Shqipëria e konsideron të nevojshme krijimin e një Fondi për Efikasitetin e Energjisë (FEE), si një



mekanizëm të mbështetjes financiare për zbatimin e projekteve për EE-në në sektorët publikë dhe privatë.

Financimi i Fondit për Eficiencën e Energjisë është parashikuar të bëhet ndër të tjera nga buxheti i shtetit shqiptar (i kufizuar në disa lloje projektesh të përgatitura për sektorin publik), donatorë të huaj, të cilët financojnë aktivitetet dhe ofrojnë shërbimet. Programet që do të mbështeten nga fondi nëpërmjet granteve, kredive, garancive financiare dhe metodave të tjera të financimit janë dhënë më poshtë:

- investime që synojnë përmirësimin e eficiencës së energjisë tek konsumatorët finalë;
- investime që synojnë përmirësimin e eficiencës së energjisë në prodhim, transmetim dhe shpërndarjen e energjisë;
- investime që synojnë përmirësimin e eficiencës së energjisë në ndriçimin publik;
- investime që synojnë përmirësimin e eficiencës së energjisë në furnizimin me ujë dhe trajtimin e ujërave të zeza;
- përgatitje e projekteve të demonstrimit me qëllim që të shikohen dhe testohen teknologji të reja energjetike ose zgjidhje të reja për organizimin e sektorit të energjisë;
- auditimet energjetike të kryera në sektorin publik;
- përmirësime të matjes dhe faturimit informativ;
- aktivitete kërkimi dhe zhvillimi për rritjen e eficiencës së energjisë;
- fushatat e ndërgjegjësimit dhe aktivitete edukimi në lidhje me eficiencën e energjisë; dhe;
- programe të financuara si rezultat i marrëveshjeve vullnetare, të propozuara nga Agjencia.

Atje ku legjislacioni dhe procedurat e kërkojnë, do të përdoren procedura të hapura konkurruese për të miratuar ndarjen e fondeve.

Megjithatë, mbeten një numër sqarimesh që duhen adresuar, lidhur me burimet që nevojiten për fondin dhe në mënyrë të veçantë se sa financime të shtetit janë të disponueshme për fondin dhe çfarë mund të gjenerohet nëpërmjet aktiviteteve të fondit – dhe se si duhet të përdoren këto burime të ardhurash.

Fondi për Eficiencën e Energjisë, në vetvete, do të ketë mjete financiare të kufizuara për të përmbushur të gjitha objektivat e përmendura në këtë PKVEE. Në të vërtetë, mund të shikohet si një mjet për të influencuar burime financiare më të mëdha nga palë të jashtme (IFN-të dhe donatorët, si edhe bankat e nivelit të dytë – shih më poshtë).

Për të bërë këtë, Fondi për EE-në, përveç financimeve direkte, ka mundësinë të japë garanci për kreditë, borxh të ndërvarur, financim të boshllëkut të investimit (*investment gap financing*) ose të

**SHTOJCA**

ofrojë ulje të normës së interesit duke blerë pjesë të saj (*interest-rate buy-downs*). Aktualisht këto mundësi po merren në konsideratë për Shqipërinë. Sipas këtyre përjasjeve, Fondi mund të:

- lehtësojë kreditë për projektet që nuk do të përfitonin financime nga bankat e nivelit të dytë pa pasur një garanci,
- përmirësojë termat financiarë për projektet, në krahasim me kreditë aktuale të dhëna nga bankat e nivelit të dytë, me periudhë të shkurtra shlyerjeje dhe interes të lartë vjetor, dhe
- mund të mbështesë zhvillimin e industrisë së Kompanive të Shërbimit Energjetik (ESCO) nëpërmjet garantimit të kredive të këtij tipi të ri huamarrësi.

Burime të tjera financimi

Sic u vu në dukje më sipër, Fondi për EE-në do të jetë në vetvete i kufizuar në kapacitete dhe në gjendje të japë vetëm një pjesë të vogël të fondeve të kërkuara. Me mbështetjen e IFN-ve (Korporata Ndërkombëtare Financiare, KfW dhe Banka Evropiane e Investimeve) dhe donatorëve ndërkombëtarë (PNUD-i, Fondi Global për Mjedisin), bankat vendase kanë qenë të përfshira në ofrimin e linjave të kreditimit për eficiencën e energjisë në përmirësimin e veshjes së jashtme të ndërtesave, përmirësimin e pajisjeve dhe makinerive të proceseve industriale. Megjithatë, njohuritë dhe kuptimi i projekteve ESCO është më pak i përhapur, prandaj diskutimi dhe koordinimi më i mirë, ndërmjet Fondit për Eficiencën e Energjisë dhe bankave të nivelit të dytë, për të fituar terren në këtë sektor duhet të jetë një prioritet për vlerësimin e periudhës tjetër.

Forma ekzakte, përzjerja dhe nivelet e mbështetjes së mundur do të varen nga sektori me pjesën më të madhe të fondeve publike (d.m.th. pjesën më të vogël të mbështetjes të fondeve të sektorit privat) me gjasa për t'u kërkuar për investime të konsideruara si me një risk të lartë.

SHTOJCA



Kategoritë dhe shembujt e masave për eficiencën e energjisë tek përdoruesit fundorë

A1 Kategoritë dhe shembujt e masave për eficiencën energjisë tek përdoruesit fundorë

Kategoria	Shembuj
1 Rregullore	Standarde dhe norma: 1.1 Kodet e Ndërtimit dhe zbatimi 1.2 Standardet minimale të performancës energjetike të pajisjeve
2 Informacioni dhe masat e detyrueshme të informimit (p.sh. etiketimi i detyrueshëm)	2.1 Fushatat e fokusuara të informimit 2.2 Skemat e etiketimit të energjisë (të detyrueshme ose vullnetare) 2.3 Qendrat e Informimit 2.4 Auditimet Energjetike 2.5 Trajnimi dhe edukimi 2.6 Demonstrimi 2.7 Roli model i sektorit publik 2.8 Matja dhe faturimi informativ
4 Marrëveshje vullnetare dhe instrumente bashkëpunuese	4.1 Marrëveshje vullnetare me kompanitë industriale 4.2 Marrëveshje vullnetare me organizatat tregtare ose institucionale 4.3 Prokurime publike që përfshijnë eficiencën e energjisë 4.4 Blerja e sasive të mëdha me çmim më të ulët 4.5 Prokurimi i teknologjisë
5 Shërbimet energjetike për kursimet e energjisë	5.1 Garancia e kontratave për kursimet e energjisë 5.2 Financimi me palë të treta 5.3 Kontraktimi i performancës energjetike 5.4 Kontraktimi i energjisë
6. Masa specifike në transport	6.1. Ndryshimi modal 6.2. Çmimi (p.sh. tarifa për zonat me trafik)
7 Mekanizma të kursimit të energjisë dhe kombinime të tjera të (nën) kategorive të mëparshme	7.1 Detyrimi i shërbimit publik për kompanitë energjetike mbi kursimet e energjisë, përfshirë "Certifikatat e bardha" 7.2 Marrëveshje vullnetare me kompanitë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë 7.3 Fondet dhe trustet për eficiencën e energjisë



Informacion plotësues mbi llogaritjen Lart-Poshtë të ecurisë së kursimeve të energjisë

A2 Informacion plotësues mbi llogaritjen Lart-Poshtë të ecurisë së kursimeve të energjisë

A2.1 Metoda LP për vlerësimin e progresit

Metodat LP të llogaritjeve përdorin të dhënat e mbledhura për sektor ose në nivel kombëtar, si një pikënisje për vlerësimin sasior të energjisë së kursyer, dhe i përdorin ato për të nxjerrë grupin e treguesve për eficiencën e energjisë. Për shkak të mungesës së ndarjes, në nivel produkti dhe nën-sektori, tregues të tillë nuk janë në gjendje që t'i atribuojnë kursimet e energjisë zbatimit të masave specifike për eficiencën e energjisë. Megjithatë, ato mund të ofrojnë një tregues të nivelit të lartë të trajektorës së plotë të ecurisë së konsumit të energjisë dhe progresit të eficiencës së energjisë në një nivel makroekonomik.

Pavarësisht thjeshtësisë së saj relative dhe saktësisë së ulët, metoda LP, për vlerësimin e tendencave të eficiencës së energjisë dhe të progresit, varet nga sasia e madhe e të dhënave, për të qenë kuptimplotë dhe efektive. Të dhëna të tilla shtrihen përtej sektorit energjetik, për të përfshirë grupe të tjera të dhënash makroekonomike dhe sektoriale. Disponueshmëria e të dhënave të kërkuara ndryshon sipas vendit dhe mund të ketë nevojë për modelim ose gjykim ekspertit për të kapërcyer boshllëqet, ndërsa cilësia do të dobësohet nga mungesa e gjithëpërfshirjes së duhur, për shkak, për shembull, të një "ekonomie në hije" të madhe. Si rrjedhim, besueshmëria e çdo rezultati të nxjerrë varet nga cilësia dhe madhësia e burimit të të dhënave. Kjo analizë nënvizon se ku janë veçanërisht të dukshme kufizime të tilla për Shqipërinë.

Vlerësimi LP i kursimeve të energjisë për periudhën 2010-2014 (me referencë vitin 2009, si 'viti bazë') është bërë kryesisht duke përdorur metodologjinë e hartuar në platformën e monitorimit, verifikimit dhe vlerësimit ("M&V&V"), e hartuar nga GIZ-i dhe Instituti i Energjisë Hrvoje Požar ("EIHP") për vendet e Komunitetit të Energjisë. Modeli LP i M&V&V-së ndjek parimet e krijuara nga projekti ODYSSEE-MURE⁸ dhe ofron një numër treguesish LP brenda katër sektorëve, sektorit të banesave, shërbimeve, transportit dhe industrisë, të ndarë në tregues të preferuar ("P") dhe minimalë ("M"). Treguesit e nivelit M janë në mënyrë tipike më pak të saktë sesa treguesit e nivelit P dhe ofrojnë në këtë mënyrë një përshkrim më pak të ndarë të gjendjes së kursimeve të energjisë në vendin që po shqyrtohet. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave të detajuara në Shqipëri, ky rishikim varet shumë nga treguesit e nivelit M, me disa përshtatje, siç përshkruhen në Tabela 3 të mëposhtme.

Modelit dhe treguesve i janë bërë rregullime për t'i bërë ato të përshtatshme për monitorimin e situatës në Shqipëri. Këto janë:

⁸<http://www.odyssee-mure.eu/>



Informacion plotësues mbi llogaritjen Lart-Poshtë të ecurisë së kursimeve të energjisë

- Sektori i bujqësisë në Shqipëri është në mënyrë të konsiderueshme më i madh sesa mesatarja evropiane dhe si i tillë i është shtuar modelit si sektori i pestë (përfshirë peshkimin); dhe
- Ashtu sikurse në një sërë vendesh të tjera në rajon, në Shqipëri, ka një përdorim të gjerë të energjisë elektrike për ngrohjen e hapësirave. Megjithatë, struktura e modelit të parazgjedhur vetëm e përshtat përdorimin e energjisë jo elektrike për ndryshimin klimatik. Prandaj, ne e kemi ndryshuar modelin për të investiguar efektet e klimës vjetore në përdorimin e energjisë jo elektrike si dhe elektrike në sektorin e banesave dhe atë të shërbimeve.
- Të dhënat e transportit rrugor, në udhëtar-km, dhe të mallrave të transportuara, në ton-km, janë në dispozicion. Këto nuk janë në nivelin që do të mundësonte përdorimin e treguesve të preferuar, por më tepër një ndryshim i treguesit “M5” (shih tabelën e mëposhtme) të EE-së në transportin rrugor, duke ditur që të dhënat që ekzistojnë për regjistrimet e vëllimit të automjeteve janë marrë parasysh, përveç treguesit minimal të parazgjedhur. Për shkak të mungesës së të dhënave për 2009, ky tregues alternativ mund të llogaritet vetëm për vitet 2011-2014.

Një përshkrim i shkurtër jepet për çdo tabelë, duke përmendur burimet e të dhënave dhe kufizimet e tyre. Përshkrime më të detajuara të të dhënave të hedhura dhe burimeve të tyre jepen në raportin e plotë - *Raporti mbi zbatimin e PKVEE-së së Parë*, janar 2017. Vihet re se ndërsa këta tregues janë miratuar për periudhën e shqyrtuar 2010-2014, për llogaritjen e kursimeve të ardhshme, nga masat e identifikuar në raportin kryesor, pritet të përdoren metodologji më të avancuara LP dhe PL, duke pasur parasysh zhvillimet në monitorimin e proceseve të propozuara. Këto trajtohen në Seksionin 3.3.1 të raportit kryesor.

Tabela 3 Pasqyra e treguesve LP të përdorur për llogaritjen dhe raportimin e kursimeve të arritura të energjisë

Sektori	Treguesi i Modelit LP i GIZ-it/EIHP-së ¹	Përshkrimi
Banesa	M1	Konsumi i energjisë jo elektrike në banesa në toe për banesë (përshtatur për kushtet klimaterike)
	M1'	Konsumi i energjisë jo elektrike në banesa në toe për banesë (<u>i papërshtatur</u> për kushtet klimaterike)
	M2	Konsumi i energjisë elektrike në banesa në kWh për banesë
	M2'	Konsumi i energjisë elektrike në banesa në kWh për



Informacion plotësues mbi llogaritjen Lart-Poshtë të ecurisë së kursimeve të energjisë

		banesë (i përshtatur për kushtet klimaterike)
Shërbime	M3	Konsumi i energjisë jo elektrike në sektorin e shërbimeve në toe për ekuivalent me kohë të plotë (i përshtatur për kushtet klimaterike)
	M3'	Konsumi i energjisë jo elektrike në sektorin e shërbimeve në toe për ekuivalent me kohë të plotë (i <u>papërshtatur</u> për kushtet klimaterike)
	M4	Konsumi i energjisë elektrike në sektorin e shërbimeve në kWh për ekuivalent me kohë të plotë
	M4'	Konsumi i energjisë elektrike në sektorin e shërbimeve në toe për ekuivalent me kohë të plotë (i përshtatur për kushtet klimaterike)
Transporti	M5	Konsumi i energjisë së automjeteve rrugore në toe për ekuivalent makine
	M5'	Konsumi i energjisë së automjeteve rrugore bazuar në gramë naftë ekuivalente (goe) për ton-km dhe goe për udhëtar-km
	M6	Konsumi i energjisë në transportin hekurudhor në goe për ton-km
	M7	Konsumi i energjisë në transportin me rrugë të brendshme ujore në koe për ton-km
Industria	M8 ²	Konsumi i energjisë së nën-sektorëve të industrisë për vlerën e shtuar
Bujqësia	M9 ³	Konsumi i energjisë në bujqësi për vlerën e shtuar

Shënime: 1: Treguesit e shënuar me thonjëza teke (') përshtatin treguesit standardë për të përfshirë përdorimin e energjisë elektrike për ngrohjen e hapësirave brenda Shqipërisë.

2: Vlerat e konsumit të energjisë në nivel nën-sektori nuk u identifikuan në kodimin NACE (shih Seksionin A2.4 për detaje të mëtejshme).

3: Ky është një tregues shtesë “minimal”, përveç atyre të propozuara në studimin e GIZ-it/EIHP-së, për të përfshirë përqindjen e lartë të përdorimit të energjisë në sektorin e bujqësisë në Shqipëri.



Informacion plotësues mbi llogaritjen Lart-Poshtë të ecurisë së kursimeve të energjisë

Si një përshtatje e mëtejshme, në nxjerrjen e kursimeve totale të energjisë, ne kemi devijuar nga modeli standard i GIZ-it/EIHP-së, pasi për treguesit e përdorimit të energjisë, ndërmjet viteve të ndryshme, ai përfshin vetëm uljet, por jo rritjet. Për shkak të ndryshimeve të mëdha të treguesve ndër vite, si dhe ndryshimeve në burimin e energjisë, nga përdorimi i energjisë jo elektrike në elektrike, mospërfshirja e rritjeve të tilla do të rezultonte në një mbivlerësim të konsiderueshëm të kursimeve reale të arritura. Për shembull, ulja e përdorimit të energjisë jo elektrike, për shkak të ndryshimit të lëndës djegëse për ngrohje, mund të klasifikohet si një “kursim energjie”, pa llogaritur rritjen përkatëse në përdorimin e energjisë elektrike.

A2.2 Treguesit LP dhe kursimet e energjisë në sektorin e banesave

Sektorin e banesave zë përqindjen e dytë më të madhe të konsumit final të energjisë në Shqipëri, pas transportit. Sektorin ka zënë një përqindje relativisht të qëndrueshme të konsumit total final të energjisë, gjatë periudhës së shqyrtuar 2009-2014, duke ndryshuar nga 26% në 30%, pa një tendencë të qartë gjatë periudhës. Në terma absolute, konsumi i energjisë në banesa ishte 11% më i lartë në vitin 2014 sesa në 2009, në 546 ktoe krahasuar me 487 ktoe, megjithatë kjo rritje nuk ka qenë e qëndrueshme gjatë periudhës së shqyrtuar.

Konsumi i energjisë në sektorin e banesave përfshin një mori shërbimesh energjetike përfshirë ngrohjen e hapësirave, kondicionimin e ajrit, ujin e ngrohtë, gatimin, ndriçimin dhe pajisjet elektroshtëpiake. Përpara dhe gjatë periudhës së shqyrtuar ka pasur një tendencë drejt përdorimit të energjisë elektrike për ngrohjen e hapësirave sesa të druve të zjarrit dhe, për rrjedhojë, mbingarkesë më të madhe të infrastrukturës së energjisë elektrike.

Kjo tendencë mund të vihet re tek rezultatet që tregojnë një rritje të konsumit final të energjisë në sektorin e banesave, nga përdorimi i energjisë elektrike. Në vitin 2009, 54% e konsumit final të energjisë në banesa vinte nga përdorimi i energjisë jo elektrike, duke rënë në nivelin 44% në vitin 2014.

Tabela 4 tregon konsumin e energjisë në sektorin e banesave të ndarë në konsum elektrik dhe jo elektrik. Tabela 5 përshkruan treguesit në toe për banesë të llogaritur për çdo vit, si edhe numrin e vlerësuar të banesave, ndërsa Tabela 6 dhe Figura paraqesin një përmbledhje të kursimeve të energjisë të llogaritura me treguesit LP, si rezultat i përmirësimeve të Eficiencës së Energjisë (EE) në sektorin e banesave. Procesi i llogaritjes është përshkruar në *Raportin mbi zbatimin e PKVEE-së së Parë*.

Tabela 4 Përdorimi i energjisë në sektorin e banesave

Nën-sektori	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Përdorimet e energjisë jo elektrike ¹	ktoe	261	265	241	233	234	240
Përdorimet e energjisë elektrike	ktoe	224	223	233	263	332	301

Shënim 1: Përfshijë energjia diellore



Tabela 5 Treguesit e sektorit të banesave


Kodi	Treguesi	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014
M1	Përdorimet e energjisë jo elektrike, të përshtatura me klimën	toe/banesë	0.26	0.26	0.21	0.20	0.23	0.25
M2	Përdorimet e energjisë elektrike	toe/banesë	0.23	0.22	0.23	0.26	0.32	0.29
<i>Treguesit alternativë:</i>								
M1'	Përdorimet e energjisë jo elektrike, të papërshtatura me klimën	toe/banesë	0.26	0.26	0.24	0.23	0.23	0.23
M2'	Përdorimet e energjisë elektrike, të përshtatura me klimën	toe/banesë	0.23	0.22	0.22	0.25	0.32	0.30
Numri i banesave (000's)			995	1,004	1,012	1,023	1,033	1,044

Tabela 6 Kursimet e energjisë në sektorin e banesave të llogaritura me treguesit LP^{1,2}

Kodi	Kursimet e energjisë - BANESA	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	Kumulative 2009-2014
M1	Përdorimet e energjisë jo elektrike, të përshtatura me klimën	ktoe	-2	51	12	-27	-17	18
M2	Përdorimet e energjisë elektrike	ktoe	3	-9	-27	-67	34	-66
Kursimet totale me treguesit M		ktoe	2	42	-15	-94	17	-48
<i>Treguesit alternativë:</i>								
M1'	Përdorimet e energjisë jo elektrike, të papërshtatura me klimën	ktoe	-1	26	11	1	-1	34
M2'	Përdorimet e energjisë elektrike, të përshtatura me klimën	ktoe	3	-1	-25	-78	3	-73
Kursimet totale me treguesit M'		ktoe	2	26	-14	-77	2	-39

Shënime: 1. Shifrat negative të kursimeve përfaqësojnë rritje

2. Shifrat në çdo kolonë për vitin X përfaqësojnë kursimet për vitin X në raport me vitin X-1.

Figura 11 Totali me treguesit minimalë (të përshtatur) për sektorin e banesave sipas viteve


Rezultatet nuk ofrojnë një evidencë të qartë të një përmirësimi të qëndrueshëm të EE-së. Në vitet 2011 dhe 2012, u vu re një rënie e përdorimit të energjisë për banesë, krahasuar me vitin 2009 dhe 2010. Kjo nuk mund të shpjegohet me ndryshime të klimës (p.sh. kërkesë më e madhe për ngrohje) sepse treguesit e përshtatur me klimën tregojnë një zvogëlim edhe më të madh në përdorimin e energjisë për banesë për këto vite. Kjo mospërputhje mund të debatohet, si pasojë e një niveli më të ulët të humbjeve jo-teknike në këto vite, por nuk ka prova të qarta për të shpjeguar këtë tendencë, veçanërisht kur merren në konsideratë temperaturat më të ftohta dhe, si rrjedhojë, kërkesë e pritshme më e lartë për ngrohje në këto vite. Megjithatë, kjo tendencë u përmbys në vitet 2013 dhe 2014, të cilat demonstruan një nivel të lartë të konsiderueshëm të përdorimit të energjisë për banesë dhe përdorimit të energjisë elektrike, në veçanti.

Për të kontrolluar ndryshimet strukturore, të cilat mund të nxisin ndryshime të pashpjegueshme të treguesve të efikasitetit të energjisë, u përdorën dy parametra të përbashkët, si PBB-ja dhe çmimi i tregut për energjinë. PBB-ja për banor, në çmime konstante, u rrit me një nivel të vlerësuar prej 17%, ndërmjet 2009 dhe 2014, duke u ulur nga rreth 5% në 2010 në rreth 2% në 2013 dhe 2014, por mbeti pozitive gjatë periudhës së shqyrtuar. Çmimi i energjisë elektrike, i raportuar nga ERE dhe Eurostat-i, ishte përgjithësisht konstant gjatë kësaj periudhe. Prandaj, asnjë parametër nuk mund të shpjegojë luhatshmërinë e parë në Figura .



A2.3 Treguesit LP dhe kursimet e energjisë në sektorin e shërbimeve

Sektorin e shërbimeve përfshin së bashku sektorin publik dhe aktivitetin tregtar jo-industrial (që njihet gjithashtu si “sektori terciar”). Ashtu si në sektorin e banesave, përqindja e konsumit final të energjisë në sektorin e shërbimeve ka mbetur e qëndrueshme gjatë periudhës së shqyrtuar, duke zënë nga 8% deri 9% të të gjithë konsumit. Kjo është në kontrast me pritshmëritë e PKVEE-së I, që parashikoi një rritje të qëndrueshme të përqindjes së sektorit të shërbimeve me zhvillimin e ekonomisë shqiptare, duke u rritur në rreth 14% deri në vitin 2014.

Në terma absolute, konsumi i energjisë në këtë sektor ishte 6% më i lartë në vitin 2014 sesa në 2009, në nivelin 176 ktoe krahasuar me 166 ktoe.

Gjithashtu, e përbashkët me sektorin e banesave, është tendenca e fortë drejt përdorimit më të madh të energjisë elektrike në raport me konsumin e energjisë jo elektrike, me një hendek prej 58% deri në 42%, në favor të energjisë elektrike, në vitin 2009, e që shkon nga 69% deri në 31%, në favor të energjisë elektrike, në vitin 2014.

Tabela 7 paraqet përdorimin e energjisë në sektorin e shërbimeve, të ndarë në përdorim të energjisë elektrike dhe përdorim të energjisë jo elektrike. Tabela 8 përmbledh treguesit në toe për punonjës të llogaritur për çdo vit, ndërsa Tabela 9 dhe Figura paraqesin një përmbledhje të kursimeve të energjisë të llogaritura me treguesit LP, si rezultat i përmirësimeve të EE-së në sektorin e shërbimeve.

Siç theksohet në Seksionin A2, paraqiten si vlerat e përshtatura me klimën, ashtu edhe ato të papërshtatura me klimën. Është konsideruar se për shumë aktivitete të rëndësishme të sektorit të shërbimeve, si furnizimi me ujë, përshtatja me klimën ka gjasa të mos jetë e rëndësishme dhe në këtë mënyrë, vlerat e papërshtatura me klimën japin një vlerësim më realist të këtij aktiviteti.

Tabela 7 Përdorimi i energjisë në sektorin e shërbimeve

Nën-sektori	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Konsumi i energjisë jo elektrike ¹	ktoe	67.8	52.3	53.0	40.2	54.8	51.8
Konsumi i energjisë elektrike	ktoe	93.7	102.9	111.6	114.0	127.1	118.0

Note 1: Përfshijë energjia diellore




Tabela 8 Treguesit në sektorin e shërbimeve

Kodi	Treguesi	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014
M3	Konsumi i energjisë jo elektrike, i përshtatur me klimën	toe/punonjës	0.18	0.13	0.12	0.09	0.14	0.14
M4	Konsumi i energjisë elektrike	toe/punonjës	0.24	0.26	0.27	0.28	0.32	0.29
<i>Treguesit alternativë:</i>								
M3'	Konsumi i energjisë jo elektrike, i papërshtatur me klimën	toe/punonjës	0.18	0.13	0.13	0.10	0.14	0.13
M4'	Konsumi i energjisë elektrike, i përshtatur me klimën	toe/punonjës	0.24	0.26	0.24	0.25	0.32	0.31

Tabela 9 Kursimet e energjisë në sektorin e shërbimeve të llogaritura me treguesit LP

Kodi	Kursimet e energjisë - SHËRBIME	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	Kumulative 2009-2014
M3	Konsumi i energjisë jo elektrike, i përshtatur me klimën	ktoe	17	7	11	-20	1	17
M4	Konsumi i energjisë elektrike	ktoe	-7	-3	-6	-14	12	-19
	Kursimet totale me treguesit M	ktoe	10	4	5	-34	14	-2
<i>Treguesit alternativë:</i>								
M3'	Konsumi i energjisë jo elektrike, i papërshtatur me klimën	ktoe	17	2	11	-15	4	20
M4'	Konsumi i energjisë elektrike, i përshtatur me klimën	ktoe	-7	8	-4	-28	6	-27
	Kursimet totale me treguesit M'	ktoe	10	10	7	-43	10	-7

Figura 12 Totali me treguesit minimalë (të përshtatur) për sektorin e shërbimeve sipas viteve



Në kombinim, treguesit nuk tregojnë përmirësim të përgjithshëm të EE-së në sektorin e shërbimeve, me ulje të përdorimit të energjisë jo elektrike për punonjës që pothuajse balancohet nga rritja e përdorimit të energjisë elektrike për punonjës. Ndërsa ka pasur një rënie në konsumin total të energjisë në të katër vitet, ka pasur një rritje të dukshme të konsumit total të energjisë në vitin 2013, në terma absolute, si dhe për punonjës.

Sektori i shërbimeve ndahet në dy nën-sektorë: shërbimet publike dhe shërbimet private. Tradicionalisht, sektori i shërbimeve publike për të siguruar ngrohjen, është mbështetur tek teknologjia e vjetër dhe jo efiçente, dhe skema specifike me EE janë futur në sektorin publik. Një ndarje e treguesve të EE-së ndërmjet këtyre dy nën-sektorëve do të ishte një analizë e dobishme. Megjithatë, informacioni i saktë apo metoda e përdorur për ndarjen e konsumit ndërmjet sektorëve të shërbimeve publike dhe private, aktualisht, nuk është në dispozicion të ekipit të konsulentëve.

Informacioni mbi numrin e punonjësve për secilin prej nën-sektorëve jepet në Tabela . Kjo tabelë tregon uljen e forcave të punës në sektorin publik, që neutralizohet nga numri në rritje i punonjësve në sektorin privat. Megjithatë, ka një dyshim të qenësishëm lidhur me shifrat e nxjerra për numrin e punonjësve duke pasur parasysh problemet me regjistrimin e saktë të punonjësve.

Tabela 30 Numri i punonjësve në sektorin e shërbimeve private dhe publike

Sektori	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Punonjës të sektorit publik	166,430	166,338	165,100	164,400	163,900	163,885



Sektori	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Punonjës të sektorit publik	166,430	166,338	165,100	164,400	163,900	163,885
Punonjës të sektorit të shërbimeve të sektorit privat	218,806	228,758	250,235	238,426	234,315	244,717

Burimi: INSTAT

A2.4 Treguesit LP dhe kursimet e energjisë në sektorin e industrisë

Përqindja e konsumit final të energjisë në sektorin e industrisë ishte më e lartë në vitin 2014, me rreth 20% të konsumit total final të energjisë sesa në 2009, kur shifra ekuivalente ishte 16%. Megjithatë, rritja nuk ishte as e qëndrueshme, as konsekuente gjatë periudhës pesëvjeçare të shqyrtuar dhe prandaj nuk mund të deklarohet me siguri se përfaqëson një tendencë të qartë. Megjithatë, vihet re se PKVEE-ja I nuk parashikoi një rritje të përqindjes në mbi 20% deri në vitin 2018, pasi përqindja kryesisht ka qenë e qëndrueshme ndërmjet viteve 2010 dhe 2017, me 15% deri 16%. Pra, ishte parashikuar një rritje e përqindjes, por në një datë të mëvonshme sesa u vërejt në të dhënat. Në terma absolute, konsumi final i energjisë në sektorin e industrisë ishte 52% më i lartë në vitin 2014 sesa në 2009, në nivelin 417 ktoe krahasuar me 276 ktoe.

Sipas dokumentit të përditësuar të Strategjisë Kombëtare të Energjisë, sektori i industrisë ndahet në nën-sektorët e mëposhtëm: metalurgji, kimi, materiale ndërtimi, miniera, ushqim/pije/duhan, tekstil/lëkurë/këpucë, dru/letër/stampim, mekanike dhe të tjera. Burimet e energjisë në sektorin e industrisë konsumohen për vënien në punë të fuqive motorike, procesin e ngrohjes me temperatura të ulëta dhe të larta, si dhe për procese të ndryshme të elektrolizës. Në sektorin e industrisë, nën-sektorët e hekurit dhe çelikut (prodhimi i ferrokromit), çimentos, ushqimit dhe materialeve të ndërtimit (tullat, tjegullat) janë konsumatorët kryesorë të energjisë.

Një përqindje e madhe e rritjes së përdorimit të energjisë në vitin 2014, krahasuar me vitet e mëparshme, vjen nga sektori i hekurit dhe çelikut, ku ndryshimet në funksionimin e impiantit të çelikut Kurum në Elbasan, dhe industria e ferrokromit me dy impiante në Elbasan dhe Burrel, patën një ndikim të rëndësishëm në kërkesën për energji. Industria ushqimore, e pijeve dhe e duhanit, si dhe industria tekstile, e lëkurës dhe e veshjeve patën rritje më të qëndrueshme në përdorimin e energjisë, gjatë periudhës së shqyrtuar. Megjithëse vlera e shtuar në ekonomi u rrit për të dy këto grupime të industrisë, në rastin e industrisë ushqimore, të pijeve dhe të duhanit, kjo nuk ishte e mjaftueshme për të mundësuar një përmirësim të efikasitetit të energjisë (intensiteti i energjisë për njësi të vlerës së shtuar).

Tabela paraqet përdorimin e energjisë në sektorin e industrisë, të ndarë sipas grupimeve të industrisë. Tabela 310 paraqet treguesit në gtoe për milionë lekë shqiptare (mln lekë) të



llogaritur për çdo vit me çmimet e viteve të mëparshme, ndërsa Tabela dhe Figura paraqesin një përmbledhje të kursimeve të energjisë të llogaritura me treguesit LP, si rezultat i përmirësimeve të EE-së në sektorin e industrisë. Ndarja sektoriale jepet sipas klasifikimit të NACE Rev. 2 i vitit 2006⁹, që përdoret për raportimin e PBB-së. Megjithatë, raportimi i konsumit final të energjisë ndjek një klasifikim të ndryshëm të aktiviteteve ekonomike, i cili kërkon supozime dhe përfaqëson një burim gabimi të mundshëm në llogaritjet e mëposhtme. Detajet e supozimeve të përdorura paraqiten në *Raportin mbi zbatimin e PKVEE-së I*.

Tabela 31 Përdorimi i energjisë në sektorin e industrisë

Nën-sektori ¹	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Industria e nxjerrjes së mineraleve	ktoe	13.9	5.5	5.6	6.2	7.0	7.4
Industria ushqimore, e pijeve & e duhanit	ktoe	28.9	37.5	45.9	49.4	48.9	57.2
Industria tekstile, e lëkurës & e veshjeve	ktoe	11.9	12.3	12.5	14.2	16.2	18.0
Letra dhe stampimi	ktoe	8.5	8.1	8.3	9.2	10.4	11.4
Industria kimike	ktoe	23.4	17.0	17.1	18.0	19.1	19.0
Industria e xhamave, qeramikës & e materialeve të ndërtimit	ktoe	86.7	157.2	194.8	144.9	129.7	154.4
Industria e hekurit & çelikut dhe e metaleve me ngjyrë	ktoe	31.0	31.1	30.1	27.2	29.6	110.8
Inxhinieria & industria e metaleve të tjera	ktoe	6.8	7.7	7.8	6.6	6.6	7.0
Industri të tjera	ktoe	65.4	31.2	35.7	35.0	37.9	35.4

Shënim 1: Nën-sektorët janë rialokuar nga të dhënat e Bilancit Energjetik në përputhje me klasifikimin NACE Rev. 2 që përdoret për raportimin e PBB-së. Për detaje shih *Raportin mbi zbatimin e PKVEE-së së Parë*.

Tabela 310 Treguesit në sektorin e industrisë

Kodi	Treguesi	Unit ¹	2009	2010	2011	2012	2013	2014
M8	Industria e nxjerrjes së mineraleve	gtoe/mln lekë	0.7	0.3	0.2	0.1	0.1	0.1
M8	Industria ushqimore, e pijeve & e duhanit	gtoe/mln lekë	3.7	3.6	4.4	4.7	5.2	6.0
M8	Industria tekstile, e lëkurës & e veshjeve	gtoe/mln lekë	0.9	0.8	0.7	0.8	0.8	0.9
M8	Letra dhe stampimi	gtoe/mln lekë	2.1	1.1	1.3	1.5	2.0	2.3
M8	Industria kimike	gtoe/mln lekë	17.9	10.7	9.9	10.6	11.7	10.2
M8	Industria e xhamave, qeramikës & e materialeve të ndërtimit	gtoe/mln lekë	0.5	0.9	1.1	0.9	0.9	1.6
M8	Industria e hekurit & çelikut dhe e metaleve me ngjyrë	gtoe/mln lekë	3.7	2.8	2.0	2.6	2.3	7.8
M8	Inxhinieria & industria e metaleve të tjera	gtoe/mln lekë	3.4	5.0	4.7	4.3	3.7	3.8
M8	Industri të tjera	gtoe/mln lekë	17.9	6.9	7.8	6.7	8.7	7.9

Shënim 1: Lekët shqiptare jepen në çmimet e viteve të mëparshme

⁹ Klasifikimi statistikor i aktiviteteve ekonomike në Komunitetin Evropian (NACE)




Burimi: PBB-ja e raportuar nga INSTAT deri më 2013; vlerat për 2014 janë bazuar në projektin e Strategjisë së Energjisë të Shqipërisë,(MEI/ AKBN) – për detaje shih PKVEE-në e Parë.

Tabela 33 Kursimet e energjisë në sektorin e industrisë të llogaritura me treguesit LP

Kodi	Kursimet e energjisë - INDUSTRIJA	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	Kumulative 2009-2014
M8	Industria e nxjerrjes së mineraleve	ktoe	9.9	3.5	2.0	1.1	1.1	51.6
M8	Industria ushqimore, e pijeve & e duhanit	ktoe	0.7	-8.7	-2.2	-5.4	-7.1	-22.1
M8	Industria tekstile, e lëkurës & e veshjeve	ktoe	1.7	2.0	-2.9	-0.4	-0.5	-0.1
M8	Letra dhe stampimi	ktoe	7.1	-0.8	-1.6	-2.3	-1.7	-1.0
M8	Industria kimike	ktoe	11.4	1.5	-1.3	-1.9	2.8	14.3
M8	Industria e xhamave, qeramikës & e materialeve të ndërtimit	ktoe	-75.5	-31.5	32.4	5.3	-70.0	-107.6
M8	Industria e hekurit & çelikut dhe e metaleve me ngjyrë	ktoe	9.3	12.7	-6.3	3.3	-77.6	-58.6
M8	Inxhinieria & industria e metaleve të tjera	ktoe	-2.4	0.5	0.5	1.2	-0.3	-0.7
M8	Industri të tjera	ktoe	49.5	-3.9	5.4	-8.7	3.5	44.3
M8	Kursimet totale me treguesit M	ktoe	12	-25	26	-8	-150	-80

Figura 13 Totali me treguesit minimalë për sektorin e industrisë sipas viteve





Treguesit nuk tregojnë përmirësim të përgjithshëm të EE-së në sektorin e industrisë. Përkundrazi në 2014, pati një rritje drastike të konsumit të energjisë në industri dhe një rritje të ndjeshme të konsumit të energjisë në industri për vlerë të shtuar, si edhe një rritje të përgjithshme gjatë gjithë periudhës 2009 deri në 2014. Ky ndryshim në vitin 2014 i atribuohet kryesisht industrisë së metaleve bazë dhe “industrisë së xhamit, qeramikës & të materialeve të ndërtimit”. Arsyet për këtë rritje të konsiderueshme të intensitetit të energjisë në këta nën-sektorë nuk dihen. Megjithatë, vihet re që shifrat e industrisë së metaleve janë shumë të ndikueshme ndaj ndryshimeve në grupin e kufizuar të të dhënave. Nuk ka pasur një rritje të qartë në madhësinë e vlerës së shtuar, për 2014, në të njëjtën mënyrë si për konsumin e energjisë. Kjo gjë krijon disa dyshime lidhur me metodologjinë e raportimit të përdorur dhe qëndrueshmërisë së saj gjatë gjithë periudhës (p.sh. nëse gjenerimi-vetjak është raportuar në mënyrë të vazhdueshme). Prandaj, ndryshimet e vërejtura në përdorimin e energjisë mund t’i atribuohen më shumë luhatjeve të prodhimit dhe çmimeve të tregut sesa veprimeve për eficiencën e energjisë.

A2.5 Treguesit LP dhe kursimet e energjisë në sektorin e transportit

Transporti në Shqipëri është rritur në mënyrë të shpejtë që nga viti 2000. Përveç rritjes së numrit të automjeteve, po përmirësohet dhe infrastruktura, kështu që ngarkesa totale e trafikut mund të vazhdojë të rritet edhe më shumë. Sektori i transportit konsumon sasi të konsiderueshme të energjisë (kryesisht në formën e naftës dhe benzinës). Sektori i transportit zë përqindjen më të madhe të konsumit final të energjisë në Shqipëri. Kjo përqindje ka mbetur relativisht e qëndrueshme gjatë periudhës së shqyrtuar, ndërmjet niveleve 41% dhe 43% të konsumit total dhe në pjesën dërrmuese kryesohet nga transporti rrugor në kontrast me transportin hekurudhor dhe transportin me rrugë të brendshme ujore. Sipas standardeve evropiane, përqindja e përgjithshme e transportit është veçanërisht e lartë, dhe në PKVEE-në I ishte parashikuar të ulej në rreth 36%, deri në vitin 2014, dhe nën 30%, deri në vitin 2018.

Në terma absolute, konsumi i energjisë së këtij sektori ishte 8% më i lartë në vitin 2014 sesa në 2009, në nivelin 816 ktoe krahasuar me 754 ktoe.

Tabela paraqet përdorimin e energjisë në sektorin e transportit, të ndarë sipas llojeve të transportit. Tabela paraqet treguesit standardë minimalë të llogaritur për çdo vit në njësitë përkatëse.

Tabela 34 Përdorimi i energjisë në sektorin e transportit

Nën-sektori	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Automjetet rrugore	ktoe	721.8	728.5	723.9	696.4	746.6	779.3
Transporti hekurudhor	ktoe	3.0	3.0	3.0	2.7	2.9	2.1
Transporti i brendshëm ujor ¹	ktoe	11.2	6.5	20.0	18.0	31.7	33.7



Tabela 35 Treguesit standardë në sektorin e transportit

Kodi	Treguesi	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014
M5	Automjetet rrugore	toe/mak. ek.	1.03	0.99	1.05	1.12	1.08	1.04
M6	Transporti hekurudhor	gtoe/tkbr	17.7	15.2	19.3	30.1	37.4	18.5
M7	Transporti i brendshëm ujor ¹	gtoe/tkm	14.4	5.2	13.8	12.3	20.3	20.4

Shënim 1: Transporti i brendshëm ujor përfshin rrugët ujore bregdetare dhe ato të brendshme

Rezultatet nuk tregojnë ndonjë mënyrë apo tendencë të qëndrueshme në konsumin e energjisë në sektorin e transportit (kryesisht për transportin rrugor). Energjia e përdorur nga automjeti ekuivalent ka pasur rritje gjatë gjithë periudhës së shqyrtuar. Megjithatë të dhënat e ofruara nga Instituti i Transporteve, për vitet 2010-2014¹⁰, tregojnë që distancat në kilometra që kryejnë udhëtarët dhe mallrat e transportuara janë rritur gjithashtu, siç paraqitet në Tabela . Tabela përfshin treguesit shtesë për “konsumin e energjisë së automjeteve dhe autobusëve në gramë naftë ekuivalente për udhëtar-km (goe/pkm)”, si dhe “konsumin e energjisë të kamionëve dhe automjeteve të lehta në goe për ton-km”. Kursimet që rezultojnë në ktoe janë quajtur tregues alternativ M5’ dhe paraqiten në Tabela . Për të nxjerrë këto të dhëna, është përdorur një supozim i ndarjes së konsumit të karburantit në 30% kamionët, 60% makinat dhe 10% autobusët. Kuptohet që të dhënat në Tabela nuk përfshijnë vëllimet brenda zonave urbane, të cilat do të rezultojnë në treguesit M5’, disi të fryra, në terma absolute, por ende konsiderohen një tregues i preferuar për eficiencën relative sesa stoqet e automjeteve.

Tabela 36 Vlerësimi i transportit të udhëtarëve dhe mallrave

Parametri	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Udhëtimet e udhëtarëve	M.p.km	N/A	7,665	8,359	8,468	8,030	8,432
Mallrat e transportuara	M.t.km	N/A	1,661	2,010	1,860	1,949	2,077

Burimi: Instituti i Transporteve

Tabela 37 Treguesit e ndryshuar të sektorit të transportit

Kodi	Treguesi	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014
M5’	Automjetet dhe autobusët	goe/p.km	-	66.5	60.6	57.6	65.1	64.7
	Kamionët dhe automjetet e lehta	goe/t.km	-	131.6	108.1	112.3	114.9	112.6

Shifrat tregojnë që pavarësisht uljes së numrit të automjeteve të mallrave, të regjistruara ndërmjet 2010 dhe 2011, pati një rritje të shpejtë të vëllimit të mallrave të transportuara. Në 2011, u pa gjithashtu një rritje e dukshme e treguesit udhëtar-km, pavarësisht një rritjeje marginale të vëllimit të automjeteve dhe një uljeje të numrit të autobusëve. Rezultati ofron një panoramë shumë të ndryshme të treguesit standard “M5”, duke treguar një rritje të madhe të eficiencës së energjisë në vitin 2011, e ndjekur nga një rënie e shpejtë në vitin 2013. Për shkak se ky tregues i ndryshuar përdor shifrat e përdorimit aktual sesa thjesht stokun e

¹⁰E-mail nga Bujar Kotri, Instituti i Transporteve, dërguar Ardian Islamit, ish Ministria e Energjisë dhe Industrisë, datë 20 nëntor 2015



automjeteve, ai konsiderohet relativisht më i besueshëm dhe si i tillë është përdorur në pjesën e mbetur të raportit.


Tabela dhe Figura paraqesin një përmbledhje të kursimeve të energjisë të llogaritura me treguesit LP, si rezultat i përmirësimeve të EE-së në sektorin e transportit.

Tabela 38 Kursimet e energjisë në sektorin e transportit të llogaritura me treguesit LP

Kodi	Kursimet e energjisë - TRANSPORTI	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	Kumulative 2009-2014
M5'	Automjetet rrugore	ktoe	0 ¹	97	18	-65	8	55
M6	Transporti hekurudhor	ktoe	0	-1	-1	-1	2	0
M7	Transporti i brendshëm ujor	ktoe	12	-13	2	-12	0	-10
	Kursimet totale me treguesit M	ktoe	12	83	19	-78	10	45

Shënim 1: Nuk ka të dhëna në dispozicion, supozohen zero

Figura 14 Totali me treguesit minimalë (të ndryshuar) për sektorin e transportit sipas viteve



Rezultatet tregojnë pak të dhëna për një tendencë ose përmirësim të efikasitetit të karburantit gjatë periudhës.

Për më tepër, ka pasur shqetësime të mëdha në lidhje me raportimet për kontrabandë të naftës dhe qëndrueshmërinë në përpilimin e statistikave zyrtare, të cilat mund të ndikojnë tek shifrat dhe pengojnë nxjerrjen e konkluzioneve kuptimplote nga ndryshimet e llogaritura të treguesve për përmirësimin e EE-së gjatë gjithë periudhës së shqyrtuar.



A2.6 Treguesit LP dhe kursimet e energjisë në sektorin e bujqësisë

Bujqësia është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë në Shqipëri, që kontribuon me rreth 20% të vlerës së shtuar në ekonomi. Gjatë dekadës së fundit, pavarësisht një sërë problemesh strukturore, sektori ka pasur një rritje të moderuar. Zgjerimi i sektorit, gjatë periudhës 2009-2014, mendohet të ketë kontribuar në performancën e përgjithshme të ekonomisë në vend. Përveç kësaj, rritja e çmimeve të produkteve bujqësore në tregjet botërore përcjell stimujt e duhur për rritjen afatgjatë të prodhimit të kësaj dege të ekonomisë shqiptare. Për më tepër, zhvillimet dhe reformat strukturore (që synojnë rritjen e efikasitetit në prodhimin bujqësor, lehtësimin e aksesit të produkteve bujqësore në tregun e brendshëm dhe tregjet e huaja, si dhe mbështetjen financiare të bizneseve dhe fermave të këtij sektori) janë konsideruar si një prioritet i politikave ekonomike të ardhshme.

Në përputhje me vendin e saj të rëndësishëm në ekonominë shqiptare, sektori i bujqësisë zë një pjesë shumë më të madhe të konsumit të energjisë në Shqipëri sesa mesatarja evropiane, prandaj është menduar që të analizohet më mirë si një sektor i ndarë nga industria. Megjithatë përqindja e bujqësisë vetëm (përfshirë peshkimin) ka rënë gjatë periudhës së shqyrtuar, nga 5.4% në vitin 2009 (120 ktoe) në 3.9% në 2014 (114 ktoe), ndërsa konsumi i energjisë në peshkim është rritur. PKVEE-ja I parashikoi një përqindje shumë më të lartë dhe konstante, ndërmjet vlerave 11% dhe 12%. Arsytet për këtë ndryshim thelbësor të shifrave nuk janë të sigurta, por vihet re që PKVEE-ja I ka cituar që bujqësia përbën 43% të PBB-së ose rreth dyfishi i asaj që është identifikuar për vitet që po shqyrtohen. Në terma absolute, konsumi i energjisë në këtë sektor ishte 5% më i ulët në vitin 2014 sesa në 2009.

Tabela paraqet përdorimin e energjisë në sektorin e bujqësisë, të ndarë sipas grupimeve të nën-sektorëve. Më pas, Tabela paraqet treguesit përkatës në gtoe për milionë lekë shqiptare (mln lekë 2008) të llogaritur për çdo vit dhe së bashku me Figura 15 paraqet një përmbledhje të kursimeve të energjisë të llogaritura me treguesit LP, si rezultat i përmirësimeve të EE-së në sektorin e bujqësisë. Për shkak të rritjes së aktivitetit ekonomik në këtë sektor, gjatë periudhës së shqyrtuar, treguesi i EE-së tregon një përmirësim të konsiderueshëm, duke qenë një të tretat më i ulët, përta i përket konsumit të energjisë për njësi të vlerës së shtuar, në vitin 2014 sesa në 2009.

Tabela 39 Përdorimi i energjisë në sektorin e bujqësisë


Nën-sektori	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Bujqësia	ktoe	94.5	79.0	75.7	81.2	75.5	80.0
Peshkimi	ktoe	25.0	20.0	25.0	22.0	27.2	34.2

Tabela 40 Kursimet e energjisë në sektorin e bujqësisë të llogaritura me treguesit LP dhe treguesit e tjerë shoqërues

Kodi	Kursimet e energjisë - BUJQËSIA	Njësia ¹	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Kumulative 2009-2014
M10	Konsumi i energjisë në bujqësi, pyje dhe peshkim për vlerë të shtuar	gtoe/mALL	0.64	0.48	0.43	0.41	0.41	0.43	-
M10	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	ktoe		31	10	4	1	-5	41

Shënime 1: Lekët shqiptarë jepen në çmimet e vitit të kaluar.

Figura 15 Totali me treguesit minimalë për sektorin e bujqësisë sipas viteve



A2.7 Përmbledhje e treguesve LP

Në Tabela është paraqitur konsumi final i energjisë për çdo sektor sipas viteve, bazuar në të dhënat e Bilancit Energjetik. Një përmbledhje e treguesve LP të kursimeve në Shqipëri, të mbledhura për secilin sektor, paraqitet në Tabela 411 të mëposhtme. Kjo tabelë përdor treguesit M të ndryshuar (që shënohen me thonjëza teke në Tabela 3).



Tabela 41 Bilanci energjetik sipas sektorëve (ktoe)

SEKTORI	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Banesa	487	489	479	501	572	546
Shërbime	166	160	171	160	188	176
Industri	276	307	356	311	305	417
Transport	754	759	767	737	802	816
Bujqësi	120	99	101	103	103	114
Të tjera ¹	65	64	41	5	0	0
TOTALI²	1,871	1,879	1,913	1,817	1,971	2,070
Ndryshimi nga viti i mëparshëm		9	34	-96	154	99

Shënim 1: Të tjera supozohet të përfshijë të dhënat e pakategorizuara. Nuk ka të dhëna për këtë kategori për vitet 2013 dhe 2014.

Shënim 2: Totali është ai që raportohet në grupin e të dhënave të Bilancit Energjetik, të cilat përbajnë disa mospërputhje të vogla nga shumatorja e të gjithë sektorëve.

Tabela 411 Totali i kursimeve të arritura të energjisë të llogaritura me treguesit LP

SEKTORI	2010	2011	2012	2013	2014
Banesa	2	26	-14	-77	25
Shërbime	10	10	7	-43	10
Industri	12	-25	26	-8	-150
Transport	12	83	19	-78	10
Bujqësi	31	10	4	1	-5
TOTALI	67	104	42	-205	-110
Kursimet kumulative totale	67	171	213	8	-102
Kursimet kumulative totale si përqindje e objektivit të PKVEE-së I (energji mesatare finale gjatë periudhës 2004-2008 (përfshirë))	3.6%	9.1%	11.4%	0.4%	-5.4%

Mbi bazën e këtyre të dhënave LP, është e vështirë për të nxjerrë madje edhe konkluzione paraprake, në lidhje me suksesin apo për zbatimin e ndonjë mase për eficiencën e energjisë. Vetëm në vitin 2010 u vu re një përmirësim i përgjithshëm, krahasuar me vitin e mëparshëm, me rritje të llogaritura për secilin prej viteve pasuese. Në të vërtetë, kumulativja totale sugjeron një dobësim të përgjithshëm të treguesve të EE-së gjatë gjithë periudhës së shqyrtuar.

Megjithatë, mungesa e ndarjes së të dhënave dhe pasiguria më e madhe gjatë plotësimit të tyre, pengon një ndarje të plotë të efekteve me synimin për të përcaktuar shkallën në të cilën rezultatet janë ndikuar nga faktorë të tillë si:

- Shqipëria ka një ekonomi të madhe në hije, e cila nuk raportohet në shifra zyrtare. Një studim i Bankës Botërore, në 2010, ka vlerësuar që ekonomia shqiptare në hije luhetet ndërmjet 33% dhe 36% të PBB-së, gjatë periudhës 1999-2007, megjithëse ekzistojnë pasaktësi të mëdha tek shifrat¹¹. Për shkak të

¹¹ Banka Botërore (2010), *Shadow EconoMIE s All over the World* (Ekonomitë në hije në të gjithë botën), Vlerësimet e reja për 162 vende, nga viti 1999 deri 2007, gjenden në

<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/3928/WPS5356.pdf?sequence=1>



madhësisë së saj, mënyra sesi kjo ekonomi në hije ndikon konsumin e energjisë dhe EE-në (përsa i përket konsumit të energjisë të peregjistruar, si dhe aktivitetit ekonomik të peregjistruar) mund të luajë një rol të rëndësishëm në nxjerrjen e shifrave Lart-Poshtë.

- Metoda LP, e përdorur, nuk i shpjegon plotësisht ndryshimet strukturore në ekonomi dhe ndryshimet në stilin e jetës së qytetarëve (rishikimi sipërfaqësor i efektit të PBB-së për banor dhe ndryshimeve të çmimit të energjisë elektrike në treg në sektorin e banesave tregon se këto parametra nuk shpjegojnë ndryshimet e vëna re tek rezultatet).

Tabela 12 krahason nivelin absolut të konsumit final të energjisë për vitet 2009-2014 krahasuar me atë të parashikuar në PKVEE-në I. Mund të shihet që konsumi total final ka qenë vazhdimisht më i ulët sesa pritshmëritë, ndërsa rritja e PBB-së ka qenë rreth gjysma e asaj të përdorur në parashikimet e PKVEE-së I (4.5%). Megjithatë, këto ndryshime nuk japin një shpjegim të qartë rreth mungesës së përmirësimit të treguesve të eficiencës së energjisë.

Tabela 12 Krahasimi i konsumit total final të energjisë me parashikimet e PKVEE-së I

Konsumi final i energjisë	Unit	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Të dhënat e bilancit energjetik	ktoe	1,871	1,879	1,913	1,817	1,971	2,070
Parashikimi i PKVEE-së I	ktoe	1,861	1,908	1,961	2,019	2,083	2,155
Diferenca	%	1%	-2%	-2%	-11%	-6%	-4%

Prandaj, konkluzionet e LP-së janë si më poshtë:

- Objektivi kombëtar orientues i përcaktuar në PKVEE-në I, i shprehur në terma të konsumit final të energjisë, ishte objektivi i kursimeve vjetore të energjisë prej 168 ktoe për vitin 2018, me një objektiv të ndërmjetëm prej 26 ktoe për vitin 2012.
- Mbi bazën e një analize LP, vitet 2010 deri 2012 demonstrojnë kursimet vjetore të përgjithshme të energjisë të identifikuar nga treguesit e EE-së. Vërtet, nga fundi i 2012, treguesit LP tregojnë një tepricë të konsiderueshme të kursimeve kumulative, krahasuar ose me objektivin prej 3% ose me nivelin më të ulët prej 26 ktoe, të cituara në PKVEE-në I.
- Megjithatë, duke u përpjekur për të përfshirë të dhënat e disponueshme deri në vitin 2014, ndryshimi kumulativ total në konsumin final të energjisë, në lidhje me treguesit referues të EE-së, gjatë periudhës pesëvjeçare 2010-2014, tregohet si rritje në masën prej 102 ktoe. Në mënyrë të përkohshme, kjo do të tregonte që progresi është dukshëm më i ulët se trajektorja e kërkuar për të përmbushur objektivin e PKVEE-së I për vitin 2018, sipas DSHE-së.



- Niveli i lartë i luhatjes ndërmjet përmirësimeve dhe përkeqësimeve të treguesve të EE-së për të gjithë sektorët, gjatë periudhës së shqyrtuar, është shqetësues dhe hedh dyshime mbi besueshmërinë e tyre, si një masë e saktë e tendencave reale në sektorin energjetik shqiptar. Gjithashtu, rezultatet e vërejtura mund t'i atribuohen më shumë luhatjeve të prodhimit dhe çmimeve që nuk janë identifikuar në mënyrë të saktë sesa veprimeve për eficiencën e energjisë.
- Është shumë e rëndësishme të vihet në dukje që ka kufizime të konsiderueshme për një numër aspektesh të të dhënave statistikore në dispozicion për këtë analizë LP. Në të vërtetë kombinimi i përdorimit të një numri të vogël të treguesve “minimalë” me saktësi të ulët, së bashku me pasiguritë që ekzistojnë në të dhënat themelore, bën që ndonjë konkluzion i nxjerrë të jetë sipërfaqësor dhe kryesisht i tepërt. Edhe nëse të dhëna të tilla do të ishin të plota, do të ishte e nevojshme të koordinoheshin konkluzione të tilla me një analizë më të thelluar PL, me synimin për të identifikuar komponentët specifikë që kontribuojnë tek kursimet e energjisë në sektorë individualë.
- Vetëm këto rezultate negative nuk duhen konsideruar si domethënie të asaj që Shqipërisë i kërkohet të bëjë, për të rikuperuar një përkeqësim të Eficiencës së Energjisë gjatë periudhës së shqyrtuar 2009-2014, në përcaktimin e objektivave për Direktivën mbi Eficiencën e Energjisë deri në 2020. Në mënyrë të arsyeshme, këto rezultate theksojnë nevojën për përdorimin e një teknike monitorimi rigoroz e nga më të mirat për matjen e kursimeve në të ardhmen dhe krahasimin e tyre me objektivat e vëna.

Në përgjithësi, kufizimet e metodës LP e bëjnë të nevojshme kryerjen edhe të një analize PL në mënyrë që të përpiqemi të vlerësojmë lidhjen ndërmjet masave për EE-në dhe kursimeve të energjisë dhe të arrijmë një nivel të kënaqshëm besimi dhe sigurie për konkluzionet.

A3 Informacion plotësues mbi llogaritjen Poshtë-Lart të ecurisë së kursimeve të energjisë

A3.1 Burimet e të dhënave

Ky seksion paraqet një analizë sasiore poshtë-lart (“PL”) të masave të miratuara për EE-në. Në mungesë të një platforme monitorimi, janë marrë në konsideratë tre burime të dhënash:

- Të dhëna që lidhen me programe specifike për përmirësimin e EE-së duke përfshirë të dhënat e kredive bankare dhe projektin e PNUD-it për kolektorët diellorë për ngrohjen e ujit;



- Të dhëna të marra nga anketimi i furnizuesve të pajisjeve, i kryer në 2013; dhe
- Të dhëna të marra nga Drejtoria e Doganave që monitoron importet e produkteve me EE në Shqipëri.

Këto trajtohen, sipas radhës, në nën-seksionet e mëposhtme.

A3.2 Të dhëna që lidhen me programe specifike për përmirësimin e EE-së

Sic shihet në raportin kryesor, pjesa më e madhe e masave të përfshira në PKVEE-në I janë ende për t'u zbatuar. Në këtë qasje alternative ndaj analizës PL, fokusi kryesor i veprimeve të ndërmarra në periudhën e shqyrtuar 2010-2014, ka qenë përditësimi ose zëvendësimi i produkteve dhe pajisjeve më të vjetra me produkte e pajisje me më shumë efikasitet të energjisë dhe mbështetja për rikonstruksionet me efikasitet të energjisë, përmes skemave të kredive të buta që ofrohen nga bankat.

Gjatë muajve shtator dhe tetor 2015, ekipi i konsulentëve zhvilloi diskutime me bankat që marrin pjesë në skemën e kredive për të mbështetur zbatimin e masave për efikasitetin e energjisë. Ky nën-seksion detajon analizën PL, bazuar në të dhënat e marra nga bankat pjesëmarrëse. Kjo analizë **nuk është gjithëpërfshirëse**, pasi ajo nuk mbulon kursimet e përfutuara nga mjetet rregullatore, informimi, marrëveshjet vullnetare dhe financimet publike. Gjithashtu, ajo nuk mbulon masat e veçanta për efikasitetin e energjisë, të ndërmarra në sektorin e industrisë.

Për më tepër, analiza dështon në përfshirjen e efekteve multiplikative të arritura nga skemat e bankës përmes stimulimit të tregjeve për produktet me EE. Në mungesë të një platforme monitorimi, një vlerësim i tillë gjithëpërfshirës i rritjes së penetrimit të produkteve me EE mund të arrihet vetëm nëpërmjet të dhënave të detajuara të furnizimit të pajisjeve. Pasiguritë shtesë dhe paragjykimet e mundshme në grupet e të dhënave përfshijnë supozimin që kreditë përbëjnë 100% të kostos së një mase, përfshirë instalimin (diskutimet me bankat sugjerojnë që për kredi të vogla, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të linjave të kreditimit, ky është kryesisht rasti), supozimin që 'efekti *free-rider*' (përmes të cilit masat që do të ishin zbatuar gjithsesi kanë ndihmuar në uljen e kostos së një kredie) nuk ndodh dhe supozimet për kursimet e energjisë për masë. Llogaritjet supozojnë që edhe kursimet që vijnë nga të gjitha masat e zbatuara vazhdojnë për periudhën e plotë të shqyrtuar dhe për thjeshtësi i atribuohen një viti të plotë të kursimeve nga viti i instalimit. Prandaj, rezultatet e prezantuara këtu duhet të trajtohen me kujdes.

Megjithatë, pjesa më e madhe e masave të përfshira në PKVEE-në I janë ende për t'u zbatuar. Fokusi kryesor i veprimeve të ndërmarra në periudhën e shqyrtuar 2010-2014, ka qenë përditësimi ose zëvendësimi i produkteve dhe pajisjeve më të vjetra me produkte e pajisje me më shumë efikasitet të energjisë dhe mbështetja për rikonstruksionet me efikasitet të energjisë, përmes skemave të kredive të buta që ofrohen nga bankat.



Metoda PL për matjen e kursimeve

Siç u trajtua më sipër, skemat e kredive për produktet me EE të ofruara nga bankat nuk përputhen me masat e parashikuara në PKVEE-në I, por i kalojnë ato. Prandaj, në vend të vlerësimit të kursimeve kundrejt çdo mase të PKVEE-së I, analiza PL e përshkruar këtu, vlerëson kursimet e energjisë të arritura nga masat e mëposhtme të standardizuara që mbështeten nga bankat:

- Ngrohja e ujit:** zëvendësimi i boilerëve elektrikë jo eficientë me boilerë me etiketë A (1), instalimi i kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit (2)
- Pajisjet shtëpiake:** zëvendësimi i makinave larëse dhe frigoriferëve (3)
- Kondicionimi i ajrit:** instalimi i kondicionerëve (me etiketë A) dhe i sistemeve qendrore eficiente për kondicionimin e ajrit (4)
- Ngrohja dhe izolimi:** instalimi i kaldajave eficiente për ngrohjen e hapësirave dhe sistemeve të ngrohjes qendrore (5), zëvendësimi i dritareve (6), dyert e jashtme (7), muret e jashtme (8), çatia/tarracat (9)
- Transporti:** zëvendësimi i kamionëve të vjetër me kamionë eficientë (10)
- Bujqësia:** zëvendësimi i traktorëve të vjetër me traktorë eficientë (11)

Shumë prej këtyre masave kalojnë ndërmjet sektorëve të ndryshëm, siç paraqitet në Tabela . Pjesët relative sipas sektorëve janë vlerësuar nga diskutimet me përfaqësuesit e bankave. Përveç listës së mësipërme, disa banka kanë mbështetur edhe masat në sektorin e industrisë që lidhen me përmirësimin e pajisjeve të proceseve industriale. Kursimet e energjisë që lidhen me masa të tilla, zakonisht, do të llogariten ose nëpërmjet kursimeve të matura ose vlerësimeve të shkallëzuara inxhinierike sesa nëpërmjet metodës¹² së supozimit të kursimeve të energjisë për më shumë masa që përsëriten, si ato të listuara më sipër. Megjithatë, është i disponueshëm informacioni për auditimet e detajuara energjetike të objekteve industriale, të kryera nga Besim Islami në kuadër të Fondit “Green for Growth” (GGF), për periudhën prill 2013 deri shtator 2015. Prandaj, këto janë përfshirë si një grup i masave shtesë jo standarde:

- Pajisje industriale:** përmirësimi i pajisjeve që konsumojnë shumë energji që përdoren në proceset industriale (12)

Përsa i përket lidhjes ndërmjet masave të mbështetura nga bankat dhe masave të PKVEE-së I, PKVEE-ja propozon instrumente të caktuara financiare (instrumente promocionale për instalimin e kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit në sektorët e banesave dhe të

¹²Kursimet e supozuara të energjisë nxirren nga rezultatet e përmirësimeve të mëparshme të energjisë të monitoruara në mënyrë të pavarur në instalime të ngjashme



shërbimeve, përkatësisht #R3 dhe #S7) që lidhen me linjat e kreditimit. Ka më pak lidhje të dukshme për llojin tjetër të masave. Pjesa më e madhe e masave rregullatore (standartet për ndërtesat, pajisjet elektrike, etj.) të PKVEE-së I nuk janë zbatuar plotësisht dhe supozohet të mos kenë pasur ndikim në zhvillimin e masave të mbështetura nga bankat. Në lidhje me masat e informimit, si aktivitetet e promovuara nga sektori publik edhe aktivitetet e bankave supozohet se kanë kontribuar në zhvillimin e produkteve për përmirësimin e EE-së.

Tabela 44 Lidhja ndërmjet masave për EE-në që mbështeten nga bankat dhe masat e PKVEE-së I

	Masat e mbështetura nga bankat	Sektorët përkatës				Lidhja me masat e PKVEE-së I
		B	S	I	T B	
1	Zëvendësimi i boilerëve elektrikë jo eficientë me boilerë me etiketë A	x	x	x		
2	Instalimi i sistemeve të kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit	x	x	x		Janë zbatuar siç parashikohet në masat #R3 dhe #S7 të PKVEE-së I
3	Zëvendësimi i makinave larëse dhe frigoriferëve jo eficientë me ato me etiketë A	x	x	x		
4	Instalimi i kondicionerëve (me etiketë A) dhe sistemeve qendrore eficiente për kondicionimin e ajrit	x	x			
5	Instalimi i kaldajave eficiente për ngrohjen e hapësirave dhe sistemeve të ngrohjes qendrore	x	x	x	x	
6	Zëvendësimi i dritareve të vjetra me dritare eficiente	x	x	x		
7	Zëvendësimi i dyerve të jashtme të vjetra me dyer hermetike dhe eficiente	x	x	x		
8	Instalimi i termoizolimit të mureve të jashtme	x	x	x		
9	Instalimi i termoizolimit të çatisë/tarracave	x	x	x		
10	Zëvendësimi i kamionëve të vjetër me kamionë eficientë				x	
11	Zëvendësimi i traktorëve të vjetër me traktorë eficientë				x	Nuk është parashikuar në PKVEE-në I



Masat e mbështetura nga bankat	Sektorët përkatës	Lidhja me masat e PKVEE-së I
12 Përmirësimi i pajisjeve që konsumojnë shumë energji që përdoren në proceset industriale	x	I ngjashëm me veprimet e parashikuara në PKVEE-në I, masa #15, por nuk është kryer nëpërmjet marrëveshjeve formale me agjenci shtetërore

Për të vlerësuar kursimet e energjisë që rezultojnë nga këto programe që mbështeten nga bankat, shumat e kredive të disbursuara për secilën masë të listuar në Tabela , gjatë periudhës 2010-2014, është përkthyer në kursime të energjisë (në GWh/vit). Për këtë, ne kemi përdorur supozimet e kostos për njësi dhe kursimeve të energjisë për njësi, siç shpjegohet në mënyrë të detajuar në *Raportin mbi zbatimin e PKVEE-së së Parë*.

Seksionet e mëposhtme paraqesin rezultatet e përkohshme të kësaj analize.

Kursimet e energjisë PL të vlerësuara sipas masave

Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e përkohshme të kësaj analize PL. Tabela përmbledh kursimet e energjisë LP sipas përdorimit fundor (ndriçimi, ngrohja e ujit, pajisjet elektrike, etj.) për të gjitha masat dhe për të pesë sektorët. Tabela dhe Figura paraqet ndarjen sipas masave dhe sektorëve. Këto të dhëna korrespondojnë me kursimet e reja nga masat e reja të zbatuara në secilin vit. Kursimet kumulative trajtohen më poshtë.

Tabela 45 Kursimet e reja të energjisë të arritura sipas llojit të përdoruesit fundor (për të gjitha masat dhe sektorët)

Kursimi i energjisë nga përdoruesi fundor	Kursimet e reja të energjisë të arritura në vit (në GWh)				
	2010	2011	2012	2013	2014
Ngrohja e ujit	30.89	9.14	10.61	10.20	7.00
Pajisjet elektrike	0.00	0.00	0.00	0.15	0.12
Kondicionimi i ajrit	0.00	0.00	0.00	0.00	0.02
Ngrohja e hapësirave	1.44	6.83	7.61	7.68	4.83
Kamionë të rinj	13.48	10.91	9.46	1.46	2.77
Traktorë të rinj	8.89	7.19	6.24	2.94	5.58
Pajisje industriale	0.00	0.00	0.00	2.44	1.05
Totali nga masat (PL) (GWh)	55	34	34	25	21
Totali nga masat (PL) (ktoe)	4.7	2.9	2.9	2.1	1.8



Figura 16 Kursimet e reja të energjisë të arritura sipas llojit të përdoruesit fundor (për të gjitha masat dhe sektorët)




Tabela 46 Kursimet e reja të energjisë të arritura sipas masave dhe sektorëve

Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Përdoruesi fundor synuar	Sektorët i	Kursimet e reja të energjisë të arritura në vit (në GWh)				
			2010	2011	2012	2013	2014
Zëvendësimi i boilerëve elektrikë jo eficientë me boilerë ujit me etiketë A për ngrohjen e ujit	Ngrohja e ujit	e Banesa	0.00	0.00	0.00	0.01	0.01
		Shërbime	0.00	0.00	0.00	0.01	0.01
		Industria	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		Transporti	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		Bujqësia	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Instalimi i kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit	Ngrohja e ujit	e Banesa	14.64	3.76	3.85	3.23	1.53
		Shërbime	16.25	4.36	5.10	4.67	4.19



Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Përdoruesi fundor synuar	Sektorët i	Kursimet e reja të energjisë të arritura në vit (në GWh)				
			2010	2011	2012	2013	2014
		Industria	0.00	1.01	1.66	2.27	1.26
		Transporti	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		Bujqësia	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Zëvendësimi i makinave larëse dhe frigoriferëve jo eficientë me ato me etiketë A	Pajisjet elektrike	Banesa	0.00	0.00	0.00	0.05	0.04
		Shërbime	0.00	0.00	0.00	0.08	0.06
		Industria	0.00	0.00	0.00	0.01	0.01
		Transporti	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		Bujqësia	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Instalimi i kondicionerëve (me etiketë A) dhe sistemeve qendrore eficiente për kondicionimin e ajrit	Kondicionimi i ajrit	Banesa	0.00	0.00	0.00	0.00	0.01
		Shërbime	0.00	0.00	0.00	0.00	0.01
		Industria	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		Transporti	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		Bujqësia	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Instalimi i kaldajave eficiente për ngrohjen e hapësirave dhe sistemeve të ngrohjes qendrore	Ngrohja e hapësirave dhe izolimi	Banesa	0.11	0.52	0.56	0.42	0.27
		Shërbime	0.28	1.34	1.42	1.26	0.79
		Industria	0.00	0.00	0.00	0.44	0.28
		Transporti	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		Bujqësia	0.00	0.00	0.00	0.22	0.14
Zëvendësimi i dritareve të vjetra me dritare eficiente	Ngrohja e hapësirave dhe izolimi	Banesa	0.03	0.28	0.31	0.24	0.16
		Shërbime	0.06	0.47	0.52	0.45	0.29
		Industria	0.04	0.32	0.35	0.45	0.29
		Transporti	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		Bujqësia	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Zëvendësimi i dyerve të jashtme të vjetra me dyer hermetike dhe eficiente	Ngrohja e hapësirave dhe izolimi	Banesa	0.00	0.05	0.05	0.04	0.03
		Shërbime	0.01	0.09	0.09	0.08	0.05
		Industria	0.00	0.04	0.04	0.06	0.04
		Transporti	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		Bujqësia	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Instalimi i termoizolimit të mureve të jashtme	Ngrohja e hapësirave	Banesa	0.23	0.87	1.04	0.88	0.59
		Shërbime	0.29	1.06	1.28	1.13	0.75



Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Përdoruesi fundor synuar dhe izolimi	Sektorët i	Kursimet e reja të energjisë të arritura në vit (në GWh)					
			2010	2011	2012	2013	2014	
		Industria	0.03	0.11	0.13	0.41	0.28	
		Transporti	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
		Bujqësia	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
Instalimi i termoizolimit të çatisë/tarracave	Ngrohja hapësirave dhe izolimi	Banesa	0.10	0.49	0.53	0.38	0.21	
		Shërbime	0.23	1.08	1.15	0.87	0.48	
		Industria	0.03	0.12	0.13	0.34	0.19	
		Transporti	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
		Bujqësia	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
Zëvendësimi i vjetër	kamionëve të rinj	Kamionë të rinj	Transporti	13.48	10.91	9.46	1.46	2.77
Zëvendësimi i vjetër	traktorëve të rinj	Traktorë të rinj	Bujqësia	8.89	7.19	6.24	2.94	5.58
Zëvendësimi i proceseve industriale	pajisjeve të ndryshëm	Të ndryshëm	Industria	0.00	0.00	0.00	2.44	1.05
Shuma e kursimeve (GWh)			55	34	34	25	21	
Shuma e kursimeve (ktoe)			4.7	2.9	2.9	2.1	1.8	

Kursimet e energjisë PL sipas sektorëve

Tabela mbledh kursimet e energjisë për të pesë sektorët bazuar në analizën e mësipërme PL. Këto kursime krahasohen me objektivat e PKVEE-së I, të paraqitura në Tabela 138, për secilin vit të periudhës së shqyrtuar, si dhe me objektivat për vitin 2018. Vihet re që ndërsa PKVEE-ja I përcaktoi një objektiv të ndërmjetëm prej 3% të konsumit mesatar vjetor, gjatë periudhës referuese, i miratuar për 2012, vlera e kursimit të energjisë që lidhet me të u deklarua 26 ktoe, e cila është aktualisht ekuivalente me rreth 1.4% të konsumit mesatar gjatë periudhës referuese. Kuptohet që ky objektiv më i ulët u përcaktua për shkak të miratimit të vonë të PKVEE-së, në shtator 2011, dhe se realizimi i nivelit prej 3% do të ishte i paarritshëm. Rezultati neto është që kursimet priteshin të ecnin me një ritëm më të ulët deri në fund të 2012, përpara se të rriteshin në vitet 2013-2018.

Tabela 47 Kursimet kumulative të energjisë nga analiza PL sipas sektorëve

Sektori	Kursimet kumulative të energjisë (GWh)				
	2010	2011	2012	2013	2014



Sektori	Kursimet kumulative të energjisë (GWh)				
	2010	2011	2012	2013	2014
Banesa	15.13	21.11	27.46	32.73	35.56
Shërbime	17.10	25.49	35.06	43.60	50.24
Industria	0.10	1.69	3.99	10.44	13.83
Transporti	13.48	24.39	33.85	35.31	38.08
Bujqësia	8.89	16.08	22.32	25.47	31.19
Totali kumulativ (GWh)	55	89	123	148	169
Totali kumulativ (ktoe)	4.7	7.6	10.5	12.7	14.5
% kumulative (krahasuar me konsumin referues të DSHE-së)	0.25%	0.41%	0.56%	0.69%	0.79%

Tabela 138 Objektivat kombëtare orientuese për periudhën afatshkurtër (2012)¹³ dhe afatgjatë (2018)


Objektivi kombëtar orientues në 2018 (GWh)	1953					
Objektivi kombëtar orientues në 2018 (ktoe)	168					
Objektivi kombëtar orientues i ndërmjetëm në 2012 (GWh)	302					
Objektivi kombëtar orientues i ndërmjetëm në 2012 (ktoe)	26					
Sektorët	Objektivi i sektorit (GWh)					
	2010	2011	2012	2013	2014	2018
Banesa	19.38	38.76	58.14	120.16	182.17	430.23
Shërbime	19.38	38.76	58.14	110.47	162.79	372.09
Industria	23.26	46.51	69.77	139.53	209.30	488.37
Transporti	31.01	62.02	93.02	178.29	263.57	604.65
Bujqësia	7.75	15.50	23.26	29.07	34.88	58.14
Totali kumulativ (GWh)	101	202	302	578	853	1953
Totali kumulativ (ktoe)	9	17	26	50	73	168
% e konsumit referues të DSHE-së	0.5%	0.9%	1.4%	2.7%	3.9%	9.0%

¹³Shifra për vitet e tjera, përveç 2012 dhe 2018, është vlerësuar duke supozuar progresion linear të objektivit të kursimeve të energjisë deri në fund të 2012, e më pas e ndarë nga 2013 deri në 2018.



Siç paraqitet në Figura 17, vlerësimi i mësipërm tregon se kursimet direkte të energjisë të kombinuara nga përmirësimi i efikasitetit të energjisë, i mbështetur nga skemat e kredive bankare, mund të përbëjnë rreth një të pestën e objektivit të DSHE-së (0.8% krahasuar me 3.9%). Ndonëse ka një sërë pasigurish në llogaritjen e shifrës, si rrjedhojë e supozimeve dhe vlerësimeve për koston e njësisë dhe kursimet e supozuara, sidoqoftë kjo paraqet progres të konsiderueshëm. Nxitësi i vetëm më i madh i kësaj arritjeje ka qenë futja në përdorim e kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit dhe, si rrjedhojë, rritja e diversifikimit të masave për kursimin e energjisë duhet të jetë një prioritet për PKVEE-në tjetër.

Figura 17 Kursimet e energjisë sipas analizës PL në krahasim me objektivin sipas viteve



Në nivel sektorial kursimet kumulative, gjatë periudhës 2010-2014 (përfshirë), për sektorët e banesave, shërbimeve dhe të bujqësisë vlerësohen të kenë arritur respektivisht rreth 20%, 30% dhe 50% të objektivave të PKVEE-së I. Megjithatë, përpjekjet në industri dhe transport kanë mbetur ndjeshëm mbrapa, dhe kursimet vlerësohen të jenë respektivisht rreth 5 dhe 10% të objektivit të tyre. Vihet re që për industrinë në veçanti, ky rezultat mund të jetë pjesërisht për shkak të mungesës së të dhënave për kursimet e matura të energjisë që vijnë nga përmirësimet me kërkesë të klientëve, për pajisjet e proceseve industriale dhe që për këtë arsye nuk është modeluar në këtë analizë.

Progresi në të gjithë sektorët ishte më i shpejtë në vitet e hershme 2010-2012, ndërsa ngadalësimi në vitet 2013-2014 mund t'i atribuohet dobësisë së përgjithshme të ekonomisë shqiptare që kufizonte dhënien e kredive.



A3.3 Të dhëna të marra nga anketimet e furnizuesve të pajisjeve

Shtojca IV e DSHE-së sugjeron përdorimin e të dhënave të shitjes së pajisjeve, direkt nga prodhuesit ose shitësit me pakicë. Është e vështirë që të merren grupe të dhënash të besueshme për Shqipërinë, pasi për pjesën më të madhe të pajisjeve, vendi nuk mbulohet ende nga agjencitë më të mëdha të mbledhjes së të dhënave të tregut, që do të thotë se kërkohen anketime të dedikuara. Një anketim i tillë u krye nga Besim Islami, pjesë e ekipit konsulent, për llogari të GIZ-it në prill 2013, që mbulon vitet 2007-2012 (përfshirë), për pajisjet e mëposhtme:

- Ndriçimi:** zëvendësimi i llambave inkandeshente me llamba CFL dhe zëvendësimi i llambave fluoreshente të vjetra me llamba moderne T5 dhe LED
- Ngrohja e ujit:** zëvendësimi i boilerëve elektrikë jo eficientë me boilerë me etiketë A
- Pajisjet shtëpiake:** zëvendësimi i makinave larëse dhe frigoriferëve
- Kondicionimi i ajrit:** instalimi i kondicionerëve (me etiketë A) dhe i sistemeve qendrore eficiente për kondicionimin e ajrit

Për vitet 2013 dhe 2014, nuk ka të dhëna në dispozicion. Qasja e zakonshme për të vlerësuar ndikimin e masave për EE-në në të dhëna të tilla, është të nxirret tendenca referuese e aktivitetit të zakonshëm (BAU), duke përdorur të dhëna nga periudha përpara zbatimit të masave për EE-në (të tilla si fushatat e informimit). Kjo përdoret për t'u përpjekur për të ndjekur se cila do të ishte norma e pritshme e rritjes së pjesës së tregut të pajisjeve me EE, gjatë periudhës së shqyrtuar, në mungesë të masave për EE-në. Çdo rritje mbi këtë normë i atribuohet masave për EE-në. Një avantazh i kësaj metodologjie, krahasuar me atë të përdorur në Seksionin A3.2, është se ajo përdor "efektin multiplikativ" të stimulimit të tregut në masat për EE-në, përtej atyre që marrin pjesë direkt në skemat e EE-së.

Për këtë studim nuk ka të dhëna në dispozicion, para vitit 2007, që do të thotë se nuk mund të krijohet një tendencë referuese BAU e qëndrueshme kundrejt të cilës të vlerësohet rritja që mund t'i atribuohet masave për EE-në. Për më tepër, megjithëse përfshihen të gjithë furnizuesit kryesorë në Shqipëri, anketimet nuk janë gjithëpërfshirëse dhe në këtë mënyrë tregu total është vlerësuar mbi bazën e pjesës së tregut të atyre furnizuesve të pajisjeve nga të cilët u mblodhën të dhënat. Si rezultat, vlerësimet e kursimeve të energjisë, që nxirren nga të dhënat e mbledhura në këtë mënyrë, nuk janë përfshirë brenda kësaj analize PL. Megjithatë, për të ofruar një ilustrim të efektit potencial, rezultatet për ndriçimin që supozojnë (në mungesë të të dhënave referuese afatgjatë) një normë rritjeje normale të pajisjeve me EE prej 3%, jepen në Tabela të mëposhtme. Tabela supozon një ndarje prej 50% për sektorin e banesave, 40% për sektorin e shërbimeve dhe 10% për sektorin e industrisë.



Tabela 49 Efekti ilustrues i EE-së tek ndriçimi duke përdorur metodën e anketimit për pajisjet

Sektori	Kursimet kumulative të energjisë (GWh)			
	2009	2010	2011	2012
Numri total i vlerësuar i njësive	418,445	435,182	465,645	516,866
Referenca (me 3% rritje)	418,445	430,998	448,237	479,614
Që i atribuohet masës për EE-në		4,184	17,407	37,252
Banesa		0.30	1.27	2.71
Shërbime		0.27	1.13	2.42
Industria		0.10	0.43	0.92
Transporti		0.00	0.00	0.00
Bujqësia		0.30	1.27	2.71
Totali (GWh)		0.7	2.8	6.1
Totali (ktoe)		0.1	0.2	0.5

A3.4 Të dhëna të marra nga Drejtoria e Doganave

Drejtoria e Doganave ofroi të dhëna, për periudhën 2009-2014, në lidhje me importet dhe eksportet e produkteve specifike që janë të përshtatshme nga pikëpamja e EE-së. Këto përfshijnë:

- Ndriçimi: përfshirë lloje të ndryshme të teknologjive
- Ngrohja e ujit: boilerët dhe kolektorët diellorë për ngrohjen e ujit
- Pajisjet shtëpiake: soba gatimi, zëvendësimi i makinave larëse dhe frigoriferëve
- Ngrohja e hapësirave dhe kondicionimi i ajrit: pompat e nxehtësisë, kondicionerët, ventilatorët
- Materialet e termoizolimit
- Automjetet, kamionët dhe traktorët



Produktet klasifikohen sipas kodeve të tyre 8-shifrore HS¹⁴, secili kod i shoqëruar nga informacioni mbi sasi të importeve dhe eksporteve, çmimet njësi dhe pesha. Duke supozuar që prodhimi lokal në Shqipëri është i papërfillshëm për pjesën më të madhe të kategorive të mësipërme, informacioni i doganave teorikisht mund të ofrojë një pasqyrë shumë të dobishme të konsumit të mallrave që përmirësojnë EE-në. Kjo qasje paraqitet në Tabela për sobat e gatimit; duke treguar totalin e importeve dhe eksporteve dhe konsumin lokal si diferencë e tyre. Të dhënat e doganave, në mënyrë të ngjashme me të dhënat nga anketimet e furnizuesve (Seksioni A3.3) do të përfshinin gjithashtu “efektin multiplikativ” të simulimit të tregut në masat për EE-në.

Fatkeqësisht, klasifikimi aktual i mallrave është në një nivel grupimi që nuk lejonte përdorimin e duhur të të dhënave në këtë fazë. Klasifikimi aktual i mallrave nuk është mjaftueshmërisht i ndarë për të lejuar diferencimin e mallrave sipas eficiencës së tyre të energjisë. Kjo do të kërkonte kryerjen e vlerësimeve sasiore të produkteve të përshtatshme për analizën tonë, pra duke ulur saktësinë. Shembuj të kësaj janë si më poshtë:

- Konsumi total i sobave të gatimit, sipas Tabela , është 1.2 milionë gjatë periudhës 5-vjeçare. Kjo shifër është më e lartë sesa numri total i banesave në Shqipëri, duke sugjeruar që lloje të tjera të produkteve vendosen nën të njëjtën kategori.
- Për materialet e izolimit, duke i shtuar konsumit lokal deri në 25 milionë € gjatë periudhës 5-vjeçare, nuk është e mundur të diferencohet se çfarë është e destinuar për izolimin e veshjeve të jashtme të ndërtesave dhe çfarë përdoret në industri (p.sh. për paketim).
- Ndërsa produktet e ndriçimit përfshijnë ndryshimin ndërmjet llambave inkandeshente dhe tubave fluoreshente. Nuk ka asnjë diferencim për teknologjitë më të reja, të tilla si llambat CFL dhe LED, me sa duket përfshihen në kategorinë “Të tjera”.
- Çmimet e ulëta për njësi në importimin e automjeteve dhe traktorëve sugjerojnë që një pjesë e madhe e tyre (mundësisht mbi 90%) janë të përdorura, prandaj nuk duhet të konsiderohen me eficiencë të energjisë.

Tabela 50 Importet dhe eksportet e sobave të gatimit

	Shuma	2010	2011	2012	2013	2014	Totali 2010-14
Importuar në Shqipëri	Euro	4,801,644	4,840,801	5,485,359	5,109,252	4,536,188	24,773,245
	Copë	213,780	185,337	426,154	230,971	229,378	1,285,620
Eksportuar	Euro	63,432	83,475	67,250	122,018	136,550	472,725

¹⁴Përshkrimi i harmonizuar i mallrave dhe sistemi i kodimit



		Shuma	2010	2011	2012	2013	2014	Totali 2010-14
nga								
Shqipëria	Copë		722	2,134	7,028	24,809	38,337	73,030
Mbetur	në	Euro	4,738,213	4,757,326	5,418,109	4,987,234	4,399,638	24,300,520
Shqipëri	Copë		213,059	183,202	419,126	206,161	191,041	1,212,590

Bashkëpunimi i mëtejshëm ndërmjet Drejtorisë për EE-në në MIE dhe Drejtorisë së Doganave, veçanërisht në lidhje me klasifikimin e mallrave, mund të lejojte diferencimin e produkteve në një mënyrë që është e përshtatshme për të ndjekur përmirësimet e EE-së. Ky bashkëpunim duhet inkurajuar për analizë dhe monitorim të ardhshëm, pasi në të ardhmen e afërt, ai ka potencialin për të qenë rruga më efiçente e marrjes së të dhënave të besueshme.

A3.5 Përmbledhja e analizës PL

Rishikimi i statusit aktual të masave për EE-në, të propozuara në PKVEE-në I, arrin në konkluzionet kryesore të mëposhtme:

- Pjesa më e madhe e masave të parashikuara në PKVEE-në e I nuk janë zbatuar dhe nuk ka pasur një monitorim dhe raportim të centralizuar mbi ndikimet që kanë pasur masat të cilat janë zbatuar. Kjo përfshin ndjekjen e veprimeve dhe raportimin e progresit, përveç matjes së ndikimit të kursimit të energjisë.
- Duket që ka pasur një mungesë të kuptimit ndër-qeveritar dhe të përkushtimit për PKVEE-në I, kërkesave të tij, si edhe urgjencës dhe rëndësisë të përgatitjes dhe miratimit të legjislacionit nxitës dhe mbështetës. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme të garantohet krijimi i strukturave institucionale të përshtatshme (p.sh. grupet e punës ndërministrorë) për përgatitjen dhe zbatimin e PKVEE-së tjetër.
- Megjithatë, disa veprime të rëndësishme janë ndërmarrë, përfshirë edhe disa veprime që nuk janë parashikuar në PKVEE-në I. Pjesa më e madhe e tyre kanë ndodhur në sajë të mbështetjes së donatorëve nëpërmjet kredive të buta të dhëna nga bankat lokale. Këto programe kanë mbështetur pjesën më të madhe të veprimeve për përmirësimin e efiçencës së energjisë dhe formojnë bazën e analizës sasiore të kryer.
- Analiza PL vlerëson përkohësisht që kursimet kumulative të energjisë të akumuluar nga këto skema të kredisë bankare, për periudhën e shqyrtuar 2010-2014 (përfshirë), mund të përbëjnë rreth një të pestën e kursimeve të synuara të PKVEE-së I (kursimet kumulative të energjisë kundrejt konsumit referues të energjisë vlerësohen rreth 0.8% deri në fund të 2014, krahasuar me objektivin prej 3.9%).



□ Kontributi më i madh për këtë objektiv është futja në përdorim e kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit, në kuadrin e programit të PNUD-it, dhe ndonëse kjo përfaqëson një program shumë të suksesshëm, rritja e diversifikimit të masave dhe e përdoruesve fundorë të synuar duhet të jetë një prioritet për PKVEE-në tjetër.

□ Pavarësisht mungesës (dhe duke ditur kufizimet që trashëgon kjo metodë e zgjedhur e cila mund të rezultojë jo e drejtë), kjo megjithatë përfaqëson një progres të dukshëm për përmirësimet e eficiencës së energjisë në Shqipëri.

□ Kursimet kumulative që rezultojnë nga analiza PL për sektorët e banesave, shërbimeve dhe bujqësisë vlerësohen përkohësisht të kenë arritur respektivisht rreth 20%, 30% dhe 50% të objektivave të tyre në PKVEE-në I për 2014, por kursimet e vlerësuara për sektorët e transportit dhe industrisë përmbushin respektivisht vetëm rreth 5% dhe 10% të objektivave të tyre përkatëse. Kjo ndodh sepse fokusi i kredive të dhëna për pajisjet ka qenë i përqendruar tek përmirësimet në pajisjet për ndërtesat.

□ Mbështetja e donatorëve i është ofruar edhe bashkive për disa programe pilote për rinovimin e ndërtesave në sektorin e shërbimeve. Fokusi i programeve të tilla pilote ka qenë disi më i ngushtë dhe intervistat e kryera, si pjesë e hartimit të këtij raporti, kanë vënë në dukje se burimet mund të kenë qenë më tepër të përqendruara në disa projekte me cilësi shumë të lartë, në vend të më shumë përmirësimeve për një numër më të madh të përfituesve potencialë.

Ndërsa analiza sasiore, sipas metodës PL, jep disa nota optimiste, përmirësimet e eficiencës së energjisë janë varur shumë nga instrumentet financiare të mbështetura nga fondet e donatorëve, ndërsa ka pasur një mungesë të një progresi në fushën rregullatore. Prandaj, ekziston një nevojë urgjente për miratimin e masave rregullatore, të kombinuara me masat për ngritjen e kapaciteteve të lojtarëve kryesorë institucionalë dhe të tregut, me qëllim që të arrihet një lëvizje në rritje dhe të sigurohet një ndikim i qëndrueshëm dhe afatgjatë. Për më tepër, nivelet e larta të pasaktësisë në rezultat, në mënyrë të veçantë për analizën LP, por edhe për atë PL, theksojnë nevojën për përdorimin e një **teknike monitorimi rigoroze e nga më të mirat** për matjen e kursimeve në të ardhmen dhe krahasimin e tyre me objektivat e vëna. Këtyre çështjeve u duhet dhënë një shqyrtim më serioz gjatë përgatitjes të PKVEE-së tjetër.

A4 Informacion plotësues mbi llogaritjen e objektivit të kursimeve finale të energjisë

Ky seksion paraqet një parashikim të konsumit të energjisë për Shqipërinë, me një përshkrim të parametrave kryesorë dhe supozimeve të përdorura në procesin e modelimit. Qëllimi i këtij ushtrimi është të ofrohet një skenar bazë kundrejt të cilit mund të vlerësohen kursimet dhe të paraqiten njëkohësisht dy skenarë të ndryshëm të konsumit të ardhshëm - njëri me aplikimin e politikave energjetike aktuale dhe aktiviteteve normale të biznesit dhe tjetri me zbatimin e të gjitha aktiviteteve të propozuara, në këtë dokument, për eficiencën e energjisë.

Baza për parashikimet e konsumit të dobishëm të energjisë për qëllime termike në banesa është numri i parashikuar i banorëve dhe i banesave. Për sektorin e shërbimeve, përcaktuesi



kryesor është sipërfaqja e katit, e kombinuar me zhvillimin e produktit të brendshëm bruto, ndërsa në sektorin e industrisë, përcaktuesi kryesor i ndryshimeve të përdorura në model është produkti i brendshëm bruto dhe struktura e tij. Treguesit kryesorë të aktivitetit, në sektorin e transporteve, janë popullsia dhe zhvillimet e supozuara të teknologjisë dhe mënyrave të sjelljes.


Modelimi i kërkesës për energji, me qëllim vlerësimin e masave të ndryshme për eficiencën e energjisë, është kryer duke përdorur MAED-in (Modeli për Analizën e Kërkesës për Energji). MAED-i është program kompjuterik i përgatitur dhe mirëmbajtur nga ANEA (Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike). MAED-i vlerëson kërkesat e ardhshme për energji bazuar në skenarët afatmesëm deri afatgjatë të zhvillimeve social-ekonomike, teknologjike dhe demografike. Kërkesa për energji është ndarë në një numër të madh të kategorive të përdoruesve fundorë që i korrespondojnë mallrave dhe shërbimeve të ndryshme në sektorë të ndryshëm. Nga një skenar i dhënë, janë vlerësuar ndikimet e faktorëve nxitës socialë, ekonomikë dhe teknologjikë. Këto janë kombinuar për të dhënë një panoramë të përgjithshme të rritjes së ardhshme të kërkesës për energji. Bazuar në eficiencën e pajisjeve të përdoruesve fundorë është vlerësuar energjia e dobishme, si dhe kërkesa për energji finale.

A4.1 Modeli për Analizën e Kërkesës për Energji

Modeli MAED vlerëson kërkesat e ardhshme për energji bazuar në skenarët afatmesëm deri afatgjatë të zhvillimeve social-ekonomike, teknologjike dhe demografike. Modeli lidh në mënyrë sistematike kërkesën specifike për energji për prodhimin e produkteve dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme, të identifikuar në model, me faktorët korrespondues socialë, ekonomikë dhe teknologjikë që ndikojnë këtë kërkesë. Kërkesa për energji është ndarë në një numër të madh të kategorive të përdoruesve fundorë; secili i korrespondon një shërbimi të dhënë ose prodhimit të një produkti të dhënë. Natyra dhe niveli i kërkesës për produkte dhe shërbime është në funksion të disa faktorëve përcaktues, përfshirë rritjen e popullsisë, numrin e personave për banesë, numrin e pajisjeve elektrike në banesa, lëvizshmërinë e njerëzve dhe preferencat për mënyrat e transportit, prioritetet kombëtare për zhvillimin e industrive të caktuara ose sektorëve ekonomikë, rritjen e eficiencës së llojeve të caktuara të pajisjeve, penetrimit në treg të teknologjive të reja ose formave të energjisë etj. Tendencat e pritshme për këto faktorë përcaktues, të cilët përbëjnë “skenarët”, janë futur në mënyrë ekzogjene.

Kuptimi i këtyre faktorëve përcaktues lejon vlerësimin e kategorive të ndryshme të kërkesës për energji për secilin sektor të ekonomisë të marrë në konsideratë. Kërkesa totale për energji për secilën kategori të përdoruesve fundorë grupohet në katër sektorë kryesorë “konsumatorë të energjisë”: industria (përfshirë bujqësinë, ndërtimin, minierat dhe prodhimin), transporti, shërbimet dhe banesat. Modeli ofron një kornizë sistematike të kontabilitetit për vlerësimin e efektit të një ndryshimi në ekonomi ose në standardin e jetesës së popullsisë tek kërkesa për energji, duke përdorur një qasje poshtë-lart.

Figura 1 Skema e përdorur për të përcaktuar energjinë e dobishme dhe kërkesën finale për energji në MAED



Pikënisja për përdorimin e modelit MAED është ndërtimi i modelit të konsumit të energjisë në vitin bazë, në kuadër të modelit. Kjo kërkon përpilimin dhe rakordimin e të dhënave të nevojshme nga burime të ndryshme, duke nxjerrë e llogaritur parametra të ndryshëm hyrës dhe duke i përshtatur ato për të krijuar bilancin energjetik të vitit bazë. Kjo ndihmon për ta kalibruar modelin sipas situatës specifike të vendit.

Hapi tjetër është zhvillimi i skenarëve të ndryshëm, specifike sipas situatës dhe objektivave të një vendi. Skenarët mund të ndahen në dy nën-skenarë:

- njëri lidhet me sistemin social-ekonomik që përshkruan karakteristikat themelore të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit;



- i dyti lidhet me faktorët teknologjikë që ndikojnë në llogaritjen e kërkesës për energji, për shembull, eficientia dhe potenciali i penetrimit në treg të çdo forme alternative të energjisë dhe teknologjie për përdoruesit fundorë.

Çelësi i skenarëve të mundshëm dhe të dobishëm është konsistenca e brendshme e supozimeve, veçanërisht për zhvillimin social, ekonomik dhe teknologjik. Është e nevojshme të kuptohet mirë ndërveprimi dinamik midis forcave të ndryshme nxitëse ose faktorëve përcaktues. Rezultati i modelit, d.m.th. kërkesa e ardhshme për energji, është vetëm një reflektim i supozimeve të këtyre skenarëve. Vlerësimi i rezultatit dhe modifikimi i supozimeve fillestare është procesi bazë nga i cili nxirren rezultate të arsyeshme.

Modeli fokusohet në mënyrë ekskluzive tek kërkesa për energji dhe në mënyrë më specifike tek kërkesa për shërbime të caktuara energjetike. Kur forma të ndryshme energjie, pra energjia elektrike, lëndët djegëse fosile etj., konkurrojnë për një kategori të dhënë përdoruesish fundorë të kërkesës për energji, kjo kërkesë llogaritet së pari si sasi e energjisë së dobishme dhe më pas konvertohet në energji finale, duke marrë në konsideratë penetrimin në treg dhe eficienten e çdo burimi alternativ energjie, që specifikohen si parametra skenarësh. Përdorimet e energjisë së pazëvendësueshme, të tilla si karburantet për automjete, energjia elektrike për përdorime specifike (elektroliza, ndriçimi etj.) llogariten direkt si sasi e energjisë finale.

A4.2 Konsumi final i energjisë në sektorin e banesave

Përcaktuesit kryesorë të konsumit të energjisë në sektorin e banesave janë popullsia dhe numri i banesave, d.m.th. madhësia e banesës. Për qëllime të këtij studimi, është përdorur parashikimi i popullsisë, i publikuar nga Banka Botërore, i cili tregon një tendencë të ngjashme rritjeje ashtu si edhe parashikimet e publikuara nga Divizioni për Popullsinë i Departamentit të Çështjeve Ekonomike dhe Sociale të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

Seritë kohore të numrit të personave për banesë në vendet e zhvilluara evropiane dhe në vendet në tranzicion tregojnë që numri i personave për banesë ulet me rritjen e standardit të jetesës. Megjithatë, kjo ulje në vendet në tranzicion ndodh relativisht shpejt dhe disa nga vendet në tranzicion janë tashmë shumë afër nivelit të banesave me dy persona, ekuivalente me pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara evropiane. Ulja ndodh për shkak të plakjes së popullsisë dhe mënyrës së jetesës, sipas të cilës përqindja e banesave me një anëtar dhe dy anëtarë po rritet në mënyrë konstante. Në Shqipëri, numri i personave për banesë pritet të ulet nga 3.92, në 2013, në 3.50, në 2020.

Me uljen e numrit të personave për banesë dhe me një numër të krahasueshëm të banorëve, numri i njësisive të banimit po rritet. Kjo lëvizje reflektohet në rritjen e numrit të njësisive të banimit në qytetet e mëdha, pasi popullsia atje rritet në mënyrë intensive dhe numri i personave për banesë ulet më shpejt sesa në qytetet më të vogla dhe, në veçanti, në zonat rurale.



Sipas statistikave të ofruara nga INSTAT-i dhe Banka Botërore, sipërfaqja e banimit të banesës mesatare në Shqipëri është 57 m², shifër që është në mënyrë të konsiderueshme më e ulët sesa mesatarja e BE-së. Është parashikuar një rritje e mëtejshme e sipërfaqes mesatare të banimit, e cila korrespondon me tendencën dhe dinamikat e rritjes së sipërfaqeve të banimit në vendet evropiane, kështu që në 2020 sipërfaqja e banimit për banesë, në Shqipëri, do të jetë 62 m².

Tabela 51 Popullsia dhe banesat në Shqipëri

		2013	2020
Popullsia	milionë	2.899	2.939
Madhësia e banesës	person/ banesë	3.92	3.61
Banesat	milionë	0.740	0.813

Burimi: Banka Botërore, INSTAT

Në model, matja bazë e standardit të ngrohjes, është sipërfaqja e ngrohur. Sipërfaqja e ngrohur e banesës mesatare u përcaktua mbi bazën e të dhënave statistikore dhe të dhënave të bilancit energjetik. Pjesa e sipërfaqes së ngrohur zë 51% të sipërfaqes totale të banimit (faktori i ngarkesës) dhe është rezultat i aftësisë blerëse të popullsisë, druve të zjarrit në dispozicion, çmimit të energjisë elektrike dhe prioriteteve të jetës që vijnë nga tradita e trashëgimia kulturore. Prandaj, me rritjen standarde, rritja e mëtejshme e pjesës së sipërfaqes së ngrohur, deri në 2020, do të zërë 63% të sipërfaqes totale të njësive të banimit.

Tabela 52 Banesat e banuara sipas sipërfaqes

	Urbane	Rurale	Totali
Më pak se 40 m ²	128,943	89,041	217,984
40-69 m ²	159,832	155,508	315,340
70-99 m ²	77,499	44,227	121,726
100-129 m ²	25,699	15,181	40,880
130 m ² e më shumë	9,522	4,413	13,935
Totali	401,495	308,370	709,865


Burimi: INSTAT

Modeli MAED përcaktoi, për vitin 2013 në Shqipëri, konsumin e nxehtësisë së dobishme për ngrohjen e hapësirave në 115 kWh/m^2 të sipërfaqes së ngrohur. Ky konsum specifik është një matje e cilësisë së termoizolimit ose humbjeve të nxehtësisë së shtëpive dhe banesave. Kjo matje është e përafërt, pasi ajo përmban ndryshueshmërinë e kohëzgjatjes së ngrohjes dhe temperaturës në një sipërfaqe banimi. Kur ky konsum ndahet sipas gradë-orëve, i ndjekur nga e ashtuquajtura vlera K (vlera e humbjeve të nxehtësisë të standardizuara në gradë-orë), ai mund të krahasohet me humbjet e nxehtësisë së rajoneve dhe vendeve të tjera. Gradë-ditët janë ditët të cilat përcaktojnë kushtet klimaterike të një viti të veçantë dhe sa më të larta të jenë, aq më të larta janë nevojat objektive për ngrohjen e hapësirave. Sipas të dhënave meteorologjike zyrtare për Shqipërinë, gradë-ditët e përshtatura bazuar në numrin e njësive të banimit në bashkitë individuale, për 2013, ishin 1,539 dhe mesatarja afatgjatë, e përdorur në modelimin e konsumit, është 1,450.

Në Shqipëri, për 2013, u përcaktua vlera K prej $3.12 \text{ Wh/m}^2/^\circ\text{C/orë}$, e cila përfaqëson humbje relativisht të larta. Për shembull, në Kroaci, humbjet janë pak më të ulëta dhe, në përgjithësi, vlera K në rajon është rreth 3. Vendet evropiane bëjnë përpjekje, në mënyrë të vazhdueshme, për të ulur humbjet e nxehtësisë në stokun e tyre të banesave, megjithatë jo të gjitha me intensitet të njëjtë. Në kontrast, vendet skandinave janë të njohura për përkushtimin e tyre të lartë, në mënyrë tradicionale, tek masat për eficiencën e energjisë, d.m.th. Danimarka ka përgjysmuar humbjet e saj të energjisë, në periudhën nga 1973 deri në 1980.

Supozohet se deri në 2020 ulja relative në humbjen e nxehtësisë do të arrijë në 0.6% me prishjen e moderuar të stokut ekzistues të banesave dhe nivelit ekzistues të ndërtimit të njësive të reja të banimit. Në skenarin bazë, supozohet që, deri në 2020, aplikimi i termoizolimit do të jetë në një nivel që mund të arrihet pa marrë ndonjë masë të veçantë për eficiencën e energjisë.

Figura 2 Shpërndarja e prefekturave sipas zonave





Në sajë të të dhënave të disponueshme të Censurit 2011, të kryer nga INSTAT-i, ishte e mundur të shpërndahej konsumi i energjisë termike në banesa, sipas përdoruesve fundorë të ndryshëm dhe rajoneve gjeografike të Shqipërisë.

Tabela 53 Banesat në Shqipëri


Rajoni	Kondicioner	Ngrohje me kondicioner	Ngrohje direkte me energji elektrike	Ngrohje me dru	Ngrohje me GLN	Ngrohje me lëndë djegëse të tjera	Pa ngrohje
Zona 1	16.8%	9.6%	12.7%	38.7%	28.6%	1.6%	8.8%
Zona 2	6.3%	2.3%	4.8%	72.7%	16.0%	0.8%	3.4%
Zona 3	1.4%	0.2%	0.9%	95.7%	2.0%	0.6%	0.6%
Shqipëria	11.3%	6.0%	8.6%	57.5%	20.8%	1.2%	5.9%

Burimi: INSTAT (Censusi 2011)

Energjia e dobishme për gatim për banesë, e kalibruar nga modeli, është relativisht e lartë krahasuar me vendet evropiane dhe është rreth 1 500 kWh/banesë. Kjo është në përputhje me normat social-ekonomike të Shqipërisë dhe është parashikuar që në të ardhmen të ulet si pasojë e uljes së numrit të personave për banesë, si dhe ndryshimit gradual të ciklit ditor të punës dhe vendit më të lartë që zë shërbimi i ushqimeve në sektorin e shërbimeve krahasuar me nivelin aktual. Energjia e përdorur për gatim pritet të arrijë 1 050 kWh/banesë në periudhën afatgjatë (në 30 vitet e ardhshme), megjithatë në periudhën afatshkurtër ulja do të jetë më e vogël dhe si rrjedhojë konsumi specifik për gatim pritet që në 2020 të jetë 1 370 kWh/banesë.

Energjia specifike e dobishme për ftohje në banesa është analizuar dhe llogaritur duke përdorur modelin MAED. Energjia e nevojshme për ftohje u llogarit duke zbritur konsumin e energjisë për ngrohje, ftohje, gatim dhe pajisje shtëpiake nga konsumi total i energjisë në banesë. Në Shqipëri energjia totale e dobishme për ftohje është modeluar të jetë 4 500 kWh për banesë në vit.

Figura 20 Parashikimi i konsumit final të energjisë në banesa



Konsumi i energjisë së dobishme për ngrohjen e ujit për banor është në nivel më të ulët se 450 kWh/banor dhe është parashikuar që, deri në 2020, të rritet në 500 kWh/banor, që do të çonte në një kërkesë mesatare të energjisë së dobishme prej 1800 kWh/banesë.

Në 2013, konsumi mesatar i energjisë elektrike për pajisjet e banesave ishte 1 733 kWh/banesë dhe pritet që në 2020 të rritet në 2 000 kWh/banesë.

Figura paraqet parashikimin e konsumit final të energjisë në banesa për skenarin e aktivitetit të zakonshëm, d.m.th. pa masat shtesë për eficiencën e energjisë. Në periudhën e analizuar, konsumi i të gjitha formave të energjisë pritet të rritet, me energjinë termike diellore që ka rritjen më të lartë - trefish. Në 2020, konsumi total final i energjisë, do të jetë 795 ktoe, që përfaqëson një rritje prej 26%, gjatë periudhës 7 vjeçare, nisur nga konsumi prej 630 ktoe. Konsumi mesatar i energjisë, gjatë periudhës pesëvjeçare përpara 2013, ishte 516 ktoe.


A4.3 Konsumi final i energjisë në sektorin e shërbimeve

Metoda për parashikimin e kërkesës për energji në sektorin e shërbimeve u përdor në mënyrë të ngjashme me atë në sektorin e banesave. Në sektorin e shërbimeve është e mundur të përcaktohen disa nën-sektore. Shumë shpesh shërbimet janë modeluar në total si një sektor, pasi të dhënat ekonomike dhe të energjisë, që lidhen me nën-sektore individuale, janë të disponueshme vetëm në vendet më të zhvilluara ekonomikisht. Burimet e lëndës djegëse për konsum final, që konkurrojnë të mbulojnë nevojat për energji të dobishme në sektorin e shërbimeve në Shqipëri, janë të njëjta si për sektorin e banesave. Përcaktuesi kryesor i nevojave për energji në sektorin e shërbimeve është sipërfaqja totale e ndërtesave dhe objekteve tregtare e publike. Sipërfaqja e vlerësuar është 5 m² për banor dhe parashikohet që deri në 2020 të rritet në 7 m² për banor.

Krahasuar me intensitetet e energjisë të sektorëve të shërbimeve në vendet evropiane, intensiteti i konsumit të nxehtësisë në sektorin e shërbimeve në Shqipëri është në një nivel pak më të ulët sesa intensiteti mesatar i energjisë për vendet në tranzicion. Parashikohet që intensiteti i energjisë i konsumit të energjisë termike do të ulët në mënyrë graduale.

Vlerësohet që për të siguruar ftohjen gjatë muajve me temperatura të larta, aktualisht, rreth 40% e sipërfaqes totale të sektorit të shërbimeve është e pajisur me kondicionerë dhe supozohet që deri në 2040 kjo përqindje do të rritet në 50%. Në periudhën afatgjatë kategoria dominuese në konsumin e energjisë së dobishme për ngrohjen dhe kondicionimin e ajrit, në sektorin e shërbimeve, është kondicionimi i ajrit.

Figura 23 Parashikimi i konsumit final të energjisë në sektorin e shërbimeve



Struktura e konsumit final të energjisë që parashikohet në sektorin e shërbimeve, në periudhën nga 2013 deri në 2020, paraqitet në Figura 23. Përsa i përket banesave, forma dominuese e energjisë është energjia elektrike, e cila pritet të rritet në terma absolute, por me përqindjen e saj në strukturën totale të energjisë që qëndron në nivelin prej 67%. Konsumi mesatar i energjisë në sektorin e shërbimeve, gjatë periudhës pesëvjeçare përpara 2013, ishte 195 ktoe.

A4.4 Konsumi final i energjisë në sektorin e industrisë

Rritja e produktit të brendshëm bruto (PBB) është përcaktuesi më me ndikim i kërkesës për energji në industri. Rritja vjetore e PBB-së së Shqipërisë, nga 2013 deri në 2020, u përcaktua në diskrecionin e FMN-së (Fondi Monetar Ndërkombëtar - Baza e të dhënave të *World Economic Outlook*, Prill 2015) dhe është 3.87%. Aktualisht, PBB-ja për banor në Shqipëri është 3914 USD₂₀₀₅/banor dhe pritet që në 2020 të rritet në 5000 USD₂₀₀₅/banor.

Tabela 54 Rritja e PBB-së së Shqipërisë deri në 2020 (FMN)

	Njësitë	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020



PBB, çmimet konstante	Ndryshimi në përqindje	1.393	2.102	3.029	4.000	4.500	4.500	4.500	4.500
-----------------------------	------------------------------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------

Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar

Përveç rritjes së PBB-së, struktura e PBB-së ka një ndikim të madh tek konsumi i energjisë. Struktura bazë e PBB-së përbëhet nga tre sektorë: primar - bujqësia, dytësor - industria dhe terciar - shërbimet.

Në procesin e zhvillimit të një shoqërie, bujqësia zë një përqindje të konsiderueshme në fazën e hershme të zhvillimit. Në procesin e zhvillimit të mëtejshëm, përqindja e këtij segmenti tkurret, ndërsa përqindja e industrisë rritet. Në ekonomitë e zhvilluara përqindja dominuese i përket shërbimeve, e ndjekur nga industria dhe më pas bujqësia. Për vendet më të zhvilluara të Evropës, përqindja e bujqësisë varion nga 2% deri në 7%, përqindja e industrisë po ulet gradualisht nga 30% në vetëm nën 20% dhe përqindja e shërbimeve arrin mbi 70%. Për vendet në tranzicion, përqindja e bujqësisë në PBB-në totale po ulet në mënyrë të shpejtë, përqindja e shërbimeve po rritet, ndërsa përqindja e industrisë, për disa nga këto vende, është ndërmjet 20% dhe 30% dhe për disa prej tyre ajo rritet nga rreth 10% drejt 20%.

Tabela 55 Struktura e PBB-së në Shqipëri

		2013	2020
PBB totale	miliardë USD ₂₀₀₅	11.35	14.80
Bujqësia	%	22.5	19.8
Miniera	%	5.7	5.7
Prodhimi	%	17.5	18.7
Shërbime	%	52.0	53.2
Spektori energjetik	%	2.4	2.7


Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Kërkimi Global i HSBC-së

Përqindja e bujqësisë në Shqipëri në 2013 është relativisht e lartë dhe deri në 2020 do të ulet nga 22.5% në 20% të PBB-së totale, ndërsa përqindja e industrisë dhe shërbimeve do të rritet.

PBB-ja e industrisë përfshin minierat, sektorin energjetik dhe prodhimin. Prodhimi ka përqindjen dominuese në sektorin e industrisë në Shqipëri dhe pritet të rritet më tej me


zhvillimin e ekonomisë. Në strukturën e PBB-së totale, përqindja e prodhimit në Shqipëri, në 2013, ishte 17.5% dhe kjo është një përqindje relativisht e lartë krahasuar me vendet e zhvilluara ekonomisht. Prandaj, në 2020, rritja e prodhimit pritet të ndalojë në nivelin prej 19%.

Figura 22 Parashikimi i konsumit final të energjisë në industrinë e prodhimit



Konsumi total final i energjisë, në periudhën deri në 2020, pritet të rritet 30%, me energjinë elektrike dhe gazin natyror si të vetmet forma të energjisë, përqindja relative e të cilave në strukturën totale do të rritet, nga 38% në 40% për energjinë elektrike dhe nga 1.6% në 9.4% për gazin natyror, i cili gjendet aktualisht vetëm në disa zona në Shqipëri. Gazi natyror pritet të jetë më gjerësisht i disponueshëm, nga 2020, dhe sektori i industrisë pritet të jetë një konsumator i rëndësishëm nxitës për zhvillimin e tregut të gazit natyror në Shqipëri. Konsumi mesatar në sektorin e industrisë, për periudhën pesëvjeçare deri në 2013, ishte 323 ktoe.

Figura 23 Parashikimi i konsumit final të energjisë në bujqësi dhe ndërtim





Konsumi i energjisë në bujqësi dhe nën-sektori i ndërtimit ka një tendencë të ngjashme, si pjesa e mbetur e sektorit të industrisë, me një rritje të konsumit të energjisë në 2020, në krahasim me 2013, që ishte 32%. Konsumi mesatar për periudhën pesëvjeçare ishte 105 ktoe.

A4.5 Konsumi final i energjisë në sektorin e transportit


Kërkesa për energji në sektorin e transportit llogaritet direkt në aspektin e energjisë finale, si një funksion i kërkesës totale për transportin e udhëtarëve (udhëtar-kilometra) dhe të mallrave (ton-kilometra), ndarja e kësaj kërkesë sipas mënyrave konkurruese (automjet, autobus, aeroplan, kamion, tren etj.) dhe nevojat specifike për energji dhe faktorët e ngarkesës për secilën mënyrë. Për transportin e udhëtarëve, ndarja bëhet për transportin urban (brenda qytetit) dhe transportin ndërqytetës.

Kërkesa totale për transportin llogaritet e ndarë për mallrat dhe udhëtarët, sipas faktorëve makroekonomikë dhe stilit të jetesës.

Në rastin e transportit të mallrave, kërkesa llogaritet si një funksion i kontributit të PBB-së (t-km/USD) nga nën-sektorët e bujqësisë, ndërtimit, minierave, prodhimit dhe shërbimeve dhe nga sektori energjetik. Të dhënat e llogaritura, të ruajtura në model, përfshijnë aktivitetin e përgjithshëm të transportit të mallrave, intensitetet e energjisë të mënyrave të transportit të mallrave dhe konsumin e energjisë së nën-sektorit të transportit të mallrave, sipas mënyrave të transportit dhe llojit të karburantit.

Pritet që, në periudhën 2015 deri në 2020, norma mesatare vjetore e rritjes së treguesit ton-km të jetë 4.5%. Ndarja modale e transportit të mallrave jepet në figurën e mëposhtme.

Figura 24 Ndarja modale e transportit të mallrave






Kërkesa për transportin e udhëtarëve përcaktohet nga popullsia totale, popullsia që jeton në qytetet e mëdha dhe distanca mesatare e udhëtimit, ndërqytetës dhe brenda qytetit, për person.

Të dhënat e llogaritura nga modeli për udhëtimin urban përfshijnë nivelet e aktivitetit të udhëtimit (udhëtar-km), sipas mënyrave të ndryshme të transportit, intensitetet e energjisë të këtyre mënyrave dhe konsumin e energjisë së nën-sektorit të transportit ndërqytetës të udhëtarëve, sipas mënyrës dhe llojit të lëndës djegëse.

Pritet që, në periudhën 2015 deri në 2020, norma mesatare vjetore e rritjes së distancës së udhëtimit në transportin brenda qytetit (km/person/ditë) të jetë 5%. Ndarja modale e transportit urban të udhëtarëve jepet në figurën e mëposhtme.

Figura 25 Ndarja modale e transportit urban (brenda qytetit) të udhëtarëve




Variablat e skenarit kryesor për transportin ndërqytetës të udhëtarëve janë distanca e udhëtimit ndërqytetës për person për vit (pritet që, në periudhën 2015 deri në 2020, norma mesatare vjetore e rritjes të jetë 5.5%), pronësia e automjetit (raporti i popullsisë me numrin total të automjeteve; pritet që, në periudhën 2015 deri në 2020, norma mesatare vjetore e rënies të jetë 0.8% me rënie finale afatgjatë në 3 persona për automjet në 2040), distanca mesatare e udhëtimit për automjet për vit dhe faktorët e ngarkesës.

Bazuar në informacionin e mëparshëm, u llogarit udhëtimi ndërqytetës i kryer me automjete. Pjesa e mbetur e udhëtimit ndërqytetës të udhëtarëve supozohet se kryhet me mënyrat e transportit publik. Udhëtimi ndërqytetës, i ndarë sipas llojeve të automjeteve, jepet në figurën e mëposhtme.


Metodologjia e M&V-së

Figura 26 Ndarja modale e automjeteve në transportin ndërqytetës të udhëtarëve



Në 2020, karburantet dominuese në sektorin e transportit janë parashikuar të jenë nafta me 88% dhe benzina me 11% të konsumit total të energjisë në transport.

Figura 27 Parashikimi i konsumit final të energjisë në transport



A5 Metodologjia e M&V-së

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për zhvillimin e një platforme monitorimi dhe verifikimi (M&V) në Shqipëri (duke ia deleguar këtë detyrë Agjencisë për Eficiencën e Energjisë, pas krijimit të saj).



Për të mbledhur dhe llogaritur të dhënat, sipas metodës PL, nevojitet një platformë integrale e M&V-së. Platformat e M&V-së mbledhin informacion mbi projektet e regjistruara, zbatimin e tyre, kursimet e energjisë, emetimet e CO₂ dhe koston e zbatimit. Kursimet e energjisë mund të vlerësohen madje edhe kur për një projekt të zbatuar janë në dispozicion të dhëna të kufizuara (viti i ndërtimit të ndërtesës, sipërfaqja e ngrohur, viti i zbatimit).

Projekti i financuar nga BE-ja, **multEE**, synon të përmirësojë vazhdueshmërinë dhe cilësinë e planifikimit të politikave për eficiencën e energjisë dhe zbatimin nëpërmjet skemave inovative të monitorimit dhe verifikimit, si dhe nëpërmjet koordinimit të përmirësuar ndërmjet niveleve të ndryshme të administratës.

Qasja e multEE-së ndaj skemave të M&V-së është inovative. Projekti synon të plotësojë platformat e M&V-së, të afta për regjistrimin dhe monitorimin e të dhënave dhe progresit kundrejt objektivave për një numër të caktuar të planeve të politikave energjetike. Kjo qasje është tashmë duke u zbatuar në Kroaci, ku përdorimi i saj për autoritetet kombëtare e rajonale dhe qytetet e mëdha parashikohet në ligjet dhe aktet nënligjore. Në periudhën afatgjatë, një detyrim i tillë ligjor mund të jetë një mundësi për promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të sistemit. Sistemi aktual do të përshtatet dhe zhvillohet më tej në kuadër të multEE-së. Si për projektet që lidhen me PKVEE-në, edhe për masat që lidhen me planet e tjera për eficiencën e energjisë, do të krijohet një ndërfaqe përdoruesi unike, duke ofruar një panoramë të plotë mbi arritjet dhe boshllëqet e mbetura.

MultEE-ja përdor përvojën e fituar nga vetë partnerët e projektit dhe partneri kryesor. Sfidat e identifikuar në terren lidhur me zbatimin e skemave efektive të monitorimit dhe mekanizmave të koordinimit për eficiencën e energjisë i shtyjnë partnerët e multEE-së të bashkojnë forcat për të gjetur zgjidhje efektive.

MultEE-ja synon që sistemet e M&V-së të jenë të afta për të përfshirë, në të njëjtën kohë, masat e zbatuara dhe masat e planifikuara nga plane të ndryshme (PKVEE-të, SEAP-të - Planet e Veprimtë për Energji të Qëndrueshme, etj.), nëpërmjet një mjeti të përbashkët, duke lejuar një proces përsëritës të planifikimit të politikave dhe njohuri më të mira rreth arritjeve të projekteve dhe rezultateve më të mira, përta i përket eficiencës së energjisë dhe/ose pakësimit të CO₂. Në kundërshtim me pjesën më të madhe të skemave ekzistuese të M&V-së, të cilat bazohen në analizën lart-poshtë të statistikave mbi energjinë, koncepti multEE bazohet në mbledhjen e të dhënave sipas metodës poshtë-lart.

Megjithëse, eficiente dhe të dobishme, skemat e M&V-së do të mbeten gjithmonë vetëm mjete. Për të përmirësuar bashkëpunimin, ato duhet të veprojnë si pika fokale për aktorët në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Në të vërtetë, një platformë e integruar M&V kërkon qarkullimin e informacionit të punës dhe krijimin e mekanizmave të koordinimit. MultEE e adreson këtë sfidë nga një këndvështrim që e vendos atë mënjanë nga projektet e tjera në fusha të ngjashme:

- Do të mbulohet zinxhiri i plotë i planifikimit dhe zbatimit, nga ministritë, si adresat kryesore, tek rajonet dhe qytetet.

*Vlerësimi i kursimeve të karbonit*

- Mekanizmat e koordinimit, të zhvilluara në kuadër të multEE-së, nuk mbulojnë as PKVEE-të, as planet lokale/rajonale (d.m.th. SEAP-të), por të gjitha llojet e planeve (për eficiencën) energjetike.
- Me e rëndësishmja, mekanizmat e koordinimit, në kuadër të multEE-së, janë të lidhura me një masë konkrete, zhvillimin dhe zbatimin e një skeme M&V. Në këtë mënyrë, koordinimi mund të vendoset menjëherë në praktikë, duke shkuar përtej përpjekjeve konceptuale të kryera në kuadër të projekteve të tjera.

Në kuadrin e Direktivës për Eficiencën e Energjisë (2012/27/EC), koordinimi efektiv i masave për eficiencën e energjisë po bëhet gjithmonë e më i rëndësishëm, duke inkurajuar zhvillimin e planeve lokale të veprimit për eficiencën e energjisë. Paratë publike të kursyera nga skemat e veçanta të monitorimit dhe moskoherencat mund të përdoren për të mbështetur zhvillimin e atyre planeve, duke përfshirë gjithmonë edhe më shumë qytete në rrugën për një të ardhme më të qëndrueshme të energjisë. Duke miratuar një qasje të integruar, multEE-ja trajton disa hapa të ciklit të politikave.

Më shumë detaje mbi aktivitetet e projektit dhe pikat e kontaktit mund të gjendet në faqen e internetit të projektit: www.multee.eu. **Faqja e internetit është burimi më i plotë i informacionit rreth projekteve dhe materialeve të përgatitura deri tani.**

A6 Vlerësimi i kursimeve të karbonit

Tabela e mëposhtme ofron një vlerësim orientues të kursimeve të pritshme të karbonit, të shoqëruara me zbatimin e masave të ndryshme, në kuadër të kësaj PKVEE-je. Vihet re që për masat të cilat synojnë vetëm energjinë energjike, faktori i supozuar është zero, duke marrë parasysh dominimin e lartë të energjisë hidrike në furnizimin vendas. Ky është një vlerësim i kujdesshëm, pasi Shqipëria është një importues neto i energjisë elektrike dhe vendet e saj fqinje kryesisht e prodhojnë energjinë elektrike nga linjitet. Megjithatë konsiderohet një supozim i arsyeshëm për këtë nivel vlerësimi dhe është në përputhje me atë të përdorur në studimin SLED. Faktorët e tjerë të emetimeve nxirren nga vlerat e paracaktuara IPCC.



Tabela 56 Pasqyra e masave së bashku me vlerësimin e kursimit të karbonit

Nr.	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Kursimet e pritshme të karbonit në 2018 [tCO ₂]	Kursimet e pritshme të karbonit në 2020 [tCO ₂]
R2	Krijimi dhe funksionimi i Fondit të Eficencës së Energjisë neni 19- 24 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë", (2018-2020).	1,170.0	3,291.0
R3	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në funksion të Performancës së Energjisë në Ndërtesa: - metodologjia kombëtare e llogaritjes të PEN - kostos optimale për kërkesat minimale të PEN - përdorimi i sistemeve alternative me efikasitet të lartë për sistemet teknike të ndërtesave.		
R4	Vlerësimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PRIVATE, përcaktimi i kostos optimale për efikasitetin e energjisë për ndërtesat që parashikohet ti nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat për ndërtesa të reja me performancë të lartë.	1,487.0	7,167.0
R5	Vlerësimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PUBLIKE, përcaktimi i kostos optimale për efikasitetin e energjisë për ndërtesat që parashikohet ti nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat për ndërtesa të reja me performancë të lartë.		
R6	Hartimi i skemave mbështetëse financiare për përmirësimin e performancës së energjisë, në veshjen e jashtme të ndërtesave dhe sistemet teknike të ndërtesës.	2,341.0	3,665.0
R7	Hartimi i një planit të veprimit për të rritur numrin e ndërtesave me performancë afër zero-energji.		
R8	Përcaktimi i klases së energjisë për produktet që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë, të cilat përmbushin kërkesat minimale të efikasitetit të energjisë, siç përcaktohet në ligjin 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë" dhe ligjin 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji".		
R9	Certifikimi energjetik i ndërtesave	-	-



R10	Rinovim i stokut të ndërtesave publike me 2% cdo vit të sipërfaqes së ngrohur/ftohur për ndërtesat që janë në administrim ose përdorim nga një autoritet publik ose nga institucionet që sigurojnë një shërbim ndaj publikut, me qëllimin për përmbushjen e kërkesave minimale të performancës së energjisë.	2,000.0	4,913.0
P1	Programi 'Ndriçimi Publik me Eficiencë të Energjisë'	-	-
P2	Miratimi i rregullave për Prokurimet publike 'të gjelbra' me fokus ndërtesat publike	-	-
I1	Kërkesat minimale të eficiencës së energjisë për proceset industriale dhe skemat detyruese.	-	-
I2	Auditimet energjetike për ndërmarrjet industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, të cilët, sipas skemes detyruese, nënshkruajnë marreveshje vullnetare në përputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë".	-	-
I3	Marrëveshjet vullnetare për ndërmarrjet industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, të cilët, nënshkruajnë marreveshje vullnetare në përputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë".	3,148.0	6,009.0
T1	Trajnim për drejtimin e automjetit në mënyrë eficiente (eco-driving)	293.0	732.0
T2	Fushatat e informimit dhe edukimit	3,683.0	9,208.0
T3	Promovimi i transportit të integruar	15,540.0	22,865.0
T4	Etiketimi energjetik i automjeteve të reja	-	10,827.0
T6	Stimujt financiarë për automjetet me eficiencë të energjisë	4,211.0	10,527.0
T7	Transporti intermodal i udhëtarëve dhe i mallrave	-	16,360.0
T8	Modernizimi i sistemit të semaforëve dhe futja e menaxhimit të automatizuar të trafikut	24,749.0	92,655.0
H1	Faturimi informativ, .Fushatat e ndërgjegjësimit, Edukimi dhe trajnimi për eficiencën e energjisë.	-	-
H2	Promovimi i Kontraktimit të Performancës Energjetike dhe Shërbimeve Energetike	-	-
H3	Udhë-treguesi për Auditimet dhe menaxhimin e energjisë për konsumatorët e mëdhenj të energjisë	-	-
H4	Krijimi i një sistemi të integruar informacioni për monitorimin, verifikimin dhe zbatimin e politikave për eficiencën e energjisë	-	-
H5	Raportet e auditimit dhe Ndërhyrjet për përdorim me eficiencë të energjisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.	-	-
	Totali për 2018/2020	58,622.00	188,219.00



Përmbledhja e kërkesave për financime publike

A7 Përmbledhja e kërkesave për financime publike

Zbatimi i masave të propozuara për EE-në në Shqipëri, do të varet nga atraktiviteti i kostos së atyre masave, në krahasim me koston e energjisë në mungesë të tyre. Konkurrueshmëria e kostos do të varet nga çmimet e tregut, subvencionet, politikat dhe sjellja e vendimet e konsumatorit. Parashikimet e penetrimit të teknologjive të ndryshme në treg dhe vendimet e konsumatorit janë çështje që po fitojnë terren në modelimin e politikave energjetike dhe qarqet vendimmarrëse në BE, megjithatë ende nuk janë publikuar kërkitime të mjaftueshme për të kryer analizë gjithëpërfshirëse. Në të vërtetë, masat specifike në kuadër të kësaj PKVEE-je mund t'i nënshtrohen veçmas vlerësimeve të plota të ndikimit rregullator për të vlerësuar kostot neto për zbatimin e tyre, si për sektorin publik ashtu edhe atë privat.

Tabelat e mëposhtme paraqesin një vlerësim të kostove direkte nga buxheti publik për masat e propozuara, kur vlerësime të tilla janë të mundura. Për më tepër, masat e propozuara përfshijnë aktivitete të cilat kanë përfitime të konsiderueshme më të gjera sesa efienca e energjisë, veçanërisht në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe furnizimit me ujë, dhe prandaj një krahasim direkt i efektivitetit të kostos ndërmjet masave mund të jetë çorientues.

Tabela 14 Pasqyra e masave në energjinë primare së bashku me vlerësimin e zbatimit të tyre

Nr.	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Kosto e vlerësuar për sektorin publik, milion ALL	Entiteti përgjegjës
E1	Rivitalizimi i hidrocentraleve ekzistuese	30'800	KESH
E2	Zëvendësimi i transformatorëve jo eficientë Instalimi i nënstacioneve dhe linjave të reja.	16'800	OST/OSHEE
E3	Ulja e humbjeve fikse në transformatorë dhe Optimizimi i konfigurimit të rrjetit TM	Nuk është vlerësuar	OSHEE



Tabela 15 Pasqyra e masave në energjinë finale së bashku me vlerësimin e zbatimit të tyre

Nr.	Emërtimi i masës për kursimin e energjisë	Kosto e vlerësuar për sektorin publik, milion ALL	Entiteti përgjegjës
R1	Krijimi dhe funksionimi i Agjencisë për Eficencën e Energjisë, neni 25 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë", (2018-2020).	345.0	MEI/MF
R2	Krijimi dhe funksionimi i Fondit të Eficencës së Energjisë neni 19- 24 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë", (2018-2020).	215.0	MEI/MF
R3	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në funksion të Performancës së Energjisë në Ndërtesa: - metodologjia kombëtare e llogaritjes të PEN - kostos optimale për kërkesat minimale të PEN - përdorimi i sistemeve alternative me efikasitet të lartë për sistemet teknike të ndërtesave.	28.0	MEI/ AEE
R4	Vlerësimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PRIVATE, përcaktimi i kostos optimale për efikasitetin e energjisë për ndërtesat që parashikohet ti nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat për ndërtesa të reja me performancë të lartë.	36.7	MEI/ AEE
R5	Vlerësimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe strategjia e për rinovimin e stokut të ndërtesave PUBLIKE, përcaktimi i kostos optimale për efikasitetin e energjisë për ndërtesat që parashikohet ti nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe rregullat për ndërtesa të reja me performancë të lartë.	33.6	MEI/ AEE
R6	Hartimi i skemave mbështetëse financiare për përmirësimin e performancës së energjisë, në veshjen e jashtme të ndërtesave dhe sistemet teknike të ndërtesës.	14.0	MEI/AEE Fondi për EE-në)/MZHU
R7	Hartimi i një planit të veprimit për të rritur numrin e ndërtesave me performancë afër zero-energji.	28.0	MEI/ AEE MZHU



R8	Përcaktimi i klases së energjisë për produktet që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë, të cilat përmbushin kërkesat minimale të efikasitetit të energjisë, siç përcaktohet në ligjin 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë" dhe ligjin 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji".	14.0	MZHEETS/ MEI/AEE
R9	Certifikimi energjetik i ndërtesave	-	MEI/AEE
R10	Rinovim i stokut të ndërtesave publike me 2% cdo vit të sipërfaqes së ngrohur/ftohur për ndërtesat që janë në administrim ose përdorim nga një autoritet publik ose nga institucionet që sigurojnë një shërbim ndaj publikut, me qëllimin për përmbushjen e kërkesave minimale të performancës së energjisë.	5,600.0	MZHU/MIE (AEE)/Fondi për EE- në/Pushteti Vendor
P1	Programi 'Ndriçimi Publik me Efiçencë të Energjisë'	-	MIE (AEE)/Fondi për EE-në/Pushteti Vendor
P2	Miratimi i rregullave për Prokurimet publike 'të gjelbra' me fokus ndërtesat publike	28.0	MEI/AEE /Fondi për EE-në/MM/ MEF
I1	Kërkesat minimale të efikasitetit të energjisë për proceset industriale dhe skemat detyruese.	36.7	MIE (AEE)
I2	Auditimet energjetike për ndërmarjet industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, të cilët, sipas skemes detyruese, nënshkruajnë marrëveshje vullnetare në përputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë".	153.0	MIE (AEE)/Fondi për EE-në
I3	Marrëveshjet vullnetare për ndërmarjet industriale të kategorizuara si konsumatorë të mëdhenj të energjisë, të cilët, nënshkruajnë marrëveshje vullnetare në përputhje me nenin 12 të ligjit 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë".	9.8	MIE (AEE)
T1	Trajnim për drejtimin e automjetit në mënyrë eficiente (eco-driving)	3.5	MTI (e mbështetur nga AEE)
T2	Fushatat e informimit dhe edukimit	56.0	MTI (e mbështetur nga AEE)
T3	Promovimi i transportit të integruar	1,288.0	Pushteti Vendor/MTI /mbështetur nga AEE
T4	Etiketimi energjetik i automjeteve të reja	-	MTI & MM/ mbështetur nga AEE



T6	Stimujt financiarë për automjetet me eficiencë të energjisë	1,400.0	MTI/Fondi për EE-në/Pushteti Vendor
T7	Transporti intermodal i udhëtarëve dhe i mallrave	-	MTI
T8	Modernizimi i sistemit të semaforëve dhe futja e menaxhimit të automatizuar të trafikut	798.0	Pushteti Vendor/MTI/mbështetur nga Fondi për EE-në
H1	Faturimi informativ, Fushatat e ndërgjegjësimit, Edukimi dhe trajnimi për eficiencën e energjisë.	42.0	MEI/AEE
H2	Promovimi i Kontraktimit të Performancës Energjetike dhe Shërbimeve Energetike	14.0	MEI/AEE
H3	Udhe-treguesi për Auditimet dhe menaxhimin e energjisë për konsumatorët e mëdhenj të energjisë	33.6	MEI/AEE
H4	Krijimi i një sistemi të integruar informacioni për monitorimin, verifikimin dhe zbatimin e politikave për eficiencën e energjisë	140.0	MEI/AEE
H5	Raportet e auditimit dhe Ndërhyrjet për përdorim me eficiencë të energjisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.	3,920.0	MTI (e mbështetur nga AEE)/Fondi për EE-në)
	Totali për 2018/2020	14,236.90	

Formati 61x86/8

Shtypshkronja KRISTALINA
Tiranë, 2017

Çmimi 1540 lekë